



Qeveria e Kosovës
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



Instituti për Planifikim Hapësinor

KOSOVA shtëpia JONË

PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR
2010-2020+

Prishtinë
Qershor, 2010





Kosova shtëpia jonë

Plani Hapësinor i Kosovës
2010 - 2020+



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Dokument i përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor
në bashkëpunim me sektorët tjerë të Qeverisë së Kosovës.

Prishtinë, Qershor 2010.

Vërejtje!

Versioni kompetent i dokumentit është versioni në gjuhën shqipe.



Parathënie

Plani Hapësinor i Kosovës është dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor i cili është ndërtuar në bashkëpunim me të gjitha sektorët e rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe profesionist të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, universiteti, organizata të ndryshme joqeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të nivelit lokal dhe pa dyshim, shumë e rëndësishme ka qenë ndihma dhe përkrahja që është ofruar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Dokumenti i ofruar është versioni plotësuar i cili për bazë ka dokumentin që në parim është aprovuar në Kuvendin e Kosovës. Për shkak të ndryshimeve politike që për rrjedhojë kanë sjellë edhe ndryshime tjera hapësinore, ka qenë e domosdoshme ndërmarrja e aktiviteteve shtesë për harmonizimin dhe plotësimin e tij.

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, është krijuar një bazament krejtësisht i ndryshëm që kërkon qasje dhe veprim sinergjik në të gjitha fushat që ndikojnë në zhvillimin e vendit. Me këtë dokument Kosova në mënyrë të pavarur orienton kahen e zhvillimit, rregullimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të territorit të vet.

Plani Hapësinor i Kosovës është dokument që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të të gjithë qytetarëve që jetojnë në të. Gjithëpërfshirja, zhvillimi i baraspeshuar dhe i qëndrueshëm, promovimi i transparencës së plotë në planifikim, janë disa nga parimet që dëshmojnë se dokumenti është në përputhje me standardet kryesore që dalin nga ligjet e vendit dhe rregullativa ligjore evropiane.

Zhvillimi i ofruar policentrik është garant i zhvillimit të barabartë të të gjitha rajoneve, komunave dhe zonave rurale në Kosovë. Me shumë kujdes janë shfrytëzuar potencialet e shumta dhe karakteristike për rajonet, që paraqesin bazë të mirë për zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë vendit.

Pozita strategjike dhe zhvillimet e propozuara në dokument, e paraqesin Kosovën si vend të inkorporuar në rajon, me tendencë të përforcimit të lidhjeve tradicionale me fqinjët dhe me synim të integritit të saj edhe në Bashkësinë e Shteteve Evropiane. Lidhjet rrugore dhe zhvillimet e parapara ndërkufitare janë dëshmi e gatishmërisë tonë, në përforcimin e bashkëpunimit dhe harmonizimit të veprimeve, që do të ndikojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm të rajonit.

Duke qenë të vetëdijshëm për situatën e vështirë ekonomike dhe problemet e shumta që po ballafaqohet vendi ynë, jemi të sigurt që dokumenti i ofruar i zhvillimit të përgjithshëm hapësinor për Kosovën, është bazë e mirë nga e cila mund dhe duhet të fillojnë zgjidhjet e problemeve të trajtuara. Prandaj, për arritjen e implementimit të tij do të na duhet gjithsesi ndihma e të gjithëve, në mënyrë që bashkërisht të ndikojmë në ndërtimin e mjedisit më kualitativ jetësorë për të gjithë qytetarët e Kosovës.



Dardan Gashi

Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PËRMBAJTJA

Hyrje	9
Roli dhe bazueshmëria e planit hapësinor	9
Procesi i hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës	10
Pjesëmarrja publike	11
Konsultimet publike	11
Indeksi i terminologjisë	13
I. Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes	19
Profili i zhvillimit hapësinor	19
Kosova - Të dhënat themelore	19
Demografia dhe zhvillimi social	20
Banimi, shpërndarja e lokaliteteve	30
Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës	35
Uji	37
Toka	41
Pyjet	48
Pasuria nëntokësore	49
Trashëgimia kulturore dhe natyrore	51
Vërshimet	52
Erozioni	55
Sizmiciteti	56
Zhvillimi ekonomik	58
Bujqësia	59
Industria	61
Tregtia	63
Zejtaria	66
Turizmi	66
Energjetika	67
Zhvillimi i pabarabartë ekonomik	71
Infrastruktura teknike	72
Transporti dhe infrastruktura e tij	73
Transporti automobilistik	73
Transporti hekurudhor	74
Transporti ajror	75
Telekomunikacioni	75
Infrastruktura e energjetikës	78
Infrastruktura ujore	80
Shfrytëzimi i ujit	80
Rregullimi i regjimit të ujërave	80
Mbrojtja e ujërave nga ndotja	81
Deponitë e mbeturinave	82
Potencialët për zhvillimin e infrastrukturës teknike	83
Skenari i trendit	83
Konteksti në rajon dhe Evropë	85

Kosova dhe fqinjët	85
Iniciativat në Evropën Juglindore	85
Strategjitë e sektorëve të Qeverisë së Kosovës	85
Vlerësimi i gjendjes në Kosovë	89
Analiza SËOT	89
Vlerësimi i kapaciteteve investive	92
Projeksionet sektoriale dhe burimet e investimeve	93
Investimet publike (qeveritare)	94
Projeksionet e burimeve të investimeve	95
Sfidat e zhvillimit hapësinor	97
Ekonomia dhe punësimi	97
Trashëgimia dhe zhvillimi i qëndrueshëm	100
Shfrytëzimi joracional i hapësirës	102
Mjedisi jokualitativ jetësor	104
Niveli i ultë i shëndetësisë dhe arsimit	107
Shkalla e lartë e varfërisë	111
Standardet, normat dhe principet	115
II. Vizioni, parimet dhe caqet	117
Deklarata e vizionit për të ardhmen e Kosovës	117
Parimet e përgjithshme për zhvillim/mbrojtje	117
Caqet zhvillimore afatgjata	118
Prioritetet strategjike	119
III. Korniza e zhvillimit hapësinor	121
Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor	121
Struktura hapësinore e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm	122
Zhvillimi socio-ekonomik	122
Shpërndarja dhe zhvillimi i vendbanimeve	123
Struktura e rrjetit të vendbanimeve	125
Qendrat e mëdha	126
Qendrat e vogla	127
Fshatrat	127
Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit	127
Zonat me interes të veçantë për Kosovën	130
Zonat e Veçanta të Mbrojtura.....	130
Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit	131
Struktura hapësinore në Kosovë	133
Thesari i Kosovës(Hapësira e Gjelbër)	133
Porti i Kosovës(Hapësira e Kaltër)	136
Urat e Kosovës(Hapësira e Verdhë)	141
Kopshti i Kosovës(Hapësira e Portokalltë)	145
Urat e Kosovës(Hapësira e Verdhë)	149
Kopshti i Kosovës(Hapësira e Portokalltë)	153
IV. Strategjia, veprimet për zbatim	157
Veprimet, aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave	157
Zhvillimi social	157

Arsimi	157
Shëndetësia	158
Gjendja jo e kënaqshme dhe qasja e vështirësuar në banim	159
Zhvillimi ekonomik	160
Papunësia e lartë	160
Shkalla e lartë e varfërisë	160
Zhvillimi i pabarabartë ekonomik	161
Kualiteti i zhvillimit në zonat urbane	161
Vendbanimet me zhvillim të pamjaftueshëm	162
Vendbanimet joformale	163
Humbja e tokës bujqësore	164
Krijimi i një fondi të qëndrueshëm blegtoral	166
Zhvillimi i sektorëve të vreshtarisë dhe pemëtarisë	167
Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit, resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore	168
Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit	178
Vlerësimi i strategjisë	181
V. Dispozitat për zbatim	183
Dispozitat e përgjithshme	183
Kushtet e ndarjes së hapësirës sipas karakteristikave të shfrytëzimit dhe destinimit	183
Kushtet e caktimit të hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën	183
Kushtet e vendosjes së veprimtarive ekonomike në hapësirë	184
Kushtet e vendosjes së veprimtarive publike në hapësirë	184
Kushtet për caktimin e zonave ndërtimore	184
Kushtet e përcaktimit të sistemeve të komunikimit dhe infrastrukturës tjetër në hapësirë	185
Masat e ruajtjes së peizazheve	186
Masat e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike	187
Mënyra e trajtimit të hedhurinave	187
Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis	188
Masat e zbatimit	188
Karakterit obligativ i hartimit të dokumentit të rregullimit hapësinor	188
Literatura	189
Organizimi dhe pjesëmarrësit	190

HYRJJE

Planifikimi hapësinor është planifikimi i hapësirës fizike e cila na rrethon: hapësira ku janë të ndërtuara shtëpitë tona, hapësira në zonat urbane dhe rurale, hapësira në të cilën janë vendet tona të punës, hapësirat e rrugëve, infrastrukturës dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Planifikimi Hapësinor në Kosovë, edhe pse si aktivitet institucional është zhvilluar që nga periudha e pas luftës së Dytë Botërore, në praktikë nuk shquhet me ndonjë rezultat të dukshëm. Me vendosjen e Kornizës Ligjore të planifikimit hapësinor-Ligji për Planifikim Hapësinor dhe aktet nënligjore, është bërë hap i madh drejt trendëve aktuale të legjislacionit në fushën e planifikimit në Evropë.

Aktualisht, trendët e zhvillimeve në hapësirën e Kosovës nuk janë të volitshme. Ato karakterizohen me probleme të mëdha të ndërtimeve të shumta ilegale, të cilat shkaktojnë probleme në infrastrukturë dhe shërbimet i bëjnë më të shtrenjta.

Hapësira ka rëndësi kyçe për zhvillimin e një shoqërie, e cila ndikon në përcaktimin e prioriteteve për investime, për të cilat nuk mund të vendoset brenda natës, prandaj, konsiderojmë se është koha e fundit për fillimin e një procesi të tillë të planifikimit.

Ngritja e institucioneve vendore të planifikimit në nivelin qendror dhe lokal shikohet si element qenësor në organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së planifikimit.

Ligji për Planifikim Hapësinor, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur nga PSSP të KB, më 10 shtator 2003, përcakton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si subjekt bartës i përgjegjësisë për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës. Brenda kësaj ministrie është themeluar Departamenti për Planifikim Hapësinor që do të merret me politikën e planifikimit, implementimin e programeve të nivelit qendror dhe monitorimin e zhvillimeve në hapësirë. Po ashtu është themeluar edhe Instituti për Planifikim Hapësinor, si njësi e Ministrisë, që do të merret me hartimin e dokumenteve të planifikimit, hulumtimin e trendëve të zhvillimeve hapësinore dhe me krijimin e bazës së të dhënave hapësinore.

1. ROLI DHE BAZUESHMËRIA E PLANIT HAPËSINOR

Plani Hapësinor i Kosovës është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Përpilimi i Planit Hapësinor të Kosovës ndihmon shtrirjen hapësinore të zhvillimeve, të nivelit kombëtar, komunale e urbane, përpilimin e Strategjisë së Përgjithshme Zhvillimore të Kosovës. Plani Hapësinor duhet të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e qeverisë në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për investime publike të cilat kanë dimension të theksuar hapësinor ose mund të ndikohen nga hapësira;

- Udhëzohet aprovimin e politikave lidhur me investimet strategjike në infrastrukturë, posaçërisht në transport dhe telekomunikime, pastaj politikave lidhur me vendosjen e zhvillimit të industrisë, banimit, shërbimeve, zhvillimit rural, turizmit dhe trashëgimisë natyrore e kulturore;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave të zhvilluara dhe zonave me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Përcaktojë lokacionet strategjike të cilat do t'i favorizonin jo vetëm zonat urbane por dhe ato rurale;
- Identifikojë rolin e qyteteve kryesore në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të Kosovës;
- Po ashtu, plani hapësinor duhet të jetë udhëzues në hartimin e planeve tjera zhvillimore - komunale dhe lokale.
- Vendosë principet gjenerale të praktikës së mirë të planifikimit hapësinor, për të mundësuar që vendosja së popullsisë, punësimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore t'i shërbejë më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe kualitetit më të mirë të jetës.

Sipas nenit 11.3. të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, plani hapësinor i Kosovës është plan strategjik multisektorial i cili:

- Bazohet në vizionin dhe caqet strategjike të propozuara nga Ministria nëpërmes pjesëmarrjes publike;
- Bazohet në raportet e sektorëve të rëndësishëm të përgatitura nga ministritë kompetente të Qeverisë së Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë;
- Bazohet në parimet ndërkombëtare të planifikimit hapësinor, zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë me qëllim të harmonizimit të zhvillimit me vendet fqinje dhe vendet evropiane.

2. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT HAPËSINOR TË KOSOVËS

Dokumenti i ofruar është plotësim i draft-dokumentit Plani Hapësinor i Kosovës 2005 - 2015+, i cili është aprovuar në parim në Kuvendin e Kosovës në seancën e mbajtur në Janar 2007.

Plani hapësinor, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, duhet të krijojë kushte për sigurimin e lokacioneve për investimet kapitale të zhvillimit ekonomik, të përmirësojë shërbimet e infrastrukturës dhe të mbrojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore.

Korniza e procesit të planifikimit hapësinor e aprovuar në Korrik të vitit 2003, parasheh proces të gjerë të pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm gjatë hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës. Sipas kësaj kornize procesi është i ndarë në 4 faza:

- KU JEMI - Sfidat e zhvillimit hapësinor;
- KU DËSHIROJMË TË SHKOJMË - Vizioni dhe caqet strategjike;
- SI TE SHKOJMË - Strategjia e zhvillimit hapësinor dhe
- SI TË BINDEMI SE KEMI ARRITUR - Monitorimi dhe evaluimi

Në fillim të procesit të hartimit të planit, korniza e procesit të hartimit të planit hapësinor të Kosovës është diskutuar me Kryeministrin dhe Ministrat e Qeverisë së Kosovës, si dhe me Kryetarin e Parlamentit për të marrë përkrahjen e tyre për bashkëpunimin institucional gjatë procesit.

Janë themeluar grupet punuese ndërministrore të përbëra nga zyrtarë përgjegjës të sektorëve të ndryshëm të institucioneve të Kosovës. Me punë të përbashkët në këto grupe punuese janë përcaktuar çështjet dhe temat të cilat do t'i trajtojë plani hapësinor dhe janë përfunduar raportet sektoriale të sektorëve të Qeverisë së Kosovës, të cilat kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e zhvillimeve në hapësirë të sektorëve përkatës.

Grupet punuese ndërministrore në fazën e tretë të planit janë zgjeruar me profesionistë të lëmive të ndryshme, kryesisht nga institucionet e arsimit të lartë, kompetentë për çështjet dhe temat të cilat i trajton plani.




2.1. PJESEMARRJA PUBLIKE

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj, e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së UN-HABITAT, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në fazën përgatitore për hartimin e Planit Hapësinor, në mënyrë që parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga shoqëria kosovare.

Në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor, Plani Hapësinor është plan multisektoral, i cili merr parasysh raportet dhe strategjitë e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë. Involvimi i të gjithë pjesëmarrësve, të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga Plani është esenciale për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Hapësinor.

Më poshtë është skema e përgjithshme e procesit të hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës dhe ndërlidhja e tij me dokumentet tjera zhvillimore të cilat i nxjerrë Qeveria e Kosovës.



► Skema e procesit të hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës

2.2. KONSULTIMET PUBLIKE

Në të gjitha fazat e planit, janë mbajtur edhe konsultimet publike ku janë diskutuar dokumentet të cilat paraqesin përfundimin e fazave të planit - Sfidat e zhvillimit hapësinor, Vizioni dhe caqet strategjike si dhe strategjia e zhvillimit hapësinor. Diskutimet dhe komentet nga këto takime kanë shërbyer për ta përparuar dokumentin si dhe për të marrë përkrahjen për procesin e hartimit të planit.

1. Konsultimet publike mbi sfidat e zhvillimit hapësinor - Në periudhën prej 08 - 29 qershor 2004, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka organizuar konsultimet publike për sfidat zhvillimore të Kosovës, në bashkëpunim me UN - HABITAT -in, Institutin për Studime të Banimit dhe Zhvillimit Urban të Roterdamit, Holanda, si dhe Institutin Rajonal për Hulumtime Zhvillimore - RIINVEST Kosovë. Konsultimet janë mbajtur në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës, në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe në Prishtinë.

Përfaqësues të Kuvendeve Komunale, Institucioneve të ndryshme, shoqërisë civile - OJQ-të vendore dhe ato ndërkombëtare kanë qenë pjesëmarrës në këto konsultime publike, Përfaqësues nga ndërmarrjet private, Qytetarë, Intelktualë, Biznesmen etj. Qëllimi i organizimit të këtyre takimeve konsultative publike dhe me ftesë për pjesëmarrje të të gjitha strukturave vendore dhe të qytetarëve ka qenë: njoftimi i tyre për punën e deritanishme të bërë në hartimin e profilit të Planit Hapësinorë për Kosovën, njoftimi me përmbajtjen e këtij dokumenti dhe me hapat pasues të tij, pastaj identifikimi i gjendjes aktuale në vendbanimet e tyre, identifikimi i sfidave nga ana e tyre dhe deklarimin e kërkesave të tyre, te cilat do të ndihmonin në koordinimin dhe harmonizimin e synimeve të mëturjeshme për arritjen e zgjidhjes së

më optimale të zhvillimit hapësinorë të Kosovës, si dhe shprehjen e vizionit për të ardhmen e vendit.

Në të gjitha këto takime ka pasur pjesëmarrje të kënaqshme të pjesëmarrësve, me ç'rast ata kanë shprehur opinionet e tyre, sugjerimet, vështirësitë me të cilat ballafaqohen në vendbanimet e tyre, sfidat dhe vërejtjet për të ardhmen etj. Numri i përafërt i pjesëmarrësve në këto takime ka qenë rreth 600.

2. Procesi konsultativ është pasuruar me konsultimet me grupet e ndryshme të interesit. UN-Habitati ka organizuar takimet me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile; shoqatat e personave me aftësi të kufizuara, shoqatat e grave, shoqatat e biznesit, shoqatat mjedisore, studentët. Pjesëmarrësit në këto takime kanë shprehur interes për përmirësimin e kualitetit të jetës së banorëve të Kosovës.
3. Instituti RIINVEST ka organizuar dy raunde të diskutimit lidhur me aspektet e zhvillimit ekonomik në procesin e planifikimit. Lidhur me sfidat e zhvillimit ekonomik të Kosovës, është diskutuar me individë dhe organizata të ndryshme, studentë, biznesin, profesionistë të planifikimit. Raundi tjetër i diskutimit është zhvilluar me të njëjtët aktorë në lidhje me kapacitetet investive të aktorëve të ndryshëm - BKK, donatorëve dhe sektorit privat. Këto diskutime kanë shërbyer për të pasqyruar mundësitë e investimeve kapitale në Kosovë dhe raporti i tyre me hapësirën në të cilën ato mund të realizohen.
4. Konsultimet publike për Vizionin caqet dhe parimet e zhvillimit hapësinor janë mbajtur në dy raunde - më 16 Qershor 2005 dhe 13 Korrik 2005. Janë diskutuar vizioni, qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit hapësinor të Kosovës, si dhe kriteret për vlerësimin e strategjisë së zhvillimit hapësinor. Në këto takime, pjesëmarrësit kanë qenë më aktiv, duke kontribuar në pasurimin e dokumentit. Në raundin e dytë diskutimi ka qenë i hapur në formë të forumit. Ka patur edhe diskutime në të cilat janë paraqitur edhe opsione të kundërta lidhur me shumë çështje të trajtuara në plan, opsione të cilat kanë ndikuar që çështjet e kontestuara të rishikohen edhe një herë.

Takimet publike kanë qenë njëditore të karakterit informativ-punues, zakonisht me agjendë të ndarë në dy pjesë, sesion plenar i cili zhvillohej gjatë sesionit të paradites, duke vazhduar me pjesën punuese të zhvilluar gjatë sesionit të pasdites.

Procesi i konsultimeve ka shërbyer për sensibilimin e popullatës dhe aktorëve tjerë për rëndësinë e planifikimit, rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje në mënyrë që të sigurohet mbështetja për planin. Në këtë mënyrë, pjesëmarrësit do të fitonin edhe një përvojë të pjesëmarrjes e cila mund të përparohet gjatë procesit të hartimit të planeve tjera.

Procesi i konsultimeve, edhe pse jo i realizuar në tërësi sipas parashikimeve në kornizë e procesit të hartimit të planit hapësinor, ai megjithatë ka qenë i suksesshëm në pikëpamje të demokratizimit dhe transparencës në vendimmarrje. Po ashtu, të gjithë të interesuarve u është dhënë mundësia e komentimit dhe propozimit për çdo gjë që është konsideruar se duhet të ndryshohet dhe përparohet.





INDEKSI I TERMINOLOGJISË

“Plani hapësinor”	Nënkupton planin për rregullimin, shfrytëzimin dhe zhvillimin e hapësirës siq është: territori i komunës, zonës së veçantë dhe territorit të Kosovës. Ky plan përshkruan afatet kohore dhe përfshinë projeksionet reale të investimeve.
Plani Hapësinor i Kosovës	Dokument në të cilin është i përshkruar zhvillimi i ardhshëm hapësinor i Kosovës
“Vendbanim”	Nënkupton zonën me karakter urban, qyteti dhe vendbanimi tjetër të cilin kuvendi i komunës e ka shpallur me karakter banimi;
“Qytet”	Nënkupton vendbanimin të cilin kuvendi i komunës, duke marrë për bazë shkallën e ndërtimit, veprimtaritë dhe karakteristikat tjera të karakterit urban, e kanë përcaktuar si të tillë;
”Plani rregullues urban”	Lloji i planit i përshkruar në nenin 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor
“Shfrytëzimi i tokës”	Nënkupton destinimin ekzistues ose të propozuar për të cilën parcela e tokës shfrytëzohet;
“Zonë urbane”	Është toka me kufinjë të përcaktuar brenda suazave të së cilës është planifikuar ndërtimi urbanistik;
“Fshati”	Është vendbanimi në të cilin popullsia kryesisht merret me veprimtari bujqësore;
“Tokë bujqësore”	Është toka e destinuar për kultivimin e kulturave bujqësore;
“Ministria”	Nënkupton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
“Dokumentacioni urbanistik”	Është tërësia e dokumenteve të cilën e përbëjnë: plani hapësinor, përkatësisht urbanistik; leja urbanistike; pëlqimi urbanistik; analizat, studimet dhe dokumente të tjera të hartuara në kuadër të punëve përgatitore për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës dhe që përmbajnë shënime mbi shfrytëzimin aktual dhe të mundshëm të territorit;
“Plani i infrastrukturës ”	Është paraqitja me plan e instalimeve dhe objekteve ekzistuese dhe të planifikuara nëntokësore dhe mbitokësore nga lëmi i: transportit, instalimeve elektrike, gazsjellësit, naftësjellësit, furnizimit me ujë dhe sistemet e ujërave të përdorura, telekomunikacionit dhe i instalimeve tjera;
“Toka ndërtimore”	Është toka në të cilën janë ndërtuar objektet në përputhje me planin rregullativ, përkatësisht urbanistik, ose me aktin tjetër të nxjerrë në bazë të këtij ligji është paraparë për ndërtimin e objekteve;
“Parcela ndërtimore”	Është toka e parashikuar për ndërtimin e objekteve të përfshira me plan, që përbëhet nga një ose më shumë ngastra kadastrale ose pjesë të tyre;



“Lokacioni”	Është vendi në të cilin kryhen punimet ndërtimore në përputhje me planin e caktuar ose me aktin tjetër të nxjerrë në bazë të këtij ligji;
“Ngastër Kadastrale”	Janë sipërfaqet e tokave bujqësore, pyjore, kullosa, të regjistruara në regjistrat kadastral;
“Vijat e rregullimit”	Nënkuptojnë vijën kufizuese në mes të ngastrës së ndërtimit dhe të drejtës së shfrytëzimit të rrugës publike;
“Vijat e ndërtimit”	Nënkupton vijën kufizuese cila definojnë se ku është i lejuar ndërtimi në ngastrën ndërtimore;
“Normat urbanistike”	Janë normat e planifikimit hapësinor, kushtet dhe rregullat e përdorura gjatë hartimit të dokumentacionit të planifikimit;
“Normat urbanistike-teknike”	Janë kushtet hapësinore ose teknike që përcaktojnë pozitën, raportet reciproke të infrastrukturës së ndërtesave dhe sigurinë e ndërtesave;
“Sipërfaqe e mbrojtur”	Janë sipërfaqet e vlerave të mbrojtura natyrore dhe mjedisore si dhe sipërfaqet bujqësore, trashëgimia e paluajtshme kulturore dhe arkeologjike;
“Zonë e mbrojtur”	Është pjesa e hapësirës e cila caktohet me qëllim të ruajtjes të vlerave natyrore, kulturore-historike dhe arkeologjike, të mbrojtjes nga ndotja të mjedisit jetësor ose siguri i kushteve hapësinore për ushtrimin pa pengesë të veprimtarisë dhe siguria e banorëve dhe e hapësirës për rreth;
“Punët përgatitore të planifikimit”	Janë kërkimet, analizat, përgatitja e të dhënave, informatave, dhe përkrahja teknike për nevojat e hartimit të dokumentacionit urbanistik;
“Kushtet e ndërtimit”	Janë kushtet që e përcaktojnë llojin, madhësinë, mënyrën e ndërtimit, kushtet e sigurisë dhe çdo kusht tjetër për ndërtimin e objekteve;
Profili i zhvillimit hapësinor	Dokument i cili përshkruan gjendjen ekzistuese të zhvillimit hapësinor në Kosovë. Më detajisht është i përcaktuar me UA për elementet e PHK;
Vlerësimi i kapaciteteve investive	Analizë e cila përshkruan kapacitetet ekzistuese për investim në të ardhmen, përfshirë të gjitha aspektet dhe mundësitë e investimit duke filluar nga resurset ekzistuese natyrore, resurset humane, buxheti vendor, sektori privat, organizatat ndërkombëtare financiare;
SËOT analiza (përparësitë, mangësitë, mundësitë dhe rreziqet)	Analiza e Përparësive, Mangësive, Mundësive dhe Kërcënimeve (PMMK), ndihmon që çështjet e shfaqura (të identifikuar) të klasifikohen në njërin nga këto katër grupe dhe të menaxhohen më lehtë në procesin e planifikimit;
Analiza e lidhjeve	Analizë përmes së cilës kërkohen lidhjet e mundshme në mes të dy dukurive, strategjive apo projekteve për të njëjtin rajon gjeografik, apo lokacion më të ngushtë i cili është duke u shqyrtuar;



Raportet sektorale	Janë dokumente analitike në të cilat janë shkoqitur pjesa thelbësore e strategjive sektoriale që trajton aspektin hapësinor të zhvillimit të sektorit përkatës. Fjala është për sektorët për të cilët janë përgjegjëse ministritë;
PZSK	Plani i Zbatimit të Standardeve për Kosovën. Ky plan përshkruan detyrat afatmesme dhe afatgjata për arritjen e 8 standardeve të përcaktuara. Po ashtu përmban edhe kriteret dhe mjetet për matje të realizimit të tij;
GIS / SIGJ	Sistemi gjeografik i informatave. Sistem informativ i cili tenton që të gjitha të dhënat të kenë referencë gjeografike-hapësinore. i rëndësishëm sepse saktëson lokalitetin e dukurisë së monitoruar;
Analiza hapësinore	Analizë e cila mundëson njohjen e shtrirjes hapësinore të çështjeve të trajtuara, konstatimit të trendëve, rajonalizimit të problemit etj.;
Konsultimet publike	Janë takime tematike me publikun mundësisht të shënjestruar. Përmes këtyre verifikohen çështjet dhe orientimet e prezantuar dhe ajo që është me rëndësi merren rekomandime përkatëse për plotësimin e materialit të prezantuar;
Grupet punuese ndërministrorë	Janë grupe të themeluara me iniciativën e MMPH në kuadër të qeverisë dhe përbehen nga numri i barabartë i pjesëmarrësve të të gjitha ministrive të QK, duhet të punojnë në zhvillimin e elementeve kryesore të PHK;
Vizioni	Deklaratë për të ardhmen e dëshiruar në bazë gjendjes ekzistuese;
Qëllimet / Caqet	Pjesë e vizionit që tregon fokusimin e tendencave për një periudhë afatmesme apo afatgjatë;
Synimet / Objektivat	Pjesë e qëllimit të deklaruar, më shumë mënyrë se si të realizohet qëllimit;
Prioritetet	Synimi parësor në proces i vlerësuar me rëndësi dhe urgjencë të madhe;
Planifikimi Strategjik	Planifikim i orientuar në zgjedhjen e problemeve kryesore, planifikim i përqendruar në numër të kufizuar të çështjeve, promovon proces proaktiv lidhur me zhvillimet etj.;
Konceptet	Mënyrë e të menduarit për të arritur deri te një gjendje e dëshiruar. Koncepti i idesë ndihmon në kërkimin e zgjidhjes së problemit. Konceptet mund të jenë tema ose fraza të përvetësuara të cilat mund të sigurojnë hulumtime më të fokusuar;
Skenaret	Janë supozim i situatave të mundshme për një zhvillim të ardhshëm. Parimi kryesor i punës me skenarë është çifti i pyetjeve - çka nëse?;
Politikat	<ul style="list-style-type: none"> • Mënyra, e pranuar nga vendimmarrësit, për arritjen e një apo më shumë qëllimeve • Një orientim i përvetësuar i pasuar nga një apo grup aktorësh për trajtimin e një problem apo çështjeje me interes • Një përpjekje për të definuar dhe ndërruar një bazë



	<p>racionale për veprim ose mosveprim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një vendim apo sërë vendimesh që nënkupton zgjedhjen në mes shumë alternativave;
Strategjia	Radhë e veprimeve për të realizuar një synim;
Alternativa strategjike	Janë mundësi, opsione të ndryshme për veprim/zgjidhje të problemit;
Fizibiliteti dhe Analiza cost-benefit - kosto-përfitimi	E para nënkupton arsyeshmërinë sociale dhe ekonomike të një projekti,(vlerësimi i investimit) ndërsa e dyta kërkon balancën në mes të koston dhe përfitimit zakonisht për një investim të propozuar;
VNM, VNS, VNE, VNP	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, Vlerësimi i Ndikimit Social, Vlerësimi i Ndikimit Ekonomik, Vlerësimi i Ndikimit të Përgjithshëm. Të gjitha këto janë studime që duhet të paralajmërojnë për ndikimet e mundshme të një politike, strategjie, plani apo një investimi të propozuar;
Toka kualitative bujqësore	Tokë e kategorizuar prej kl I-IV të bonitetit të tokës bujqësore;
BPV	Bruto Produkti Vendor;
Sfidat e Zhvillimit Hapësinor	Çështje të pazgjidhura që kërkojnë vëmendje urgjente
Çështjet kyçe të zhvillimit hapësinor	Grupi i çështjeve të identifikuar si kryesoret gjatë procesit të hartimit të PHK dhe që kanë relevancë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Kosovës, të cilat në parim janë të dakorduara përmes procesit konsultativ;
Sistemi informativ Hapësinor	Sistemi i të dhënave hapësinore;
Indikatorët hapësinor	Indikatorët (Treguesit) të cilët përdoren për monitorimin e zhvillimeve në hapësirë;
Monitorimi dhe Evaluimi	Proces i vrojtimit dhe vlerësimit të realizimit të ndonjë detyre, në këtë rast të PHK;
Plani i Veprimit	Rrjedhë e aktiviteteve që përshkruan veprimet, përgjegjësit për ato veprime, rezultatet e pritura, implikimet kohore, organizative dhe financiare;
Standardi VI i PZSK	E drejta pronësore;
Vendbanimet joformale	Janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm. Si të tilla, vendbanimet joformale mund të kenë karakteristikat si në vijim: zotërim joformal i pronësisë; qasje joadekuate ose privim në shërbime elementare; pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje; rrezikshmëri e lartë;
Konfliktet dhe sinergjitë në hapësirë	Politikat e niveleve të ndryshme dhe sektorëve të ndryshëm në një lokalitet mund të jenë në kundërshti që paraqet konflikt, ose mund ta përkrahin njëra tjetrën që konsiderohet sinergji;
Rritja urbane	Aspekte të ndryshme të rritjes së njësishë së vendbanimit - qytetit, aspekti territorial/fizik,



socio/demografik, ekonomik;

Degradimi i mjedisit	Ndikim negativ në mjedis me tendencë të shkatërrimit të vlerave të tij;
TEN	Rrjeti trans-Evropian i infrastrukturës së transportit;
Zhvillimi i qëndrueshëm	Zhvillim social ekonomik dhe mjedisor i cili shfrytëzimin e resurseve e konsideron si pasuri e cila duhet të ruhet edhe për gjeneratat e ardhshme;
Zhvillimi i balancuar	Parim i cili synon zhvillim sa më të barabartë të rajoneve të ndryshme brenda një territori, apo të territorit të Kosovës me vendet e rajonit;
Zhvillimi policentrik	Zhvillim i cili konsiston në zhvillimin e më shumë se një qendre të fortë në një territor, dhe insiston në shpërndarje të barabartë/komplementare të funksioneve themelore të zhvillimit;
Zhvillimi monocentrik	Zhvillim i cili synon monopolizimin e funksioneve, administrative, sociale, ekonomike etj, në një qytet-zakonisht kryeqytet;
Konteksti urban-rural (konflikti?!)	Sqarimi i raportit të ndërsjellë të zhvillimit të zonave urbane për atyre rurale;
Kohezioni territorial	Parim i cili synon lidhje më të mira hapësinore duke mos marrë m parasysh kufijtë administrativ, por i cili realizohet përmes bashkëpunimit më të mirë social, ekonomik dhe mjedisor;
Zhvillimi kompakt, i përqendruar	Zhvillim i cili tenton shfrytëzim sa më racional të hapësirës përmes të dendësimit të ndërtimit dhe zhvillimeve brenda një hapësire të kufizuar;
Parimet	Zakonisht janë vlera të propozuara dhe në vazhdim të dakorduara të cilat duhet respektuar në të ardhmen. Në rastin tonë në pyetje janë vlerat që duhet respektuar gjatë hartimit dhe pas miratimit të planit, mendohet në implementimin e tij;
Ekonomia e centralizuar	Ekonomi në të cilën kushtet ekonomike diktohen nga niveli qendror i pushtetit;
Ekonomia e tregut	Ekonomi e cila bazohet në kushtet e tregut të lirë, konkurrencës dhe ofrimit të shërbimeve/ofertës në baza të kërkesës reale;
Zonat - brezat e gjelbër	Zonat të cilat kanë një kontroll rigoroz të zhvillimit. Qëllimi i brezave të gjelbër të kontrollojë shtrirjen jo të kufizuar të zonave të ndërtimit, të pengojnë bashkëngjitjen e qyteteve fqinje, të pengojnë cenimin e peizazhit, të ruajnë mjedisin dhe karakterin specifik të qyteteve historike dhe të ndihmojë rigjenerimin urban duke inkurajuar ri-shfrytëzimin e tokës së braktisur dhe llojeve tjera të tokës;
Zonat e Veçanta të Mbrojtura	Është një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.





I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

1.1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

1.1.1. KOSOVA - TË DHËNAT THEMELORE

Kosova gjendet në Evropën Juglindore, e karakterizon pozita qendrore në Gadishullin Ballkanik. Kufizohet me: Shqipërinë (112 km gjatësia e kufirit), Maqedoninë (161 km), Serbinë (352 km) dhe Malin e Zi (77 km)¹. Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 41°50'58" deri 43°15'42" dhe gjatësi gjeografike lindore prej 20°01'02" deri 21°48'02"².

Sipërfaqja e Kosovës është 10.907 km², në të cilën jetojnë rreth 2.4 milionë banorë (sipas OSBE-së në vitin 2000), paraqet hapësirë me dendësi të madhe të popullsisë (220 banorë në km²).

Kosova është e rrethuar me male të larta, disa kreshta malore kalojnë edhe mbi 2000 m lartësi mbidetare (maja më e lartë Gjeravica 2.656m)³, që kanë përbërje të ndryshme gjeologjike, ndërsa në mes shtrihen dy fushëgropat më të mëdha, ajo e Dukagjinit dhe Kosovës. Malet nuk e izolojnë Kosovën nga vendet e tjera, sepse në të katër anët lumenjtë kanë prerë lugina të gjera dhe të thella lumore, duke i tejkaluar këto barrierë natyrore, dhe duke e vënë Kosovën në funksion lidhës në brendësinë së Gadishullit Ballkanik dhe deteve që e rrethojnë. Kosova është kyçi hidrografik prej nga rrjedhin ujërat në drejtim të Detit Adriatik, Detit të Zi dhe Detit Egje.

Kosova, me të gjitha elementet gjeografike, është një hapësirë e individualizuar dhe specifike. Nëpër territorin e saj kalojnë rrugë të rëndësishme, të cilat lidhin Evropën e Mesme me bregdetin e Detit Mesdhe. Si e tillë ajo ka një pozitë të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Evropës.



¹ UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor, Kosova 2002, Prishtinë, fq.15

² MMPH-DPH, Raport 2002, Prishtinë, fq.8.

³ Dr. Riza I. Çavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës, fq.319

► Pozita gjeografike e Kosovës në Evropë

Pozitën e mirë gjeografike Kosovës ia mundëson edhe llojllojshmëria e faktorëve natyrorë: përbërja gjeologjike, relievi, klima, hidrografia, vegjetacioni dhe tipet e tokave, si dhe pasuritë nëntokësore që janë bazë e mirë për zhvillimin ekonomik. Me elementet e peizazhit natyror, ajo tregon diferencat e veta. Në një hapësirë gjeografike aq të kufizuar, janë zhvilluar gati të gjitha kategoritë e relievit me forma të larmishme dhe gjithashtu me ndryshime të theksuara klimatike. Ndërrimet në elementet natyrore janë manifestuar edhe në tipet e tokave dhe vegjetacionit natyror, duke e bërë një peizazh specifik. Kosova shquhet për shumë resurse natyrore të cilat e kanë bërë të njohur, jo vetëm në suaza të Gadishullit Ballkanik por edhe më gjerë.

Bujqësia është veprimtaria kryesore ekonomike, me dendësi të madhe agrare, me mekanizim të pamjaftueshëm, me strukturë të pavolitshme për kultivimin e kulturave etj. Toka bujqësore janë 53% dhe 39.1% pyje, rreth gjysma e tokës bujqësore (52.3%) është e lërueshme, kurse një e treta (31%) janë kullosa (UNDP). Industria gjendet në fazën e tranzicionit. Një profil i tillë ekonomik ka kushtëzuar dominimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane.

Në aspektin demografik Kosova është hapësirë kompakte ku kombësia shqiptare përbën rreth 90% ndërsa kombësitë e tjera rreth 10% (serbë, malazez, turq, myslimanë, romë etj.). Për nga mosha popullsia e Kosovës është e re, ku dominon mosha nën 19 vjeç dhe atë me 42.5%. Kryeqyteti i saj është Prishtina, kurse qytetet e tjera të mëdha janë: Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj.

1.1.2. DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL


1.1.2.1. Demografia

1.1.2.1.1. Numri i popullsisë - Vlerësohet se në Kosovë jetojnë rreth 2.4 milionë⁴ banorë. Mirëpo, ekzistojnë vlerësime të ndryshme mbi numrin e popullsisë nga institucione të ndryshme (p.sh. ESK-ja vlerëson se Kosova ka 2.2 milion banorë). Ky numër është relativisht i madh në një sipërfaqe prej 10.907 km² sa ka Kosova. Rritja e numrit të popullsisë është 1.3 % që është më e larta në rajon. Gjatë periudhës 82 vjeçare (1921-2003) popullsia është rritë për 4.6 herë. Nëse vazhdon rritja e popullsisë me këtë trend, vlerësimet tregojnë se në vitin 2050 popullsia do të arrijë deri në 4.5 milionë banorë⁵.

1.1.2.1.2. Dendësia e popullsisë - Kosova për nga dendësia e popullsisë renditet ndër vendet e para në Evropë me rreth 220 b/km². Përqendrimi i funksioneve të ndryshme ekonomike, shëndetësore, tregtare, kulturore etj., në qytetet e Kosovës ka ndikuar në koncentrimin e madh të popullsisë në këto qendra.

⁴ OSCE, viti 2000, Prishtinë, cituar nga ESK.

⁵ Dr. H. Islami -Dimensioni Demografik në Kosovë, cituar nga MMPH, Kosovo State of the Environment Report, prill 2003, Prishtinë.



► Dendësia e popullsisë sipas komunave


Dendësia më e madhe është e shprehur në komunën e Prishtinës - mbi 900 banorë/km² ndërkohë që rajonet më të pabanuara janë viset malore dhe kodrinore me dendësi përafërsisht 50 banorë/km²

Në anën tjetër, mungesa e infrastrukturës, largësia nga qendrat arsimore, shëndetësore, kulturore etj, kanë ndikuar në migrimin e madh të popullsisë prej viseve rurale në ato urbane, i cili paraqitet problem të dyfishtë në shfrytëzimin e hapësirës. Ky revolucion urban paraqitet si urbanizim i dhunshëm dhe sfidë aktuale në Kosovë. Për dallim nga qytetet e tjera, Prishtina si kryeqendër është vendi ku graviton jo vetëm popullsia e fshatrave përreth por nga mbarë viset e Kosovës, që pason me shkeljen e normave të jetës urbane. Në dendësinë e popullsisë gjithashtu ndikoi edhe konflikti i fundit, sepse shkatërrimet e shtëpive janë bërë kryesisht në fshatra, i kanë detyruar familjet të gjejnë strehim për shkak të pamundësive për rindërtimin e tyre. Këto familje kryesisht janë vendosur në qytete. Dukuritë e tjera negative janë: fokusimi i popullsisë në qendra urbane, zgjerimi horizontal dhe pa plan i qyteteve, shfrytëzimi joracional i tokës bujqësore, mungesa e infrastrukturës, ndotja e mjedisit etj.

1.1.2.1.3. Shtimi natyror i popullsisë - Edhe pse pothuajse të gjithë treguesit e shtimit të popullatës kanë shënuar rënie gjatë dekadës së kaluar, popullata e Kosovës ende mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë, ky është rezultat i zvogëlimit të ngadalshëm të shkallës së natalitetit dhe i zvogëlimit rapid të shkallës së mortalitetit. Shkalla e shtimit natyror është rreth 16 ‰ në vit. Shkalla e madhe e shtimit natyror të popullsisë është faktori kryesor që ka ndikuar në numrin dhe dendësinë e popullsisë si dhe problemet që rrjedhin prej tyre.

► Shtimi natyror në Kosovë dhe në rajon (‰)

Në shumë vende të rajonit shtimi është negativ ndërkohë që në Kosovë është pozitiv dhe ndër më të lartët




1.1.2.1.4. Popullsia sipas gjinisë - Raporti në mes të përqindjes së gjinisë mashkullore dhe femërore është 50.4 % meshkuj dhe 49.6 % femra⁶. Gjinia mashkullore kishte përqindje më të madhe deri në vitet e 90-të, me 51.55 % meshkuj dhe 48.45 % femra⁷.

⁶ Riinvest, Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, Raport hulumtues 8, Prishtinë 2003, fq.42
⁷ ESK



1.1.2.1.5. Popullsia sipas grupmohave - Gjysma e popullsisë në Kosovë është nën moshën 25 vjeç. Në Kosovë kategoria e popullsisë së re (prej 1-14 vjeç) është përfaqësuar me 33 %. Pjesëmarrja e popullsisë së moshës 15-64 vjeç është 61 %. Popullsia e moshës mbi 65 vjeç përfshin vetëm 6 %⁸. Dominimi i strukturës së re të popullsisë ndikon në shkallën e lartë të shtimit natyror.

► Piramida e popullsisë sipas grupmohave në Kosovë (1991)





1.1.2.1.6. Popullsia sipas etniteteve - Në Kosovë jetojnë etnitate të ndryshme. Rreth 92% e popullsisë janë shqiptarë, serbë 5.3 % dhe të tjerë 2.7 %.⁹

1.1.2.1.7. Jetëgjatësia mesatare - Gjatë viteve nëntëdhjetë, jetëgjatësia mesatare për Kosovën është zgjatur për gati 30 vjet, në krahasim me vitet pesëdhjetë (prej 46 deri 74 vjet). Aktualisht nuk ka të dhëna ose vlerësime të cilat do të mbulonin periudhën pas vitit 1999. Është e arsyeshme të supozohet se kushtet e përgjithshme jo të favorshme që mbizotëruan gjatë periudhës që çoi drejtpërdrejt në konflikt dhe të asaj menjëherë pas konfliktit, kanë pasur ndikim negativ dhe shkaktuan rritjen e nivelit të varfërisë.

Në RZHNJK 2004 thuhet se jetëgjatësia mesatare në Kosovë është 68.8 vjet, (67.8 për meshkuj, 69.9 për femra). Që nga mesi i viteve nëntëdhjetë mesatarja e jetëgjatësisë ka rënë për pesë vjet, për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Për shkak të shumë përmirësimeve sa i përket kushteve të jetesës dhe kushteve ekonomike gjatë 4-5 viteve të fundit trendi rënës i jetëgjatësisë është ndalur. Kosova ka indeksin më të ulët të jetëgjatësisë në rajon. Njerëzit në Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë, Maqedoni dhe Kroaci mund të presin të jetojnë 3 deri 4 vjet më gjatë se kosovarët.

► Jetëgjatësia - krahasimet rajonale¹⁰



⁸ EKS

⁹ Burimi : OSCE , Pot

¹⁰: UNDP, RZHNJ Glot

Shpërndarja e jetëgjatësisë në mes të komunës më të lartë dhe më të ultë është përafërsisht 10 vite (71.1 në Gjilan krahasuar me 61.5 në Skenderaj). Siç shihet në figurë Indeksi i Jetëgjatësisë është më i larti në Gjilan, Gjakovë, Podujevë, Istog dhe Lipjan; dhe më i ulti në Skenderaj, Novobërdë, Shtime, Malishevë dhe Dragash.

► Jetëgjatësia ne vite

1.1.2.1.8. Depopullimi i vendbanimeve - Kosova për nga dendësia e popullsisë renditet ndër vendet e para në Evropë me rreth 220 b/km². Ndryshimet e mëdha në zhvillimin ekonomik në mes rajoneve në Kosovë janë shkaktarët kryesor të lëvizjes dhe migrimit të popullsisë. Një pjesë e madhe e vendbanimeve e sidomos ato që ndodhën në pjesët kodrinore-malore përballen me një zhvillim shumë të ulët ekonomik. Pjesa më e madhe e popullsisë është e papunë dhe mundësitë për të gjetur punë janë minimale. Në disa zona, bujqësia është e vetmja mundësi e krijimit të të ardhurave të nevojshme për mbijetesë të cilat shpesh janë peng i pasigurisë dhe rreziqeve që e përcjellin këtë lloj të veprimtarisë. Në kërkim të burimeve më të sigurta të të ardhurave një pjesë e madhe e familjeve janë detyruar ti braktisin vatrat e tyre duke lëvizur në drejtim të zonave urbane të cilat ofrojnë mundësi më të mëdha për një jetë më të mirë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre zonave janë të shkëputura dhe nuk kanë qasje në rrjetin e rrugëve dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse. Shkollat dhe ambulancat si shërbime elementare janë shpesh shumë larg nga vendbanimet dhe paraqesin njërin ndër shkaqet kryesore të uljes së kualitetit të jetës në këto vendbanime. Për shkak të ecjes së gjatë, shumë fëmijë janë të detyruar të braktisin shkollimin dhe të mbesin me përgatitje minimale shkollore, ndërsa përkujdesja për shëndetin është sjellë në nivelin më të ulët të mundshëm.


Gjatë konfliktit të fundit që ndodhi në Kosovë situata u keqësua edhe më shumë, ishin po të njëjtat zona të cilat pësuan më së shumti. U shkatërruan shumë shtëpi dhe pasuri familjare, u dëmtua në masë të madhe infrastruktura edhe ashtu e dobët teknike, u dogjën shumë shkolla, ambulanca dhe shumë objekte të kultit. Banorët e fshatrave të tëra u detyruan të zhvendosen ose të shpërngulen me dhunë në drejtim të zonave kryesisht urbane, që për pasojë kishin mbingarkimin e tyre. Pas konfliktit, me ndihmën e donacioneve të ofruara nga shtetet dhe organizatat e shumta ndërkombëtare, sa i përket objekteve të dëmtuara gjendja filloi të përmirësohej. Një ndihmë e konsiderueshme u dha edhe në ngjalljen dhe hapjen e disa veprimtarive ekonomike të cilat ndikuan që një pjesë e popullatës së shpërngulur të kthehet në vendet e tyre.

E gjithë kjo nuk ishte e mjaftueshme për një pjesë të madhe të banorëve, në shumë zona gjendja është ende ekonomikisht e pasigurt. Shumë të rinj dhe familje të tëra janë duke vazhduar lëvizjen drejtë zonave me ofertë më të madhe të mundësive duke krijuar në këtë mënyrë ngarkesë të papërbalueshme. Shumë vendbanime u përgjysmuan dhe nuk janë të pakta edhe vendbanimet tërësisht të braktisura të cilat kryesisht ndodhen në pjesët e skajshme dhe zonat kufitare të Kosovës.

Fluksi i madh i popullsisë drejtë qendrave të mëdha dhe mungesa e planeve rregulluese urbane kanë shkaktuar çrregullime të mëdha urbane. Janë krijuar zona të tëra të vendbanimeve pa infrastrukturë të rregullt teknike duke krijuar kështu pengesa potenciale për zhvillimin dhe planifikimin e zonës në tërësi. Infrastruktura sociale edhe ashtu e vjetruar është mbingarkuar dhe nuk po ka mundësi të ofrimit të shërbimeve të rregullta.

Më të ngarkuarat me këtë problem janë qendrat e mëdha urbane ndër të cilat Prishtina paraqitet si qendra më atraktive, në të cilën të ardhurit nuk janë vetëm nga zonat e afërta rurale por edhe nga qendrat tjera urbane. Sot në Prishtinë jetojnë më tepër se ¼ e popullsisë së përgjithshme të Kosovës nga të cilët pjesa më e madhe janë të privuar nga shërbimet minimale komunale.


1.1.2.2. Zhvillimi social



1.1.2.2.1. Punësimi - Vlerësohet se numri total i të punësuarve në Kosovë është rreth 260 mijë, prej tyre rreth 61 mijë janë të punësuar në ndërmarrje shoqërore, rreth 125 mijë në ndërmarrjet private, rreth 65 mijë në sektorin qeveritar dhe rreth 18 mijë në organizatat e huaja dhe OJQ-të¹¹. Numri i madh i të punësuarve në Kosovë është edhe në sektorin joformal. Ngarkesa dhe dispersioni i tatimeve kanë ndikim të madh në zgjerimin e sektorit joformal e posaçërisht në rritjen e kontigjentit joformal të të punësuarve¹².

1.1.2.2.2. Papunësi e lartë dhe në rritje të vazhdueshme - Një ndër sfidat kryesore për popullatën e Kosovës është shkalla e lartë e papunësisë. Kosova është vendi me shkallë më të lartë të papunësisë në rajon. Kjo normë e papunësisë sillet rreth 49%. Papunësia më e shprehur është te femrat rreth 63%, ndërsa te meshkujt kjo normë paraqitet më e ulët rreth 37%. Pjesa më e madhe e të papunëve janë të moshës 16-24 vjeçare dhe shprehur në përqindje kjo përbën rreth 40% të numrit total të të papunëve. Pajtimet e punësimit në njerëzor 2004, shkalla e papunësisë tek femrat e reja është 56%. Për të rinjtë e moshës 16-24 vjeç shkalla e papunësisë është mbi 63%.

Norma e papunësisë është e lartë në tërë territorin e Kosovës, por në disa rajone paraqitet përqindje më e theksuar e papunësisë (pjesa qendrore e Kosovës - Malisheva, Glogoci, Skenderaj, Mitrovica dhe disa komuna periferike - Dragashi, Kamenica), të cilat janë edhe rajonet më të pazhvilluara, përqindja e papunësisë në këto rajone sillet rreth 55 - 60 %. Papunësia prej vitit 1988 deri në vitin 1991- 92 nuk ka shënuar rritje. Në periudhat e më vonshme pas vitit 1992 vërehet një rritje e madhe e përqindjes së papunësisë. Gjatë kësaj periudhe në rritjen e papunësisë ka ndikuar largimi i dhunshëm nga puna të një numri shumë të madh të punonjësve, si pasojë e zhvillimeve politike të atëhershme në Kosovë.



1.1.2.2.3. Varfëria e lartë dhe në rritje të vazhdueshme - Me gjithë përparimin e konsiderueshëm në rindërtimin e vendit pas konfliktit të fundit, sfida e reduktimit të varfërisë gjatë viteve të ardhshme mbetet ende shumë e madhe. Zhvillimet e kohëve të fundit janë udhëhequr dhe financuar nga ndihmat e marra nga shumë shtete të dedikuara për zhvillimin dhe mëkëmbjen e vendit. Këto ndihma në fakt, krijuan një numër të konsiderueshëm por të përkohshëm të vendeve të punës të cilat me kalimin e kohës u shuan varësisht nga niveli dhe vlera e donacioneve. Derisa zhvillimi i fundit dhe pabarazia mesatare e konsumit sipas të gjitha gjasave kanë shpjer në reduktimin e varfërisë në mes viteve 2000 dhe 2003, prapë se prapë rreth 37% e popullatës llogaritet se jetojnë në vijën e varfërisë (1.42 Euro për person të rritur në ditë) ndërsa 15.2% jetojnë nën vijën ekstreme (ushqimore) të varfërisë (0.93 Euro në ditë), sipas të dhënave nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) 2002/03¹³. Bazuar në hulumtimet e Bankës Botërore të realizuara gjatë vitit 2004, tregon se shkalla e varfërisë në Kosovë është gjerësisht e përhapur, më tepër se gjysma e popullatës (50.3%) jeton në varfëri, kurse 16% e popullatës jeton në varfëri ekstreme¹⁴. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, procesi i ngadalshëm i privatizimit, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos te të rinjtë, janë faktorë kryesorë të shkallës së lartë të varfërisë¹⁵, ndërkohë që numri i familjeve që jetojnë nga ndihmat humanitare është rritur për 10 herë. Kur kësaj i shtojmë edhe numrin e atyre që jetojnë nga mjetet dhe ndihmat financiare të marra nga punëtorët që përkohësisht punojnë jashtë e tregojnë më së miri gjendjen ekonomike të një pjese të konsiderueshme të familjeve kosovare. Pas konfliktit, ndihmat e marra nga familjarët në diasporë përbënin gjysmën e buxhetit të familjeve kosovare¹⁶. Filluar nga viti 1999, shumë familjeve u është dashur t'i shpenzojnë kursimet e tyre, e shpesh edhe t'i shesin patundshmëritë e tyre, për të siguruar nivelet minimale të mbijetesës. Shkalla e varfërisë ndryshon sipas rajonit, më e theksuar është në rajonin e Drenicës dhe në disa pjesë të skajshme të Kosovës.

¹¹ ESK, Prishtinë.


¹² Riinvest, Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, Raport hulumtues 8, Prishtinë 2003, fq. 48.

¹³ Cituar në raportin e BB. nr.32378-xk, Vlersimi i varfërisë në Kosovë, 16 Qershor 2005, Prishtinë

¹⁴ EB, maj 2004

¹⁵ UNDP, raporti i zhvillimit njerëzor, Kosova 2002.

¹⁶ UNDP, raporti i zhvillimit njerëzor, Kosova 2002.



► Shkalla e varfërisë në rajon sipas WB viti 2001

Shkalla më e lartë e varfërisë në rajon është në Kosovë

Si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga konflikti dhe gjendjes ende transitore të zhvillimeve pas konfliktit, papunësia është bërë problem i madh social dhe ekonomik për shumë shtresa të shoqërisë kosovare. Të ardhurat e pamjaftueshme ndikojnë në mënyrë të ndryshme, tek fëmijët, të moshuarit, ekonomitë familjare të udhëhequra nga femrat, personat me aftësi të kufizuara dhe të punësuarit me punë të përkohshme. Gjendja e pasigurt ekonomike është shpesh shkaktare e pengesave në vijimin e shkollimit të rregullt tek fëmijët dhe përkujdesjes së rregullt të shëndetit. Nga raporti Bankës Botërore, shihet se niveli i përgjithshëm i arsimit është relativisht i ulët dhe analfabetizmi në Kosovë është mjaft prezent. Deri në vitin 2002 gjysma e popullatës kishte të paktën shkollën fillore të përfunduar, ndërsa rreth 6% nga numri i tërësishëm i banorëve ishin analfabet (nga të dhënat e Bankës Botërore - 2005).

Përkujdesi shëndetësor - i popullatës është në nivel të ulët, ende ekziston pasiguri e konsiderueshme në llogaritje, por dëshmitë në dispozicion tregojnë për rezultatet shumë të dobëta të shëndetësisë të cilat janë ndër më të dobëtat në Evropën Jug-Lindore. Vdekshmëria e foshnjave gjatë lindjes dhe gjatë vitit të parë të jetës është problem madhor, rezultatet tregojnë për shkallën e lartë të vdekjes së foshnjave të porsalindura e cila sillet prej 18 deri në 44 në 1,000 (4 deri 10 herë më e lartë se mesatarja e BE). Të ushqyerit jo adekuat është problem tjetër me ndikim në shëndetin e një numri të madh fëmijësh. Sëmundjet si tuberkulozi dhe aftësitë e kufizuara janë ende prezentë te fëmijët sidomos në rajonet ku varfëria është më e shprehura. Edhe pse viteve të fundit është vërejtur një rënie e numrit të të sëmurëve nga këto lloje të sëmundjeve, prapë se prapë kemi mbetur rajoni ku niveli i këtyre sëmundjeve është 5 herë më i lartë se në vendet e Evropës.

Ndotja dhe degradimi i mjedisit paraqesin rrezik potencial për shëndetin e popullatës në Kosovë, pasojat janë të ndryshme dhe ato ndryshojnë varësisht nga vendi. Shkaqet kryesore të rreziqeve mjedisore për shëndetin janë:

- infrastruktura e vjetruar industriale e cila ka injoruar ndikimet mjedisore
- kushtet e dobëta të banimit dhe kualiteti i dobët i shërbimeve bazë, dhe
- sistemet e dobëta të menaxhimit mjedisor.

Dallimet hapësinore sociale-ekonomike janë të mëdha dhe plotësisht e arsyetojnë përqendrimin gjeografik që po planifikohet në strategjinë e reduktimit të varfërisë. Kosova ka shkallë të lartë të varfërisë dhe ajo paraqitet e ndryshme varësisht nga rajoni dhe numri i të papunëve që është shkaku kryesor i përcaktimit të varfërisë. Mundësitë e punësimit në disa zona sidomos ato rurale janë të pakët, një pjesë e madhe e popullatës së aftë për punë janë të detyruar të largohen nga vendet e tyre në kërkim të punës dhe kushteve më të mira. Shërbimet në këto zona janë në nivelin e ulët, për shkak të largësisë së shkollave dhe infrastrukturës përcjellëse një pjesë e madhe e fëmijëve (më tepër janë vajza) janë të detyruar të ndërprejnë shkollimin (Gjatë vitit 2002, në zonat rurale shkalla e përfundimit të shkollimit të mesme ishte vetëm 46% e cila në zonat urbane paraqitet në mes 64% dhe 77% sa ishte në Prishtinë). Situata paraqitet e njëjtë edhe me shëndetin, largësia e objekteve dhe mungesa e personelit shëndetësor janë shkaku kryesor i trajtimit jo të rregullt dhe adekuat të pjesë së moshuar të të sëmurëve.



1.1.2.2.4. Arsimi

Zhvillimi njerëzor është proces i vazhdueshëm i cili varet nga tre faktor themelor që ndryshojnë në proporcion me ndryshimin e nevojave njerëzore nga të cilat më thelbësore janë: arsimimi - marrja e njohurive dhe aftësive, shëndetësia - jeta e gjatë dhe e shëndoshë dhe qasja në burime private dhe publike të nevojshme për jetë normale.

Në Kosovë që nga viti 2000 ka filluar të aplikohet sistemi i ri i arsimit i klasifikuar sipas ISCED 97¹⁷, duke e bërë sistemin e arsimit të Kosovës të përputhshëm me shtetet e BE-së.

Rrjeti shkollor është i organizuar në shkolla kryesore dhe paralele të ndara fizike. Mësimi mbahet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe kroate.

Në vitin 2002/03 në Kosovë ka pasur 1165 shkolla, 985 ose 84.5% e shkollave e mbajnë mësimin e tyre në gjuhën shqipe. Mësimi në gjuhën serbe mbahet në 136 shkolla (11.7% e shkollave), 23 shkolla në gjuhën boshnjake (2.0%), në gjuhën gorane në 3 shkolla (0.3% e shkollave), në gjuhën turke në 2 shkolla (0.2% e shkollave) dhe mikste 16 (1.4% e shkollave).

Në vitin 2002/03 janë regjistruar 425.194 nxënës. Rreth 74.1% e nxënësve të regjistruar ishin në shkollat fillore dhe 20.4% në shkollat e mesme. Rreth 5.3% ishin në parashkollor dhe më pak se 1% në shkollat speciale.

Rreth 92% nga numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar janë shqiptarë, serbë rreth 5.4%, boshnjakë rreth 1%. Mesatarja e numrit të nxënësve për klasë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në nivel të Kosovës është 24.5 nxënës. Ndërsa mesatarja e nxënësve për paralele në arsimin e mesëm të lartë në nivel të Kosovës është 29.2 nxënës.

Në vitin shkollor 2004/05 në Kosovë¹⁸ kanë qenë 944 shkolla fillore në të cilat mësimin e vijuan 327.207 nxënës dhe nga ky numër 170.641 (52.15%) ishin meshkuj ndërsa 156.566 (47.85%) ishin femra. Numri i përgjithshëm i personelit arsimor në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2004/05 ka qenë 20.812, ku nga ky numër 17.009 (81.7%) mësimdhënës.

Sa i përket arsimit të mesëm të lartë në Kosovë në vitin shkollor 2004/05 kanë qenë gjithsej 103 shkolla në të cilat mësimin e vijuan 69.760 nxënës, prej tyre 38.940 (55.8%) ishin meshkuj ndërsa 30.820 (44.2%) femra. Numri i përgjithshëm i personelit arsimor në arsimin e mesëm të lartë në vitin shkollor 2004/05 ka qenë 5.353, prej tyre 4.314 (80.6%) mësimdhënës.

Gjatë vitit 2004 shihet një zhvillim, përkatësisht ngritje e institucioneve private dhe numri i tyre ka arritur në 12 institucione private në të gjitha nivelet e arsimit në të cilat kanë qenë të regjistruar 1.107 nxënës. Prej tyre në nivelin parashkollor 273 nxënës (24.6%), në atë fillor dhe të mesëm të ulët 411 nxënës (37.1%) dhe 423 (38.2%) në nivelin e mesëm të lartë. Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në arsimin privat, në vitin 2004 ishte 158 (59.8%) ndërsa raporti mesatar 7 nxënës për mësimdhënës.

Kosova ka një universitet publik të themeluar në vitin 1970 me seli në Prishtinë. Përbrenda këtij universiteti ekzistojnë 21 fakultete dhe shkolla që ofrojnë studime universitare në 57 fusha të specializimit. Prej tyre 14 fakultete ofrojnë studime pasuniversitare në më se 30 fusha. Gjatë vitit akademik 2001/2002, në shkollat dhe fakultetet e Universitetit ka pasur gjithsej 20.227 studentë, prej të cilëve 14.596 (72%) të rregullt dhe 5.681 (28%) me korrespondencë.

Në vitin akademik 2003/2004 në Universitetin e Prishtinës janë regjistruar gjithsej 6.372 studentë, nga të cilët 47 ishin studentë të huaj. Nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin 2003/2004, femra ishin gjithsej 2.962 apo 46.48%, ndërsa meshkuj 3.410 apo 53.52%. Përqindja e studentëve në raport me numrin e popullatës në moshën 18-25 vjeçare në vitin 2003/04 ka qenë 12%.

Zhvillim përkatësisht ngritje të institucioneve private kemi edhe në arsimin e lartë dhe numri i tyre në vitin 2004 ka arritur në 10 institucione private, të cilat kryesisht kanë qenë të koncentruar në Prishtinë.

¹⁷ ISCED - KSNA Klasifikimi standart ndërkombëtar i arsimit(modeli 5+4+3-4).

¹⁸ Mungojnë të dhënat nga disa pjesë të Kosovës.



Në bazë të raportit¹⁹ nx./mës. të përcaktuar nga MASHT²⁰, për shqiptarë ky raport është 22nx./1 mës, ndërsa për grupet etnike të tjera ky raport është 15nx./1 mësimsdhënës.

Krahasuar me vitin 2001/2002, numri i mësimsdhënësve në vitin 2002/2003 është rritur, por raporti në mes mësimsdhënësve dhe nxënësve në nivelin parashkollor është ende i pavolitshëm, 39.2 nx./1 mës. Mirëpo, kjo ndryshon në nivelin fillor 19.0 nx./1 mësimsdhënës, në nivelin e mesëm 14.9 nx./1 mësimsdhënës, ndërsa në shkollat speciale është 9.0 nx./1 mës. Në përgjithësi raporti mës./nx. në Kosovë është 18.5 nx./1 mës.

Sa i përket hapësirës shkollore, paraqitet nevoja e përmirësimit të standardeve²¹. Hapësira shkollore në Kosovë në kontekst të përgjithshëm dhe rajonal mund të thuhet se është e pamjaftueshme. Nëse analizojmë problematikën nëpër komuna veç e veç, shihet se ka mungesë të hapësirës shkollore - gjendja momentale nuk i përgjigjet trendit të lëvizjes së popullatës. Mungesa e hapësirës është e theksuar në zonat urbane ku shkollat punojnë deri në 4 turne. Ky problem është rritur në mënyre drastike pas luftës, si pasojë e lëvizjeve të mëdha të popullatës.

Në bazë të shënimeve të deritashme raporti mësimsdhënës/nxënës nuk na paraqitet si problem, përkundrazi është mjaft i mirë dhe mund të krahasohet me standardet.


Për kuadrin mësimsdhënës është vlerësuar se në çdo fushë deri më 50% të arsimtarëve që punojnë mund të jenë të pakualifikuar. Tek arsimit special është shumë e theksuar mungesa e personelit të kualifikuar i cili mund të krijoj për këta fëmijë ambient të përshtatshëm të arsimit. Niveli jo adekuat i kuadrit arsimor nuk po mund ti përgjigjet kërkesave të nxënësve dhe si i tillë po paraqitet si problem tjetër që po e mundon këtë sektor me rëndësi për shoqërinë tonë.

Po ashtu duhet kushtuar vëmendje të vazhduar zhvillimit profesional të personelit të tanishëm të universitetit, si dhe trajnimit të kuadrit të ri mësimit për universitet.

Sipas të dhënave të vitit 2001, vijimi i shkollës për fëmijët e moshës së shkollës së obligueshme (7-14 vjeçe) është gati universal, megjithatë ekzistojnë jo barazi të mëdha të ndërlidhura me nivelet e të ardhurave. Mirëpo në arsimin e mesëm vijimi i shkollës keqësohet në mënyrë të ashpër. Vështirësia kryesore është në kalimin tek arsimi i lartë i mesëm kjo vërehet edhe në të dhënat e vitit 2002/2003. Përqindja e të rinjve nga kategoritë më të varfra në hapësirat rurale që vazhdojnë shkollimin në shkollat e mesme është përgjysmë më e vogël se sa e bashkëmoshatarëve të tyre nga kategoritë më të pasura.

Kalimi tek arsimi i mesëm i lartë mbetet ende vështirësia kryesore, numri i nxënësve që kanë kryer klasën e 9-të në vitin 2002/03 ka qenë 30.802, ndërsa numri i atyre që kanë vazhduar në klasën e 10-të në vitin 2003/04 ka qenë 25.126 nxënës. Nga kjo rrjedhë se 80% e nxënësve që kryejnë arsimin e obligueshëm fillor vazhdojnë mësimet në arsimin e mesëm të lartë.

Barazia e gjinive në arsimin e mesëm (15 -18 vjeçe) është po ashtu brengë e veçantë. Raporti mashkull/femër nëpër nivelet shkollore tregon se përqindja e femrave në arsim është më e vogël. Sidomos kjo vërehet në kalimin tek arsimi i mesëm i lartë.



► Struktura gjinore nëpër nivelet shkollore (2004-2005)


Në të gjitha nivelet tregohet shkallë më e ulët e pjesëmarrjes së gjinisë femrore

¹⁹ Raporti nx./mës. është përcaktuar për përpilimin e buxhetit 2001/2002.

²⁰ MASHT- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

²¹ Në nivel të komunave paraqitet mungesa e hapësirës shkollore. Në disa komuna mësimi mbahet deri në 4-ër turne.





► Analfabetizmi sipas gjinisë dhe shtrirjes (2003)

Analfabetizmi është ende prezent dhe më shumë i shprehur te gjinia femrore

AMSJ²² -a identifikon shpenzimet private, të ardhurat e familjes, largësinë e objekteve shkollore dhe sigurinë në zonat rurale si arsye kryesore për mos vijimin e shkollës.

Në Kosovë njohuria e shkrim-leximit është çështje që lidhet me gjininë, moshën, por po ashtu edhe me vendin ku jetohej. Analfabetizmi është zakonisht më i lartë në zonat rurale se në ato urbane. Gati 14% e femrave që jetojnë në zonat rurale definohej si analfabetë, përdërisa pjesëmarrja e meshkujve analfabetë është 4%.

1.1.2.2.5. Shëndetësia

Kriteri më i rëndësishëm që përdoret për të vlerësuar nivelin e zhvillimit human është kujdesi për shëndetin dhe jetëgjatësinë e popullatës. Shëndeti përcakton drejtpërdrejt aftësinë e popullatës për të marrë pjesë aktive në të gjitha sferat e jetës, shoqërore, politike dhe ekonomike.

Shërbimet shëndetësore në Kosovë kryhen në disa nivele: shërbim parësor, shërbim dytësor, shërbim tretësor dhe sektori privat. Shërbimet parësore kryhen në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), qendra të Mjekësisë Familjare dhe Ambulanca. Shërbimet dytësore kryhen në 5 Spitale Rajonale dhe dy spitale tjera në Vushtrri dhe Ferizaj. Shërbimi tretësor ofrohet në qendrën Klinike Universitare në të cilën graviton për shërbim e tërë popullata e Kosovës. Sipas indikatorëve themelor shëndetësor, të përdorur për të matur nivelin relativ të zhvillimit në këtë fushë janë: jetëgjatësia, fertiliteti i përgjithshëm, lindjet, vdekjet, rritja e popullatës. Numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësorë të punësuar në këtë sistem është 14.114²³. Numri i mjekëve të punësuar është 2.474, teknik medicinal 7.929 dhe të tjerë 3.711. Nëse shikohet raporti mjek/banorë atëherë në 1.000 banorë janë 1.6 mjek, kjo do të thotë se mesatarja është shumë më e vogël se mesatarja evropiane, e cila numëron rreth 35 mjek në 10.000 banorë. Po ashtu edhe numri i shtretërve është shumë më i vogël, që është 1.7 shtretër /1.000 banorë krahasuar me mesataren evropiane.

Duke përjashtuar sëmundjet për të cilat vetë trajtimi konsiderohet i mjaftueshëm, pengesa më e madhe në qasjen e popullatës në shërbime shëndetësore është kostoja e shërbimit. Më shumë se 95% të popullatës paguajnë për shërbime shëndetësore, pavarësisht se a janë trajtuar në objekte shoqërore apo private. Përdërisa në sektorin publik këto shërbime paguhen në formë të participimit që nganjëherë e kalojnë mundësinë e pacientit, në sektorin privat, për të cilin mungojnë të dhëna që do të pasqyrojnë gjendjen reale, ofrohen shërbime vetëm për pacientë me mundësi të mira materiale. Elementi i sigurimit social me të cilin karakterizohet sistemi para konfliktit, nuk funksionon më dhe kjo zbrazëti nuk është sanuar. Në lidhje me perceptimin e kualitetit të shërbimeve të ofruara, vlerat janë shumë të ulëta, pacientët nuk janë të kënaqur me qasjen në shërbime dhe trajtimin në sistemin ekzistues. Faktor tjetër i rëndësishëm, posaçërisht në zonat rurale, është distanca e institucioneve shëndetësore. Lëvizja e madhe e popullatës rurale drejt qendrave urbane ka shkaktuar stërngarkimin e institucioneve shëndetësore në mjediset urbane, sidomos në qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Si pasojë, një pjesë e kuadrit profesional shëndetësor të hapësirave


²² AMSJ - Anketa e Masës së Standardit Jetësor

²³ Sipas raportit sektorial të Shëndetësisë




rurale u punësua në qendrat urbane, kështu që qasja në shërbimet shëndetësore në këto hapësira u pakësua. Shumë banorë të hapësirave rurale duhet të kalojnë distanca të mëdha për t’u mjekuar.

► Shpërndarja e shërbimeve shëndetësore



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



► Raporti mjek, shtetër/banorë në Kosovë dhe në Evropë

Në Kosovë shërbimet mjekësore janë më të ulëta në rajon dhe në Evropë



Në Kosovë ende ka nevojë për trajtime shëndetësore jashtë vendit, si pasojë e nivelit relativisht të ulët të teknologjisë dhe paisjeve shëndetësore, mandej mungesës së kuadrit adekuat shëndetësor, disa nga sëmundjet dhe intervenimet nuk kanë mundësi të shërohen gjegjësisht të kryhen brenda vendit.

Statusi i shëndetit të popullatës dhe niveli i sistemit shëndetësor në Kosovë nuk është i kënaqshëm në shumë aspektet si në: infrastrukturë, pajisje, menaxhim, financim etj.

1.1.3. BANIMI, SHPËRNDARJA E LOKALITETEVE

1.1.3.1. Shpërndarja e lokaliteteve (vendbanimeve) - Në Kosovë sot jetojnë mbi 2 milion banorë të shpërndarë në 1457 vendbanime, nga të cilat 38 janë të nivelit komunal dhe të tjerat janë vendbanime që për nga përmbajtja dhe veprimtaritë që zhvillohen dhe ofrohen në to, janë të statusit të fshatit. Vendbanimet janë të shpërndara kryesisht në gjithë sipërfaqen e Kosovës, (53% e vendbanimeve) ose 63% e popullsisë shtrihet në trevat me lartësi mbidetare deri 700 m, kurse pjesa tjetër përbën vendbanimet në lartësi mbi 700m, në të cilat mungon infrastruktura dhe shërbimet sociale. Në mungesë të këtyre shërbimeve një pjesë e popullatës së këtyre vendbanimeve janë shpërngulur në vendbanime më të zhvilluara, në kërkesë të kushteve më të mira për banim. Lëvizja e pandërprerë e popullatës ka shkaktuar një tejngarkim të zonave urbane, të cilat, në mungesë të planeve janë duke u zhvilluar pa ndonjë kontroll të ndërtimeve dhe zhvillimit hapësinor.

Sa i përket strukturës së vendbanimeve, sidomos në pjesën qendrore, kodrinore dhe zonat kufitare karakterizohen me një zhvillim mjaft të dobët ekonomik social etj. në të cilat vendbanime gjithnjë e më shumë po kanoset rreziku i depopullimit, orientimi i tyre drejt qendrave të zhvilluara.

1.1.3.2. Banimi - Banimi është funksioni bazë i vendbanimeve dhe i cili ndikon në rrjedhën e zhvillimit. Banimi është shfrytëzuesi më i madh i hapësirës dhe udhëheqës në përmbajtjen e funksioneve elementare të vendbanimeve të njerëzve. Banimi është komponent i rëndësishme ekonomike dhe sociale e zhvillimit, organizimit dhe rregullimit të hapësirës si dhe standardit jetësor të banorëve.

Mënyra e organizimit të banimit luan rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e hapësirës e posaçërisht në shfrytëzimin racional të energjisë, ndotjes së ujit dhe krijimit të mbeturinave.

Banimi dhe politikat e banimit janë ndër problemet esenciale për zhvillimin social, ekonomik dhe politik të vendit, andaj është me rëndësi krijimi i mekanizmave të cilët do të ofronin zgjedhjen e kushteve adekuate për banim për të gjithë qytetaret, e sidomos të kategorive me të rrezikuara sociale.

Zhvillimi, ndërtimi, financimi, pronësia dhe shfrytëzimi i objekteve banesore, gjegjësisht i fondit banesorë, kanë qenë një kontribut i përbashkët i ndërmarrjeve shoqërore dhe të të punësuarve në këto ndërmarrje.

Fondi banesor deri në këto vite (1990) është krijuar dhe zhvilluar me qëllim të sigurimit të nevojave për banim të punësuarve në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore - shoqërore, me të drejtë të shfrytëzimit gjatë periudhës së marrëdhënies së punës në ndërmarrjet përkatëse.

Kosova në vitin 1981 ka pasur 220 mijë njësi të banimit të të gjitha llojeve, në të cilën kanë jetuar rreth 223 mijë ekonomi familjare me rreth 1.6 milion banorë.

Sipas vlerësimit të Departamentit të Rindërtimit - UNMIK, gjatë luftës 1998/99 janë dëmtuar plotësisht ose pjesërisht rreth 120.000 mijë shtëpi dhe objekte përcjellëse të banimit. Afër 60.000 shtëpi janë rindërtuar deri në fund të vitit 2002 nga donatorët, ndërsa pjesa tjetër nga vet familjet. Nga të dhënat e Entit Statistikor të Kosovës për vitin 2003, llogaritet se në Kosovë, janë rreth 360 mijë objekte banimi të të gjitha llojeve, në të cilat jetojnë rreth 370 mijë ekonomi familjare apo rreth 2.04 milion banorë. Krahasuar me vitin 1981, në vitin 2003 fondi banesor ka shënuar rritje, janë shtuar 139 mijë objekte të banimit. Nga analiza e këtyre të dhënave vlerësohet se në Kosovë ka mungesë të njësive të banimit.

Migrimi i familjeve drejt qyteteve të mesme dhe të mëdha dhe nataliteti i lartë janë dy faktorë kryesor që kanë rritur kërkesat për banim pas luftës.



Mungesa e aktiviteteve ekonomike dhe standardeve të tjera të jetës, infrastrukturës dhe shërbimeve të tjera, ka ndikuar në migrimin e familjeve fshat -qytet.


Në bazë të të dhënave të mësipërme rrjedh se një banori i takojnë 18.65 m² sipërfaqe banimi. Ndërsa mesatarja e anëtarëve të familjes është 6.5 anëtarë për familje.

Nga raporti në mes të sipërfaqes së përgjithshme të shtëpive dhe banesave rrjedh se në Kosovë ka 93.7% banim individual dhe 6.23% banim kolektiv.

Banimi në Kosovë është i përqendruar kryesisht në shtëpi si njësi të banimit, të cilat janë shumë shpesh të mbipopulluara. Vendbanimet të cilat ndodhen në afërsi të zonave urbane, në afërsi të rrugëve magjistrale në Kosovë, dukuria e ndërtimeve pa leje dhe zhvillimit të vendbanimeve pranë rrugëve magjistrale është e shprehur në tërë Kosovën. Posaçërisht janë të atakuar korridoret kryesore ku përveç objekteve të banimit, janë të shprehura edhe ndërtimet e tjera të paligjshme. Mungesa e stimulimit të zhvillimit ekonomik, mungesa e infrastrukturës sociale dhe teknike, në vendbanimet rurale ndikon në kahen dhe zhvillimin e tyre drejt zonat urbane, dhe përgjatë rrugëve magjistrale.

Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme për banim do të jetë njëra ndër sfidat kryesore të shoqërisë tonë. Pa dyshim se kërkesa për banim është e madhe dhe ajo paraqitet në shkallë të ndryshme varësisht nga rajoni. Shumica e familjeve të reja, që për nga numri nuk janë pak (në Kosovë për çdo vit shtohen 25 - 30 mijë banorë të rinj), me punën dhe me të hyrat që krijojnë nga kjo punë nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë. Arsyeja kryesore është çmimi shumë i lartë i m² të sipërfaqes së ndërtuar banimore, që krahasuar me rajonin është ndër më të lartat. Momentalisht vetëm sektori privat është i kyçur në shtimin e fondit banesor, që shumë shpesh karakterizohet me parregullsi dhe mungesë kriteresh, ndërkohë që sektori shoqëror nuk ka qenë shumë aktiv në zgjerimin e fondit banesor.

Zgjidhjen e këtij problemi e vështirëson edhe mungesa e të dhënave për kërkesën dhe ofertën e banesave. Nga analiza e bërë në zonat urbane të shtatë qendrave të mëdha të Kosovës shihet qartë se ndër zhvillimet më të mëdha në hapësirë janë ato të objekteve banimore. Mesatarja e rritjes urbane për 20 vjetët e kaluara (1980-1999) ose sipërfaqja e secilës qendër është rritur për 2.7 herë që shprehur në hektarë vetëm për qytetin e Prishtinës do të thotë: në vitin 1980 Prishtina i ka pasur 450 ha dhe pas 20 viteve (1999) është rritur në rreth 1500 ha ose afër 1000 ha më tepër.



► Rritja urbane në shtatë qendrat e mëdha kosovare - periudha 1980 - 1999 dhe parashikimi i rritjes deri në 2020.

1.1.3.2.1. Problemet**Aspekti institucional - ligjor**

- Mungesa e ligjeve dhe rregulloreve, në fushën e banimit (mos aprovimi i tyre);
- Mungesa e Raportit të gjendjes ekzistuese të banimit në Kosovë, si dhe mungesa e strategjisë për banimin në Kosovë;
- Mungesa e politikave të banimit;
- Mungesa e harmonizimit të nevojave për banim, në raport me kërkesat;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pa organizuar e objekteve të banimit kolektiv;
- Statusi i pa definuar i ndërmarrjeve banesore;
- Mungesa e sektorëve të posaçëm për banim në komuna;
- Nxjitja e ndërtimeve të reja, përmes politikave të banimit nga niveli qendror dhe lokal.

Aspekti social

- Ekzistimi i strehimoreve kolektive;
- Sigurimi i banimit adekuat për familje me të ardhura të ulëta, si dhe familjeve;
- Mungesa e banesave sociale dhe joprofitabile;
- Mungesa e banesave të volitshme.

Aspekti financiar

- Mungesa e fondeve për zhvillimin e banimit;
- Mungesa e fondit të banimit nga niveli qeveritar;
- Promovimi dhe sigurimi i banimit me qira të subvencionuar dhe joprofitabile.

Aspekti hapësinor

- Vendbanimeve joformale, në zonat urbane dhe jashtë tyre;
- Zgjerimi i vendbanimeve përgjatë rrugëve magjistrale;
- Shfrytëzimi joracional i hapësirës, raporti banim individual dhe kolektiv në zonat urbane;
- Mungesa e planeve zhvillimore urbane dhe planeve zhvillimore komunale;
- Mungesa e infrastrukturës teknike në zonat e banimit, sidomos në vendbanimet rurale;
- Shtrirja e vendbanimeve në zonat e rrezikuara nga rrëshqitja e dheut si dhe nga vërshimet (dislokimet dhe rilokimet e vendbanimeve).

1.1.3.2.2. Potencialet

Kosova ka hapësira urbane mjaft të përshtatshme për banim, hapësira të pashfrytëzuara urbane me infrastrukture të gatshme brenda territorit urban, shtrirjen horizontale dhe vertikale të banimit (raporti banim individual dhe kolektiv) të cilat, mund të realizohen me anë të politikave dhe udhëzuesve nga sektori i Banimit, Planifikimit të cilat do të ndihmonin komunat si orientime për hartimin e planeve zhvillimore urbane e komunale. Me popullsinë e re që e ka Kosova në pikëpamje kuantitative ka shumë fuqi punëtore të etshme për të punuar, po ashtu interesimi i investimeve private në objektet e banimit është mjaft i shprehur.

Potencial tjetër është iniciativa e popullatës për investimet në banim në rritjen dhe zgjerimin e hapësirave ekzistuese.

Potencialet mund të numërohen në bazë të këtyre kritereve:

Organizative

- Resurset humane
- Institucionale (niveli qendror, dhe ai lokal)

Financiare

- Interesi i sektorit privat për investime
- Themelimi i fondit të banimit,

Politike

- Politika e banimit dhe zhvillimit urban
- Ligji i banimit



Hapësinore

- Rritja e kërkesës për banim
- Hapësira të përshtatshme për banim me të cilat disponon Kosova , ende të pashfrytëzuara
- Hapësirat e pandërruara me infrastrukturë të gatshme brenda territorit urban


1.1.3.2.3. Skenari i trendit

Nëse vazhdon skenari i trendit zhvillimit të paplanifikuar me ndërtime ilegale dhe zgjerimi i mëtejshëm i vendbanimeve joformale në zonat urbane dhe jashtë tyre, pasojat negative do të fillojnë të reflektohen në organizimin dhe përmbajtjen e funksioneve të brendshme të vendbanimeve, si dhe në kualitetin e jetës së banorëve. Vështirësitë do të jenë të shprehura në këto aspekte:

- Vështirësitë në rregullimin e marrëdhënieve pronësore juridike;
- Shërbimet dhe infrastruktura do të jetë vështirë të ofrohen për shkak të rritjes së çmimit nga shfrytëzimi joracional i tokës;
- Shërbimet terciare janë pak të mundshme të sigurohen për këto zona;
- Problemet e ndotjes së mjedisit nga mungesa e infrastrukturës;
- Problemet e ngarkesave në trafik, për shkak të rritjes së distancave;
- Cenimi i korridoreve të infrastrukturës;
- Humbje të pakthyeshme të resursit të tokës bujqësore.

1.1.3.2.4. Shfrytëzimi joracional i hapësirës - raporti banim individual dhe kolektiv në zonat urbane

Zonat urbane karakterizohen me shtrirje horizontale të banimit në përqindje shumë të madhe në krahasim me atë kolektiv. Raporti banimi individual, dhe ai kolektiv në kuadër të zonës urbane është: 90 % banim individual, 10 % banim kolektiv në shumicën e qyteteve të Kosovës



Ri-shfrytëzimi i hapësirave në kuadër të zonave urbane, është komponentë tjetër shumë e rëndësishme në shfrytëzimin racional të hapësirës. Planet komunale dhe planet zhvillimore urbane duhet të ofrojnë udhëzime të qarta mbi lokacionin e zhvillimeve të reja ashtu që të plotësojnë nevojën për banim në mënyrën të qëndrueshme. Në nivelin komunal, DPU duhet të identifikojnë zonat kryesore të zgjerimit të vendbanimeve, dhe të përcaktojë hapësirat ku ofrimi i banimit duhet të kërkohet nga plani zhvillimor komunal, duke marrë parasysh kapacitetin e vlerësuar;

1.1.3.2.5. Mungesa e planeve zhvillimore urbane dhe planeve zhvillimore komunale

Qytetet e Kosovës sot ballafaqohen me zhvillime joformale dhe ndërtime pa leje. Shfrytëzimi joracional i hapësirës në zonat urbane dhe rurale, mungesa e planeve zhvillimore që do të tregonin kahen e zhvillimit të qyteteve, krijojnë një mjedis të papërshtatshëm për banorët e Kosovës pothuajse në të gjitha aspektet e zhvillimit: social, ekonomik, mjedisorë-zhvillimor etj. Mungesa e planeve ose planet e vjetruara nuk sigurojnë plotësimin e kërkesave të banorëve për ndërtime të reja, me infrastrukturë fizike dhe sociale të nevojshme për një jetë bashkëkohore.

Pasojat e kësaj janë:

- zhvillim jo i barabartë në mes të zonave urbane dhe rurale;
- krijimi i zonave të banimit pa infrastrukturë të duhur fizike dhe sociale (vendbanimet joformale);
- ndërtimi i objekteve ilegale në zonat urbane dhe rurale dhe përgjatë magjistrave;
- krijimi i mjedisit të papërshtatshëm jetësor;
- mungesa e kujdesit adekuat ndaj trashëgimisë natyrore, dhe kulturore etj;
- problemet pronësore juridike.

1.1.3.2.6. Mungesa e infrastrukturës teknike në zonat e banimit, sidomos në vendbanimet rurale

Ndër problemet kyçe që i atakon vendbanimet urbane dhe rurale është infrastruktura teknike, e cila në viset rurale është si problem me i shprehur. Mungesa e infrastrukturës teknike në zonat urbane e vështirëson jetën normale dhe ulë dukshëm kualitetin e jetës.

Në zonat rurale mungesa e infrastrukturës teknike përveç që ndikon negativisht në kualitetin e banimit të banorëve të vendbanimeve, në mungesë edhe të shërbimeve shëndetësore arsimore, mungesë e zhvillimit ekonomik në zonat rurale, bën që kualiteti i jetës në këto vendbanime të jetë mjaft i papërshtatshëm, si rezultat kemi paraqitjen e një gjendjeje të vështirësuar sociale, varfëria mjaft e shprehur, migrimet e popullatës drejt zonave urbane, papunësia etj.

1.1.3.2.7. Dislokimi dhe rilokimi e vendbanimeve

Dislokimi dhe rilokimi i vendbanimeve imponohet për shkak të shfrytëzimit të pasurive minerale të Kosovës dhe evitimit të rrezikshmërisë së popullatës nga ndikimet e ndotjes së mjedisit dhe fatkeqësive natyrore. Janë procese të gjata kohore të cilat kërkojnë jo vetëm mjete financiare të mëdha por edhe një politikë të qartë në lidhje me sigurimin e hapësirës së nevojshme për banim, duke marrë parasysh trajtimin e aspekteve sociale, ekonomike dhe mjedisore të cilat shoqërohen me dislokimin e banorëve. Problemet e dislokimit janë:

- Rrezikimi i vendbanimeve nga ndotja e mjedisit dhe fatkeqësitë natyrore - vërshimet, tërmetet, erozioni dhe rrëshqitja e dheut;
- Vështirësitë gjatë procesit të eksproprijimit, zhvendosjes, dhe rilokimit të cilat manifestohen në aspektin social, ekonomik dhe mjedisor etj.





1.1.4. MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

Territori i Kosovës shtrihet në lartësi mbidetare në mes të pikës më të ulët 265m - në Vërmicë, në grykëderdhje të Drinit Bardhë dhe pikës më të lartë 2656m - Maja e Gjeravicës, në Bjeshkët e Nemuna.

Relievi në Kosovë dallohet me: vise të larta (Bjeshkët e Nemuna - Alpet Shqiptare; Malet e Sharrit; M.e Kopaonikut dhe M. Qendrore) dhe vise të ulëta (Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës me disa lugina lumenjsh). E gjithë sipërfaqja e Kosovës e ndarë në bazë të lartësisë mbidetare tregohet si në vijim: më tepër se 17% e sipërfaqes shtrihet në lartësi mbidetare më të vogël se 500m. Pjesa më e madhe e sipërfaqes (63.4%) së Kosovës shtrihet në lartësitë në mes 500 deri në 1000m lartësi mbi detare, ndërsa në lartësitë prej 1000 deri në 2000m janë vetëm 17% e territorit të Kosovës. Sipërfaqet (2.3%) më të larta të Kosovës shtrihen në lartësi mbi 2000m' ku shtrihet maja më e lartë e Kosovës - Maja e Gjeravicës në lartësi prej 2656m' nga niveli i detit.

Kosova shtrihet në brezin e gjerësisë së mesme gjeografike veriore dhe karakterizohet me klimë të mesme kontinentale. Amplitudat $-20C^{\circ}$ gjatë dimrit dhe deri $+38C^{\circ}$ gjatë verës dhe reshje mesatare vjetore prej 700mm.

1.1.4.1. Ndotja e ajrit ²⁴

Cilësia e ajrit në vendin tonë tregon zbrazëtira domethënëse kur bëjmë krahasimin me standardet e BE -së për mjedisin. Monitorimi i të gjithë indikatorëve të përcaktuar me Ligjin e ajrit nuk ekziston ende dhe si pasojë e kësaj edhe të dhënat nuk janë të plota dhe konsistente. Burimet potenciale të ndotjes së ajrit konsiderohen:

- Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B);
- Mihjet sipërfaqësore të linjtit në Obiliq;
- Kompleksi industrial në Mitrovicë;
- Feronikeli në Gllgovc;
- Fabrika e përpunimit të metalit në Janjevë;
- Fabrika Ballkan në Therandë;
- Fabrika e çimentos-Sharçem në Han të Elezit;
- Sistemet për ngrohje qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë);
- Prodhimi i bazës së asfaltit;
- Trafiku, etj.

Amëvisëria - Numri i popullësisë që janë të kyqur në sistemin e ngrohjes qendrore llogaritet të jetë vetëm 11 %, kështuqë energjia për ngrohje sigurohet nga djegia e drurit dhe thëngjillit. Konsumi i energjisë për ngrohje, në amvisëri përdoret në mënyrë të pa kontrolluar, dmth nuk ka statistika të sakta për numrin e amvisërive dhe shërbimeve tjera, se çfarë burimi të energjisë për ngrohje shfrytëzohet dhe çfarë sasie. Sasitë e lirit të emetimeve nga sektori i amëvisërisë vetëm mund të supozohen sepse ende nuk është bërë ndonjë studim i veçantë për këtë kategori të ndotësve.

Energjetika - Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të madhe të mjedisit në Kosovë, posaçërisht në rajonin e Prishtinës. Emisionet e gazrave nga TC-të me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit, e po ashtu shkarkimin e gazrave serë. Probleme shtesë janë edhe deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milion tonelata hi dhe zënë rreth 150 ha tokë, si dhe krateret e hapura gjatë mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit.

Industria - Burimet potenciale të ndotjes së ajrit nga industria konsiderohen:

- Fabrika e çimentos-Sharçem në Han të Elezit;
- Kompleksi industrial në Mitrovicë;
- Feronikeli në Gllgovc;
- Industria kimike, ushqimore, përpunimi i metaleve;
- Aktivitetet eksploatuese, thërrmuese dhe separuese të gurit gëlqeror, rërës Zhavorit, bazave të betonit dhe asfaltit.

²⁴ Draft Strategjia dhe Plani i Veprimit për cilësinë e ajrit, 2010

Ndikimet kryesore në mjedis nga fabrika e çimentos janë ndikimet në ajër nga oxhaku i furrës si rezultat i zberthimeve fiziko - kimike të lëndës së parë.

Pluhuri - ndikimi më i madh në ambient nga fabrikat e çimentos është nga emisionet e pluhurit. Keto emisione kryesisht shkaktohen nga mulliri i pregaditjes së lëndëve të para dhe kontrollohen më së miri përmes filterave elektrostatik ose filterave mekanik me thasë të cilët janë të instaluar para burimeve për shkarkim në mjedis.

Efikasiteti i filterave elektrostatik arrin shkallen e filtrimit dei në $50\text{mg}/\text{m}^3$ kurse i atyre mekanik me thasë arrin shkallën deri në $20\text{mg}/\text{m}^3$.

Pluhuri fluturues - kryesisht shkaktohet nga depot e lëndës së parë dhe depoja e klinkerit si dhe nga trafiku i mbrendshëm i fabrikës.


Oxidet e Azotit (NOx) - emisionet e NOx kryesisht shkaktohen si rezultat i proceseve te djegies jo të mirë në furrat rotative të çimentos e shumë pak si NOx nga lëndët djegse.

Dioxidi i Sulfurit (SO₂) - emisionet e SO₂ nga fabrikat e çimentos paraqiten si rezultat i presences së sulfurit në lëndën e parë dhe prezencën e sulfurit në lëndën djegse i cili zakonisht lidhet me klinker dhe shumë pak emitohet në atmosferë.

Komponimet Organike të Avullueshme (VOC) - prezenca e këtyre emisioneve shkakton "smogun-fotokimik" dhe ndikon në shtresës së ozonit.

Gazrat serrë - në kuader të gazrave serrë CO₂ në industrinë e çimentos është në përqindje më të madhe afro 65% pastaj metani CH₄ 20%, oksidet e azotit me 5%. Industria e çimentos është gjeneruese e afro 5% te emisioneve globale të CO₂ në botë.

Emisionet e CO₂ - Në grafikun e paraqitur më poshtë mundë të vërehet se edhe pse vlerat e emisioneve absolute të CO₂ tregojnë rritje, ato janë më të vogla për 9% ndaj rritjes së prodhimit të çimentos në krahasim me vitet paraprake.



Ndotja e trashëguar dhe aktuale në Mitrovicë - Mitrovica me pasojat nga mbeturinat industriale të mbetura nga kompleksi i Trepçës, numërohet poashtu ndër burimet e mëdha të ndotjes. Në të shumtën e rasteve ndotja paraqitet në formë të emisioneve të dioksidit të

sulfurit (SO₂), oksideve të azoti (NO_x), ozonit (O₃), plumbit (Pb), dioksid karboni (CO₂), pluhuri, tymi, grimcat e patretshme dhe dioksinat.

Gjendja mjedisore në Feronikel - Gllgovc - Kompleksi Industrial i Ferronikelit përbëhet nga dy miniera sipërfaqësore dhe nga shkretorja: Minierat sipërfaqësore janë:

1. Miniera e Çikatovës
2. Miniera e Gllavicës

Problemet kryesore të ndotjes së mjedisit nga minierat janë se gjatë mihjes lirohet sasi e madhe e pluhurit, e kjo sidomos gjatë stinës së verës, çka e dëmton mjedisin. Në nyjën e xehes në të cilën bëhet përgatitja e xehes lirohet sasi e madhe e pluhurit i cili është i rrezikshëm për mjedisin dhe vetë shëndetin e punëtorëve që punojnë në këtë repart sepse xehja e Fe-Ni ka mbi 50% SiO₂.

Transporti - Sektori i transportit është mjaft specifik në raport me mjedisin ngase paraqet ndikime negative serioze gjatë ndërtimit dhe operimit. Transporti ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit në Kosovë (posaçërisht në mjediset urbane) duke ndotur ajrin, ujin dhe tokën. Gjithëashtu transporti kontribuon në ndryshimet klimatike, ndryshimet e peizazhit dhe shfrytëzimit të tokë, degradimin e mundshëm të habitateve dhe trashëgimisë kulturore gjatë fazave të ndërtimit. Sistemi i tanishëm paraqet rrezikshmëri në rritje për shëndetin njerëzor dhe për mjedisin për arsye të rritjes së madhe të mjeteve të transportuese në rrugët tona si e vetmja formë kryesore e transportit. Shumë prej automjeteve në Kosovë janë më të vjetra se 20 vjet, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre teknikisht nuk janë në rregull. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka identifikuar rreth 572 pompa të benzinës në Kosovë gjatë shërbimit i cili është kryer 2003/2004 apo rreth 1 pompë të benzinës për 463 automjete.

Është bërë një krahasim i emisioneve nga veturat me emisionet nga KEK-u, edhe pse emisionet nga KEK-u, për PM₁₀ janë 10 herë më të mëdha, si dhe dy herë më të mëdha për NO_x, mund të pritët që ndikimi i PM, No₂ dhe benzenit, nga transporti rugor të jetë i madh për shkak të distancës shumë të shkurtër në mes të veturave (emetuesit) dhe njerëzve (pranuesit).

Modelet e llogaritjes të dispersionit për impiantet e mëdha për djegie dhe emisionet nga transporti në Berlin, sugjerojnë që emisionet nga veturat janë 6 herë më të rëndësishme për koncentriket e ndotjeve, se ato të emisioneve nga oxhaqet 100m mbi tokë.

1.1.4.2. Uji

1.1.4.2.1. Resurset ujore

Pasuria e një shteti çmohet edhe për nga pasuritë ujore. Ujërat në Kosovë shfrytëzohen për pije, për furnizim të industrisë, ujitje, rekreacion etj. Kosova bën pjesë në rajonet me sasira të limituara të resurseve ujore me rreth 1600m³/b.²⁵ Dendësia e madhe e popullsisë dhe vendbanimeve, rritja e qendrave urbane, shfrytëzimi i ujit nga sektorët ekonomikë, shtimi natyror i popullsisë kushtëzojnë nevojën e menaxhimit të veçantë të resurseve ujore në Kosovë.

► Gjendja e resurseve ujore-lumore.

Emri i lumit	Sipërfaqja e pellgut	Prurja m ³ /s	Shkarkimi vjetor mil.m ³	Numri i përgjithshëm i popullsisë Sasia e ujit për m ³ /b (Vlerësim)	
				1985	2000
Drini i Bardhë	4289	61.7	1945.26	746647 2638	1039388 1895
Lumi i Pllavës	360	6.0	190.04	41985 5478	59451 3869
Lumi Lepenc	685	8.4	263.72	109962 2792	153819 1996
Morava e Binqës	1564	8.7	272.76	255553 1291	356057 927
Lumi Ibër	4009	36.4	1146.34	745220 1035	1031193 748
Gjithsej	10907	121.2	3818.12	1899367 1899	2639908 1397

²⁵ Strategjia e Mjedisit-2003

Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11645 km², që është 6,5% më e madhe se sipërfaqja administrative-politike, që do të thotë se pjesa më e madhe e ujërave të Kosovës formohet brenda hapësirës së saj.²⁶

Ujërat e Kosovës u takojnë tri pellgjeve detare. Sipërfaqësisht, me 50,7%, më i madhi është pellgu i Detit të Zi, pastaj pellgu i Detit Adriatik 43,5% dhe më i vogli është pellgu i Detit Egje, me 5,8%.

Sipas bilancit të thjeshtë, mbi territorin e Kosovës bien gjithsej 8957 m³10⁶ ujë, prej kësaj sasia me lumenj rrjedh 39,9% dhe avullohet 60,1% e ujit²⁷. Në pjesën perëndimore të Kosovës mesatarisht bien 836 mm reshje, ose 3890 m³10⁶ ujë, përkatësisht 26,4 l/sec/km² ose 123,2 m³/sec. Prej kësaj sipërfaqeje, mesatarisht në vjet rrjedh 59,7 m³/sec (ose 1882 m³10⁶ ujë apo 12,9 l/sec/km²) me kapacitetin rrjedhës 53%. Më shumë ujë me këta lumenj rrjedh në pranverë(88,1 m³/sec), më pak në verë (29,1 m³/sec, me raportin 3:1). Gjatë periudhës jashtë vegjetative, nga ky pellg rrjedh 72,2 m³/sec, ndërsa gjatë periudhës vegjetative 47,2 m³/sec (raporti 1,5:1). Rrjedhja mesatare e ujërave nga rajoni perëndimor është 59,7 m³/sec, ndërsa nga rajoni lindor 29,5 m³/sec (raporti 2:1), që tregon për deficitin e ujërave në rajonin e Kosovës. Me qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm, për industri dhe ujitje, në skajet e Fushës së Kosovës janë ngritur tri penda artificiale dhe janë formuar tri liqene: *i Badovcit* (mbi lumin Graçanka), *i Batllavës* (mbi lumin e Batllavës, degë e Llapit), *i Gazivodës* (mbi lumin Ibër). Përveç këtyre, në Kosovë janë ngritur edhe këto liqene artificiale: *i Livoçit*, *i Përlepnicës dhe ai i Radoniqit*.

Për nga sasia e ujit të akumuluar, liqeni më i madh është ai i Gazivodës, me vëllim 390 mil.m³ ujë, i Radoniqit me 113 mil.m³ ujë, pastaj i Badovcit me 3l mil.m³ (kur ka qenë i plotë), i Batllavës 30 mil.m³, i Përlepnicës 4,2 mil.m³, i Livoçit 1 mil.m³ dhe i Pridvoricës 0,49 mil.m³ujë.²⁸

Liqeni i Badovcit dhe ai i Batllavës shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të Prishtinës dhe vendbanimeve përreth, si dhe për furnizim me ujë teknik të objekteve industriale.

Pas sjelljes së ujit nga kanali i Liqenit të Gazivodës në Liqenin e Badovcit, në fund të vitit 1995, situata e furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Prishtinës dhe vendbanimet përreth, dukshëm është përmirësuar.

Qytetet e Kosovës, në përgjithësi, kanë probleme të konsiderueshme të furnizimit me ujë të pijshëm. Për furnizim më të sigurt me ujë, nevojitet të ngritën edhe disa liqene artificiale në pjesët periferike të fushave në viset kodrinore-malore e malore, mirëpo, për ngritjen e tyre nevojiten sasi të mëdha të mjeteve materiale.

Rrjedhën më të madhe e kanë lumenjtë e tipit alpin, që i kanë burimet e fuqishme karstike dhe burimet në malet e larta, në të cilat bie më shumë reshje shiu e bore, ndërsa më të vogël e kanë degët e majta të Drinit (përveç lumit të Prizrenit) dhe lumenjtë e Rafshit të Kosovës e të Anamoravës, në pellgjet e të cilëve bien për 50-100% më pak reshje dhe kanë përbërje tjetër gjeologjike.

Liqenjtë natyrorë kanë shtrirje kryesisht në Malet e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna. Dallohen me ujëra me temperatura të ulëta, me ujë të pastër dhe peizazhe të bukura natyrore, që mund të shfrytëzohen për turizëm.

Në Kosovë janë prezentë edhe ujërat mineral dhe termo-mineral siç janë: uji mineral në Kllokot, në Ilixhë, në Malishevë, në Velekincë, në Mirash e në disa burime të tjera. Momentalisht kapacitetet e tyre janë shumë të vogla.

Resurset ujore në Kosovë janë mjaft të kufizuar, prandaj duhet që të hartohet strategjia e domosdoshme e ruajtjes dhe të shfrytëzimit të tyre.

²⁶ Grup autorësh, pjesa e R.Planës, Gjeografia e Kosovës, Prishtinë 1995, fq.30

²⁷ D.Labus, Vodni resursi SAP Kosova, Zbornik radova jugoslovenskog simpozija, Priština 1984, fq.62

²⁸ Grup autorësh, pjesa e R.Planës, Gjeografia e Kosovës, Prishtinë 1995, fq.39-40



1.1.4.2.2. Shfrytëzimi joracional i resurseve ujore

Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore është konsideruar si një çështje shumë e rëndësishme dhe pasojat nga kjo mënyrë e sjelljes ndaj resurseve mund të jenë katastrofale për zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës. Për shume vjet shfrytëzimi i resurseve ka qenë i paplanifikuar, i lënë stihisë dhe pa kontroll të nevojshëm. Kjo situatë është manifestuar që nga instalimi i pushtetit të dhunshëm serb në vitet '90 e deri në themelimin e IPVQ. Shfrytëzimi i agregateve nga lumi kanë shkaktuar dëme të mëdha në shtretërit e lumenjve. Me këtë janë rrezikuar edhe vetë resursi lumor. MMPH së voni ka ndaluar shfrytëzimin e separacioneve nëpër lumenjtë e Kosovës. Kjo tregon për interesin në nivelin qendror që shfrytëzimi joracional i resurseve të ndalohet ose të së paku të vihet nën kontroll.

1.1.4.2.3. Ndotja e ujërave

Lumenjtë në Kosovë janë burime të rëndësishme natyrore në sigurimin e ujit për përdoruesit shtëpiak dhe industrial, për ujitje, hidro-energji dhe për mjediset natyrore të ujit. Mbrojtja e ujërave nga degradimet fizike e sidomos pas vitit 1999 nuk ka qenë nën kontrollin e organeve përgjegjëse andaj ka ardhur deri te degradimi i resurseve ujore.

Janë eksploatuar sasi të mëdha të rërës dhe zhavorrit nga operatorë të ndryshëm në shtretër të lumenjve me lloje të ndryshme të mekanizimit, duke shkaktuar kështu dëme të mëdha në mjedis. Derdhja e vajrave të ndryshme nga makinat operuese ka efekte negative në ujërat e lumenjve si dhe dukuria e pastrimit të rërës në ujë-rrjedhje dhe ndarja e materialit të mbetur dhe depozitimi i tij ka degraduar edhe shtratin e lumit, por ka rritë edhe shkallën e ndotjes së ujërave.

Dukuri negative që ka ndikuar në ndotjen e ujërave është edhe hedhja e mbeturinave përgjatë rrjedhave ujore që ndikon negativisht edhe në ujërat sipërfaqësor.

Deponitë e mbeturinave të ndryshme në sipërfaqen tokësore si ato individuale, komunale, rajonale, industriale etj. ndikojnë negativisht në ujërat nëntokësor dhe ato sipërfaqësorë, ngase nuk janë ndërtuar konform standardeve. Shpëlarja e këtyre deponive që pason nga të reshurat, është element tjetër me rëndësi që ndikon dhe rrezikon botën bimore dhe shtazore.

Faktorë tjetër është edhe përdorimi joprofesional i kemikateve në mënyrë direkte ndikojnë në ndotjen e mjedisit (ujit, tokës dhe ajrit).

Problem tjetër është edhe industria, nga e cila për shkak të proceseve të ndryshme teknologjike lirohen ujëra të pa trajtuara të cilët, në të shumtën e rasteve pa kurrfarë kontrole derdhen në ujërrjedhat e lumenjve duke e rritë kështu shkallën e ndotjes në nivel shumë të lartë (ndotësit industrial më të mëdhenj janë: Korporata energjetike e Kosovës në Obiliq, Kompleksi Trepça në Mitrovicë etj.). Impiantet për trajtimin e ujërave industriale dhe ujërave të zeza në pjesën më të madhe nuk ekzistojnë, por edhe atje ku ekzistojnë nuk funksionojnë fare.

Industria në Kosovë pas vitit 1999 nuk ka qenë shumë aktive, kështu që edhe ndotja e mjedisit nga ndotësit industrial është në shkallë të ulët.

Vetëm gjysma e popullatës së Kosovës është e kyçur në rrjetin e ujësjellësit (44%) e prej saj 8.4% pop. rurale, ndërsa qasje në rrjetin e kanalizimeve kanë vetëm 28% e pop²⁹.

Ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësor janë vendbanimet, janë zonat urbane dhe rurale dhe pjesët industriale të zonave urbane. Ujërat e zeza dhe ato industriale shkarkohen pa kontroll dhe pa trajtim paraprak në lumenj duke shkaktuar kështu ndotjen ujërave me materiale organike dhe mikrobiologjike.


Bazuar në të dhëna më të mira të mundshme totali i shkarkimit të ujërave të zeza në vitin 2004 në Kosovë është 1.200l/s apo 110.000m³⁰/d.

Në bazë të të dhënave kualiteti i ujit në lumenjtë kryesorë të Kosovës është me sa vijon:

²⁹ MMPH-DMU-Gjendja e mjedisit në Kosovë

³⁰ MMPH-DMU dhe KEIM Ëater nga Finlanda: Studim mbi strategjinë për trajtimin e ujërave të zeza

► Shkalla e ndotjes së lumenjëve





1.1.4.3. Toka

Nga e gjithë sipërfaqja e territorit të Kosovës 53% është tokë bujqësore ose rreth 577 mijë hektarë, mandej 41.8% janë tokë pyjore ose rreth 460 mijë hektarë dhe 5.2% janë sipërfaqe tjetër (e ndërtuar dhe ujore) ose 56 mijë hektarë. E shprehur për kokë banori: tokë bujqësore një banori i takojnë 0.24ha dhe tokë pyjore 0.18ha. Sipas bonitetit toka ndahet në tetë klasë prej të cilave vetëm pesë të parat shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore (455.000 ha) prej të cilave në vitin 2002 janë shfrytëzuar vetëm gjysma. Një pjesë e madhe e kësaj toke është e kategorisë I dhe të II, ndërsa pjesa tjetër është tokë e përzier bujqësore ku ka edhe djerrina. Një pjesë tjetër e kësaj sipërfaqeje është nxënë me ndërtime dhe deponi të ndryshme mbeturinash që shkaktojnë degradimin e saj.

► **Raporti i shfrytëzimit të sipërfaqeve në 1.1.4.3.1. Toka bujqësore Kosovë**



Toka bujqësore paraqet njërin ndër resurset natyrore më të rëndësishëm për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore e cila në bruto produktin vendor (GDP - Mujori Makroekonomik, 2003) merr pjesë me 25-27,4%. Kosovarët, bazuar në të dhënat statistikore, rreth 55 % të buxhetit familjar e ndajnë për sigurimin e ushqimit, ndërkohë që në BE është rreth 22%.

Bazuar në kushtet tokësore dhe klimatike territori i Kosovës ndahet në dy zona agroekologjike.

Rrafshi i Dukagjinit që mbulon rreth 48 % të sipërfaqes së përgjithshme, me klimë kontinentale nën ndikim të asaj Mesdhetare,

Rrafshi i Kosovës përfshin rreth 52 % të sipërfaqes, dhe karakterizohet me klimë kontinentale

Duhet te theksohet se në Kosovë nuk ka ndonjë sistem të organizuar të monitorimit të tokës, prandaj nuk ka të dhëna të besueshme për proceset e degradimit të saj. Megjithatë, sipas të dhënave statistikore të viteve të 80-ta (1989) sipërfaqja e përgjithshme bujqësore ka qenë rreth 400.000 ha, nga e cila janë punuar rreth 340.000 ha.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, në pronësi private është 88% (përfshirë këtu 90% deri 95% të tokës së punueshme, 30% te kullosave dhe 38% te tokës pyjore) dhe 12% është në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore (shumica e të cilave, për shkak të statusit të pa definuar të pronës shoqërore, janë lënë djerrinë - nuk punohen).

Në Kosovë nuk është punuar harta e bonitetit të tokës, por me qellim të vlerësimit të sajë është shfrytëzuar klasifikim kadastral.

Megjithatë, sipas të dhënave të disa autorëve mbështetur në pjellorinë e tokës është llogaritur se sipërfaqja bujqësore dhe ajo e punueshme mund të klasifikohen me sa vijon:

klasa I dhe II me 91.900 ha

klasa III me 96.000 ha dhe

klasa IV me 208.000 ha (gjithsejtë klasa I-IV me 396.000 ha).

Bazuar në të dhënat statistikore madhësia mesatare e fermës është 2.2 - 2.4 ha për familje, të ndara në 6-8 ngastra, fermat janë kryesisht të vogla dhe gjysmë komerciale. Më tepër se 60 % e popullatës jetojnë në zonat rurale, ndërsa vlerësohet se 160.000-180.000 ekonomi familjare merren kryesisht me bujqësi.

Qarkullimi bimorë bëhet në bazë të planifikimit dhe ndryshon varësisht nga regjionet. Përparësi i jepet zakonisht prodhimtarisë së drithërave sidomos në Rrafshin e Kosovës e po ashtu janë të njohura zonat me traditë të kultivimit të kulturave pemëtoze dhe vreshtore dhe perimeve sidomos në Rrafshin e Dukagjinit. Disa nga prodhimet në Kosovë kanë qenë të njohura dhe eksportuara edhe në tregjet e Evropës. P.sh. Prodhimi dhe eksportimi i verës si një ndër bizneset e rëndësishme për Kosovën (me kapacitet përpunimi në më shumë se 1.000.000 hl/vit).



Në Kosovë dendësia e popullsisë është 220 banorë në 1km² që do të thotë sipërfaqja e tokës së punueshme për kokë banori vlerësohet se është rreth 0.15ha/b ose 0.24 ha/b tokë bujqësore (nën kufirin kritik prej 0.17 ha/b sa i duhet një vendi për prodhim të mjaftueshëm të ushqimit dhe repromaterialit të nevojshëm për popullatën e saj). Krahasuar me Evropën, Kosova është e varfër me tokë të punueshme bujqësore, në BE mesatarja për një banor llogaritet 0.52 ha.

► Ndarja e tokës sipas kulturave bujqësore

KULTURAT	577,000 ha	100 %
Drithërat	193,078 ha	33,46 %
Bimët industriale	2,520 ha	0,44 %
Perimet	21,500 ha	3,73 %
Patatet	7,500 ha	1,30 %
Vreshtat	4,891 ha	0,85 %
Pemët	4,542 ha	0,80 %
Kullosat	166,769 ha	28,90 %
Livadhet	86,000 ha	14,90 %
Bimë foragjere	38,000 ha	6,59 %
Djerrinat	52,200 ha	9,03 %


Humbja e tokës bujqësore - Në vitet e kaluara e sidomos në vitet e 90-ta të pushtetit të dhunshëm serb në Kosovë, si resurset tjera natyrore, po ashtu edhe toka bujqësore është shfrytëzuar në mënyrë joracionale. Pas çlirimit nga regjimi serb nga fillimi i vitit 2000 e këtej, fatkeqësisht në mungesë të mbrojtjes institucionale, ka vazhduar kjo praktikë duke zënë tokën bujqësore me ndërtime pa leje. Në këtë mënyrë toka e kultivueshme ka humbur (humbja e përhershme dhe e përkohshme) në vazhdimësi. Sot po bëhen përpjekje për të mbrojtur resursin e tokës bujqësore nga shfrytëzimi i saj për qëllime të ndërtimit por rezultatet janë të vogla. Arsye kryesore e humbjes së tillë të tokës është mungesa e planeve zhvillimore urbane dhe komunale. Po ashtu, për shkak të mos kultivimit, shumë sipërfaqe të tokës së punueshme janë shndërruar në djerrina të cilat nevojitet kohë për t'u rikthyer në gjendjen e mëparshme. Llogaritet se brenda vitit në Kosovë humben afërsisht 5.000 ha të tokës bujqësore.

Humbje e përhershme:

- *Vendbanimet;*
- *Veprimtaritë komerciale;*
- *Industria;*
- *Komunikacioni;*
- *Akumulime ujit;*
- *Aeroporte*

Humbje e përkohshme:

- *Mihjet sipërfaqësore;*
- *Eksplotimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës;*
- *Hedhurinat e automjeteve (deponitë);*
- *Mbeturinat industriale;*
- *Mbeturinat komunale;*
- *Procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj).*



**Zënia e tokës
kualitative bujqësore**

Legjenda

- Liqenet
- Kulllosat
- Zona me tokë kualitative bujqësore
- Pyjet
- Rrugët magjistrale
- Rrugët rajonale
- Hekurudhat
- Lumenjtë
- Aeroportet
- Kufijt Komunal
- Kufijt ndërkombëtar
- Industria
- 0.00- 1400
- 1401 - 2400
- 2401 - 4000
- 4001 - 30000
- 30001 - 68000
- 68001 - 600000
- Zonat bazenet_Li_ qymyr

Tipet e tokave

Kosova, edhe pse ka sipërfaqe të vogël, dallohet me llojllojshmëri të tipeve të tokave, në formimin e të cilave ka ndikuar struktura e reliefit, baza gjeologjike, bota bimore, klima e hidrografia dhe njeriu me mjetet dhe mënyrën e shfrytëzimit. Sipas Hartës Pedologjike, e në bazë të Klasifikimit sipas FAO-UNESKO³¹ tipet më të përfaqësuara të tokës në Kosovë janë: shih tabelën:

► Tab. Tipet kryesore pedologjike të tokës

Tipi i tokës	Pjesëmarrja në sip. të përgjithshme (%)	Sipërfaqja e përgjith. (Ha)	Pjesëmarrja (%)	Sipërfaqe Bujqësore (Ha)
Cambisole	42	456512	28.94	99260
Rankere	11.24	121822	0.27	943
Vertisole	10	108444	19.2	65458
Fluvisole	7.71	83862	17.49	59881
Koloviume	6.42	69830	15.23	52160
Litosole	3.87	42143	0	0
Pseudogleje	3.7	40245	8.02	27453
CacoCambisole	3	32631	4.06	13900
Terra Rossa	2.56	27845	0.88	3000
Rendzine	2.42	26332	2.50	8579
Semigleje	1.26	13748	3.43	11753

Nga të dhënat e tabelës mund të konkludojmë se më të përfaqësuara janë takat CAMBIC (rreth 42%), pastaj RANKERET (11%), VERTISOLET (SMONICA) me 10% kurse FLUVISOLET dhe KOLOVIUMET përbëjnë rreth 14%. Këto tipe të tokave karakterizohen me veti të caktuara fizike dhe kimike. Ato kryesisht kanë reaksion acidik, janë të varfra me lëndë organike dhe të varfra dhe deri mesatarisht me lëndë ushqyese.

Tokat më cilësore, që shtrihen në pjesët e ulëta fushore, lugina, tarraca lumore e liqenore, gjithnjë e më tepër po mbulohen me shtëpi dhe oborre, fabrika, rrugë, deponi xeherorësh,

³¹ Sipas hartës pedologjike të adaptuar nga Fakulteti i Bujqësisë - Katedra e Tokave



shkolla, spitale e objekte të tjera. Kjo dukuri po ndodh si rezultat i shtimit të lartë të popullsisë dhe ndërtimit pa plan.

Ujitja e tokave bujqësore


Të gjitha sistemet e ujitjes kanë qenë të organizuara dhe të menaxhuara nga gjashtë Ndërmarrje Shoqërore me kapacitet projektuese për ujitjen e 72.440 ha, prej këtyre 33.490 ha. ujitje me shi artificial dhe 38.950 ha ujitje sipërfaqësore.

Duke u bazuar në përgjithësi para aneksimit të Kosovës është ujitur në rreth 50.000 ha ose rreth 71% të sipërfaqeve nën ujitje, ku mundë të konstatojmë se komplet sistemet e ujitjes ishin në funksion.

- “Ibër - Lepenc”, me seli në Prishtinë
- “Istog”, me seli në Gurrakoc
- “Drini Bardhë” me seli në Pejë
- “Lumi Bardhë” me seli në Deçan
- “Radoniqi”, me seli në Gjakovë
- “Dukagjini”, me seli në Prizren

Nga mungesa e mirëmbajtjes me aplikimin e masave të dhunshme dhe luftës në Kosovë, sipërfaqet ujitës janë reduktuar në gjithsejtë 19.150 ha. në vitin1999.

Drejtoritë e hidrosistemeve (ndërmarrjeve publike) kanë bërë projektet për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes me ndihmën FAO-s dhe Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) ku pas përfundimit të fazës së parë të rehabilitimit të sistemeve të ujitjes në Kosovë (PRUK-I) janë aftësuar rreth 23.984 ha. (sipas të dhënave të KRU-ve).



Mundësitë e ngritjes së mikro-akumulimeve dhe hidrosistemeve në Kosovë, e që sipas Bazës së Hidroekonomis së Kosovës të vitit 1982 parashihet të ujitjen rreth 200.000 ha. ose 18 % të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës, e cila ka tokë të klasit I; II; dhe III e që janë të klasifikuara si të përshtatshme për ujitje.





Kullimi i tokave bujqësore

Studimet specifike si pasojë e lagështisë së tepërt të tokës nuk janë zbatuar në territorin e Kosovës përpos për:

- Pjesën vërshuese të zonës së luginës të lumit Sitnica;
- Një projekt në territorin e Vitisë në sipërfaqe prej 1.500 ha. (Morava e Binçes).
- Dy,tri projekte në sipërfaqe të vogla në territorin e Prizrenit rreth 600 ha.
- Në kuadër të sistemit të ujitjes në HS. “Radoniq” KK. Gjakovë vlerësohet rreth 3.500 ha.
- Në kuadër të HS. “Ibër-Lepenc” është punuar projekti i kullimit për 3.000 ha. me sistem të kanaleve të hapur dhe drenazh të kombinuar.

Zgjidhja për këto sipërfaqe kërkohet me qëllim të përmirësimit të rezhimit uJOR, ujitjes dhe rritjes së mundësisë për një prodhimtari të planifikuar.

Parashihet se për kullim të tokës bujqësore në Kosovë duhet të merren të gjitha sipërfaqet të cilat janë nën ndikimin e ujit të tepërt e që janë të dëmshme për kultivimin e bimës. Kjo sipërfaqe sillet sipas Bazës Hidroekonomike të Kosovës prej 80.000 - 100.000 ha.

Në takimet e mbajtura në disa qendra të Kosovës problemi i humbjes së tokës kualitative bujqësore u rendit ndër çështjet më të rëndësishme dhe që kërkojnë zgjidhje të ngutshme. Nga këto takime u propozuan disa rekomandime nga të cilat më të shpeshta ishin ato që bënin fjalë për mbrojtjen sa më të madhe të këtij resursi të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës.

- Strategjia për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë
- Zhvillimi i politikave të mirëfillta në bujqësi
- Favorizimi i prodhimeve vendore
- Mbrojtja me ligj e tokave bujqësore
- Riparcelizimi i tokave bujqësore-komasacioni
- Vënia dhe zbatimi i dënimeve rigoroze për ata që e rregullativës ligjore për mbrojtjen e fondeve tokësore
- Favorizimi i ndërtimeve në lartësi si masë për ruajtjen e tokës bujqësore.
- Stimulimi i bujqësisë dhe blegtorisë, përmes kredive me kamata të volitshme.
- Stimulimi i biznesit rural
- Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimet ilegale, deponitë e egra, etj.

Këto rezultate ishin burim i formulimit të qëllimeve specifike që rrjedhën nga qëllimet kryesore të vizionit për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të Kosovës:

- Ngritje e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale
- Krijim i vendeve të mjaftueshme për punë
- Avancim i teknologjisë prodhuese
- Krijim i kushteve për konkurrencë në tregun rajonal
- Zhvillim hapësinor i balancuar
- Stimulim i politikave të zhvillimit të zonave rurale
- Mbrojtja e resurseve natyrore (ajri, uji dhe toka)

1.1.4.3.2. Degradimi i sipërfaqeve tokësore

Prerja e pyjeve - njëri ndër shkaktarët e degradimi të tokës në Kosovë është edhe prerja e pakontrolluar e pyjeve. Në bazë të shënimeve që disponojmë janë më tepër se 12 mijë hektarë pyje të dëmtuara. Një pjesë e madhe e tyre janë dëmtuar edhe nga zjarret e shkatëruara në disa komuna që shkatërruan më tepër se 545 hektarë, pjesa më e madhe e tyre janë në komunën e Pejës, Gjilanit dhe Prishtinës. Degradimi i pyjeve ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve të tëra të tokës të cilat e kanë rolin mbrojtës.

Gurëthyesit dhe seperacionet - shkaktar tjerë janë edhe gurthyesit dhe seperacionet, nga të dhënat që disponojmë, veprojnë 120 kompani, 39 me veprimet e të cilave po ndërrohet konfiguracini i terrenit e në veçanti i shtretërve të lumenjve.

Deponitë - sipas supozimeve të GTZ³²-së për sasinë e mbeturinave të prodhuara në Kosovë për vitin 2000-2001, në Kosovë janë „prodhuar“ 1.2 kg mbeturina për kokë banori në ditë (438kg ose 3.2 m³ në vit). Në përbërje të kësaj sasive, përveç mbeturinave shtëpiake, hyjnë edhe mbeturinat e aluminit, qelqit, plastikës, tekstilet etj. Ndërsa sipas shënimeve të fundit nga GTZ-ja, rezultati është 0.6 kg/banor në raportin ditor. Nga 30 komuna të Kosovës 26 kanë pasur deponi (fushëhedhurinë) komunale qysh prej shumë viteve, kurse tani janë evidentuar edhe rreth 140 vendgrumbullime të tjera.

Menaxhimi i mbeturinave është përmirësuar dukshëm falë donacioneve të ndryshme (AER-it, COOPI-it dhe DANID-ës), të cilët me programet e tyre kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve sa i përket menaxhimit të mbeturinave komunale. Disa nga deponitë komunale janë rehabilituar ndërsa disa të tjera që kanë qenë vatra të ndotjes dhe degradimit të mjedisit janë mbyllur. Është filluar ndërtimi i deponive rajonale të nivelit të lartë, një pjesë e madhe e të cilave kanë filluar punën si në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Podujevë, Ferizaj, Dragash dhe Zveçan.

Shërbimet e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave në Kosovë kryhen nga shtatë kompani regjionale të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime kryesisht në zonat urbane. Në bazë të numrit të konsumatorëve shtëpiak të cilët faturohen është vlerësuar se numri i popullatës që u ofrohen shërbimet e grumbullimit të mbeturinave është 794.081 banorë ose 39 %. Totali i mbeturinave të grumbulluara nga shtatë kompanit regjionale të mbeturinave në vitin 2008 është 233.835 ton. Prej kësaj sasive 194.497 ton janë deponuar në deponitë sanitare, kurse sasia tjetër e mbeturinave 39.338 ton në deponitë e vjetra komunale. Kjo para se gjithash ka të bëjë me kompanin regjionale të mbeturinave „Çabrati“ që edhe në vitin 2008 ka vazhduar t’i deponojë mbeturinat në deponin e vjetër të Gjakovës.


TC - A dhe B bashkë prodhojnë më shumë se një milion ton të hirit brenda vitit, nga kjo sasi rreth 700.000 ton janë të depozituar në deponitë e hirit, kurse 300.000 ton lirohen në ajër. Mbeturinat medicinale që krijohen në spitale dhe objekte tjera shëndetësore në tërë vendin tonë brenda ditës arrin sasinë rreth 5500 kg, kurse brenda vitit rreth 2.014.500 kg apo 2.014.5 ton. Kjo vlerë kur llogaritet për kokë banori, në raport ditor është 0.0023 kg. Këto mbeturina nuk trajtohen në mënyrë të duhur, nuk grumbullohen e as nuk transportohen sipas normave dhe standardeve të parapara. Në Kosovë ekzistojnë qendra të cilat posedojnë furrat për djegien e mbeturinave spitalore, këto furra gjenden në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Pejë, në të cilat bëhet djegia e vetëm 20 - 30 % e mbeturinave medicinale, kurse pjesa tjetër hudhet në kontejner të mbeturinave komunale, sidomos në sektorin privat.

Materiet e rrezikshme që janë të mbledhura në disa komuna, poashtu janë ndotës të tokës, ajrit si dhe ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Në Kosovë janë evidentuara 110 pika të nxehta, si lokacione që janë të kontaminuara nga metalet e rënda, produktet kimike, vajrat e përdorura dhe ndotës të tjerë.³³



³² GTZ - Organizatë e Qeverisë Gjermane për ndihmë dhe bashkëpunim teknik

³³ Raport - Gjendja e mbeturinave në Kosovë, 2008; Performanca e kompanive publike të ujit dhe mbeturinave, 2008.



Zhurma - Transporti rrugor, ajror, gjeneratorët, veprimtaritë e ndryshme po edhe sporti dhe aktivitetet e lira janë burime potenciale të zhurmës të cilët ndikojnë në uljen e kualitetit të jetës në vendbanime. Hulumtimet tregojnë se ngarkesa e zhurmës ndikon në shëndet të njeriut, në pagjumësi, e deri tek smundjet kardio-vaskulare. Edhe pse në Kosovë nuk ekziston sistemi monitorues për zhurmën , ajo tregohet si shumë e lartë në çdo mjedis.

1.1.4.3.3. Pyjet

Pyjet mbulojnë 42% të sipërfaqes së Kosovës dhe janë burim kryesor i mirëqenies ekonomike, sociale dhe mjedisore, janë rregullator natyror të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit dhe mbrojnë token nga erozioni, janë akumulues të mëdhenj, të sasisë së CO2 në tokë dhe furnizues kryesor të atmosferës më Oksigjen. Pyjet anë resurse të ripërtëritshme, produktet e të cilave mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi mjekësore dhe ushqyese për njeriun.

Ndikimi i njeriut në pyje është shumë i theksuar. Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore si ndryshime klimatike, vërshime etj.

Gjatë inventarizimit pyjor të vitit 2003 është vlerësuar se sipërfaqja totale e pyjeve është 464.800 ha prej së cilës 278.880 ha janë prone publike dhe 185.920 ha janë prone private. Pyjet gjethegjera mbulojnë 90% të sipërfaqes me llojet e ahut dhe lisit. Vëllimi total i lisave më të mëdhenj se 7 cm në diametër, në pyjet publike vlerësohet të jetë 33.5 milion m³ dhe në pyjet private sillet rreth 19.5 milion m³. Prerja e lejuar vjetore sillet rreth 900.000 m³ bruto me 700.000 m³ në pyje të larta dhe rreth 200.000 m³ në pyje të ulëta. Gjatë inventarizimit është vlerësuar se rreth 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private janë prekur nga aktivitetet e prerjes ilegale dhe se shumë pyje të reja dhe të moshës së mesme kanë nevojë urgjente për intervenime duke përfshirë pastrimin dhe rrallimin.

Vëllimi i përgjithshëm drunor në këmbë është rreth 40 milion m³. Vëllimi mesatar vjetor për hektar është 90 m³/ha. Shtimi vjetor i përgjithshëm është llogaritur rreth afro 1.3 milion m³. Rritja vjetore është llogaritur rreth 3 m³/ha.

► Sipërfaqja pyjore në bazë të origjinës dhe pronësisë (ha)³⁴

Origjina e grumbullit	Shtetërore	Private	E panjohur	Gjithësej
Përkohësisht pa trungje	21,200	7,600	3,400	32,200
Farim natyral(trungishte)	82,000	74,000	15,200	171,200
Pyllëzime ose farim artificial	1,800	400	-	2,200
Cungishte të përziera/Farim ose pyllëzime	17,600	19,000	-	36,600
Cungishte	64,000	54,000	19,000	137,000
Nuk ka shënime	1,000	400	80,200	81,600
T o t a l i	187,600	155,400	117,800	460,800

Gjatë dekadës së kaluar prerjet e planifikuara/raportuara të prerjes së drurit fletorë për industri kanë qenë të nivelit 70,000 m³ - 90,000 m³, e cila është vetëm gjysma e vëllimit të potencialit sipas inventarizimit të pyjeve. Rritje e potencialit në furnizimin e drunjve fletor mund të arrihet përmes menaxhimit të përmirësuar pyjor, dhe përdorimit të trungjeve të ahut me madhësi mesatare. Një redistribuim i tillë i përdorimit, megjithatë, kërkon një instalim të mjeteve për dizajnimin dhe përpunimin e dimensioneve të vogla.

Prerjet e pyjeve janë përqëndruar më shumë në zonat në të cilat ka çasje më të lehtë përmes rrugëve. Tani diku rreth 200.000 m³ dru në vit prehen legalisht. Që nga mbarimi i luftës shumica e masës drunore është shfrytëzuar për dru zjarri dhe ky është burim kryesor për nxemje, bile edhe në disa zona urbane. Kërkesa për dru zjarri është e madhe, kështu që sipas vlerësimeve supozohet se kërkesa kombëtare sillet afër një milion m³ në vit.

Pjesa më e madhe e pyjeve të Kosovës rreth 50% i takon vjetërsisë prej 0 - 20 vjet, ndërsa pjesa më e vogël e pyjeve rreth 17% i takon vjetërsisë 60 - 80 vjet.

► Klasa e vjetërsisë së pyjeve sipas pronësisë në % (APK 2006)

Klasa e vjetërsisë	Pyejt publike	Pyjet private
0 - 20	29%	23%
20 - 40	18%	32%
40 - 60	11%	23%
60 - 80	9%	8%

³⁴ Shënime janë marrë nga inventarizimi nacional i pyjeve (Dhjetor) 2003.

Pyllëzimet në Kosovë mesatarisht janë rreth 240ha për vit. Ekziston një fidanisht në Pejë nën kontroll të Institutit Hulumtues Pyjor, i cili prodhon rreth 700.00 fidane në vit. Llojet kryesore janë pishat (Pinus Nigra dhe Pinus sylvestris), hormoqi (Picea alba) dhe Dugllazi (Pseudotsuga taxifolia). Për çdo vit APK alokon rreth 10% të fidaneve të prodhuara për sektorin privat. Deri më tani sukcesi më i madh në pyllëzime është konsideruar pyllëzimi i përzier dhe kjo kur është ndërmarr edhe nga Agjencia Pyore e Kosovës apo sektori privat. Një studim i vitit 2001 për sektorin e pylltarisë ka konkluduar se vlera vjetore e produkteve dhe përfitimeve tjera të pyjeve dhe tokave pyjore është prej 50 - 70 milion euro. Aktualisht kontributi i sektorit të pylltarisë në GDP është vlerësuar të jetë në mes të 1.8% deri në 2.6%.

► Pyllëzimi i pyjeve sipas llojit dhe pronësisë (MMBPZHR, 2003)

Lloji i pyllëzimit	Pyjet publike	Private	E panjohur	Gjithësejt
Përkohësishtë pa trungje	21.200	7.600	3.400	32.200
Pyllëzim natyral	82.000	74.000	15.200	171.200
Pyllëzim artificial	1.800	400	-	36.600
Pyllëzimi i përzier	64.400	54.000	19.000	137.000

Inventarizimi ka vlerësuar se rreth 40% të pyjeve publike dhe 29% të pyjeve private kanë qenë subjekt i aktiviteteve të prerjeve të pakontrolluar apo ilegale. Gjithashtu rezultatet e inventarizimit konfirmojnë opinionet e ekspertëve se pyjet e ulëta veçanërisht ato në pronësi publike janë të ekspozuar shumë me prerje për dru zjarri. Rezultatet po ashtu tregojnë se shumë pyje të reja dhe të moshës mesatare kanë nevojë urgjente për intervenime menaxhuese, duke filluar me pastrime/rrallime para komerciale e deri te rrallimet komerciale. Pyjet gjithëashtu janë burim i produkteve jo-drusore. Këtu përfshihen kërpudhat e egra, manaferrat, pemët, lajthia, gështenja dhe produktet që rrjedhin prej tyre (marmelada, lëngje, xhelatina, etj), mjaltë, rërë, zhavor dhe gurë/minerale. Gjithëashtu ekzistojnë mundësi për të zhvilluar gjuetin dhe agro/eko-turizmin.

Pyejt e Kosovës janë të ndara në pyje të larta, pyje të ulëta, shkurre dhe pyje të degraduara. Pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës e përbëjnë pyjet e ulëta 42%, ndërsa pjesën më të vogël pyjet e larta 15%.

► Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë në ha dhe % (APK)

Lloji i pyjeve	Pronësia			%
	Shtetërore	Private	Gjithsejtë	
Pyjet të larta	51000	15000	66000	15
Pyjet të ulëta	116000	63000	179000	42
Pyje të degraduara	34000	48000	82000	20
Shkurre/kaçuba	67000	36000	103000	23
Gjithsejtë	268000	162000	430000	100

Mbi 50.000 ha të pyjeve janë të shtrira në zona të mbrojtura. Pjesa më e madhe e tyre i takon Parkut Nacional “Mali Sharr” (18.884 ha) dhe “Gërmia” (885 ha).

Sipas të dhënave të prezentuara në raportin e publikuar nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së pyjeve të dëmtuara nga zjarri, rreth 6.682 ha e pyjeve të Kosovës gjatë vitit 2007 është përfshirë nga zjarri. Nga kjo sipërfaqe 4.142 ha janë pronë publike, ndërsa 2.548 ha janë pronë private. Rreth 1.439 ha e sipërfaqes së dëmtuar nga zjarri është kullota. Vëllimi i humbur në m³ dru zjarri shprehur në euro llogaritet të jetë rreth 29.645, ndërsa vëllimi i humbur në m³ dru teknik është 17.170. Vlera e humbur e masës drunore në këmbë është 2.942.338.

1.1.4.3.4. Pasuritë nëntokësore

Burimet minerare të Kosovës janë kryesisht me prejardhje magmatike, si ato metalike, po ashtu edhe ato jometalike dhe ujërat termominerale.³⁵ Në bazë të hulumtimeve intensive gjeologjike, të kryera sidomos gjatë viteve 1953/66, Kosova ka rezerva të konsiderueshme të metaleve, jometaleve dhe qymyrit. Studimet gjeologjike të mëhershme dhe pas viteve 70,

³⁵ Pruthi Valdet, “Metodologjia bashkëkohore në hulumtimin e materies rajonale gjeologjike në Kosovë, me trajtim të veçantë në metalogjenin dhe prognozën e mineraleve “(disertacion i doktoratës, Mitrovicë 1986, fq.42
Institutit Ekonomik në Prishtinë: “Pasuritë natyrore dhe ndikimi i tyre në zhvillim dhe ndryshimet strukturore në ekonominë e Kosovës”, Prishtinë, 1981. Të dhënat për begatitë minerare janë marrë kryesisht prej këtij studimi, në përpilimin e të cilit kanë marrë pjesë shumë autorë, ekspertë të lëmisë së gjeologjisë e xehetarisë

tregojnë për rezervat e konsiderueshme të xeheve metalike dhe jometalike, të shtrira kryesisht në rajonin e Rrafshit të Kosovës dhe Drenicës.


Kosova ka burime energjetike të mëdha në thëngjill (linjit) dhe fuqi hidroenergjetike të lumenjve. Në bazë të studimeve gjeologjike, në Kosovë janë vlerësuar rezerva linjiti në sasi prej 10-12 miliardë tonësh në të dy basenet kryesore, të Kosovës dhe Dukagjinit. Shtresat e sipërme janë të cilësisë më të mirë sesa të shtresave të thella. Baseni i qymyrit të Kosovës përbëhet prej tri fushave: veriore, qendrore dhe jugore².

► Rezervat e burimeve minerare të Kosovës (në milionë tonë) dhe vlerësimet në vitin 1985.

Rezervat A + B + C		1985
I. Burimet energjetike minerare		
1.	Linjiti (miliardë tonë)	12.0
2.	Nafta (mil.tonë)	1.0
II Burimet minerare metalike		
1.	Xehja e boksitit	5.0
2.	Xehja e plumbit dhe zinkut	75.0
3.	Xehja e nikelit	40.0
4.	Xehja e kromit (1000 tonë)	0.6
5.	Xehja e hekurit	5.0
6.	Xehja e manganit	6.36
III Burimet minerare jometalike		
1.	Rërë kuarci dhe kuarcit	30.0
2.	Magnezit	17.0
3.	Argjil i padjegshëm	8.0
4.	Xehe azbesti	20.0
5.	Bentonit	120.0
6.	Tuf	30.0
7.	Lapor çimentoje	175.0
8.	Gur zbukurues	5.0

Burimi: Plan i Strategjik i Zhvillimit të Kosovës 1985-2000 (Enti për Plan dhe Zhvillim i Kosovës)

Shfrytëzimi i linjtit nga basenet në Obiliq, përkundër nevojës së madhe për prodhimin e energjisë elektrike, nuk është në harmoni me kriteret e qëndrueshmërisë, pasi që kthimi i tokës në gjendjen e mëparme nuk është pjesë e procesit të nxjerrjes së linjtit.





1.1.4.4. Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.³⁶

Trashëgimia kulturore është pasuri e përgjithshme, që duhet të shfrytëzohet dhe mbrohet nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjeneratat e ardhshme.

Në bazë të koncepteve themelore të UNESCO-s secili element, monument apo tërësi e trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unike dhe zhdukja e cilitdo prej tyre përbën humbje definitive dhe të pakthyeshme të trashëgimisë.

Rregullimi i planifikimit hapësinor duhet të bazohet në parimet ndërkombëtare:

1. Promovimi e interesave të përbashkëta të vendit duke mbrojtur resurset natyrore dhe kulturore, të mbështetur në zhvillim të qëndrueshëm;
2. Përparimi i trashëgimisë kulturore si faktor për zhvillim, mbrojtja e trashëgimisë kulturore si pjesë integrale e zhvillimit të shoqërisë, pasuritë kulturore trajtohen si potencial i zhvillimit të zonës në të cilën gjenden, në aspektin e zhvillimit ekonomik;
3. Zhvillimi dhe konservimi i TK dhe TN përmes një menaxhimi të matur. Me këtë do të ruhet dhe mbrohet thellimi i identiteteve regjionale dhe ruajtjes së llojllojshmërisë natyrore dhe kulturore të qyteteve dhe zonave rurale të një vendi.

TK dhe TN konsiderohet potencial për zhvillim dhe integrim të qëndrueshëm, faktorë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit të një vendi, rajoni dhe më gjerë.

Në Kosovë, TK dhe TN konsiderohen si pasuri e vendit, që shpreh identitetin e shoqërisë, por e cila po kërcënohet çdo ditë e më shumë nga shkatërrimi.

Momentalisht nuk kemi pasqyrë reale të gjendjes së objekteve dhe tërësive me trashëgimi kulturore, shkaktarë i gjithë kësaj është mungesa e të dhënave për tërë territorin e Kosovës.

Situata rreth këtyre përmbajtjeve është alarmante, një pjesë e madhe e tyre i janë nënshtruar rrezikut nga zhdukja e tërësishtme. Vetëm disa iniciativa të pakta të ndërmara nga bashkëpunimi privat-publik po ngjallin ndjenjën për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Nga vala e madhe e ndërtimeve të pakontrolluara janë zhdukur dhe janë në proces të zhdukjes tërësi dhe objekte me vlera të mëdha, poashtu edhe nga ndërtimet urbane, turizmi masiv, deponitë e mbeturinave etj.

Në Prishtinë është i vogël numri i objekteve që dëshmojnë të kaluarën e qytetit, edhe ato pak objekte ekzistuese janë të ngulfatura nga ndërtimet dhe zhvillimet që po ndodhin përreth tyre. E njëjta gjë po ndodhë edhe në qytetet tjera, në mënyrë sistematike po vazhdon zhdukja e të vjetrës dhe janë vetëm përpjekjet e rralla të individëve dhe ndonjë organizate joqeveritare ato që po ndihmojnë ruajtjen e këtyre përmbajtjeve. Pasojat e konfliktit të fundit që ndodhi në Kosovë ishin katastrofale, një pjesë e madhe e objekteve dhe tërësive u dogjën ose u dëmtuan deri në masën më të madhe. Pamundësia financiare që ato të rehabilitohen po krijon kushte që ato pak dëshmi të mbetura me ndihmën e kushteve atmosferike dhe vet njeriut të zhduken fare.

Qëllimi ynë kryesor nga e tëra kjo që u tha është mbrojtja nga degradimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore në tërësi në tërë Kosovën.

Vlerat e trashëguara natyrore janë gjithashtu të rrezikuara, përmbajtje të mëdha po i nënshtrohen veprimeve pa kontroll që po ndodhin afër dhe brenda tyre. Në Kosovë llogaritet se janë diçka më pak se 5% e sipërfaqeve që janë nën mbrojtje.

Humbja e trashëgimisë natyrore është çështje e rëndësishme jetike për të gjithë. Shkaktarët janë të ndryshëm si: ndërtimet kaotike në afërsi të zonave me trashëgimi natyrore, prerjet e pakontrolluara të pyjeve, erozioni, shkatërrimi i monumenteve të natyrës me vlera, ndotja e zonave kryesisht turistike, e të gjitha këto si pasojë e mos efikasitetit të organeve menaxhuese për mbrojtje të trashëgimisë natyrore në pajtim me kriteret ndërkombëtare dhe vendore, si dhe vetëdija e ulët e popullatës për ruajtjen e zonave të mbrojtura si potencial i zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë së vendit.

³⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Neni 9).

Nga takimet e shpeshta të organizuara në qendrat e ndryshme të Kosovës është trajtuar edhe çështja e trashëgimisë natyrore. Disa rekomandime të nxjerra nga këto takime flasin për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore (atyre të ripërtrishme), ruajtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore, nënshkrimin në konventat ndërkombëtare, monitorimin profesional mbi elementet e trashëgimisë, mekanizmat zbatues për parandalimin e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore, inicime të investimeve nga niveli qendror për zhvillim të turizmit etj.

1.1.4.5. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni

1.1.4.5.1. Vërshimet

Në Kosovë vërshimet janë prezentë. Në të kaluarën kanë ndodhur vërshime siç është rasti në vitin 1979, ku rrugë, ura dhe shtëpi kishin pësuar dëmtime të mëdha.

Vërshimet të përmasave të vogla kanë ndodhur shumë më shpesh, siç janë ato në Janar të vitit 2003 ku lumi Sitnica ka përmblytur sipërfaqe të tokave bujqësore, vendbanime në komunën e F.Kosovës, Obiliqit dhe Vushtrrisë si dhe shumë lumenj tjerë i kanë rritur nivelet kritike.

Kosova ka një rrjet hidrografik kryesisht autoktonë ku sipërfaqja ujëmbledhëse është 10.907km² përafërsisht i përgjigjet kufijve administrativ të Kosovës.

Kosova ndahet në katër pellgje lumore³⁷.

► Pellgjet lumore të Kosovës

Pellgu lumor	Ujëmbledhësi detar	Sip.e pellgut km ²	Prurja m ³ /s	Shkarkimi vjetor mil.m ³
Drini Bardhë i	Deti Adriatik	4289	62.53	1970
Lumi Pllavës i	Deti Adriatik	360	7.30	230
Lepenci	Deti Egje	685	9.74	307
Morava Binçës e	Deti i Zi	1564	10.47	330
Ibër	Deti i Zi	409	24.49	771
Gjithësej		10907	114.54	3608

Burimet e lumenjve të Kosovës janë autokton pjesa e sipërme e shtratit të lumit përveç dukurisë erozive për shkak të pjerrtësisë së terrenit dhe përbërjes gjeologjike te terrenit nuk shkakton ndonjë dukuri negative sa i përket vërshimeve.

Pjesa e mesme dhe e poshtme e shtratit të lumit janë aktive si dukuri negative dhe rrezikon zonat fushore dhe të vendbanimeve nga se shtrati i lumit nuk mund të pranojë të plotat ujore dhe vjen deri te vërshimet.

Vërshimet janë prezentë në periudhën kur reshjet atmosferike janë të mëdha gjatë stinës së pranverës kur reshjet e shiut janë më të mëdha dhe kombinohen me shkrirje të borës dhe gjatë stinës së vjeshtës³⁸.

Gjendja momentale e shtretërve të lumenjve është e keqe si pasojë e faktorit njeri dhe natyror.

Faktori njeri me aktivitetin e vetë ka shkaktuar dëme të mëdha përgjatë shtratit lumor në rrjedhjen e mesme dhe të poshtme ku në disa raste janë edhe të riparueshme.

Nxjerrja ilegale e inerteve përgjatë pellgut lumor pa kriteret ka shkaktuar degradim të shtratit lumor ku pasojat janë të mëdha gjatë periudhave të lagështa të vitit që manifestohen me vërshime.

Ndërtimi i objekteve të banimit, objekteve ekonomike dhe objekteve tjera përgjatë shtretërve të lumenjve si dhe hedhja e mbeturinave te ngurta dhe shkatërrimi i botës bimore përgjatë brigjeve lumore ka ndikuar që ato regjione te jenë te ekspozuara rrezikut permanent nga vërshimet.

³⁷ Dr. Ruzhdi Pllana-Shoqata e gjeografëve të Kosovës 1984

³⁸ MMPH-IHMK

Vërshimet në mënyrë natyrore ndodhin përreth fushave lymore dhe në veçanti në grykëderdheje te degëve të lumenjve në lumin kryesor ku akumulimi i sedimenteve nga degët e lumenjve mund të shkaktojë një bllokadë të pjeshme të rrjedhës normale të lumit kryesor dhe mund të shkaktohet devijimi i vijës lumore dhe vërshimi në tokat bujqësore.

Në bazë të Master Planit për ujëra 1983 është konstatuar edhe gjatësia e shtretërve të lumenjve ku i kanoset rreziku i vërshimeve shih tabelën:

Dëmet më të mëdha që shkaktohen nga vërshimet janë përgjatë pellgut të: Drini i Bardhë 50%, Ibër-Sitnicë 24%, Lepencë 20%, dhe Morava e Binçes 6%³⁹.

► Gjendja momentale e sipërfaqeve të rrezikuara nga përmbytjet në ha në bazë të të dhënave nga Departamenti i ujërave⁴⁰:

Nr	Ujë rrjedhja	Gjatsia e parapar për rregullim në km	Gjatësia rregulluar në km	%
1	Morava e Binçes	86.80	46.25	52.28
2	Sitnica	203.10	59.70	29.39
3	Ibri	10.30	5.35	51.94
4	Drini i Bardhë	168.63	26.32	15.60
5	Lepenci	22.50	2.80	12.44
	Gjithsej	492.33	140.92	28.62




Zonat e rrezikuara nga vërshimet

Legjenda

- Vendbanim
- Kufiri i Kosovës
- Lumë i madh
- Lumë i mesëm
- Lumë i vogël
- Liçen
- Basin
- Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet

³⁹ Baza e hidroekonomisë së Kosovës. 1983

⁴⁰ MMPH-DMU





1.1.4.5.2. Erozioni

Erozioni rrezikon begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njerëzimit. Është prezent në tërë territorin e Kosovës dhe shfaqet në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, brigjeve të lumenjve, e përrrenjve, transport i depozitimeve të ngurta e të zhavorreve shkarje e shembje masive apo të lokalizuara si dhe degradim fizik e kimik të tokave.


Shkaqet e erozionit si fenomen shkaktohen nga një kombinim faktorësh siç janë: shkalla e pjerrtësisë së terrenit, klima, përdorimi i pa përshtatshëm i tokës, mbulesa bimore e tokës dhe shkatërrimet ekologjike siç janë: djegia apo prerja e pa kontrolluar e pyjeve, mungesa e investimeve për mbrojtjen e tokave, për ndërtimin e pritave malore, pyllëzime të reja etj.

► Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas kategorisë së erozionit

Kategoritë e erozionit	Sip në km ²	%
Kategoria e parë	714.3	6.6
Kategoria e dytë	1890.2	17.6
Kategoria e tretë	3367.7	31.3
Kategoria e katërt	3680.2	34.3
Kategoria e pestë	1097.5	10.2

Erozioni në Kosovë me fuqinë e vetë grryerëse ku brenda një viti krijohet produkt për bartje ~12mil/m³/vit. Nga ky material i eroduar për bartje arrihet të bartet rreth 5 mil/m³në vit ose rreth 460m³/km² ose rreth 5m³/ha. Krahasuar me Shqipërinë 20-25 t/ha/vit ose rreth 60 mil/vit ka shkallë më të ulët erozive Kosova.

Harta erozive



Planimetri 0714
Zona 34 N
Sistemi koordinues UTM
Datumet geografitik
Kontrollimi Pjesor i Tokave dhe Përdorimi (PPTP)
Pjesa e Bregdetit dhe Pjesa e Dytë (P2P)
Agjencia Kosovare e Tokave (AKT)
Agjencia Shqiptare e Tokave (AST)
Regjistri Kombëtar i Tokave (RKT)
Harta e Tokave
Pjesa e Tokave dhe Përdorimi Hapësinor (PHH)
Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH)



1.1.4.6. Sizmiciteti i territorit të Kosovës

Territori i Kosovës në aspektin sizmotektonik përfaqëson një terren mjaft aktiv, në të cilin mund të priten tërmete katastrofike me karakter autokton. Të dhënat për tërmetet nga e kaluara dëshmojnë qartë se dukuria e tërmeteve katastrofike në disa pjesë të territorit të Kosovës ka qenë evidente shumë herët. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Kosovën përmendim:

1. Tërmeti i Prizrenit, 16 qershor 1456 me intensitet epiqendror $Io=9$ ballë shkalla MSK dhe magnitudë 6.6 shkalla Rihter;
2. Tërmeti i Pejës, 11 nëntor 1662 me intensitet epiqendror $Io=8$ ballë shkalla MSK dhe magnitudë 6.0 shkalla Rihter;
3. Tërmeti i Ferizajt, 26 shkurt 1755 me intensitet epiqendror $Io=9$ ballë shkalla MSK-64 dhe magnitudë 6.1 shkalla Rihter;
4. Tërmeti i Ferizaj-Vitisë, 10 gusht 1921 me intensitet epiqendror $Io=9$ ballë shkalla MSK-64 dhe magnitudë 6.1 shkalla Rihter;
5. Tërmeti i Kopaonikut, 18 maj 1980 me intensitet epiqendror $Io=8$ ballë MSK-64 dhe magnitudë 6.0 shkalla Rihter (Sulstarova et al, 2000; Orana et al., 1985; Elezaj, 2001; Pekevski, 2001);
6. Tërmeti i 24 Prillit 2002 me intensitet epiqendror VII $1/2$ ballë MSK-64 që dëmtoi rëndë rajonin e Komunës së Gjilanit dhe magnitudë 5.2 shkalla Rihter.

Territori i Kosovës gjithashtu karakterizohet me atë se është nënshtruar edhe lekundjeve të forta nga tërmetet, vatrat e të cilëve kanë qenë jashtë territorit të Kosovës, në Maqedoni, Shqipëri, Malit të Zi dhe Sërbi. Këto dy dukuri, sizmiciteti lokal autokton dhe sizmiciteti që shkaktohet prej tërmeteve të largëta, dëshmojnë për renditjen e Kosovës në radhën e territoreve me një aktivitet të lartë sizmik. Ky aktivitet mjaft i lartë dikton ndërmarrjen e studimeve të duhura të gjithanëshme, në mënyrë që, në bazë të analizës dhe sintezës së të dhënave komplekse të fituara, të jepet një tablo e plotë, reale dhe e besueshme për vlerësimin e rrezikut sizmik të Kosovës.




► Harta e intenziteteve maksimale të vrojtura për Kosovën - Periudha 1900 - 2002



Në qoftë se e shqyrtojmë hartën e epiqendrave shihet qart se me ekzistencën e hipoqendrave autoktone të tërmeteve karakterizohen rajonet e gjëra të terreneve si vijon: Ferizaj-Gjilan-Viti-Kaçanik, Prishtinë, Skënderaj, Gjakovë-Rahovec-Prizren-Dragash dhe Pejë. Thellësia e hipoqendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon 25 km. Kështu pra, bëhet fjalë për tërmete të cekta, që dëshmon qart se edhe tërmetet me shkallë të ulët të intensitetit, për shkak të thellësisë së vogël, në sipërfaqe mund të manifestohen me shkallë të lartë të intensitetit. Në bazë të të dhënave të gjertanishme ekzistuese, thellësia mesatare e hipoqendrave për tërmetet në territorin e Kosovës, lëviz në kufinjtë 10-15 km, por ka edhe raste të rralla, kur nuk ka pasur mundësi të caktohet thellësia e hipoqendrës, siç shihet nga katalogu dhe hartat. Thellësia mesatare e hipoqendrave të tërmeteve për disa zona epiqendrore, jepet në tabelën e mëposhtme.

Zona epiqendrore	Ferizaji, Gjilani, Vitia, Kaçaniku	Prishtina	Skënderaji	Peja	Gjakova, Rahoveci, Prizreni, Dragashi
Thellësia e hipoqendrës km.	15	5-10	10	10	20



1.1.5. ZHVILLIMI EKONOMIK

“Zhvillimi ekonomik është proces me të cilin krijohen të mirat materiale, përmes mobilizimit human, financiar, kapitalit, resurseve fizike dhe natyrore, për të gjeneruar shërbime dhe të mira materiale atraktive/të ofrueshme për treg”⁴¹.

Zhvillimi i qëndrueshëm - nënkupton zhvillimet që plotësojnë nevojat e së tashmes duke mos komprometuar aftësitë e gjeneratave të ardhshme që të plotësojnë nevojat e tyre. Kjo nënkupton atë se veprimet zhvillimore të së tashmes nuk guxojnë të shpenzojnë resurset të cilat nuk mund të përtërihen ose zëvendësohen⁴².

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm nga aspekti i zhvillimit hapësinor nënkupton zhvillimin e qëndrueshëm që mbulon jo vetëm zhvillimin ekonomik por edhe atë mjedisor, që ruan resurset e tashme për tu përdorur nga gjeneratat e ardhshme por gjithashtu përmban edhe zhvillimin e balancuar hapësinor.⁴³

Në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik parësore është shkalla e prodhimitarisë industriale, komerciale dhe aktiviteteve shërbyese, të cilat së bashku krijojnë të ardhura për banorët.

1.1.5.1. Historiku i shkurtër

Deri më 1950, Kosova ishte vend tipik agrar, pa industri të zhvilluar, ku bujqësia merre pjesë me 70 % në BPV. Si pasojë e politikës diskriminuese e koloniale të Jugosllavisë së parë Kosova ishte lënë jashtë çdo procesi të industrializimit dhe zhvillimit ekonomik e social.⁴⁴

Gjatë viteve 1947-65-70 Kosova ishte krejtësisht jashtë aktiviteteve inventive nga fondet shtetërore pa kthim.


Gjatë 1971-1980, Kosova e realizoi shkallën më të lartë të rritjes ekonomike dhe të ndryshimeve cilësore në strukturën e prodhimit. Sistemi ekonomik e politik në ish-Jugosllavi u decentralizua, kurse pozita kushtetuese e Kosovës u avancuar sa u plotësisht e barabartë me republikat tjera. Në këtë periudhë u realizuan projekte të rëndësishme në industri dhe infrastrukturë ekonomike.

Gjatë viteve 1989-1998, dështimi i prodhimit në të gjitha degët dhe komplekset, paralizoi të gjitha proceset zhvillimore dhe progresin teknologjik. Kjo periudhë karakterizohet me tensione politike te karakterit te mbyllur deri 1999 kur konflikti merr përmasa te një lufte sa faktori ndërkombëtare detyrohet te ndërhyje ne mënyre që ta rikthej paqen.

Me vendosjen e protektoratit të OKB në Kosovë, u ndërmorën masa të caktuara për tejkalimin e situatës së vështirë ekonomike dhe sociale.

Gjatë viteve 1999-2004, pjesën më të madhe të ndihmës ekonomike e kanë realizuar donatorët e jashtëm. Ekonomia e sektorit shoqëror ende pret të rimëkëmbet përmes procesit të privatizimit i cili është i ngadalshëm, ndërsa biznesi privat ka shënuar hapa të dukshëm të zhvillimit (51% të BPV)⁴⁵.

Diaspora përben një faktorë të rëndësishëm ekonomik, e cila është e gatshme të investojë, edhe pse ballafaqohet me pengesa të mëdha, te lidhur me investimet e veta te mundshme.



⁴¹ Këshilli Amerikan për Zhvillim Ekonomik

⁴² (Brundtland Commission, 1987) Resurse të pa-ripërtrishme nënkuptojnë resurset që trashegimisht janë të limituara për shërbim. Kjo nënkupton se me të përdorur një herë, duhet të gjenden resurse tjera, resurset minerale dhe karburantet (gasi natyral, nafta dhe thëngjilli) janë resurse të paripërtrishme (European Commission, 2000)

⁴³ (ESDP, 1999).

⁴⁴ Riinvest-Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik i Kosovës

⁴⁵ MTI-Strategjia e zhvillimit afatmesem të ekonomisë së Kosovës '04-'08



1.1.5.2. Gjendja ekzistuese ekonomike e Kosovës

Zhvillimi ekonomik është njëri ndër katër lëmenjtë e hulumtuar në kuadër të procesit të hartimit të Planit hapësinor me qëllim të përshkrimit të gjendjes ekzistuese ekonomike në Kosovë. Çështjet kyçe të trajtuara në kuadër të zhvillimit ekonomik si: bujqësia, industria, tregtia dhe turizmi, janë të përshkruara në aspektin hapësinor, me fakte, dukuri apo edhe trendë të aktiviteteve ekonomike në Kosovë.


Nga të dhënat në dispozicion paraqiten shtrirjet hapësinore të aktiviteteve ekonomike në Kosovë, në shumicën e rasteve në nivelin komunal e në disa edhe atë kombëtar.

Rreth 478 ndërmarrje shoqërore (NSH) listohen për privatizim. Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe tash Agjencioni për Privatizim i Kosovës (APK) është ngarkuar me përgjegjësinë për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Deri tani janë përfunduar disa runda të privatizimit, në të cilat janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve shoqërore.

► Të dhënat statistikore për 2007/08

Sipërfaqja e Kosovës km ²	10.907
Popullsia/milion	2.13
BPV I Kosovës/mld €	3,433,6
BPV/ kokë banori, €	1,612
Bujqësia/ BPV, % (2006)	12 %
Industria %	13 %
Tregtia %	10%
Turizmi BPV %	1%
Numri I ndërmarrjeve	67.950
Papunësia %	43.6 %
Papunësia në moshë pune 15-64	63.7 %

► Produkti shoqëror në Kosovë dhe i vendeve në rajon



1.1.5.3. Bujqësia


Sektori i bujqësisë mundë të jetë një burim potencial i rritjes. Kosova është e begat me tokë pjellore dhe klimë të butë, që është e përshtatshme për prodhimin e kulturave bujqësore. Megjithëse, dominohet nga pronat e vogla, produktiviteti i ulët, mungesa e shërbimeve të këshillimit, ajo kontribuon me 12% në Bruto Produktin e Përgjithshëm të Vendit (GDP). Vlerësohet se dy të tretat e numrit të përgjithshëm të punësuarve janë të angazhuar në bujqësi.

Kosova ka 577,000ha tokë bujqësore⁴⁶. Nga kjo sipërfaqe 47.1% është tokë e mbjellur, e cila dominohet nga drithërat kurse pjesa tjetër livadhe, kullosa dhe djerrina.


Pjesa dërmuese e tokës bujqësore është në pronësi private (88.6%). Madhësia mesatare e fermës është 2.36ha, e tokës bujqësore 2.01 ha, e tokës që punohet 1.30ha dhe 0.7ha livadhe dhe kullosa.

⁴⁶ Anketa me familje, Riinvest


Viteve te fundit, sektori agro-ushqimore ka shënuar një rritje që është premtues për zhvillimin e bujqësisë. Vërehen sidomos aktivitete në përpunimin e frutave, qumështit, pulari, mullinj, thertore. Prodhimi i perimeve në veçanti prodhimi, i patates, mishit, pularisë dhe vezëve po tregojnë shenja të avantazheve krahasuese. Ndërsa kërkimet e marketingut kane treguar se prodhimet, si, djathi i deleve, mjaltit, kërpudhave, prodhimi i frutave, bimët mjekësore mundë të jene potenciale për eksport



- Burimi: Statistikat rreth Bujqësisë ne Kosove, Enti Statistikor i Kosovës,
- Organizata e ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve te Bashkuara, MBPZHR, 2001



- Kontributi i bujqësisë në BPV, në Kosovë dhe rajon.⁴⁷



Pjesëmarrja në BPV e pylltarisë me bujqësi arrin në 12%. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve është 464.800 ha.


⁴⁷ CIA-the world fact Book, MBPZHR



Pas lufte fondi blegtoral është dëmtuar për 60%⁴⁸.

Sipas vlerësimeve të MBPZHR-së prodhimi vjetor blegtoral nuk i plotëson nevojat vendore. Shtetet e BE-së, 70% të buxhetit kombëtar e shpenzojnë në përkrahjen e zhvillimeve rajonale rurale. Në vendin tonë konsumatorët janë ata që e bartin barrën kryesore financiare të fermave. Kulturat më të shpeshta të mbjella në Kosovë janë misri dhe gruri.

► Prodhimtaria bujqësore gjatë periudhave të ndryshme kohore.



1.1.5.4. Industria

Niveli i zhvillimit ekonomik e me atë edhe industrial të Kosovës në ish Jugosllavi ishte tejet i ulët në krahasim me mesataren e sidomos me rajonet e zhvilluara⁴⁹. Ai sillet rreth gjysmës së nivelit të njësive të tjera federale të pazhvilluara. Me këtë nivel të ulët të trashëguar të zhvillimit ekonomik, përballet sot Kosova, duke ia shtuar edhe problemet aktuale të një shoqërie në tranzicion.


Vështrimi paraqet gjendjen e prodhimitarisë industriale në Kosovë⁵⁰. Paraqitja është bërë sipas tre treguesve kryesorë ekonomikë: numri dhe llojet e ndërmarrjeve të angazhuara në sektorin industrial, numrin e punëtorëve të angazhuar në sektorin e prodhimit industrial dhe vlerën e brutoproduktit. Vendin e parë në të gjithë treguesit e zë industria ushqimore.

Deri në fund të viteve të 80-ta industria dhe xehetaria bënin pjesë me gati 50% në brutoproduktin vendor.

Në vitin 2002 UNMIK-u përmes AKM⁵¹ ka filluar privatizimin. Ndërmarrjet shoqërore në Kosovë janë kryesisht ndërmarrje të mesme.

- 478 ndërmarrje për t'u privatizuar,
- 18 ndërmarrje të komercializuara,
- 25 ndërmarrje të tenderuar

► Pjesëmarrja e nënsektorëve të industrisë në nivel të Kosovës



Problemi i madh ekonomik me të cilin ballafaqohet Kosova është punësimi apo papunësia, sidomos e të rinjve, e cila sillet prej 35% deri në 60%.

Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në Evropën Juglindore.

⁴⁸ MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

⁴⁹ Njesite federale tei sh Jugosllavise.


⁵⁰ Ministria e tregtisë dhe Industrisë

⁵¹ Agjensioni kosovar I mirëbesimit (për administrim, menaxhim dhe privatizim të ndërmarrjeve publike)



Në fund të vitit 2008, ishin aktive 67950 ndërmarrje. Komunitat të cilat kanë numrin më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara janë kryesisht: Prishtina, Prizreni, Ferizaj dhe Peja vetëm ato përbëjnë afër 40% nga numri i gjithmbarshtëm i ndërmarrjeve në nivel vendi. Në vitin 2008 numri i bizneseve është më se 66% më i madh se sa që ishte në fund të vitit 2004. Vetëm brenda këtij viti janë regjistruar 7424 ndërmarrje të reja. Aktiviteti tregtar hotelieri dhe restorante vazhdon të jetë më i preferuari në vendim marrje për një aktivitet të ri dhe përfaqëson 56 % të ndërmarrjeve në fund të vitit 2008.

► Paraqitja grafike e ndërmarrjeve nëpër komuna në T1 dhe T2 2009 (në %)




Analiza sipas madhësisë dhe aktivitetit të ndërmarrjeve të reja tregon që vazhdojnë të jenë mbizotëruese ndërmarrjet me 1-4 të punësuar, 94%. Prodhues të shërbimeve (Tregtia, hotelieri, kafe dhe restorante, Transporti me telekomunikacion dhe shërbime tjera) me 83%.

Ka një trend rritës në vitin 2008 të pjesëmarrjes së prodhuesit e të mirave, 17 % nga 16 sa ishte në vitin 2004, mbulojnë në numër prodhuesit e të mirave (Industri, bujqësi me peshkim, dhe ndërtim) por ato punësojnë rreth 40% të punësuarve të ndërmarrjeve ekonomike.


Ndërmarrjet e mëdha, me 50 e më shumë të punësuar, përfaqësojnë në numër më pak se 1%, por kontributi i tyre në punësim në ndërmarrjet ekonomike është shumë i ndjeshëm, rreth 33%.

► Ndërmarrjet ekonomike nëpër komuna

► Madhësia e ndërmarrjeve



LEGJENDA





1.1.5.5. Tregtia


Tregtia e ka vendin e vet meritor në zhvillimin ekonomik të një vendi. Tregtia është sot degë parësore në ekonominë e Kosovës. Tregtia përmban numër të theksuar të bizneseve, të të punësuarve dhe investimeve. Tregtia vazhdon të jetë forma më e përhapur e koncentrimit të kapitalit në sektorin privat. Tregtia e brendshme është gjithsesi më e përfaqësuar në krahasim me tregtinë e jashtme. Në përgjithësi në Kosovë importohet nga vendet fqinje e më pak nga ato të rajonit dhe të shteteve të BE-së. Tregtia nga jashtë është burimi kryesor i plasimeve në tregun kosovar.

► Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme - vitet 2001 dhe 2008


Viti	2001	2008
Eksportet	10.559 €	198.463 €
Importet	684.500 €	1.928.236 €
Bilanci tregtar	-673.941 €	-1729.773 €

Nga tabela e mësipërme shihet se vlera e mallrave të eksportuar nga Kosova në vitin 2001 arrinte vetëm 5.3% të vlerës së mallrave të eksportuar në vitin 2008, kurse vlera e mallrave të importuar arrinte 35.5% të vlerës së mallrave të importuar në vitin 2008. Bilanci tregtar, që nga viti 2001, çdo vit, deri më sot ka qenë i disfavorshtëm për Kosovën. Për shembull vlera e mallrave të eksportuar nga Kosova në vitin 2008 arrinte vetëm 10.3% të vlerës së mallrave të importuar në atë vit.


► Eksporti dhe importi kryesor i Kosovës për vitin 2008



► Eksporti sipas seksioneve të KSTJ (SITC) 2008 (2007)



► Importi sipas seksioneve të KSTJ(SITC) 2008 (2007)






Eksportet dhe importet sipas pikave kufitare (Qershor 2009)

Më së shumti kemi eksport mallrash përmes pikave kufitare: Hanit të Elezit (59.1%) , Vërmicës (18.2%), Kullës (11.6) etj.


Hani i Elezit mbetet pika më e frekventuar doganore

► Eksporti sipas pikave kufitare 2008 (2007)



Ndërsa import më së shumti kemi përmes pikës kufitare të: Hanit të Elezit (36.9%), Kullës (13.6%), Mitrovicës (13.2%), Merdarës (11.7%) etj.

► Importi sipas pikave kufitare 2008 (2007)



1.1.5.6. Zejtaria

Organizimi i jetës ekonomike në Kosovë deri para një gjysmë shekulli bazohej kryesisht në ekonominë familjare dhe organizimin patriarkal të familjes. Ekonomia familjare ishte e përqendruar pos të tjerash edhe në zejtari. Dominonin kryesisht prodhimi natyral dhe manifaktura e thjeshtë në zejtari. Zejtaria përfaqësohej nga zejet tradicionale si: zdrukthëtaria, farkëtaria, saraçët etj. Zejtaria me prodhimet dhe shërbimet e veta paraqet një segment të veçantë të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kërkesat për këto prodhime e shërbime në treg janë permanente dhe shënojnë trend të rritjes. Sipas shënimeve të vitit 1986, në Kosovë kanë qenë aktive 113 veprimtari zejtare. Më tepër se gjysma e zejtarisë së pavarur të ushtruar në Kosovë është përqendruar kryesisht në 15 zeje ku mungojnë veprimtaritë zejtare prodhuese bashkëkohore⁵².

1.1.5.7. Turizmi

Vlerat natyrore me të cilat disponon Kosova paraqesin resurse turistike të rangut të lartë. Përshkrimi i potencialeve turistike të Kosovës është ngushtë i lidhur me pozitën e saj gjeografike. Pozita e saj në Evropën Juglindore, me një vend qendror në Gadishullin Ballkanik, paraqet udhëkryq i cili daton historikisht prej kohës së romakëve. Duke pasur Kosova një pozitë të përshatshme në marrëdhënie me pikat e rëndësishme turistike, ka këto distanca hapësinore:

Bregdeti Adriatik -Bregdeti Shqiptar (Prishtinë-Shëngjin)	283 km
Prishtinë Deti Egje - Selanik	340 km
Prishtinë Beograd	360 km
Prishtinë Nish	138 km
Prishtinë Sofje	290 km
Prishtinë Shkup	84 km
Prishtinë Budvë	350 km

Kosova shquhet me potencial të turizmit malor, parqeve nacionale, të gjuetisë dhe kulturor. Krahas resurseve edhe hoteleria është koncentruar në zonat e ofertës turistike, qendrave urbane dhe rrugëve më me rëndësi në Kosovë. Kosova ka potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit dimëror në Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna.

Tani ka vetëm një qendër të skijimit - Brezovicën e cila shfrytëzohet nga turistët vendorë dhe ato ndërkombëtarë që ndodhen në Kosovë.

Në Kosovë kemi gjithsej dy banja rehabilituese, atë të Kllokotit dhe të Pejës. Numri më i madh i shfrytëzuesve konsiston në qëndrim një ditë, të cilët vijnë nga qendrat e afërta.

Kosova ka potencial edhe për zhvillim të turizmit të gjuetisë. Ky lloj turizmi mund të bëhet në shumë vende të Kosovës, si Rezervati i Kozhnjarit, Rusolisë dhe të Blinajës. Vlera të tjera natyrore në Kosovë janë edhe: Kanioni i Mirushës, Shpella e Mermertë në Gadime, lumenjtë dhe akumulimet artificiale që ofrojnë mundësi për zhvillimin e peshkatarisë, sporteve në ujë dhe rekreacionit. Prodhimi i artizanatave dhe ushtrimi i zejeve të rralla, siç është filigrani paraqesin atraksion për turistë të huaj.

Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me shumë objekte me vlerë të jashtëzakonshme kulturo-historike. Numri i tërësishëm i objekteve dhe institucioneve kulturore është 1282 sosh⁵³.

Duke u bazuar në të dhënat me të cilat posedon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) departamenti i Turizmit, si dhe Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), del se në të gjitha komunat e Kosovës veprimtarinë Hoteliere e ushtrojnë 147 hotele të licencuara me gjithsej 2261 shtretër .


Qytetet të cilat kanë më së shumti hotele janë: Prishtina (29), Prizreni (18), Ferizaj (14) dhe Lipjani (12).

⁵² Riiinvest /Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik I Kosovës

⁵³ MTI




► Struktura sipas dhomave me numër të shtretërve



Gjithsej numri i vizitorëve gjatë vitit 2008 ka qene 44294, prej cilëve 44% vizitor vendor me net qëndrimi 22602 si dhe 56 % vizitor te huaj me 46910 net qëndrimi.

► Numri i vizitorëve dhe net qëndrimi



1.1.5.8. Energjetika


Në Kosovë një KWh kushton 0.083 euro që është barrë serioze për ekonominë familjare.

Energjetika në kushtet bashkëkohore është një resurs i pazëvendësueshëm në kuptim të zhvillimit ekonomik, të ushtrimit të veprimtarive të tjera, të ngritjes dhe mbajtjes në nivel të standardit jetësor dhe të mirëqenies sociale në përgjithësi. Sot, sektori energjetik nuk është në gjendje të bëjë një furnizim 24 orësh dhe bizneset e konsumatorët shtëpiakë ngarkohen me shpenzime shtesë duke përdorë gjeneratorë. Kapaciteti i instaluar i termoelektranave dhe hidroelektranave ka qenë 1.527 MW, ndërsa aktualisht kapacitetet prodhuese të disponueshme sillen rreth 900 MW. Korporata energjetike e Kosovës-KEK është ndërmarrje publike e cila bën prodhimin, distribuimin dhe menaxhimin e energjisë elektrike. Me gjithë tarifat mesatare të arsyeshme të energjisë elektrike prej 0.083 euro/KWh, sektori energjetik është bërë barrë serioze e ekonomive familjare.


Linjiti ishte dhe në planin afatgjatë do të mbetet lënda e parë kryesore për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.

Kontributi në konsumin total të energjisë, nga çdo sektor ekonomik është paraqitur në figurën e mëposhtme. Pjesa kryesore e këtij konsumi është mbuluar nga linjiti dhe më pas nafta dhe nën produktet saj.






► Figura 5: Kontributi i secilit burim primar të energjisë në Kosovë (ktoe)




► Figura 6: Kontributi ne konsumin total te energjisë nga çdo sektor (ktoe)

Bazuar në disa studime të rëndësishme të pas vitit 2000 si dhe në analizat e bilanceve të energjisë të përgatitura nga MEM, analiza këto që kanë marrë parasysh karakteristikat dhe strukturën e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, humbjet në rrjet dhe importin neto të energjisë elektrike, rezultojnë se për periudhën 2000-2007 prodhimi i secilit central elektro-gjenerues ka qenë siç paraqitet në figurën 7, ndërsa kontributi në përqindje i secilit central elektro-gjenerues në mbulimin e konsumit total të energjisë elektrike ka qenë siç paraqitet në figurën 8.




► Figura 7: Kontributi i secilit central ne mbulimin e nevojave për energji elektrike (GËh)



► Figura 8: Kontributi i secilit central ne mbulimin e nevojave për energji elektrike (%)

► Prodhimi dhe shpenzimi i energjisë elektrike gjate viteve '85-'03⁵⁴



Rezervat e linjtit në Kosovë gjenden në dy basenet më të mëdha, të emërtuara “Kosova” dhe “Dukagjini”. Rezervat gjeologjike të linjtit janë vlerësuar të jenë rreth 12.5 miliardë ton (këtu përfshihen të gjitha kategoritë e rezervave). Në tabelë paraqitet përmbledhja e rezervave të linjtit sipas lokacioneve⁵⁵.

Baseni	Siperfaqja [km ²]	Rezervat [Milion Ton]			
		Të hulumtuara		Të shfrytëzueshme	
		T	t _{ce}	T	t _{ce}
Kosova	274	10,091	2,957	8,772	2,521
Dukagjini	49	2,244.8	782	2,047.7	464
Drenicës-Fusha e Skenderajt	5.1	106,6	22	73.2	19
Totali		12,442.4	3,761	10,892.9	3,004

► Rezervat e linjtit sipas lokacioneve

Kapacitetet e instaluar teknike të dy termocentraleve, me gjithë vjetërsinë e tyre prej 24-46 vitesh, do të mund të përmbushnin kërkesat e konsumit për energji elektrike bazike, por, për shkak të degradimit dhe mos investimit në sektorin e linjtit dhe të termocentraleve në Kosovë gjatë periudhës 1990-1999, mirëmbajtjes së mangët, dhe mos rehabilitimit të domosdoshëm dhe në kohë, gatishmëria teknike dhe performancat e njësive gjeneruese, me gjithë ngritjen e vazhdueshme të evidentuar deri në vitin 2008, janë nën nivelin e parametrave të instaluar.

Sistemi i energjisë elektrike i Kosovës ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërlidhëse me sistemet e Shqipërisë, të Malit të Zi, të Serbisë dhe të Maqedonisë. Me përjashtim të Serbisë, të gjitha këto sisteme janë neto-importuese të energjisë elektrike. Ky fakt paraqet mundësi për investime potenciale në termocentrale të reja të linjtit në Kosovë.

Burimet e ripërtëritshme - Vetëm rreth 2% e tërë energjisë elektrike që prodhohet në Kosovë brenda një viti, prodhohet duke shfrytëzuar fuqinë e ujit. Pjesa tjetër prodhohet duke shfrytëzuar lignitin, ndërkaq era apo dielli pothuajse nuk shfrytëzohen fare për prodhimin e elektricitetit. Kohëve të fundit janë bërë disa aktivitete sa i përket zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. MEM-i në fund të vitit 2006 ka finalizuar një studim të parafizibilitetit për disa hidrocentrale të vogla. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZrRE) ka hartuar Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. MEM-i ka iniciuar procesin dhe ZrRE ka aprovuar tarifën nxitëse (feed-in tarifën) për gjenerimin nga hidrocentralet e vogla dhe fermat e ertes. Kosova ka potencial për ndërtimin e hidrocentraleve me kapacitet të vogla (sipas hulumtimeve 16 deri 18), të cilat mund të arrijnë prej 64 MW me prodhim vjetor prej 294 GWh. Në proces është fillimi i ndërtimit të HC

⁵⁴ ESTAP-Banka Botërore/raporti final 2002

⁵⁵ Instituti Inkos - “Studimi për Vlerësimin e hulumtimeve dhe rezervave gjeologjike të qymyrit në Kosovë”, Baseni i Kosovës, Prishtinë 2007, fq. 81 dhe Baseni i Dukagjinit, Drenicës dhe Basenet tjera, Prishtinë 2007, fq.56, dhe fq. 24.

të Zhurit prej 305 MW me prodhim mesatar vjetor prej 398 GWh, i cili paraqet 43% nga kapaciteti i tërësishëm i prodhimit të energjisë në Kosovë.

Gjatë vitit 2008 janë vlerësuar potencialet e energjisë diellore, të erës, biomasës dhe ujërave gjeo-termike.

MEM-i, me burime financiare nga Buxheti i Kosovës, gjatë vitit 2008 ka zbatuar në ndërtesa publike disa projekte demonstruese për ngrohje të ujit përmes energjisë diellore. Në këtë vit janë vendosur panelet diellore në disa klinika të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Kosova brenda vitit ka 265 ditë me diell, prandaj ka të gjitha parakushtet e mundshme për aplikimin e energjisë solare, që llogaritet të jetë energjia e së ardhmes, krahas burimeve tjera energjetike. Ekzistojnë disa projekte testuese për shfrytëzimin e energjisë diellore, të cilat konsistojnë në instalimin e paneleve solare në qendrat shëndetësore dhe arsimore⁵⁶, që kanë për synim përmbushjen e objektivave të parapara nga BE-ja (deri në vitin 2020, ER 20%). Në kodrën e Goleshit janë vendosur tre gjeneratorë me 1.35 MW për prodhimin e energjisë elektrike nga era.

Kosova është nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) të Evropës Juglindore, i cili ka hyrë në fuqi në 1 korrik 2006. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës është e angazhuar substancialisht për të zhvilluar sektorin e energjisë në përputhje me kërkesat e TKE-së. Ky Traktat obligon implementimin e 'Acquis Communautaire' të BE-së nga ana e secilës palë kontraktuese sipas një kalendari për zbatim të reformave të kërkuara. Nën kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE), Kosova ka zhvilluar caqet indikative vjetore edhe 10-vjeçare për burime të ripërtërishme. Ajo gjithashtu ka përpiluar planin e detajuar për implementimin e (i) Direktivës 2001/77/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 shtator 2001 mbi promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, dhe (ii) Direktivës 2003/30/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 8 maj 2003 mbi promovimin e shfrytëzimit të bio-karburanteve dhe karburanteve tjera të ripërtërishme për transport. MEM ka hartuar dhe po zbaton disa projekte në kuadër të Programit trevjeçar të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (EE) dhe Burime të Ripërtërishme Energjetike (BRE) 2006-2008 e poashtu ka promovuar nxjerrjen e disa akteve nënligjore që rregullojnë çështje të caktuara për fushat e EE dhe BRE.

1.1.5.9. Sistemi bankar

Sistemi monetar duhet t'i përshtatet sistemit të transformimit dhe ndërtimit të sistemit ekonomik. Si komponentë kryesore të sistemit monetar duhet të merren institucionet monetare dhe instrumentet mund të funksionojnë si para.

Në Kosovë sistemi bankar ishte shkatërruar në tërësi nga regjimi i dhunshëm serb. Është shuar Banka Popullore e Kosovës si njësi e veçantë e sistemit të Bankave Popullore (Qendrore), e cila ishte ndër bankat më të forta të ish Jugosllavisë dhe emër i respektuar bankar që bashkëpunonte me të gjitha bankat e rëndësishme në botë.

Përderisa sektori bankar është zhvilluar në vitet e fundit, nuk shërben aq shumë si kapital investues në ekonominë e Kosovës.⁵⁷

Depozitat bankare patën një rritje të madhe: në vitin 2000 prej 90 milionë eurosh përderisa më 2003 - 515 milionë euro. Struktura e depozitave përkundër përmirësimit ende mbetet i pafavorshëm.

"Zhvillimi njerëzor varet në masë të madhe nga niveli i zhvillimit ekonomik. Kur proceset zhvillimore janë të formuluara me kujdes, mund të arrihet si zhvillimi njerëzor po ashtu edhe ai ekonomik. Për këtë kërkohet nja balancim i përgjegjësive shoqërore dhe prioriteteve zhvillimore".⁵⁸

⁵⁶ Vendosja e paneleve diellore në disa Klinika të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, 2008

⁵⁷ Riinvest-Aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi demokratik I Kosovës

⁵⁸ UNDP-raporti I zhvillimit njerëzor -Kosovë 2002

1.1.5.10. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik

Në Kosovë kemi një zhvillim të pabarabartë ekonomik. Ku dhe pse ndodh zhvillimi i pabarabartë në Kosovë - cila është shtrirja hapësinore?

Kosova në kontekstin rajonal dhe atë evropian, sipas BPV-së ka një nivel shumë të ulët të zhvillimit ekonomik, zë vendin e fundit në listë. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik ose shpërpjesëtimet më të theksuara, origjinën e kanë në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të trashëguar, pasojat e situatës ekonomiko politike gjatë viteve të nëntëdhjeta, në resurset dhe fondet e kufizuara zhvillimore dhe në proceset e ndërlikuara tranzitore në kushte të rindërtimit të pasluftës.

Shpërpjesëtimet më të shprehura kanë të bëjnë me: raportin midis BPV (GDP-së) dhe konsumit, eksportit dhe importit, ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore, buxhetit të konsoliduar dhe nevojave për investime në infrastrukturë dhe shërbime publike.

Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, si një çështje me rëndësi parësore, sfidohet me shpërpjesëtimet prezente që e karakterizojnë në këtë moment ekonominë e Kosovës. Zhvillimi i industrializimit në bazë të burimeve natyrore në të kaluarën është shprehur në shtrirjen jo proporcionale të efekteve të këtij zhvillimi. Kështu gjatë viteve shtatëdhjeta deri në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjeta në aspektin e zhvillimit industrial dhe urban qartas janë diferencuar shtatë qendrat më të mëdha urbane.

Me rrënimin e strukturës së vjetër industriale, de industrializimin e viteve 90-ta dhe ndryshimet e mëdha teknologjike që ndodhën viteve të fundit ndikuan që këto zona të mos kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të ri ekonomik.


Nga vlerësimi i shkallës së zhvillimit socio ekonomik të komunave në Kosovë (numri i të punësuarve, GDP sipas komunave, të hyrat prej industrisë, bujqësisë, numri i ndërmarrjeve tregtare, niveli i infrastrukturës shkollore, rrugore) del se komunat me të zhvilluara janë Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani, Ferizaj dhe Mitrovicë, ndërsa pjesa qendrore dhe viset kufitare si më të pazhvilluarat. Njëra ndër arsyt kryesore të një zhvillimi të tillë i takon nivelit të zhvillimit të rrjetit rrugor, hekurudhor, kualitetit të tyre fizik si dhe nivelit të shërbimeve transportuese. Faktori tjetër është rrjeti i energjisë elektrike, cilësia fizike e rrjetit, distribuimit (cilësia e rrjetit ndryshon dhe në shumë vise rurale tensioni nuk është adekuat për veprimtari prodhuese dhe industriale dhe po ashtu edhe problemi i ndërprerjes së energjisë elektrike është më i shprehur në disa nga komunat më pak të zhvilluara). Pasojat e zhvillimit të pabarabartë reflektohen në aspekte të ndryshme si atë social, ekonomik dhe mjedisor.

Aspekti social - Një zhvillim i tillë i pa barabartë i komunave në Kosovë si pasojë në aspektin social ka migrimin e popullsisë si nga viset rurale në ato urbane dhe me tej në ato urbane më të zhvilluara, si ngarendje për një siguri të punës në radhë të parë, e më pas për një kualitet më të mirë të jetës. Dukuria e lëvizjeve të tilla përcillet edhe me problemet e banimit, punësimin, shkollimit, transportit si dhe shërbimeve tjera komunale. Migrimi si i tillë në aspektin institucional ngërthen në vete problemin e të dhënave të pa sakta për vendqëndrim, huti sa i përket taksa-pagimeve, etj., ndërsa në aspektin e shfrytëzimit të tokës dhe objekteve, problemet qëndrojnë në pa-banushmërinë aktuale të shumë pronave të braktisura e cila sjell jozhvillim të mëtutjeshëm. Rreziku ekziston që në qendrat e mëdha urbane të koncentrohen kuadrot intelektuale të cilët mbesin dhe nuk kthehen në vende të tyre paraprake për shkak të mundësive më të mira ekonomike, përderisa qytetet e vogla fillimisht të mbetura të pazhvilluara të mbesin edhe më tej në gjendje të njëjtë. Ndikim të madh në këtë drejtim ka edhe shpërndarja e pabarabartë e nivelit të lartë të arsimit. Pjesa më e madhe e degëve të arsimit të lartë është e përqendruar vetëm në Prishtinë gjë që po shkakton lëvizjen e popullatës nga viset tjera në drejtim të kësaj qendre.

Aspekti Ekonomik - Zhvillimi i pabarabartë në aspektin ekonomik ndërthurë çështjen e papunësisë, shkallës së ulët të të ardhurave personale, mos investimet nëpër sektorë si dhe investimet kapitale në sfera të ndryshme. Nevoja e madhe për investime kapitale sidomos në shërbime komunale nuk po mund të tejkalohet me një fluks të tillë të zhvillimeve, e sidomos me jo efikasitetin në punën e qeverive lokale.

Aspekti Mjedisor - Zhvillimi i pabarabartë në aspektin mjedisor ka për pasojë shfrytëzimin joracional të tokës (pronat e lëna dhe të zbrazëta e të pashfrytëzuara për shkaqe të

migrimeve, ndërtime joformale), dukuri kjo e mbështetur me jo efikasitetin e qeverisjes lokale në sferën e planifikimit si dhe monitorimit të gjendjes.



1.1.6. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në përgjithësi, infrastruktura ka të bëjë me gjërat që e mbajnë civilizimin të bashkuar si: prodhimin e energjisë dhe sistemet e shpërndarjes; pendat dhe sistemet e ujit; mbledhjen e ujërave të zeza, tubacionet dhe përpunimin; rrugët dhe urat; aeroportet dhe sistemet e transportit publik, gjëra këto prej të cilave të gjithë ne varem shumë. Këto gjëra janë fryt i përpjekjeve të kombinuara të sektorit publik dhe atij privat. Për shembull shumica e aeroporteve janë pronë e entiteteve publike, derisa shumicën e linjave ajrore e posedojnë biznesmenët.

Infrastruktura është trungu i pajisjeve themelore dhe aparaturës kapitale të nevojshme për funksionimin e bazës ekonomike të një shteti. Është e zakonshme që infrastruktura të futet si në një sendiç midis qeverisjes që e rregullon atë dhe tregtisë që varet prej saj.

Më tepër se 250 mijë automjete qarkullojnë sot nëpër rrugët e Kosovës



1.1.6.1. Transporti dhe infrastruktura e tij


Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm të njerëzimit. Ai është pjesë e domosdoshme e ekonomisë dhe luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis lokaliteteve. Transporti krijon lidhje të çmuar në mes të rajoneve, aktiviteteve ekonomike, popullsisë dhe botës. Transporti është faktor dhe pasojë e zhvillimit ekonomik.

Transporti në Kosovë, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike, pastaj transporti ajror i udhëtarëve për në vendet e huaja, ndërkaq transporti përmes hekurudhës është pothuaj simbolik.

1.1.6.1.1. Transporti automobilistik

Lidhja e Kosovës me korridoret rrugore evropiane E10, E8 dhe magjistralen e Adriatikut është një sfidë për ne, dhe në bazë të saj ne duhet të krijojmë një strategji për kyçjen në këto korridore. Në korridorin E10 ne do të mund të kyçeshim përmes magjstrales M25 (Prishtinë - Besianë), apo përmes autostradës Merdare - Durrës që është në fazën fillestare të ndërtimit. Në korridorin E8 (Durrës - Varna), Kosova do të mund të kyçej përmes magjstrales M2 (Ribariq - Hani i Elezit).

► Qarkullimi ditor i automjeteve në rrugët magjistrale



Me magjistralen e Adriatikut Kosova mund të lidhet përmes magjstrales M9 (Prishtinë - Pejë). Kjo do të thotë se këtyre magjstraleve do të duhej t’u kushtohet rëndësi e veçantë në planifikimin strategjik. Në Kosovë aktualisht janë rreth 250 mijë automjete. Transporti më i dendur është në rrugën Prishtinë - Hani i Elezit, pastaj në rrugën Prishtinë - Mitrovicë dhe në rrugën Prishtinë - Pejë.

Më se 50% e të gjitha vendbanimeve të Kosovës nuk kanë qasje direkt në rrugë të asfaltuara. Kosova nuk ka autostradë dhe rrugët e asfaltuara në vendbanimet rurale janë në shumë raste shumë të dëmtuara. Zonat me nivelin më të ulët të zhvillimit të infrastrukturës rrugore janë ato të komunave të Skenderajt, Drenasit, Malishevës, Kaçanikut dhe Shtimes.

Pas luftës, në Kosovë janë bërë shumë ndërtime dhe kyçe ilegale përgjatë brezit rrugor të rrugëve magjistrale. Ky fenomen vazhdon edhe sot dhe paraqet një problem serioz. Kështu po rrezikohen mundësitë për zgjerimin e këtyre rrugëve në të ardhmen; në masë të madhe është ulur niveli i sigurisë dhe shpejtësia e lëvizjes gjë që ka ulur edhe kategorinë e këtyre rrugëve. Dukuria e ndërtimeve ilegale në brezin rrugor është alarmuese dhe kërkon intervenim të shpejtë të shoqërisë. Sa më vonë që të intervenohet dëmet do të jenë më të mëdha dhe më vështirë do të jetë të sanohen.

Në mungesë të transportit përmes hekurudhës, sidomos të mallrave me tonazhë të lartë, rrugët automobilistike ngarkohen së tepërmi dhe kështu vjen deri te dëmtimi i tyre.

RRUGËT E KOSOVËS NË VITIN 2009						
EMËRTIMI I RRUGËVE	LLOJI I SIPËRFAQES QARKULLUESE					
	Rrugë të asfaltuara		Rrugë të paasfaltuara		Gjithsejtë	
	Km	%	Km	%	Km	%
NACIONALE	625	100			625	100
RAJONALE	1127	87.5	161	12.5	1288	100

GJITHSEJTË	1752			1913	100
------------	------	--	--	------	-----

1.1.6.1.2. Transporti hekurudhor

Transporti hekurudhor në Kosovë është në nivel shumë të ultë. Kjo është si pasojë e infrastrukturës së pazhvilluar hekurudhore. Në vitin 2008 kanë qarkulluar tre trena të udhëtarëve:


- Treni i lëvizjes së lirë i cili subvencionohet nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe qarkullon dy herë në ditë në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit - Leshak dhe anasjelltas. Ky tren për shkak të uzurpimit të linjës veriore, që nga tre marsi ka pushuar së qarkulluari në linjën Fushë Kosovë - Leshak dhe pritet që me krijimin e kushteve të futet prap në operim.
- Treni Prishtinë - Shkup i cili për shkak të numrit të vogël të udhëtarëve krijon humbje vjetore prej 620,000.00 eurove.
- Treni Prishtinë-Pejë i cili është mjaft i shfrytëzuar por megjithatë në vitin 2008 ka krijuar humbje prej 230,000.00 eurove.

Me përjashtim të linjës hekurudhore lindore (Bardhosh - Podujevë) dhe të asaj jug perëndimore (Xërxë - Prizren) të cilat nuk janë në operim, të gjitha linjat tjera janë në operim të plotë. Numri i udhëtarëve që shfrytëzojnë trenat është i vogël. Në vitin 2007 ishin 304133 udhëtarë, kurse në vitin 2008 vetëm 102624 udhëtarë.

Niveli i zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë, krahasuar me vendet e rajonit është i ultë. Vet fakti se që nga viti 1963 nuk është ndërtuar asnjë vijë e re hekurudhore flet mjaft për këtë. Kosova ka 333.451 km linjë të hapur hekurudhore, 105.784 km në stacione dhe 103.4 km vija industriale. Rrjeti hekurudhor i Hekurudhave të Kosovës ka 23 tunele me një gjatësi totale prej 9020 metrash dhe 115 ura me një gjatësi prej 2988 metrash. Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit - Mitrovicë. Në vitin 1931 është ndërtuar hekurudha në relacionin Mitrovicë - Leshak, pastaj në vitin 1934 hekurudha në relacionin Fushë Kosovë - Prishtinë - Besianë, në vitin 1936 është ndërtuar ajo në relacionin Fushë Kosovë - Pejë dhe në vitin 1963 hekurudha në relacionin Klinë - Prizren.

Vijat hekurudhore, me përjashtim të atyre që gjenden në disa stacione hekurudhore, janë vija njëfishje. Hekurudhat e Kosovës janë të ngadalshme, si pasojë e mungesës së investimeve në to. Shpejtësia maksimale e lejuar vetëm në disa pjesë të hekurudhave është 80km/h, kurse në pjesët e tjera është edhe më e vogël. Ka mungesa në mirëmbajtjen e hekurudhave, ato po dëmtohen nga mbikalimet e paautorizuara, nga ndërtimet ilegale në brezin hekurudhor dhe hedhja e mbeturinave në afërsi të tyre.

Pasojat e gjendjes së rëndë në të cilën gjendet transporti



PROJECTION - PROJEKSIONI
 Universal Transvers Mercator
 Zone 34
 Projection Transvers Mercator
 Spheroid
 Datum
 WGS 84
 Unit of Measurement
 Meter

LEGJEND - LEGJENDA

ROADS - RRUGE
 - Main Road - Rrugë Magjistrale
 - Regional Road - Rrugë Regionale Asf.
 - Regional Road No Asph. - Rrugë Regionale Pa Asf.

CODE OF ROAD - KODI I RRUGËVE
 112 Main Road - Rrugë Magjistrale
 201 Regional Road - Rrugë Regionale

RAILROADS - HEKURUDHORE
 - Rail Road - Hekurudhore

PLACES - VENDRINDRAT
 - City - Qytet
 - Village - Fshat

BORDER - KUFIT
 - Kosovo Border - Kufiri i Kosovës
 - Border Crossing - Vendi i kalimit

Republic of Kosovo
 Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
 Министерство за Transport, Postë i Telekomunikacion
 Ministry of Transport and Communications

Transport Planning Unit, 2009 Provisional

MINISTRIA E MËJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



hekurudhor dhe infrastruktura përcjellëse e tij janë:

- mbingarkesa e rrugëve automobilistike dhe rrjedhimisht dëmtimi më i shpejtë i tyre,
- transporti më i shtrenjtë automobilistik dhe
- ndotja më e madhe e ajrit.

1.1.6.1.3. Transporti ajror

Nga aeroporti i Prishtinës udhëtarët udhëtojnë në destinacione të ndryshme në Evropë. Kjo mundësohet nga aviokompani të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Numri i fluturimeve të realizuara nga aeroporti i Prishtinës në vitin 2009 ishte 5.714, ndërsa numri i udhëtarëve (shkuarje - ardhje) ishte 1.191.978 udhëtarë.

Në Kosovë sot ekzistojnë aeroporti civil në Sllatinë afër Prishtinës dhe aeroporti ushtarak afër Gjakovës. Ekzistojnë edhe 12 fusha ajrore - aerodrome bujqësore të Aviokosovës dhe një fushë ajrore e Federatës Aeronautike të Kosovës në Dumosh. Shumë prej aerodromeve bujqësore janë në gjendje të keqe fizike dhe pa përkujdesje.

1.1.6.2. Telekomunikacioni


Telekomunikacioni si fushë me rëndësi gati në të gjitha sferat e jetës ka një shtrirje mjaft gjithëpërfshirëse me shërbimet e saj në vend.

Aktualisht në Kosovë, shërbimet e telefonisë fikse, asaj mobile, Internetit, shërbimet postare dhe televizioni kabllor ofrohen nga kompania publike - Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) dhe ato private: Ipko, Kujtesa, D3 mobile dhe Z mobile.

1.1.6.2.1. Telefonia fikse

Telefonia fikse është rrjet tokësor dhe ka shtrirje në shtatë qendrat më të mëdha të vendit si dhe në vendbanimet tjera më të afërta prej këtyre qendrave. Janë rreth 100000 konsumatorë të kësaj telefonie në Kosovë. Shërbimin e telefonisë fikse e ofrojnë PTK që ka rreth 90% të numrit të përgjithshëm të konsumatorëve dhe kompania Ipko me rreth 10% të konsumatorëve. Bazuar në kërkesat për shfrytëzimin e telefonisë fikse nga ana e popullatës shtrohet nevoja për zgjerimin e këtij rrjeti në të gjitha vendbanimet e Kosovës si dhe për zhvillimin dhe modernizimin e këtij shërbimi.


Rrjeti i telefonisë fikse gjendet në procesin e modernizimit dhe zgjerimit të shtrirjes së tij, ngritjen e kualitetit të shërbimeve me aplikimin e teknikës digjitale, fibrave optik dhe sistemit SDH. Shtrirja e fibrave apo kabllit optik me qëllim të ngritjes kualitetit të shërbimeve të këtij rrjeti. Shtrirja e rrjetit tokësor i digjitalizuar është realizuar vetëm në Prishtinë deri më tani, përderisa punët në qytetet tjera janë në proces e sipër.




1.1.6.2.2. Telefonia mobile

Në sistemin e serviseve të telefonisë mobile, aktualisht në Kosovë ekzistojnë 4 operatorë të kësaj telefonie që shfrytëzojnë standardin evropian të teknologjisë GSM. Ata janë Vala (në kuadër të PTK), Ipko, D3 mobile dhe Z mobile. Aktualisht telefonia mobile ka rreth 1400000 konsumatorë prej të cilëve Vala ka rreth 70% dhe Ipko 28%. Vala mbulon rreth 90% të territorit të populluar të Kosovës, kurse rrjeti i Ipkos mbulon me sinjal të kësaj telefonie 99.7% të popullatës, përkatësisht 98.5% të territorit të Kosovës.

► Numri i telefonave në Kosovë dhe në rajon në 100 banorë



► Mbulueshmëria me sinjal të telefonisë mobile nga operatori Ipko



Rrjeti i internetit


1.1.6.2.3. Shërbimet e internetit

Aktualisht në Kosovë shërbimet e internetit ofrohen nga kompanitë: Ipko, Kujtesa dhe PTK të cilat në rrjetin e tyre kanë një numër të konsiderueshëm të shfrytëzuesve të Internetit. Kohëve të fundit janë duke u bërë përpjekje në shtrirjen e rrjetit pa tela që në masë të madhe do të ndikojë në kualitetin dhe shtimin e numrit të shfrytëzuesve. Marrja e sinjalit përmes telave është një mundësi e shtrenjtë dhe më e ngadalshme për dallim nga forma tjetër e marrjes së sinjalit pa tela që është shumë e shpejtë dhe më ekonomike.

Resurset humane, me të cilat Kosova ka përparësi zhvillimore, do të mund të jenë në funksion të zhvillimit bashkëkohor vetëm nëse ngritët arsimimi dhe aftësimi në fushën e teknologjisë informative.

- Rrjeti i shtrirjes së internetit në Kosovë - PTK







1.1.6.3. Infrastruktura e energjetikës

Në Kosovë kapacitetet për prodhimin e energjisë elektrike përbëhen nga: dy termoelektrana - Kosova A me 5 blloqe dhe kapacitet të projektuar prej 800 MW, Kosova B me dy blloqe dhe kapacitet të projektuar prej 678 MW, hidrocentrali i Ujmanit në liqenin e akumuluar të Gazivodës me kapacitet të projektuar 35 MW, hidroelektrana e Radavcit me kapacitet prej 1MW, hidroelektrana e Dikancit me kapacitet prej 4MW, hidroelektrana e Burimit me kapacitet prej 1 MW dhe hidroelektrana Kozhnjer afër Deçanit me kapacitet prej 8.3 MW. Në fillim të vitit 2010 në kodrën e Goleshit janë vendosur tre gjeneratorë me 1.35 MW për prodhimin e energjisë elektrike nga era. Termoelektranat ndodhen në afërsi të Kastriotit dhe punojnë me kapacitet të zvogëluar. Si lëndë djegëse në termoelektrana përdoret linjiti rezervat e të cilit në Kosovë vlerësohen në rreth 12.5 miliard tonelata. Stabilimentet e termoelektranës Kosova A janë shumë të vjetra dhe prishjet janë shumë të shpeshta, kështu që kjo termoelektranë punon me kapacitet të zvogëluar dhe nga 5 blloqet e saj, në funksion janë vetëm 3. Kapaciteti i instaluar i termoelektranave dhe hidroelektranave është 1.527 MW, mirëpo aktualisht kapacitetet prodhuese të disponueshme sillen rreth 900 MW.

Gjatësia e tërësishme e vijave të bartjes (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1,187 km. Rrjeti i bartjes prej 400 kV dhe 220 kV të Kosovës është pjesë integrale e sistemit të ndërlidhur rajonal transmetues. Sistemi i bartjes të energjisë elektrike është i ndërlidhur me të gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV, përveç me Shqipërinë, ku lidhja është vetëm në nivelin 220 kV. Një linjë e re me tensionin prej 400 kV me Shqipërinë, konsiderohet vitale për realizimin e këmbimeve të konsiderueshme të energjisë elektrike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë ndërmjet sistemit të Kosovës, të bazuar në termocentrale dhe sistemit të Shqipërisë, të bazuar në hidrocentrale.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (OSTTK) momentalisht është anëtar i SETSO/NACMF (Network Access, Congestion Management and Power Flows). OSTTK ka për objektiv të anëtarësohet në ETNSO/E, organizatë e re në të cilën janë shkrirë funksionet e UCTE dhe ETSO dhe për këtë janë duke u ndërmarrë hapa konkret si në planin e brendshëm edhe në atë ndërkombëtar.

Problem kryesor në gjendjen e tanishme të furnizimit me rrymë elektrike në Kosovë janë mungesa e sasisë së nevojshme e energjisë elektrike. Arsye për këtë është mungesa e kapaciteteve prodhuese, kapacitetet e vjetruara (termoelektrana Kosova A), pastaj rrjeti i amortizuar i shpërndarjes dhe humbjet e mëdha që në një masë të madhe janë pasojë e mospaguarjes së shërbimeve nga ana e konsumatorëve. Problemi i energjisë ndikon në hezitimin e investitorëve të huaj që të investojnë në Kosovë, si njëra nga mundësitë për ringjalljen e ekonomisë kosovare. Prodhimi i energjisë elektrike është më i vogël se kërkesat e konsumatorëve, që do të thotë se është e nevojshme të ndërtohen kapacitete të reja prodhuese me çka do të përmirësohej furnizimi i konsumatorëve dhe këmbimi i energjisë në rajon do të jetë një mundësi e zhvillimit të këtij sektori.

Kapacitetet e vjetruara janë ndotës të ambientit, prandaj kapacitetet e reja do të duhej të kenë komponentë mjedisore. Ngritja e kapaciteteve të reja do të mundësonte furnizimin e sigurt me energji elektrike të zonave të zhvillimit ekonomik.

Disa të dhëna lidhur me rrjetin e transmisionit mund të shihen në tabelat e mëposhtme:


NIVELI I VOLTASHIT	35 (kV)	10 (kV)	0.4 (kV)
GJATËSIA E LINJAVE (KM)	657	4862	10303

NIVELI I VOLTASHIT	400 (kV)	220 (kV)	110 (kV)
GJATËSIA E LINJAVE (KM)	183	289	625



KARAKTERISTIKAT E RRJETIT TË DISTRIBUCIONIT		
NIVELI I VOLTAZHIT	35/10 (kV)	10/0.4 (kV)
NUMRI I TRAFOSTAC.	58	3875
NUMRI I TRANSFORM.	113	3915
FUQIA E INSTALUAR(MVA)	626	1150

KARAKTERISTIKAT E RRJETIT TË TRANSMISIONIT				
NIVELI I VOLTAZHIT	400/220 (kV)	220/110 (kV)	220/35 (kV)	110/xx (kV)
NUMRI I TRAFOSTAC.	1	4	1	22
NUMRI I TRANSFORM.	2	8	2	40
FUQIA E INSTALUAR(MVA)	800	1170	300	1223



Ngruhja e përqendruar

Sistemet e ngrohjes së përqendruar ekzistojnë vetëm në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Këto sisteme janë të shtrira për aq sa përmbushin vetëm 3% të kërkesave për ngrohje të hapësirave. Teknologjia e ngrohjes bazohet në mazut dhe në naftën për djegie. Ky sektor ballafaqohet me teknologji të vjetruar, ndikim negativ në mjedis, si dhe me nivel të ulët të faturimit dhe arkëtimit të energjisë së shpenzuar.

Gazsjellësi dhe naftësjellësi

Në Kosovë nuk ka burime të gazit që do të mund të shfrytëzoheshin. Për këtë arsye duhet të analizohen mundësitë e furnizimit me gaz nga burimet jashtë Kosovës dhe rrugët më të favorshme për sjelljen e tij. Gypi ekzistues i gazsjellësit në relacionin Kosova "A" - Shkup i cili ka funksionuar deri në vitin 1986, ka bërë furnizimin me gaz të shkrites në Shkup (Maqedoni), Fabrikën e çimentos në Elez Han, Feroniklin, Trepçën dhe ngrohtoren e qytetit në Prishtinë. Gazi është prodhuar nga procesi i gazifikimit të lignitit. Tani ka disa dëmtime në gjatësinë e këtij gypi, prandaj nuk funksionon. Mirëpo për të ardhmen duhet të shqyrtohet mundësia për sjelljen e shpejtë të gazit, fillimisht në Prishtinë e Ferizaj, e më vonë edhe në qendrat e tjera të Kosovës.

Nga aspekti i furnizimit me naftë dhe prodhimit të naftës Kosova është në pozitë të vështirë. Nuk ka burime të naftës dhe rafineri naftë. Kosova tërësisht varet nga importi i naftës dhe derivatet e saj. Importi kryesisht realizohet përmes transportit rrugor, përmes rrugëve magjistrale dhe rajonale përpos një sasi të vogël të importit të naftës i cili bëhet përmes transportit hekurudhor, e cila sasi naftë shfrytëzohet për nevojat e UNMIK-ut dhe KFOR-it. Udhëzimet e BE-së për sistemin energjetik, e posaçërisht për sektorin e naftës dhe derivateve të naftës, janë të fokusuar në ndërtimin e rezervuarëve për naftë, me qëllim që të sigurohen rezervat, në rast të mungesës së furnizimit apo në rast të restriksioneve të furnizimit.

1.1.6.4. Infrastruktura ujore

1.1.6.4.1. Shfrytëzimi i ujit

Me përjashtim të Malishevës, në qendrat e tjera komunale ka sisteme të instaluar të ujësjellësve. Përkundër kësaj sipas OBSH (Organizatës Botërore të Shëndetësisë), në Kosovë vetëm 44% e popullatës urbane dhe 8% e asaj rurale është e kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë. Rreth 64% e popullatës rurale përdorë ujin e puseve të cektë dhe të pambrojtura. Siç shihet nga lart, vetëm banorët të cilët janë duke banuar nëpër qytete furnizohen me ujë nga rrjeti qendror i ujësjellësit dhe në shumë raste jo të gjithë banorët. Në disa qytete, lagje të tëra nuk janë të kyçura në rrjetin qendror të ujësjellësit (Besiana, Gjilani, Ferizaj etj). Për shkak të mungesës së ujit në shumicën e qyteteve ka reduktime të rregullta (Prishtina, Ferizaj 16-18 orë/ditë, Besiana në disa lagje edhe nga 18 orë/ditë, Vushtrri deri 20 orë/ditë, Mitrovica etj) ose pjesët e larta të qytetit nuk kanë ujë me ditë të tëra. Humbjet teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit janë shumë të mëdha (mesatarja e humbjeve është rreth 50%).


Sa i përket ujitjes së tokës, në vitin 2003 kompanitë rajonale të ujitjes kanë ujitur vetëm 20,4% të sipërfaqeve të tokave që janë nën menaxhimin e tyre.

1.1.6.4.2. Rregullimi i regjimit të ujërave

Shikuar në tërësi, gjendja e rregullimit të ujërrjedhave dhe mbrojtja nga vërshimet në territorin e Kosovës është e pavolitshme. Edhe pse në periudhën e kaluar janë bërë disa punë për rregullimin e ujërrjedhave të shumta, përsëri kohë pas kohe kanë ndodhur vërshime të intenziteteve të ndryshme të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në amvisni dhe shumë degë të ekonomisë.

Kjo gjendje është pasojë, parasegjithash e faktit se gjatë aktiviteteve për rregullimin e ujërrjedhave dhe mbrojtjes nga vërshimet më shumë janë bërë punë të karakterit parcial, dhe vetëm gjatë kohës së fillimit të ndërtimit të sistemeve hidromelioruese këtij problemi i është qasur më me intensitet. Mirëpo, intensiteti i realizimit të këtyre punëve edhe më tutje është i pavolitshëm. Situatën më së shumti e rëndon mirëmbajtja e dobët dhe kontrolli i pamjaftueshëm i objekteve mbrojtëse përgjatë lumenjve, puna e pamjaftueshme hulumtuese dhe studimore.

Lumenjtë e Kosovës nuk janë të rregulluar që të mund t'i pranojnë plotat (nivelet maksimale të ujit) dhe si pasojë do të ishin përmbytjet me përmasa të mëdha. Në bazë të shënimeve të sistematizuara (master planit të vitit 1983), gjatësia e lumenjve që rrezikojnë të vërshojnë është 492 km. Prej këtyre deri më tani janë rregulluar vetëm rreth 140km apo rreth 28%.



SHPJEGUËSI

	Nuk furnizohet nga KUR
	Projekti i ri për furnizim është planifikuar
	Projekti i ri për furnizim është në implementim
	Pjesërisht e furnizuar nga KUR <50%
	Pjesërisht e furnizuar nga KUR >50%
	Furnizuar nga KUR
	Republika e Kosovës



1 : 100 000

► Mbulueshmëria e furnizimit me ujë nga kompanitë rajonale. Burimi: AKMM - Raporti i Gjendjes Mjedisore në Kosovë 2008 - 2009.

1.1.6.4.3. Mbrojtja e ujërave nga ndotja

Rreth 28% e popullatës në Kosovë është e kyçur në sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza (rreth 25% në zonat urbane dhe 3% në ato rurale). Në Kosovë nuk kemi asnjë impiant për pastrimin e ujërave të ndotura nga vendbanimet urbane dhe rurale. Ujërat e zeza janë njeri nga ndotësit e lumenjve dhe ujërave nëntokësore, prandaj shtrihet nevoja e ndërtimit të fabrikave për pastrimin e ujërave të zeza. Impiantet për pastrimin e ujërave të ndotura industriale kanë filluar të ndërtohen paralel me ndërtimin e kapaciteteve prodhuese dhe kanë funksionuar vetëm në periudhën provuese, kurse më vonë janë lënë jashtë funksionit.



1.1.6.5. Deponitë e mbeturinave

Procesin e grumbullimit përkatësisht bartjes së mbeturinave prej bazës (prodhimit) deri te deponimi e bëjnë ndërmarrjet publike për shërbime komunale. Në trajtimin e mbeturinave, përkatësisht grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave operojnë edhe kompani private dhe OJQ. Në tërë Kosovën kemi gjithsejtë 30 ndërmarrje publike komunale, në secilin qytet nga një, ndërsa 8 janë kompani private vendore që kryejnë shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në disa qytete të Kosovës.

Prej 30 komunave të Kosovës, 26 prej tyre kanë pasur deponi (fushëhedhurinë) komunale qysh prej shumë viteve. Me ndërtimin e deponive të reja, MMPH në bashkëpunim me AKM dhe komunat gjegjëse, disa prej tyre i ka mbyllur dhe është duke u angazhuar që t’iu dali në ndihmë strukturave komunale për gjetjen e fondeve që të bëhet një rehabilitim i tyre sa më i suksesshëm pasi që t’iu bëhet VNM-ja. Këtyre deponive nuk u është bërë asnjëherë vlerësimi i ndikimit në mjedis edhe pse ato paraqesin burim ndotje të ajrit tokës e në veçanti ujërave nëntokësor. Pas luftës është bërë mbyllja e disa deponive të vjetra të financuara nga AER-i edhe pse ato ende vazhdojnë të përdoren derisa të ndërtohen deponitë e reja rajonale. Shembull përmendim deponitë e mbuluara të Lipjanit, Prizrenit, Besianës, Prishtinës, ndërsa deponitë që nuk shfrytëzohen dhe që janë në mëshirë të askujt dhe presin të rishikohen dhe të mbyllen janë: deponia e Gjilanit Besianës, Dardanës, Artanës, Vitisë dhe Ferizajt.


Në Kosovë largimi i mbeturinave të ngurta bëhet në mënyrë të organizuar në deponitë rajonale dhe komunale. Janë rehabilituar dhe po ashtu janë ndërtuar disa deponi të reja me ndihmën e donacioneve të AER-it, COOPI-it dhe DANID-ës. Punët në ndërtimin e deponive të reja kanë përfunduar në deponitë e Gjilanit, Pejës, Besianës, Mitrovicës, Fushë Kosovës dhe Kaçanikut, ndërkaq në përfundim janë punët në deponitë e Prizrenit, Dragashit dhe Zveçanit. Në tabelën e mëposhtme në vendet që janë theksuar me ngjyrë të zezë, deponitë e reja nuk janë ndërtuar ende mirëpo AER-i ka ndarë mjetet financiare për ndërtimin e tyre.

Mbeturinat e rrezikshme janë një nga problemet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Momentalisht nuk ekziston asnjë deponi e materieve të rrezikshme, një pjesë e mbeturina te rrezikshme hedhen ne deponitë rajonale.

► Deponitë e reja

VENDI	Për numër të banorëve	VËLLIMI - m ³	DONATORI
PRISHTINA	700.000	5.000.000	AER
MITROVICA	250.000	-	DANIDA
PODUJEVA	100.000	700.000	AER
GJILANI	200.000	1.200.000	AER
PRIZRENI	500.000	2.500.000	AER
PEJA	300.000	1.500.000	AER
FERIZAJI	200.000	deponi - stacion transfer	AER
ZVEQANI	50.000	300.000	AER
DRAGASHI	20.000	150.000	AER
KAÇANIKU			





► Lokacionet e deponive ekzistuese në Kosovë

1.1.6.6. Potencialet për zhvillimin e infrastrukturës teknike

Pasuritë e mëdha me linjit janë një potencial i madh për zhvillimin e energjetikës. Sipërfaqe të mëdha të pasura me linjit që ndodhën në pjesë të ndryshme të Kosovës sigurojnë sasi të mjaftueshme për prodhim të energjisë elektrike edhe për disa dekada. Konfiguracioni i mirë i terrenit i përshtatshëm për akumulimin e ujërave të nevojshëm për ujitje, prodhim të energjisë dhe ujit të pijes është tjetër potencial i rëndësishëm që në mënyrë direkte ndihmon në zhvillimin e infrastrukturës ujore dhe shërbimeve që lidhen me të.

1.1.6.7. Skenari i trendit

Nëse vazhdon trendi i tanishëm i ndërtimeve të paligjshme në brezin rrugor do të ulët niveli i sigurisë dhe shpejtësia në rrugët do të pamundësojë qarkullim normal. Ndërtimet përgjatë rrugëve janë gjithashtu pengesë në zgjerimin eventual të tyre.

Kjo po shkakton edhe humbjen e tokës kualitative bujqësore dhe në këtë drejtim edhe vështirësi në hartimin e planeve të niveleve dhe llojeve të ndryshme.

Jostabiliteti në furnizimin me energji elektrike po shkakton mjedis të pasigurt dhe joatraktiv për investitorët e kjo natyrisht po ndikon negativisht edhe në funksionimin e gjithmbarshëm të ekonomisë.

Shkalla e ulët e ujitjes së tokave bujqësore po rezulton me rendimente të ulëta bujqësore por edhe me stagnim të bujqësisë në tërësi.

Shumica e shtretërve të lumenjve janë të pa rregulluar, faktori antropogjen dhe një pjesë e madhe e tyre nga të reshurat e mëdha shkaktojnë vërshimin e sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore e cila po shndërrohet në tokë të pashfrytëzueshme.

Mos ekzistimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza po shkakton ndotjen e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor. Kjo në mënyrë direkte po krijon probleme në furnizim me ujë të pijshëm, sidomos në zonat rurale ky problem është më i theksuar edhe për faktin e mungesës së rrjetit të ujësjellësit.

Kërkesat e pjesëmarrësve në fushën e infrastrukturës teknike që dolën nga takimet publike:

- Zhvillimi i infrastrukturës teknike në zonat rurale (rrugët, elektriciteti, ujësjellësit, kanalizimet e ujërave të zeza)
- Investimet në zhvillimin e hekurudhave
- Preokupimi i shoqërisë me korridoret e trafikut dhe planifikimi i tyre (ndalimi i ndërtimeve të paligjshme në brezin rrugor)
- Qasja sa më e lehtë në korridoret rrugore rajonale
- Hapësirë më e madhe për trafikun, ngritja e sigurisë në trafik
- Investimet në ngritjen e prodhimit të energjisë elektrike
- Ndalimi i ndërtimeve mbi kanalet e ujitjes



1.1.7. KONTEKSTI NË RAJON DHE EVROPË

1.1.7.1. Kosova dhe fqinjët

Kosova është e lidhur historikisht me fqinjët në rajon. Përveç lidhjeve nga ish RSFJ-së, interesat e përbashkëta për integrimet rajonale dhe integrim në BE kanë hapur rrugën për bashkëpunim në projekte konkrete ndërkufitare sidomos me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë. Projektet e infrastrukturës rajonale, projektet e parqeve rajonale dhe zonave turistike malore janë disa fusha ku bashkëpunimi mund të forcojë pozitën për një integrim më të shpejtë në BE.

1.1.7.2. Iniciativat në Evropën Juglindore

Plani hapësinor i Kosovës trajton sfidat dhe mundësitë të cilat Kosovën mund ta integrojnë në rajon dhe Bashkimin Evropian. Pozita e Kosovës në raport me zhvillimet rajonale, deri më tani, ka qenë e margjinalizuar për shkak të statusit të saj të padefinuar. Mirëpo ajo gradualisht ka filluar të marrë pjesë në iniciativat e ndryshme të integrimi evropiane siç është CADSES dhe Pakti i Stabilitetit. Përmes tyre, Kosova do të mund kyçet në projektet zhvillimore të rajonit të Evropës Juglindore lidhur me këto katër prioritete:

- *Promovimi i zhvillimit hapësinor për arritjen e kohezionit social dhe ekonomik*
- *Sisteme efikase të transportit dhe kyçja në shoqërinë informative*
- *Promovimi dhe menaxhimi i pejzazhit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore*
- *Mbrojtja e mjedisit, menaxhimi i resurseve dhe parandalimi i risqeve*

1.1.8. STRATEGJITË E SEKTORËVE TË QEVERISË SË KOSOVËS

Politikat sektoriale në formë të dokumenteve të publikuara janë përmbledhur si pjesë e veçantë e Planit Hapësinor të Kosovës. Ato kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimeve në hapësirë të sektorëve përkatës. Përcaktues të kornizës politike të sektorëve janë edhe strategjitë sektoriale të hartuara prej disa sektorëve të cilat kanë përcaktuar në mënyrë të qartë qëllimet dhe synimet e zhvillimit të sektorit përkatës. Qëllimet e zhvillimit hapësinor, në parim, i referohen edhe qëllimeve të sektorëve përkatës, për të siguruar se aspekti hapësinor është mbështetës i zhvillimeve të sektorit.

1.1.8.1. Strategjia e Mjedisit⁵⁹

Kosova është duke kaluar nëpër një fazë të rëndësishme të zhvillimeve të një periudhe të pasluftës ku ngjashëm me vendet e pasluftës të rajonit, megjithatë mjedisi fillimisht nuk ka qenë një ndër prioritetet.

Kosova nuk ka pasur ndonjë traditë të gjatë të trajtimit të problemeve mjedisore, nuk ka pasur institucion (ministri) përgjegjës për mjedisin e as legjislacion të duhur për të realizuar këtë. Të gjitha këto fakte krijojnë pasqyrën e interesimit të administratave të kaluara në Kosovë për mjedisin. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë është miratuar në vitin 2003 dhe obligon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për përgatitjen e propozimit të Strategjisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Mjedisit sot paraqet një problem global dhe është një nga problemet e përbashkëta si atyre të zhvilluara ashtu edhe atyre në zhvillim. Në aspektin ndërkombëtar sot objektivat kyçe afatgjate për mbrojtjen e mjedisit janë:

- a. Përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve - është e qartë se pa një zhvillim ekonomik nuk mund të ketë as përkujdesje të duhur për mjedisin, sepse mbrojtja e mjedisit kushton.
- b. Përdorimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore - duke u orientuar në resurset ekzistuese të cilat janë në dispozicion dhe ato resurse që mund të ripërtërihen.
- c. Ndikimet e dëmshme në mjedis të eliminohen - duke u orientuar në veprimtaritë ekonomike që kanë ndikim sa më të vogël në mjedis.

Në këtë aspekt këto objektivat për Kosovën do të paraqesin sfida të mëdha drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së mjedisit i cili është i

⁵⁹ MMPH - Departamenti i Mjedisit



shkoqitur në disa fusha të mbrojtjes së mjedisit (ku janë identifikuar projektet konkrete për periudhën pesë vjeçare) është mjeti më i mirë për të realizuar objektivat mjedisore.

1.1.8.2. Libri i Gjelbër - Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë⁶⁰


Qëllimi i këtij Libri të Gjelbër është që të përcaktojë politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Drejtoratit të Çështjeve Rurale (DÇR) për të ardhmen e parashikueshme, së bashku me kornizat e tyre ligjore dhe organizative. Strategjia synon përmirësim të sektorit bujqësor dhe rural në Kosovë. Ministria do të luajë një rol lehtësues në themelimin e kornizës juridike dhe institucionale, në mënyrë që të promovojë tranzicionin nga ish ekonomia e centralizuar në ekonomi të planifikuar të tregut të lirë përbrenda rolit rregullator të Administratës Publike. Duke marrë parasysh faktin se 60 për qind e popullsisë jeton në zona rurale dhe në të shumtën me nivel të ulët të punësimit, strategjia përkon me të dyja, me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, duke synuar aktivitetet gjeneruese të të ardhurave dhe shumëfishimin e të mbjellave drejt produkteve me vlerë të shtuar me mundësi të mbulimit të pjesës më të madhe të kërkesës së konsumit vendor. Gjithashtu, strategjia adreson mundësitë e tregut rajonal dhe të BE-së dhe zhvillimin e zinxhirit të ushqimit prej fermës deri të produkti final i ushqimit.

1.1.8.3. Strategjia e Energjisë e Kosovës⁶¹

Strategjia e Energjisë e Kosovës është hartuar në përputhshmëri me Ligjin e Energjisë dhe Programin e Qeverisë së Kosovës dhe përbën kornizën themelore në bazë të të cilës pas aprovimit në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës i përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore sipas sektorëve të energjisë. Për të realizuar objektivat e Strategjisë duhet të përcaktohen edhe politikat, projektet, dhe masat e nevojshme Ligjore, organizative, strukturore, edukative dhe politike. Obligimi për të hartuar Strategjinë del edhe nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi krijimin e tregut të përbashkët rajonal dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Strategjia për zhvillimin e energjisë së Kosovës ka të bëjë me menaxhimin efektiv të burimeve ekzistuese energjetike dhe me zhvillimin e burimeve të reja. Ajo përcakton politikat dhe masat për të shfrytëzuar burimet energjetike në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale, duke siguruar ruajtjen e mjedisit sipas standardeve të pranura ndërkombëtare. <http://www.ks-gov.net/mem>

► Fushat e minierave potenciale të linjtit



⁶⁰ MBPZHR
⁶¹ MEM



1.1.8.4. Strategjia e arsimit të lartë të Kosovës⁶²

Strategjia 10-vjeçare e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë është dokumenti që reflekton konsensusin në mes të faktorëve politikë, komunitetit akademik dhe shkencor, studentëve, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë për një vizion të artikuluar qartë se çfarë arsimit të lartë dëshirojmë dhe skicon rrugën për t'i përmbushur objektivat tona strategjike.

Dokumenti i strategjisë është një propozim për transformimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas një modeli, planifikimi, administrimi dhe menaxhimi më të efektshëm.

Realiteti i ri politik, shoqëror dhe ekonomik në Kosovë është pika fillestare e ndryshimeve dhe zhvillimeve të reja në fushën e arsimit të lartë. Izolimi dhe zhvillimet politike të periudhës së kaluar kanë rezultuar me një ngecje në zhvillim, e cila vazhdon të jetë e evidente edhe në periudhën e pasluftës, me gjithë praninë e disa zhvillimeve pozitive në këtë hapësirë.

Transformimi i arsimit të lartë ndodh kur vendi po kalon periudhën e tranzicionit. Agjenda kombëtare ka përcaktuar si pika kryesore: përcaktimin e statusit final politik të Kosovës, zhvillimin ekonomik të vendit, politikat sociale për të krijuar mundësi të barabarta dhe për të vendosur drejtësi për të gjitha grupet etnike dhe të pafavorizuara, si dhe integrimin e vendit në bashkësinë evropiane.

Sistemi i arsimit të lartë nevojitet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i shërbejë rendit të ri shoqëror, t'i përgjigjet nevojave kombëtare dhe t'i përgjigjet realiteteve dhe mundësive të reja.

Me gjithë problemet e shumta dhe vullnetin për të bërë ndryshime, është bërë e qartë se nuk ka zgjidhje të lehta dhe të shpejta për zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë është përcaktuar që ndryshimeve t'u qaset në mënyrë sistematike, duke përfshirë në këtë proces të gjithë faktorët relevantë në shoqëri. Duke u nisur nga ky përcaktim janë kërkuar zgjidhje të cilat do të bëjnë të mundur që vendi ynë të bëhet pjesë e pandashme e hapësirës evropiane të arsimit të lartë e përcaktuar me objektivat e Procesit të Bolonjës. Në këtë kontekst, duke ndërtuar një sistem cilësor e fleksibil të arsimit të lartë që u përgjigjet kërkesave të shoqërisë, do të krijohen parakushte që arsimit i lartë të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë. <http://www.mashtgov.net>





1.1.8.5. Strategjia e Shëndetësisë⁶³

Misioni i Ministrisë së shëndetësisë është që të zhvillojë sistem efektiv dhe efikas të shërbimeve shëndetësore të kualitetit të lartë për të plotësuar nevojat e tërë popullsisë së Kosovës, pa marrë parasysh origjinën etnike, religjionin ose gjininë, dhe të përmirësojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore përmes:

- Zhvillimit të politikës dhe këshillës profesionale për shërbimet shëndetësore, për të siguruar politika dhe këshilla më të mira profesionale dhe standarde më të mira të shërbimeve shëndetësore përmes aktiviteteve parandaluese;
- Menaxhimit strategjik duke siguruar kornizë menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme dhe të cilat përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe duke i përkrahur ato përmes zhvillimit të potencialit njerëzor, koordinimit të investimeve menaxhimit të kualitetit, dhe sistemeve informative; dhe
- Menaxhimit operativ duke siguruar ofrimin e shërbimeve publike kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar, sekondar, terciar në të gjitha institucionet shëndetësore. <http://www.mshgov.net>



1.2. VLERËSIMI I GJENDJES NË KOSOVË

Zhvillimet që po ndodhin në Kosovë janë kryesisht pa plan dhe në të shumtën e rasteve përfaqësojnë interesin e grupeve të caktuara dhe të një pjese të caktuar të territorit të Kosovës. Trevat që tradicionalisht janë përballur me probleme esenciale të papunësisë dhe varfërisë ende po vazhdojnë të përballen me to, në krahasim me trevat tjera ku zhvillimi është i paqëndrueshëm i cili nuk plotëson kriteret themelore të zhvillimit hapësinor.

Mjedisi, si resurs i pakompenzueshëm është duke u atakuar nga të gjitha anët dhe format e mundshme duke u shndërruar, në të shumtën e rasteve, në mjedis pa vlerë dhe pa të ardhme të qëndrueshme.

Krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik, përkujdesja për trashëgiminë, shfrytëzimi më me kujdes i tokës, krijimi i një mjedisi më kualitativ jetësor, ngjitja e nivelit të shërbimeve në arsim dhe shëndetësi, ulja e varfërisë dhe përmbushja e standardeve janë gjithsesi çështjet prioritare për të cilat duhet të ndërmerren veprime që do të mundësonin përmirësimin e tyre.

Këto kërkesa dolën si rezultat i vlerësimit të gjendjes së zhvillimit hapësinor në Kosovë dhe si të tilla u vërtetuan, u plotësuan dhe u mbindërtuan edhe nga pjesëmarrësit e shumë gjatë konsultimeve publike të organizuara në disa qendra të mëdha urbane në Kosovë.

1.2.1. ANALIZA SWOT

Kjo analizë shqyrton ndikimin e çështjeve të hulumtuara të cilat në formë të përparësive dhe dobësive që veprojnë nga brenda, dhe mundësive dhe rreziqeve që veprojnë nga jashtë, paraqesin faktorët kryesorë për zhvillimet e ardhshme në hapësinën e Kosovës.

1.2.1.1. Aspekti legjislativ, institucional dhe politik

Përparësitë

- Struktura e re demokratike e institucioneve të Kosovës
- Lidhshëria dhe dëshira për të arritur zhvillimin e dëshiruar
- Ligjet e reja
- Prezenca institucionale ndërkombëtare - ICO, EULEX, EU, KFOR, UNDP etj.
- Bashkëpunimi i vendosur me vendet e rajonit
- Orientimi drejt integritimit në BE

Dobësitë

- Mungesa e strategjisë kombëtare për zhvillim
- Mungesa e zbatimit të ligjeve në fuqi
- Mungesa e kadrove të specializuara
- Mungesa e sistemit informativ qendror dhe sektoral
- Shkalla e ulët e bashkëpunimit ndërinstitucional
- Kufizimet financiare dhe teknike
- Sistemet paralele qeverisëse

Mundësitë

- Bashkësia Evropiane e përcaktuar për përmirësimin e situatës
- Përkrahje nga shumica e vendeve për zhvillim
- Shfrytëzimi i prezencës institucionale ndërkombëtare për përfitime të ndryshme
- Programet e bashkëpunimit në rajon
- Diaspora burim potencial për zhvillim
- Kyçja në korridoret e infrastrukturës rajonale

Rreziqet

- Vonesa e vendosjes së kontrollit nga institucionet shtetërore në tërë territorin e Kosovës
- Perceptimi për Kosovën si jostabile
- Korridoret e infrastrukturës ndërkombëtare e anashkalojnë Kosovën
- Vendet fqinje me atraktive për investime



1.2.1.2. Aspekti i përgjithshëm - Socio-ekonomik-mjedisor dhe fizik

Përparësitë

- Pozita qendrore ne rajon me mundësi kapitalizimi per investitoret e jashtem ne kushtet e liberalizimit tregtar
- Kushtet e përshtatshme natyrore - klima dhe topografia, resurset natyrore-nëntokësore mbitokësore, biodiversiteti -(metalet dhe ligniti)
- Kuadri ligjor modern dhe stabiliteti makroekonomik,
- Kapitali njerëzor - popullata e re me energji dhe frymë ndërmarrëse dhe me qëndrim pozitiv ndaj reformave dhe ekonomise së tregut
- Vlera të krijuara dhe të trashëguara
- Potencial për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë, energjetikës, tregtisë dhe turizmit
- Distanca relativisht të vogla midis qendrave të mëdha
- Përvetësimi i lehtë i teknologjisë informative dhe njohurive të reja
- Organizmi rajonal i mbledhjes së mbeturinave
- Reformat në arsim

Dobësitë

- Mungesa e regjistrimit të popullsisë
- Dendësia e madhe popullesisë në zonat urbane
- Migrimi i popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane
- Shkalla e lartë e papunësisë
- Shkalla e lartë e varfërisë
- Shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjave
- Mungesa e sigurimit social
- Braktisja e shkollimit
- Mungesa e hapësirës së mjaftueshme shkollore dhe shëndetësore
- Ndotja dhe degradim i madh i mjedisit
- Shfrytëzim joracional dhe i pakontrolluar i resurseve natyrore dhe i hapësirës
- Kapaciteti i pamjaftueshëm dhe menaxhimi i dobët i deponive lokale
- Resurset ujore të pa mjaftueshme (Kosova Lindore dhe Qendrore)
- Shtretërit e lumenjve të parregulluar
- Shtirirja horizontale e vendbanimeve
- Ndërtimet ilegale dhe vendbanimet joformale
- Kualiteti i dobët i ndërtimeve
- Niveli i tashëm i zhvillimit ekonomik, shpërpjesitmet e tij dhe stagnimi ne rritje ekonomike
- Niveli i tashëm i zbatimit të shtetit ligjor dhe i qeverisjes së zhvillimit
- Ambienti ende jomiqësor për investime
- Qasja e vështirësuar në lokacionet për biznes me infrastrukturë adekuate
- Privatizimi i ngadalësuar
- Moszhvillim i sektorit NVM - prioritet për zhvillim ekonomik
- Çmimi i ulët i tokës bujqësore
- Mungesë e marketingut - promovimit të Kosovës,
- Prodhimtaria jo e zhvilluar,
- Kredi jo të favorshme,
- Nivel i ulët i zhvillimit te bujqësisë e blegtorisë
- Infrastrukturë fizike jo e mjaftueshme dhe jofunksionale
- Mungesë e sistemit të ujitjes
- Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza

Mundësitë

- Përvetësimi i teknologjive të reja
- Hapja e universiteteve të reja në favor të zhvillimit të balancuar
- Zhvillim ekonomik i mbështetur në kapacitetin e ri intelektual dhe zotërimin e njohurive të reja
- Kyçja në korridoret e infrastrukturës pan - Evropiane.
- Përfshirja në programet e zhvillimit rajonal (INTRREG, CADSES, ESTIA ...)
- Dendësimi i vendbanimeve në favor të mbrojtjes së tokës

- Tërheqja e investimeve dhe donacioneve
- Harmonizimi i zhvillimit socio ekonomik me zhvillimet demografike
- Përmirësimi i kualitetit jetësor
- Kyçja në korridoret e infrastrukturës pan - Evropiane.
- Prania Ndërkombëtare në Kosovë
- Shfrytëzimi i përvojës së vendeve të zhvilluara
- Përfshirja në Euro - Zonë
- Angazhimi i faktorit ndërkombëtar me asistencë teknike dhe financiare

Rreziqet

- Ndërrimi i strukturës së popullsisë për shkak të emigrimit të popullatës së re
- Kthimi i refugjatëve pa status të zgjidhur politik
- Rritja e dukurive negative
- Rënia e kualitetit jetësor
- Humbja e pakthyeshme e resurseve natyrore dhe vlerave të krijuara dhe të trashëguara
- Vendet fqinje janë më atraktive për investime
- Rritja e ndotjes së mjedisit.
- Mbetja e Kosovës jashtë korridoreve evropiane rrugore të parapara
- Humbja e traditës së familjes kosovare

Hulumtimet e përmbledhura në këtë dokument dhe diskutimet në lidhje me to, si dhe dokumentet tjera në dispozicion të hartuara nga agjenci dhe institute vendore ndërkombëtare të cilat trajtojnë zhvillimin e Kosovës në periudhën e ardhshme dhjetëvjeçare, kanë shërbyer si bazë për punë në hartimin e Vizionit dhe caqeve të zhvillimit hapësinor të Kosovës.



1.3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INVESTIVE

Në rrethanat e Kosovës vlerësimi i kapaciteteve investive (sektorët dhe burimet) ka rëndësi të veçantë duke pasur parasysh nevojën për mobilizimin e të gjitha burimeve të investimeve. Kjo sidomos ka rëndësi për të vlerësuar sidomos kapacitetet e investimeve publike.

► **Struktura e burimeve te investimeve në %**

	2004 - 2015
Investimet	100.00
Private	60.00
Qeveria	25.00
Donatorët	5.00
Institucionet financiare ndërkombëtare	10.00

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

Nga aspekti i burimeve, investimet kryesisht do të gjenerohen nga sektori privat. Gjatë kësaj periudhe ato do të kenë pjesëmarrje dominante (60%), ndërsa buxheti i Kosovës vlerësohet të ketë pjesëmarrje prej ¼ në gjithsej investime. Është për tu pritur se komuniteti ndërkombëtar do ta reduktojë mbështetjen me ndihma në favor të mbështetjes me fonde strukturore. Nga këto raporte, vërehet një mbështetje e rritjes ekonomike me mobilizimin e fondeve dhe të investimeve të brendshme dhe të jashtme. Ky orientim ofensiv investues do ta reflektohet me rritjen e pjesëmarrjes së investimeve në BPV nga 28.4% (2004) në 34.8% (2010) dhe 47.7% (2015).

Projeksionet e strukturës indikative të investimeve për periudhën 2005 - 2015 janë bërë duke u bazuar në tre faktorë.

1. Trendet ekonomike të pasluftës në Kosovë
2. Planifikimet e bëra nga institucionet kosovare me theks të veçantë në Ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit
3. Përvojat nga vendet tjera, sidomos ato të vendeve fqinje dhe vendeve në tranzicion, Investimet janë planifikuar për sektorët që supozohet se do të jenë absorbuesit kryesorë të tyre në dhjetëvjetëshin e ardhshëm.

Tabela në vijim paraqet shumën e planifikuar në miliarda euro për investime në disa sektorë.

► **Struktura sektoriale e investimeve në mld. Euro për periudhën 2005-2015**

Bujqësia	0.72
Arsimi	1.44
Ndërtimi/Banimi	2.10
Industria/	3.85
Tregtia/ Shërbimet	2.65
Telekomunikimet	0.65
Shëndetësia	0.43
Totali	11.84

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

Investimet në sektorët e arsimit dhe bujqësisë janë planifikuar në bazë të përvojave të vendeve tjera, sidomos përvojave bullgare dhe atyre maqedonase, dhe në bazë të vlerësimeve mbi arsyeshmërinë e atyre investimeve, për ngritjen e cilësisë së resurseve humane në Kosovë si faktorë thelbësorë i zhvillimit. Supozohet se pjesa më e madhe e investimeve do të shkojë drejt aktiviteteve industriale, tregtare dhe atyre shërbuese.

Sektori i energjisë po ashtu do të jetë absorbues i madh i investimeve. Ndërtimi i një termocentrali të rij nënkupton investimin e rreth 2.2 miliard euro derisa investime tjera planifikohen edhe në termocentralet ekzistues dhe në mihjen sipërfaqësore.

► Energjetika dhe minierat - Investimet e planifikuara për periudhën 2009 - 2020

TC i ri (2000 MW)	2.250 MD
Minierat e qymyrit	0.616
TC e vjetra (A e B)	0.454
Total	3.320

Burimi: PATEL/MEM

Një pjesë e madhe e investimeve planifikohen të alokohen në sferën e ndërtimit të sipërfaqeve për banim. Në këtë sektorë janë planifikuar të investohet rreth 2.1 miliardë euro. Kjo llogaritje është bërë duke marr parasysh shtimin e popullsisë për 300 000 - 400.000 persona, numrin mesatar deri në vitin 2015. Duke marr një mesatare të një familjeje prej 5 anëtarëve atëherë do të kemi një kërkesë mesatarisht 70.000 banesash të cilat do të kishin një kosto prej 30000 euro që do të rezultonte më shifrën investuese të dhënë më lart.

Planifikohen rreth 4.5 miliard euro investime në infrastrukturën e transportit deri në vitin 2022.

Bazuar në të dhënat e AKM-së kërkesat kapitali investuese të PTK-së janë afër 450 mil. Euro. Nga ana tjetër, futja e operatorëve të rijë do të nënkuptonte investimet e rreth 200 mil Eurove shtesë.


Në përgjithësi kjo strukturë e investimeve, nisët nga trendët e investimeve të deritanishme, përvojat e tjerëve e gjithashtu reflekton nevojat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejtpeshuar si në aspektin social ashtu edhe në regional. Për këtë arsye rëndësi të madhe ju kushtohet investimeve në arsim, edukim, transport, dhe në përmirësim të kushteve të banimit dhe zhvillim të sektorit të NVM-ve.

Gjithashtu investimet në energjetikë dimensionohen në atë masë që duke krijuar parakushte për zhvillim, nuk dëmtohet ambienti. Për më tepër kjo strukturë e investimeve ofron mundësi të zhvillimit policentrik të Kosovës që do të reduktonte diferencën në zhvillim midis rajoneve dhe komunave të Kosovës.

1.3.1. PROJEKSIONET SEKTORIALE DHE BURIMET E INVESTIMEVE

Realizimi i rritjes ekonomike sipas normës mesatare rreth 9% është i kushtëzuar me krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm afarist dhe rritjen e atraktivitetit të vendit për investime e sidomos për investime të jashtme. Ne periudhën 1999 - 2003 bashkësia ndërkombëtare kishte siguruar donacione në shume prej rreth 2.0 mld. US dollar për të mbështetur rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke inkuadruar rindërtimin e shtëpive të shkatërruara (46 %), infrastrukturën publike (34%, posta dhe telekomunikacioni, shërbimet publike dhe transport dhe infrastrukture) dhe ekonomike si dhe ndërtimin e institucioneve të vendit. Ne kuadër të programit të rindërtimit, vetëm në sektorin energjetik ishin orientuar rreth 413 mil. Euro, respektivisht rreth 21% nga gjithsej investimet e angazhuara. Gjerë në vitin 2003 komuniteti ndërkombëtar kishte ndjekur një mbështetje substanciale për ekonominë e vendit, ndërsa pas këtij viti fillon të reduktohet në mënyre rapide ndihma ndërkombëtare e cila është reflektuar negativisht në ritmet e rritjes ekonomike. Ne të njëjtën kohë nuk janë gjetur burime tjera të investimeve për të kompensuar këtë shpërpjesëtim në raport me ndihmën ndërkombëtare. Sidomos kjo ka të bëjë me mungesën e burimeve afatgjate të investimeve publike, nga se buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk ka kapacitet për të përballuar nevojat për investime publike afatgjate në disa sektor kritik. Nga përvojat e vendeve të Evropës Qendrore dhe Jug - lindore mund të nxjerrim mësimë rreth mobilizimit të investimeve nëpërmjet:

- Institucioneve financiare ndërkombëtare dhe kreditimit ndërkombëtar,
- Programeve dhe fondeve strukturore të EU,
- Tregut financiar kombëtar (kredive të bankave komerciale dhe fondet e privatizimit & pensioneve),
- Fondeve private,
- Donacioneve dhe granteve ndërkombëtare.



Burimi: Vlerësim i Institutit Riinvest

1.3.2. INVESTIMET PUBLIKE (QEVERITARE)

1.3.2.1. Investimet ne energjetikë dhe miniera

Nevojat e përgjithshme financiare për projektet kapitale energjetike të Kosovës në periudhën prej vitit 2009 - 2020 vlerësohen të jenë rreth 3.3 miliard euro. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve i dedikohen sektorit të energjisë dhe atë në vlerë prej rreth 2.7 miliard. Sektori i linjtit merr pjesë në shumën totale me rreth 600 mil. euro.

Sipas Strategjisë së Energjisë, është planifikuar ndërtimi i termocentralit të ri që mund të jetë nga 300 - 1000 MW, dhe sipas planeve të reja të Qeverisë së Kosovës, kapacitetet mund të ngiten deri në 2000 MW, me kosto të investimeve që llogariten të jenë 1 mil.\$ për një MW.

Investimet në rrjetin elektrik në periudhën 2003 - 2005 ishin 24,64 mil. EUR, derisa planifikohet të investohen, në po të njëjtin rrjet, në periudhën 2009 - 2015 edhe 26,10 mil. Euro.

Sa i përket investimeve në sektorin e mihjeve te linjtit për periudhën 2009 - 2020 janë planifikuar të investohen 616.2 mil. Euro. Kjo shumë planifikohet për hapjen e mihjes së re në Sibovc.

“Në mes viteve 1999 dhe 2004, BE ka shpenzuar 374 milion € që të ndihmoj në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të popullit të Kosovës. Përveç rehabilitimit të Kosova B, sfidat kryesore përfshinin rehabilitimin e minierave të qymyrit të cilat furnizojnë termocentralet, përmirësimin e sistemit të transmisionit dhe të distribuimit, dhe modernizimin e sistemit të ngrohjes qendrore në zonat me dendësi të madhe të popullsisë”⁶⁴.

1.3.2.2. Investimet në infrastrukturën e transportit

Sipas Strategjisë Zhvillimore të Transportit Multi Modal, dokumenti i miratuar në vitin 2009 nga Qeveria e Kosovës, në periudhën kohore 2010-2022, në Kosovë parashikohen rreth 4.5 miliard euro investime në infrastrukturën rrugore dhe në hekurudha.

- Investimet e parashikuara në infrastrukturën e transportit për periudhën 2010-2022

Hekurudha	0.443 MD
Rrugët/Autostrada	4.060 MD
Total	4.503 MD


Burimi: Strategjia Zhvillimore e Transportit Multi Modal të Kosovës

⁶⁴ <http://www.ear.eu.int/kosovo/kosovo.htm>

Aktivitet investuese të pas luftës kanë qenë të shumta. Kështu në vitin 2000, donatorët kanë ndarë rreth 19 mil Euro për riparimin e rrugëve dhe urave në Kosovë. Në vitin 2001 kjo shumë rritet në 26 mil. Euro. Është karakteristike se gjatë vitit 2001 për here të pare ndahen mjete nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK)dhe atë në vlerë prej 4 mil. Gjatë viteve në vijim pjesëmarrja e BKK-së rritet ndjeshëm duke arritur në 9.5 mil në vitin 2002, 17 mil euro në vitin 2003, 24.84 milion në vitin 2005, 26.85 milion në vitin 2006, 30.71 milion në vitin 2007, 134,71 milion në vitin 2008 dhe 156.57 milion euro në vitin 2009.

1.3.3. PROJEKSIONET E BURIMEVE TË INVESTIMEVE

Niveli i investimeve përpos faktorëve tjerë edhe nga potenciali kreditor i sistemit bankar si dhe mundësia e orientimit të fondeve vendore në financimin e zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst rol të rëndësishëm kanë edhe investimet qeveritare dhe përfshirja e vendit në investimet regjionale të financuara nga BE dhe programet e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare. Mirëpo, në periudhën e ardhshme investimet private do të rrisin pjesëmarrjen e tyre në gjithsej burimet e investimeve. Në kuadër të investimeve private pjesëmarrje më të lartë duhet pritur nga kursimet bankare afatgjata, investimet e jashtme dhe nga mjetet e mobilizuara në tregun financiar. Vlerësojmë se në vitin 2015 investimet private të arrijnë rreth 60 %, ndërsa investimet qeveritare rreth 35 %.



	Private 60%		Publike 35%		Donatorët
	Bizneset 45%	FDI 15%	Buxheti 25%	IFI 10%	5%
2009-2015	4.830	1.610	2.683	1.073	536

Burimi: Vlerësimet e Institutit Riinvest

Për tu arritur një rritje e BPV-së prej 9%, duhet të investohen rreth 35% të BPV-së. Në periudhën kohore 2009 - 2015 planifikohet të investohen rreth 11 miliardë euro.

Mjetet financiare do të rrjedhin nga 3 burime kryesore:

1. Private - 60%
2. Publike - 35%
3. Donatorët - 5%

Në investimet private përfshihen bizneset me 45% dhe Investimet e Huaja Direkte me 15%. Bizneset do të marrin pjesë në investime me € 4.83 miliardë kurse Investimet e Huaja Direkte marrin pjesë me € 1.61 miliardë. Investimet private do të ndahen në katër kategori kryesore:

1. Mjetet vetjake
2. Diaspora
3. Kreditë bankare
4. Investimet e huaja direkte




Investimet publike do të marrin pjesë me € 3.756 miliardë që është e barabartë me 35% të investimeve totale në periudhën 2009 - 2015

Donatorët do të marrin pjesë në totalin e investimeve me 5% të investimeve.

Për periudhën kohore në fjalë është karakteristike edhe futja e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, të cilat në investimet totale të fazës së dytë do të marrin pjesë me rreth 10% të investimeve apo rreth € 1 miliardë euro.

Investimet private do kenë pjesëmarrje kryesisht konstante gjatë viteve në vazhdim, do të marrin pjesë me 55% - 60% të investimeve totale.

Investimet publike nga buxheti do të rriten nga viti në vit dhe do të kenë një pjesëmarrje nga 30%-35%, në këto investime do të përfshihen investimet nga buxheti dhe investimet nga huat shtetërore që do të merren nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare.



1.4. SFIDAT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

1.4.1. EKONOMIA DHE PUNËSIMI

Ekonomi e ngecur në Kosovë, e veçanërisht shkallë e lartë e papunësisë. Konkurrenca ndërkombëtare kërkon infrastrukturë funksionale.

Si mund të ndihmojë planifikimi hapësinor në ringjalljen e ekonomisë?

1.4.1.1. Prapavija

Plani Strategjik i Kosovës nga Grupi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (2003-2004) parasheh një sfidë tjetër përveç sfidave të njohura për vendin në aspektin ekonomik, atë të reduktimit të pritur të asistencës ndërkombëtare dhe pamundësinë e hyrjes apo shfrytëzimit të fondeve alternative, nevojën për krijimin e kornizës ligjore dhe rregulloreve favorizuese për zhvillimin e sektorit privat, nevojën për privatizimin e ndërmarrjeve publike në deficit dhe përpjekjet për shfrytëzimin e këtyre burimeve për të stimuluar zhvillimin ekonomik.

Strategjia Afatmesme e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, thekson zhvillimin e ekonomisë së stagnuar, nivelin alarmant të papunësisë, strukturën joadekuatë të ekonomisë ekzistuese, mungesën e politikës makro-ekonomike dhe mungesën e strategjive të zhvillimit ekonomik si sfidat kryesore që vendi do të ballafaqojë gjatë viteve në vazhdim. Vizioni i kësaj strategjie pajtohet me Strategjinë e Asistencës së USAID për Kosovën 2004-2008, e cila sheh rritjen ekonomike dhe sundimin e ligjit si sfida kryesore të territorit drejt arritjes së mirëqenies ekonomike dhe politike, dhe në veçanti elaboron që një ekonomi në skaj të zhvillimit normal, artificiale dhe e paqëndrueshme, e cila mbështetet më shumë në tregti, shërbime dhe ndërtimtari sesa në prodhim, proporcion të madh negativ të tregtisë me eksportin, mungesë të furnizimit solid të rrymës dhe çështjen e statusit si sfida kryesore të territorit.

1.4.1.2. Konteksti

Historia e gjatë e menaxhimit të dobët nga autoritetet e mëparshme ka shkatërruar ekonominë gjatë dekadës së para-luftës. Kjo ka rezultuar në dëmtime të pronës dhe kompanive, si dhe përjashtimin e një numri të konsiderueshëm të punëtorëve jo-serbë (sidomos në pozitat drejtuese) që ka krijuar mungesë të përvojës në kushtet e tregut të hapur tek kosovarët. Vështirësitë në qasjen ndaj arsimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve tjera ka qenë fuqi udhëheqëse drejt themelimit të strukturave paralele shqiptare për të ofruar këtë lloj shërbimesh, financuar kryesisht nga Diaspora dhe tatimet e vjelura në vend⁶⁵.

Qysh prej themelimit të paqes (1999) Kosova ka përjetuar një ringjallje ekonomike. Shtëpitë dhe infrastruktura janë rindërtuar, dhe ofrimi i shërbimeve publike është përmirësuar. Legjislacioni dhe politikat ekonomike janë ndërtuar në bazë të reformave ekonomike dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, Kosova ende përballet me pengesa të shumta që janë më të vështira për t'u zgjidhur sesa fqinjët e saj, kryesisht sepse ende nuk shikohet si pjesë e komunitetit ndërkombëtar.

Vonesa e procesit të privatizimit të NSH-ve ka lënë sektorin privat të Kosovës me karakteristikat e tij të trashëguara nga 1989, të përbëra kryesisht nga ndërmarrjet individuale të dominuar nga tregtia me shumicë e pakicë. Shumica e këtyre ndërmarrjeve punësojnë 2 apo 3 persona. Kjo strukturë e papërshtatshme pritet të ndryshojë me reformën privatizuese. Edhe pse Kosova ka shfaqur shenja të qarta të zhvillimit gjatë viteve të fundit, ndikimi i kësaj rritjeje nuk ka qenë i njëjtë në popull. Derisa shumë familje janë nxjerrë nga varfëria, shumë nga ato nuk janë nxjerrë. Sipas një studimi të Bankës Botërore, gati gjysma e popullsisë bie nën vijën e varfërisë. Përafërsisht 10% janë në kategorinë e varfërisë së skajshme. Papunësia është një nga çështjet kryesore, pasi që sipas RIINVEST-it 39% e fuqisë punëtore është aktualisht e papunësuar⁶⁶.

Edhe pse investimet privatë vlerësohen diku rreth 30% e BPV, ato duhen të jenë më shumë jo-produktive dhe nuk gjenerojnë të ardhura. Investimet direkte nga jashtë, duke qenë tejet të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës, duken të jenë të pakta⁶⁷, për shkak të mungesës së stabilitetit në rajon, kontestet pronësore, korniza ligjore dhe rregullative,

⁶⁵ Strategjia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (date?)

⁶⁶ Riinvest, tregu i punës dhe papunësia (date?)

⁶⁷ Mungojnë të dhënat.

mungesa e energjisë elektrike, vonesa dhe ngecja e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Investimet publike (rreth 90 milionë) përkundër rritjes nga 2003, në krahasim me 2002 janë larg nga të qenit të mjaftueshme. Këto investime kanë shkuar kryesisht në infrastrukturë, sidomos për sistemin e energjisë (KEK).

Importet janë rritur për 3% (gjithsejtë importe të regjistruara deri në fund të 2003 shkojnë deri në 960.3 milionë euro). Një fakt brengosës është pjesa e madhe ushqimit në importe (34%) dhe në të njëjtën kohë pjesa e kapitalit mbetet në nivel shumë të ultë (12%). Shkalla e lartë e importimit të ushqimit paraqet një mundësi të mirë të zëvendësimit të tij. Origjina e importeve nuk ka ndryshuar shumë në 2003, në krahasim me 2002. Ende BE, Zvicra, Maqedonia, Bullgaria, BH, Kroacia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia janë eksportuesit kryesorë në Kosovë, me ndryshime të vogla gjatë kësaj periudhe.

Eksportet janë rritur në një nivel mjaft të ultë në krahasim me shkallën e rritjes prej 30% më 2003, dhe shumica e mallrave të eksportuara janë të një niveli të ultë të përpunimit, si vera, metalet, kërpudhat, etj. Mbulimi i importit me eksport shkon prej 2% - 3,5% gjë që flet për një prodhimtari mjaft të vogël në Kosovë. Zhvillimi i ardhshëm i Kosovës varet nga kapaciteti i rritjes së eksporteve, si dhe rritja e eksportimit të prodhimeve me vlerë të shtuar.

1.4.1.3. Konteksti i gjerë

Transporti dhe lidhjet në kuadër të rajonit janë trajtuar me nivel të lartë të rëndësisë në politikat evropiane të planifikimit hapësinor (*ESDP, CADSES...*). Lëvizshmëria e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe të dhënave është faktor i rëndësishëm vendimtar për zhvillimin hapësinor në Evropë. Synimi kryesor nga pikë-vështrimi i planifikimit hapësinor është ideja e “koncentrimit të decentralizuar” në ndërtimin e strukturave të vendbanimeve evropiane (kjo mund të promovohet me sukses duke miratuar një politikë të përshtatshme transporti).

1.4.1.4. Lista e çështjeve

Zhvillimi i Kosovës varet nga rigjenerimi i ekonomisë së ngecur. Parametrat e përgjithshëm për rritjen e parashikuar ekonomike duhet të definohen për t’i dhënë drejtim planeve zhvillimore hapësinore.

- Çka pritet nga planifikimi hapësinor në drejtim të përmirësimit të mundësisë së integritit me vendet e EJL dhe BE?
- Si ndikon shoqëria vendore afariste në drejtimin e ekonomisë së Kosovës? Cilat janë nevojat, spektri i vendosjes dhe
- Në cilët sektorë do të rritet ekonomia kosovare? Në cilët sektorë dëshirojmë të rritet Kosova? Në cilat zona gjeografike?
- Import apo eksport? Fuqizimi rural-urban apo ekonomi të reja (TI)? (Ri)trajnimi për të hyrë në ekonomi të re? Apo trajnim për të forcuar asetet e humbura të zhvillimit ekonomik?
- A duhet të ringjallim industrinë e minierave? Si mund ta bëjmë këtë në mënyrë që të ruajmë mjedisin?
- A duhet kërkuar zhvillimi ekonomik në sektorë që janë të qëndrueshëm në aspektin mjedisor?
- Ekonomi/teknologji të reja - është vlerësim global që rritja e teknologjisë informatike do të vazhdojë në periudhën e ardhshme të planifikimit. A duhet që sektorët si TI të trajtohen me favorizim? A duhet që këto veprimtari të reja ekonomike të vendosen afër koncentimeve të popullatës?
- A priten investime nga jashtë në të ardhmen? Në cilët sektorë? Cili është spektri i vendosjes, nevojave dhe dëshirave të investimeve të jashtme dhe ekonomisë globale? Çfarë nevojitet nga planifikimi hapësinor për tërheqjen e investimeve të ardhme?
- Si do të sigurojmë drejtpeshimin e duhur rajonal?
- Si do të sigurojmë energjinë, komunikimet, etj të duhura për investimet e ardhme? Si do t’i ofrojmë ato në mënyrë të qëndrueshme me ndotje të kufizuar? Dhe si të parashikohet qasje e barabartë ndaj të gjitha këtyre?
- A duhet që rrjeti i infrastrukturës së Kosovës të lidhet me rrjetin e ardhshëm të infrastrukturës së EJL? Si mund ta bëjmë këtë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme?

- Si mund të ofrojë planifikimi në përgjithësi, përveç planit hapësinor të Kosovës mënyra të qëndrueshme të transportit? Si mund të inkurajojë Kosova zgjidhje të qëndrueshme të transportit dhe në cilat rajone, nëpërmjet planeve dhe projekteve të veprimit? Si dhe ku mund të sigurojmë shfrytëzim efikas të infrastrukturës? Dhe për secilën ide të re, a do të shfrytëzojmë tokë të re apo do ta ri-shfrytëzojmë tokën tanimë të ndërtuar?
- Veprimtaria turistike mund të prodhojë punësim dhe të ofrojë mundësi tjera argëtimi. Si mund ta zhvillojmë këtë sektor të veprimtarisë ekonomike? Në cilat fusha gjeografike?
- Kushtet e tregtisë, qasjen ndaj tregjeve dhe rrjedhave të kapitalit financiar, të cilat janë të kontrolluar apo të ndikuara nga vendet më të zhvilluara, kanë pasoja të mëdha në ekonomitë e vendeve në tranzicion drejt integritit në ekonominë globale të tregut. Një vend i vogël si Kosova duhet të llogarisë në integrim me fqinjët e saj dhe BE-në në mënyrë të dobisë prej tregtisë ndërkombëtare. Ku duhet të përqendrohet plani hapësinor për t'u integruar me rajonin? Cili është roli i vendeve më të zhvilluara, ekonomive rajonale dhe bashkësisë botërore në trajtimin e sfidave?
- Pasi që qytetet janë aktualisht prodhuesit më të mëdhenj të BPV, si mund të përmirësojmë komunikimin dhe transportin brenda dhe mes qyteteve?
- Kosova ka rrjetë të infrastrukturës rrugore e cila ka nevojë për përmirësim në shumë aspekte. Cili do të jetë përqendrimi për 10 vitet e ardhshme. Për të qenë në gjendje t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, duhet pasur një perspektivë më të gjerë. A do të fokusohet Kosova në rrjetin ekzistues të brendshëm rrugor si të tillë dhe të mundohet të përfundojë mungesat dhe të përmirësojë gjendjen e tyre aktuale? Apo duhet të fokusohet në forcimin e lidhjeve kryesore me rajonin nëpërmjet rrjeteve të reja në rajon dhe të lidhet me rrjetet madhore të infrastrukturës në rajon nëpërmjet rrjeteve të reja apo avancimit të atyre ekzistuese? Dhe cilat janë elementet që duhen marrë parasysh për definimin e drejtimeve të ardhshme?
- Si mund të përmirësohet dhe ruhet cilësia e mjedisit në nivel të lartë përkundër gjitha vështirësive dhe përparimit të zhvillimit ekonomik?

1.4.2. TRASHËGIMIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Po e humbim trashëgiminë natyrore dhe kulturore!

Si mund të zhvillohemi në ndonjë mënyrë që shfrytëzon këto pasuri për zhvillimin tonë por gjithashtu të ruajmë ardhmërinë e fëmijëve tanë?

1.4.2.1. Prapavija - Çfarë thonë agjendat dhe dokumentet kryesore?

Konceptet themelore të UNESCO-s thonë që secili send i trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unik dhe zhdukja e cilitdo send përbën një humbje definitive dhe varfërim të pakthyesëm të trashëgimisë. Trashëgimia kulturore është pronë e përgjithshme, që duhet të shfrytëzohet nga të gjithë dhe të mbrohet ashtu që t'i dorëzohet gjeneratave të ardhshme.⁶⁸

Trashëgimia kulturore dhe natyrore jep një ndjenjë identiteti dhe ndihmon në dallimin e bashkësive në klimën e globalizimit. i mundëson bashkësive kulturore të zbulojnë dhe kuptojnë njëri-tjetrin, dhe njëkohësisht përbën një pasuri të rëndësishme zhvillimi. Kjo ide mbrohet me forcë nga Këshilli i Evropës. Për këtë të gjithë anëtarët e BE-së i japin rëndësi të veçantë mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë së tyre kulturore dhe natyrore të themeluar me standarde të BE-së, gjë që na jep të kuptojmë që nëse Kosova në të ardhmen dëshiron të bashkohet me Bashkësinë, do të ketë nevojë të përmbushë këto standarde evropiane.

Tanimë mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore është shprehur në dokumentin zyrtar të “Standardeve për Kosovën” si njëri nga standardet⁶⁹ që duhen të përmbushen, pra: “Trashëgimia kulturore e Kosovës të respektohet si pronë e përbashkët e të gjitha bashkësive etnike, fetare dhe gjuhësore të Kosovës”. Të gjitha komunitetet duhet të ruajnë, rikthejnë dhe mbrojnë vendet e rëndësishme për trashëgiminë e tyre kulturore, historike dhe fetare me ndihmën e institucioneve të Kosovës, në pajtim me standardet evropiane.

Zhvillimi i qëndrueshëm - Agenda 21 dhe Agjenda e Habitat-it janë caqë të rëndësishme drejt një ndryshimi perspektive që është bërë në të 90-tat. Lëvizja prej një “mjedisi përkundër zhvillimit” tek një që thekson që brengat mjedisore janë të lidhura me proceset e zhvillimit social dhe ekonomik. Më tej, në një botë përditë e më të urbanizuar, qytetet shuhën si vendqëndrim i problemeve kritike sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe mundësi unike për një të ardhme më të qëndrueshme. Perspektiva e re gjithashtu thekson lidhjen mes qëndrueshmërisë dhe qeverisjes. Më shumë sesa fushë ekskluzivisht e qeverive dhe ekspertëve, zhvillimi i qëndrueshëm tani shihet si proces që përfshin njerëzit e thjeshtë në jetën e tyre të përditshme.⁷⁰ Të dy agjendat nënvizojnë nevojën e zvogëlimit të varfërisë dhe përfshirjes së njerëzve që tradicionalisht nuk kanë pasur të drejtë votimi dhe të përjashtuar nga proceset vendim-marrëse.

1.4.2.2. Lista e çështjeve

- Sipas koncepteve të UNESCO-s, BE-së dhe Standardeve, zhdukja e çfarëdo sendi të trashëgimisë kulturore apo natyrore është humbje e trashëgimisë kosovare. Në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të një trashëgimie të pasur kulturore dhe natyrore, autoritetet duhet të punojnë në rritjen e vetëdijes mbi vlerat e saj dhe forcimi e shfrytëzimit të saj si potencial për zhvillim të qëndrueshëm. Çfarë marrim si trashëgimi e përbashkët për të gjithë banorët e Kosovës dhe si vlera në rajonin e gjerë? Çfarë dëshirojmë t'i lëmë fëmijëve tanë? Ku është duke shkuar kultura e Kosovës sot?
- Edhe pse parimi i “zhvillimit të qëndrueshëm” është shkruar brenda Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor, standarde dhe agjenda të ndryshme, është koha që këto parime të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim. Zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm janë me rëndësi kryesore për një të ardhme të mirë dhe kërkon vëmendje më të madhe në Kosovë. Si mund të shfrytëzohet trashëgimia kulturore dhe natyrore për zhvillim të qëndrueshëm? Apo si mund të rrisim vlerat e saj të shumëfishta tani (p.sh. Për argëtim të qytetarëve të Kosovës, rritje të turizmit të gjerë, avancimin e kuptueshmërisë së dyanshme të komuniteteve të ndryshme, tërheqjen e

⁶⁸ Konceptet e përmendura në Standardin 6, të cilat vijnë nga Rekomandimi i UNESCO-s në lidhje me Mbrojtjen e Nivelit KOMBëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, UNESCO Doc.17C/107, 15 Nëntor 1972

⁶⁹ Standardi 6 në “Plani i Implementimit të Standardeve për Kosovën”, Mars 2004, Kosovë

⁷⁰ “Urbanizimi i Qëndrueshëm: Lidhja e Agjendave të Gjelbra me ato të Verdha”, dpu University College London, 2002 (në bashkëpunim me UN-HABITAT) - ekstrakt bazuar në Agjenda 21 dhe Agjendën e Habitat-it

investuesve, ofrimin e punësimit), duke u siguruar që fëmijët tanë mund t'i shfrytëzojnë (aspekti i mbrojtjes) këto vlera? A nënkupton kjo përmirësim apo kufizim të qasjes publike? Cilat elemente duhet të zhvillohen më tej?

- Përveç trashëgimisë së njohur kulturore, cilat pamje, pejsazhe, lagje, ndërtime, ndërtesa i kuptojmë si vlerë dhe cilësi specifike Kosovare? Cili është imazhi, identiteti dhe vlerat që do të duhej të përkraheshin? Turizmi varet shumë nga mjediset e hapura dhe të ndërtuara me cilësi; prodhon punësim dhe ofron mundësi argëtimi me shpërndarje në gjitha rajonet. Pra si mund t'i vlerësojmë këto vlera dhe si t'i menaxhojmë ato? Ku mund të kujdesen komunitetet? (p.sh. Sllovenia)
- Cili është identiteti që duam ta kemi? Çfarë imazhi dëshiron ta ketë Kosova në rajon? Cilat karakteristika dëshirojmë të forcojmë dhe cilat dëshirojmë t'i kthejmë prapa?
- Si mund t'i shfrytëzojë Kosova burimet e saj natyrore deri në masën që nuk do të rrezikonte të ardhmen e gjeneratave të ardhshme? Deri ku duam të shkojmë në kërkimin e mjedisit të pastër apo luftën për zhvillim të shpejtë ekonomik duke shfrytëzuar burimet natyrore? Ligji i ri mbi Mbrojtjen e Mjedisit përfshin parimet e kujdesit dhe parandalimit, prodhimit dhe reciklimit të pastër, dhe parimin që ndotësi dhe eksploatuesi paguajnë. Sot problemet mjedisore në Kosovë janë të rënda dhe përfshijnë: mbeturinat në zonat e populluara; ndotja e ajrit nga djegia e mbeturinave, qymyrit dhe drurëve për djegie; metaleve të rënda në ujën e pijes si rezultat i minierave sipërfaqësore të pakontrolluara dhe industrisë së rëndë; shpyllëzimit në vendet malore; dhe mjetet e shpërndara të paeksplojuara⁷¹.

Kërcënim të veçantë ndaj shëndetit publik dhe mjedisit paraqesin Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), furnizuesi kryesor i amvisërive dhe industrisë, si dhe hapja e vendeve të mëparshme industriale të Trepçës dhe Ferronikelit.

- Ejl posedojnë një pasuri të gjerë natyrore të llojshmërisë së madhe. Kjo pasuri po rrezikohet nga veprimtaria njerëzore në shumë vende. Zonat e ndjeshme natyrore dhe zona tjera të vlefshme nuk mund të trajtohen në izolim. Nëse bëhet kjo, ekziston rrezik i madh që veprimtaritë nga zonat fqinje apo zona më të largëta mund ta rrezikojnë mjedisin. Këto zona duhet të trajtohen në perspektivë/kompleks më të gjerë gjeografik. Çfarë vende dhe elemente kulturore e natyrore duhet të trajtohen në bashkëpunim me zonat fqinje, ashtu që i gjithë rajoni të ketë dobi? Dhe, si?
- Përveç trendëve lokale dhe dinamikës rajonale, ndryshimet globale gjithashtu ndikojnë në mjedisin e hapur dhe të ndërtuar në përgjithësi, si dhe menaxhimin e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në veçanti në Kosovë. Si do t'i qaset Kosova ndryshimeve globale me ndryshimin klimatik dhe të përshtatet me përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar këtë problem?

⁷¹ Vela Blerim, Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore në Kosovë

1.4.3. SHFRYTËZIMI JORACIONAL I HAPËSIRËS

A duhet që vendbanimet të vazhdojnë të zgjerohen horizontalisht duke uzurpuar tokën bujqësore?

1.4.3.1. Prapavija - Çfarë thonë agjendat dhe dokumentet kryesore?

Marrëdhëniet urbane-rurale - Derisa shumë vëmendje i është kushtuar agjendave urbane mbi përmirësimin e kushteve të jetës dhe mjedisit në brendësinë e qyteteve, procesi i urbanizimit nuk është i kufizuar në qytete, dhe përfshin më shumë sesa dimensionet fizike dhe sociale të banimit, infrastrukturës, shërbimeve urbane. Qytetet mbështeten në zonat e thella rrethuese, për një spektër të gjerë burimesh, duke përfshirë ujë, energjinë, materialet ndërtimore dhe burimin e ushqimit. Banorët gjithashtu shfrytëzojnë pjesët rurale përreth dhe hapësirat e hapura për qëllime pushimi dhe argëtimi. Qytetet, si pagesë, ofrojnë mallrat, shërbimet dhe vendin e tregut për prodhimet rurale dhe bujqësore.⁷²

Multi-funksionaliteti i zonave rurale është çështje kyçe në ESPD⁷³ dhe planifikimin trans-kombëtar. Këtu duhen marrë parasysh aspektet e partneriteteve të reja urbano-rurale, shërbimeve, trashëgimia kulturore dhe natyrore.

1.4.3.2. Konteksti në Kosovë - Cilat janë trendët/elementet/forcat lëvizëse kryesore që qartësojnë gjendjen e tanishme?

Pas luftës së 1999, shumë ndërtime ilegale janë bërë në Kosovë, sidomos në Prishtinë, ku numri i banorëve është rritur më shumë se dyfish. Ky problem është shumë-drejtimesh dhe i lidhur jo vetëm me qeverisjen (paqartësi në përgjegjësi, plane joefektive dhe të vjetra), por është edhe problemi teknik, pronësor dhe infrastrukturor. Aktualisht planet urbane janë duke u azhurnuar në mënyrë të ofrimit të përgjigjeve hapësinore ndaj zhvillimeve aktuale shoqërore dhe demografike në Kosovë, për të qenë në gjendje për ballafaqim me fenomenin në bazë reale dhe më efektive.

Ngjashëm me zhvillimet tjera në Evropë, por me formë më të intensifikuar këtu, fshatrat po urbanizohen. Për shkak të urbanizimit, ekziston një llojshmëri në rritje e nevojave dhe interesave lokale, duke sfiduar planifikimin dhe planet që lëvizja prej një funksioni në shfrytëzimin e shumëfishtë të tokës do të rritet. Nuk është vetëm presioni në burimet bujqësore, por edhe ndryshimi i karakterit dhe cilësisë pamore të zonave rurale.

Toka bujqësore përgjatë rrugëve kryesore po okupohet nga funksione të ndryshme, si shitoret, hotelet, pompat e benzinës, vend-shitjet e pjesëve të automjeteve, shtëpi pa shërbime, dhe po shkatërrojnë mjedisin duke vështirësuar trafikun përgjatë rrugës drejt Shkupit.

Me shpërndarjen e vendbanimeve në tokën e haput, disa zona bëhen viktimë e fenomeneve natyrore si vërshimet.

1.4.3.3. Konteksti i gjerë

Trendët e vonshme të zhvillimit të popullatës urbane janë të ndryshme në vendet e ndryshme të EJL; rritja tejet e shpejtë e popullatës në veçanti pritet në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Kjo do të rritet migrimin e vazhdueshëm drejt qyteteve. Zonat rurale përbëjnë një çështje të rëndësishme në planifikimin hapësinor të EJL.

Si në Kosovë, një numër i madh i rajoneve evropiane janë duke u përballur me problemin e shfrytëzimit të hapësirës së hapur, për shkak që zonat peri-urbane dhe fshatrat janë nën presionin e vazhdueshëm urban. Gjatë dekadave të fundit, urbanizimi dhe dendësimi kanë çuar drejt fragmentimit masiv të hapësirave të hapura. Njëkohësisht, hapësira në ato zona duhet të përmbushë një numër të rritur funksionesh. Bashkimi Evropian tanimë kujdeset për funksionet e hapësirave dhe marrëdhëniet urbano-rurale në rregullimin dhe iniciativat e tyre, edhe pse pak fokusohen në natyrën e zonave të urbanizuara.

⁷² 'Urbanizimi i Qëndrueshëm: Lidhja e Agjendave të Gjelbra me ato të Verdha', dpu University College London, 2002 (në bashkëpunim me UN-HABITAT) - ekstrakt bazuar në Agjenda 21 dhe Agjendën e Habitat-it)

⁷³ Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor (European Spatial Development Perspective - ESPD), 1999

1.4.3.4. Lista e çështjeve

- Zhvillimi i sistemeve të vendbanimeve është rezultat, në një rën anë, i kushteve specifike gjeografike dhe natyrore, ndërsa në anën tjetër i faktorëve historikë, ekonomikë dhe shoqërorë. Struktura e vendbanimeve dhe qyteteve ndikohet shumë nga faktorët shoqërorë.
- Hapësira është duke u parë si burim i shterrshëm, si burimet natyrore. Duhet ta trajtojmë me shumë kujdes. Pra, si të trajtojmë hapësirat e hapura nën presion dhe të ndërtojmë rritjen e mjedisit në shkallë të lartë; si të sigurojmë urbanizim të qëndrueshëm?
- Roli i qyteteve bëhet shumë i rëndësishëm (globalisht) në formësimin e mjedisit tonë dhe në kontribimin ndaj formave më të qëndrueshme të zhvillimit.
- Masat teknike për fatkeqësitë natyrore (vërshimet) ofrojnë pak mbrojtje. Si mund të ndihmojë planifikimi hapësinor në parandalimin e fatkeqësive?
- Si duam të zhvillojmë qytetet tona më tej? Krijimi i mundësive të ndërtimit mund të bëhet me zhvillim horizontal, duke lejuar zhvillimin e ndërtimeve vertikalisht, apo lejimit të dendësisë më të madhe. Të mos bësh asgjë nuk është zgjidhje. (ev) ndërtimet ilegale po ndikojnë në shoqëri dhe mjedis në shumë mënyra. (planifikim: shkatërrimi i zonave të gjelbra, shfrytëzimi i tokës, deformimi i linjave të ndërtimit... / teknike: standardet e ndërtimit dhe cilësia e materialeve.../ prona: kërkesa individuale dhe abuzimi i pronës publike / infrastruktura: një qytet i ndërtuar për 200.000 nuk është i përshtatshëm për vendosjen e 500.000 banorëve)



1.4.4. MJEDISI JOKUALITATIV JETËSOR

Kualiteti i mjedisit jetësor në qytete dhe fshatra është i ulët. Zhvillimi i paplanifikuar i rritë shpenzimet e shërbimeve.

Si mund t'i përmirësojmë vendbanimet dhe t'i zhvillojmë ato më mirë në të ardhmen?

1.4.4.1. Prapavija

Forma fizike-dukja dhe organizmi i rrethinës në vendbanime ka një ndikim të rëndësishëm në përjetimin e përditshëm të njerëzve dhe në kualitetin e jetës.

Kur vendbanimet nuk mund t'i përshtaten ritmit të zhvillimit, kualiteti i mjedisit jetësor fillon të bie. Kualiteti i jetës varet nga ajo se si ndjehemi në hapësirë. Kërkesat për një ambient më kualitativ jetësor dhe hapësira të lira janë vazhdimisht në rritje. Ndjenja e kualitetit të hapësirës në qytete është po aq e rëndësishme sa edhe në fshatra. Rrugët e reja, urat, zhvillimi i fshatrave duhet t'i nënshtrohen trajtimit kualitativ hapësinor në mënyrë që ato të mos jenë ngrehina të thjeshta të cilat e shëmtojnë pejsazhin.

Hapësira për njerëzit nuk është e rëndësishme vetëm për të jetuar dhe punuar në të. Ajo duhet të plotësojë edhe kërkesat tjera të popullatës siç është arsimi, shëndetësia, kultura, tregtia dhe shërbimet, rekreacioni dhe pushimi. Ekonomia e tregut të hapur, për shkak të karakterit garues, është vazhdimisht në kërkim të hapësirës kualitative.

Jeta e qytetarëve nuk mund të jetë e begatshme pa mundësitë për jetën sociale, përjetimin e pejsazhit natyror, mjedis të shëndoshë, siguri të pranueshme, pra një ambient ku jetohej më mirë.

1.4.4.2. Konteksti në Kosovë

Zhvillimi i qyteteve tona ka qenë i ndikuar nga sundimi otoman dhe si vendbanime ato janë zhvilluar në mënyrë qendrore nga tregu dhe çarshia ku është këmbyer malli, por është zhvilluar edhe jeta sociale e njerëzve.

Intensiteti i migrimit kah qendrat urbane në 3 dekadat e fundit ka qenë i ndikuar nga forcimi i pozitës kushtetuese të Kosovës, hapjes së institucioneve publike, sociale dhe kulturore dhe shkencore - siç është universiteti.

Ky trend vazhdon edhe sot. Zhvillimi i qyteteve pa plan ka sjellë problemet e shtrirjes urbane e cila pamundëson vendosjen e të gjitha përmbajtjeve të cilat e karakterizojnë një vendbanim urban. Mungesa e infrastrukturës teknike dhe asaj sociale është prezentë në çdo vendbanim të Kosovës. Rrugët, furnizimi me ujë, kanalizimi, furnizimi me energji elektrike, telefonia fikse, ngrohja qendrore, janë problemet me të cilat çdo qytet ballafaqohet.

Në pikëpamje të menaxhimit, asnjëra komunë nuk ka as mundësi financiare as kapacitete të personelit për t'i zgjidhë këto probleme.

Mungesa e institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollor, institucioneve kulturore, rekreacionit dhe përmbajtjeve tjera publike e bëjnë jetën më të varfër në qytetet dhe fshatrat tona.

Planifikim hapësinor duhet të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, posaçërisht:

- Sfida e hapësirës dhe ofrimi i formave të qëndrueshme të zhvillimit urban, nuk është vetëm çështje kuantitative. Nuk bazohet vetëm në gjetjen e balancit delikat në mes kërkesave kontraktore për banim, tregti, industri, transport, shërbimet publike.
- Gjithashtu është edhe çështje e kualitetit, duke i respektuar vlerat dhe përparësitë kulturore dhe sociale, me qëllim të arritjes së kualitetit jetësor. Kualiteti i mjedisit jetësor në qytete dhe fshatra është i varfër. Zhvillimi i paplanifikuar i bënë shërbimet e shtrenjta.

Sfidë e rëndësishme për qytetet në Kosovë është që të arrihet kombinimi i kërkesave hapësinore kuantitative dhe fitimeve kualitative.

Mjedis jetësorë duhet t'i plotësojë nevojat e ndryshme të qytetarëve, por njerëzit duhet gjithashtu të jenë në gjendje të jetojnë në te, dhe ta shijojnë atë. Si do ta perceptojmë

ne vendin kualitativ jetësor, mjedisin tonë kualitativ? Çka duhet të përmirësojmë? Çfarë përpjekje ne mund të ndërmarrim për ta përmirësuar ambientin tonë jetësorë.

- Zhvillimi i shpejtë dhe i pakontrolluar i zonave urbane ka shkaktuar probleme në trafik. Ka zënë sipërfaqe të madhe të hapësirave publike, duke shkaktuar probleme sociale, urbane dhe kulturor dhe duke dëmtuar zhvillimin e përgjithshëm kualitativ. Nuk e bënë vetëm rritjen e presionit për zhvillim të shpejtë ekonomik dhe rritjen e mundësisë së punësimit, por edhe të banimit, infrastrukturës dhe shërbimeve tjera. Disa zona kanë presion më të lartë përderisa disa tjera jo. Si do të ballafaqohemi me to? Si të ballafaqohemi me kualitetin e banimit dhe të mjedisit të punës, mjedisit jetësor, mjedisit relaksues të lirë, transportit? Si dhe cilat vlera të shtohen në ambientin rural dhe urban? Si të sigurohen qasje të barabarta dhe të drejta për mjediset jetësore?
- Disa vende janë të “tejngruara”. Kjo ka të bëjë me pjesët atraktive dhe historike si dhe me qytetet, por gjithashtu edhe me vendet e reja të krijuara, dyqanet përgjatë rrugëve, pishinat e hapura në tokat bujqësore. Komercializimi aktual i mjedisit, gjate ndryshimit të mënyrës së jetës, shpesh shpien drejt zgjidhjeve të dobëta të standardeve dhe kualitetit jetësor.

Çka mendojmë ne për pejsazhet e reja në Kosovë, lidhur me përmbajtjet e reja (dyqanet, pompat e benzinës, hotelet), anekset e pishinave, parkingjet, deponitë e automjeteve në zonat rurale? Si mund planifikimi hapësinor të ndikojë në përmirësimin e kualitetit mjedisor dhe diversitetin e perjsazheve urbane dhe rurale.

Qytetet atraktive dhe pejsazhet rurale i tërheqin turistët dhe investimet ndërkombëtare, të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave.

1.4.4.3. Konteksti i gjerë

Në kontekstin më të gjerë, përmirësimi i kualitetit të jetesës në radhë të parë nënkupton bashkëpunimin me qytetet në rajon sidomos ato të cilat janë afër kufirit dhe të cilat i lidhë në radhë të parë këmbimi i mallrave dhe afërsia e banorëve. Bashkëpunimi intensiv ofron mundësi edhe të përparimit të mjedisit jetësor përmes zhvillimit të ekonomisë së këtyre qyteteve posaçërisht tregtisë.

Më gjerë me rëndësi është edhe kooperimi në bazë të programeve të binjakëzimit me qytetet nga vendet e zhvilluara, ose programeve tjera ndërkombëtare të cilat financohen nga BE ose organizata tjera.

Iniciativat e tilla për përparimin e ambientit në qytetet në rajon janë përkrahur nga disa agjenci, duke promovuar partneritetin dhe garën në mes qyteteve me qëllim të zhvillimit ekonomik.

1.4.4.4. Lista e çështjeve

- Sfidë për qytetet tona është sigurimi i plotësisht të nevojave kualitative të popullsisë. Jo vetëm sigurimi i hapësirave për banim, punë, tregti dhe afarizëm, transport dhe shërbime, por edhe aspekti kualitativ i tyre të merret në konsiderim, me qëllim që hapësira ku jetojmë dhe punojmë të ketë vlerat e veta kulturore estetike. Hapësira në të cilën jetojmë nuk është e pasur, në fshat apo qytet. Ndërtimi i paplanifikuar i bën shërbimet më të shtrenjta.
- Një sfidë e rëndësishme për qytetet e Kosovës është si të kombinohen kërkesat kuantitative hapësinore me të arriturat kualitative. Mjedisi jetësor duhet të plotësojë nevojat e ndryshme të banorëve dhe njerëzit duhet të jenë në gjendje të jetojnë dhe kënaqen në të. Si ta identifikojmë kualitetin e hapësirave ku jetojmë. Çka duhet të përparohet dhe çfarë përpjekje duhet bërë për të arritur këtë?
- Zhvillimi i paplanifikuar i qyteteve shkakton probleme edhe në trafik. Pasojë e kësaj është zvogëlimi i hapësirës publike, ndryshimi i kulturës urbane dhe në përgjithësi zhvillimin jokualitativ të qyteteve.
- Zhvillimi i hovshëm, pa plan i qyteteve shkakton trysni jo vetëm për vende të reja të punës, por edhe për banim, infrastrukturë dhe shërbime. Disa treva kanë më pak trysni e disa më shumë. Si mund t'i zgjidhim këto probleme. Çka mund të bëjmë për ta përparuar kualitetin e mjedisit ku jetojmë dhe punojmë, ku e kalojmë kohën e lirë, si mund ta bëjmë trafikun më të lehtë në qytetet tona?

Cilat janë vlerat të cilat duhet t'i shtohen mjedisit jetësor në qytetet dhe fshatrat tona dhe si të sigurojmë qasje të barabartë në hapësirat publike.

- Shumë vende janë të tejshfrytëzuara. Posaçërisht vendet me trashëgimi kulturore dhe natyrore - pejsazhet karakteristike. Po ashtu janë shumë përmbajtje të reja, të ndërtuara pranë rrugëve - tregti, pishinat në arat e bukës. Komercializimi i hapësirës i shkaktuar nga mënyra e jetesës, zakonisht çon kah zgjidhja me kualitet të ultë.

Si mundet planifikimi hapësinor të kontribuojë në përmirësimin e kualitetit dhe llojllojshmërisë së pejsazhit urban dhe rural.

Qytetet atraktive dhe pejsazhi rural janë pasuri të cilat tërheqin investimet ndërkombëtare posaçërisht në turizëm, që mund të gjenerojë vende të reja të punës dhe zhvillim ekonomik.

1.4.5. NIVELI I ULËT I SHËNDETËSISË DHE ARSIMIMIT

Përgjithësisht niveli i shërbimeve në shëndetësi dhe arsim në Kosovë është i ulët, madje disa zona kanë nivel tejet të ulët të shërbimeve.

Si dhe ku duhet të përmirësohen shërbimet në mënyrë që të jenë më afër banorit?

Duhet të përqendrohem në ruajtjen dhe përforcimin e kapitalit njerëzor.

1.4.5.1. Prapavija

Qysh nga mbarimi i konfliktit në Kosovë, komuniteti ndërkombëtarë dhe ai vendor janë përpjekur të adresojnë çështjet me rëndësi të veçantë për Kosovën siç janë: arsimi dhe shëndetësia, si parakusht për zhvillimin e mirëfilltë të resurseve njerëzore, të shoqërisë dhe ekonomisë në Kosovë. Zhvillimi njerëzor është proces i vazhdueshëm i cili varet nga tre faktor themelor që ndryshojnë në proporcion me ndryshimin e nevojave njerëzore nga të cilat më thelbësore janë: arsimimi - marrja e njohurive dhe aftësive, shëndetësia - jeta e gjatë dhe e shëndoshë dhe qasja në burime private dhe publike të nevojshme për jetë normale. Temë e këtij koncepti janë dy faktorët e parë, ARSIMIMI dhe SHËNDETËSIA, të cilët janë parakusht për sigurimin e faktorit të tretë.

1.4.5.2. Konteksti në Kosovë

1.4.5.2.1. Arsimimi

Kapitali më i madh që ka Kosova janë njerëzit e saj, popullata e re e Kosovës: Zhvillimi afatgjatë i Kosovës, si kudo në botë, është ngushtë i lidhur me kualitetin dhe gjithëpërfshirjen e të rinjve në arsim. Kjo është shumë me rëndësi për Kosovën, duke e ditur se Kosova ka përqindjen më të madhe të popullatës së re në Evropë. Janë dy indikatorë kryesorë të cilët shërbejnë për të krahasuar nivelin relativ të zhvillimit në rajon në fushën e arsimit, të cilët përcaktojnë nivelin e arsimimit⁷⁴: shkalla mesatare e arsimimit e popullatës dhe shkalla e vijimit në shkollimin fillor. Zyra Federale e Statistikës në vitin 1999 ka raportuar të dhënat të cilat tregojnë se në Kosovë niveli i analfabetizmit është 11,9% nga numri i përgjithshëm i popullatës. Në bazë të hulumtimit në nivel të ekonomisë familjare, të udhëhequr nga UNFPA-ja dhe IOM-i, niveli i përgjithshëm i analfabetizmit në vitin 2000 në Kosovë ka qenë 6,5%. Të dhënat tjera, duke përfshirë Qendrën Arsimore të Kosovës⁷⁵, vlerësojnë se përqindja e popullatës analfabete në Kosovë është më e madhe. Hulumtime detajore mungojnë, ato janë të nevojshme për të bërë vlerësim më të saktë në mënyrë që gjendja të pasqyrohet më e qartë. Sa i përket shkallës së vijimit nëpër nivele, sipas hulumtimit⁷⁶ të UNFPA-së dhe IOM-it gjendja paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

	Femrat	Meshkujt	I tërë
Shkollat fillore	91.2%	92.1%	91.7%
Shkollat e mesme	54.0%	65.0%	59.5%
Shkollim i lartë	16.4%	18.2%	17.3%
MESATARJA	53.7%	58.4%	56.2%

Hapësira shkollore në Kosovë në kontekst të përgjithshëm dhe rajonal mund të thuhet se është e mjaftueshme. Mirëpo nëse analizojmë problematikën nëpër komuna veç e veç, shihet se ka mungesë të hapësirës shkollore - gjendja momentale nuk i përgjigjet trendit të lëvizjes së popullatës. Mungesa e hapësirës është e theksuar në zonat urbane ku shkollat punojnë deri në 4 turne. Ky problem është rritur në mënyrë drastike pas luftës, si pasojë e lëvizjeve të mëdha të popullatës nga zonat rurale në ato urbane dhe nga zonat tjera urbane në zonën e Prishtinës ku problemi paraqitet më i theksuari. Këto të dhëna edhe pse të mangëta, pasqyrojnë lloj-llojshmërinë e problemeve në arsim. Niveli jo adekuat i kuadrit arsimor nuk po mund ti përgjigjet kërkesave të nxënësve dhe si i tillë po paraqitet si problem tjetër që po e mundon këtë sektor me rëndësi për shoqërinë tonë. Në bazë të shënimeve të deritashme raporti mësimdhënës/nxënës (1 mësimdhënës/në 18.5 nxënës) nuk na paraqitet si problem, përkundrazi është mjaft i mirë dhe mund të krahasohet me standardet.

⁷⁴ Sipas UNDP - HDI - Human Development Indicators

⁷⁵ OJQ në Kosovë

⁷⁶ Hulumtimi Komunal në nivel të Ekonomive Shtëpiake, mostra: 6,000 ekonomi shtëpiake në 30 komuna të Kosovës, me përfaqësimin e të gjitha komuniteteve

Mungesa e balancit në mes të nivelit të arsimimit të vajzave dhe djemve në arsim të mesëm (15-18 vjeçe) dhe të lartë është brengë e veçantë. Shkalla e duhur e vijimit në nivelin e shkollave të mesme në zonat urbane dhe rurale e observuar nga aspekti gjinor tregon mungesë të theksuar të balancit mes gjinive⁷⁷. AMSJ⁷⁸-a identifikon shpenzimet private, të ardhurat e familjes, largësinë e objekteve shkollore dhe sigurinë në zonat rurale si arsye kryesore për mosvijimin e shkollës.

Edhe pse të dhëna për gjendjen reale mungojnë, me një formë ende të paqartë ka filluar të funksionojë sektori privat i shkollimit. Kanë filluar punën disa shkolla në disa vende dhe në disa nivele të ndryshme. Statusi ende i pa zgjidhur i kësaj forme të shkollimit po krijon huti dhe nuk po mund të jetë alternativë serioze e shkollimit publik i cili për nga ana materiale financiare mund të ju ofrojë shërbime vetëm një pjese të shoqërisë tonë.

1.4.5.2.2. Shëndetësia

Kriteri më i rëndësishëm që përdoret për të vlerësuar nivelin e zhvillimit human është kujdesi për shëndetin dhe jetëgjatësinë e popullatës. Shëndeti përcakton drejtpërdrejt aftësinë e popullatës për të marrë pjesë aktive në të gjitha sferat e jetës, shoqërore, politike dhe ekonomike.

Sipas vlerësimit të Bankës Botërore, sistemi i shëndetësisë i pasluftës në Kosovë është shumë i ngjashëm me sistemin paralel të paraluftës i cili ka mbijetuar konfliktin. Shërbimet shëndetësore në Kosovë kryhen në disa nivele: shërbim parësor, shërbim dytësor, shërbim tretësor dhe prakta private. Shërbimet parësore kryhen në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (26), Qendra të Mjekësisë Familjare (122) dhe Ambulanta (240). Shërbimet dytësore kryhen në 5 Spitale Rajonale dhe dy spitale tjera në Vushtrri dhe Ferizaj. Shërbimi tretësor ofrohet në Qendrën Klinike Universitare në të cilën graviton për shërbim e tërë popullata e Kosovës. Sipas indikatorëve themelor shëndetësorë, të përdorur për të matur nivelin relativ të zhvillimit në këtë fushë janë: Jetëgjatësia, Fertiliteti i përgjithshëm, Lindjet, Vdekjet, Rritja e popullatës. Për shkak të të dhënave kontradiktore gjatë dekadave të fundit, indikatorët e shëndetit kanë pësuar disa ndryshime. Disa nga indikatorët janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme.

► Tabela 2⁷⁹. Indikatorët Shëndetësorë Demografik për Kosovën nëpër vite të paraqitura në %, 2000b UNFPA/IOM; 2001 WHO, UNICEF, 2000a

	1991	2000a	2000b	2001
Numri i përafert i të lindurve në 1000 banorë	28.5	26.9	18.9	
Numri i përafert i të vdekurve në 1000 banorë	5.2	4.8	5.8	
Rritja natyrore në 1000 banorë	23.3	22.1	13.1	20.1
Vdekshmëria infantile	44.0			
Vdekshmëria potenciale në 1000 banorë			33	28.7

Duke përjashtuar sëmundjet për të cilat vetëtrajtimi konsiderohet i mjaftueshëm, pengesa më e madhe në qasjen e popullatës në shërbime shëndetësore është kostoja e shërbimit. Një mesatare prej 28% e atyre që nuk kanë raportuar problemet mjekësore për të cilat do të duhej kërkuar trajtim mjekësor, për shkak që nuk kanë pasur mundësi materiale.

► Pengesat kryesore në qasjen e popullatës në shërbime shëndetësore⁸⁰

Arsyet për moskërkimin e trajtimit mjekësor	Sëmundjet jo serioze të vettrajtuara	Sëmundjet jo serioze të patrajtuara	Largësia	Pasiguria	Shërbimet jo të mira	Shërbimet e shtrenjta	Të tjera	Totali
15 e më pak	55.2%	14.1%	5.3%	0.9%	0.8%	21.1%	2.7%	20.9%
16-24	53.3%	16.6%	2.2%	1.1%	0.0%	26.6%	0.3%	11.4%
25-49	44.6%	12.8%	5.7%	1.2%	1.0%	30.1%	4.6%	28.5%
50-69	41.5%	11.0%	9.2%	2.3%	0.5%	31.1%	4.3%	28.1%
70 dhe mbi	39.3%	8.0%	14.9%	2.8%	0.5%	28.6%	6.0%	11.1%
Mesatarja	46.3%	12.5%	7.2%	1.6%	0.7%	27.9%	3.8%	100.0

⁷⁷ Vlerësimi i Bankës Botërore për Varfërinë në Kosovë

⁷⁸ AMSJ - Anketa e Masës së Standardit Jetësor

⁷⁹ Tabela është marrë nga UNDP Human Development Report (2002).

⁸⁰ Banka Botërore, Hulumtimi në Kosovë, viti 2000

Faktor tjetër i rëndësishëm, posaçërisht në zonat rurale, është distanca e institucioneve shëndetësore. Siguria nuk duket të jetë faktor i cili shfaq vështësi të mëdha. Nuk është befasi që grupi i popullatës i prekur nga largësia dhe mungesa e sigurisë janë të moshuarit, posaçërisht ata të moshës mbi 70 vjeç. Në lidhje me perceptimin e kualitetit të shërbimeve të ofruara, vlerat janë shumë të ulëta (Vlerësim i Bankës Botërore; 0.7 %), nuk është e qartë nëse mendohet që shërbimet shëndetësore janë jo të mira, apo pacientët nuk janë të kënaqur me qasjen në shërbime dhe trajtimin në sistemin ekzistues.

Elementi i sigurimit social me të cilin karakterizohet sistemi para konfliktit, nuk funksionon më dhe kjo zbrazëti nuk është sanuar. Më shumë se 95% të popullatës paguajnë për shërbime shëndetësore, pavarësisht se a janë trajtuar në objekte shoqërore apo private. Përderisa në sektorin publik këto shërbime paguhën në formë të participimit që nganjëherë e kalojnë mundësinë e pacientit, në sektorin privat, për të cilin mungojnë të dhëna që do të pasqyronin gjendjen reale, ofrohen shërbime dentare, diagnostike, ilaçe dhe shërbime tjera ambulatore vetëm për pacientë me mundësi të mira materiale. Në Kosovë ende ka nevojë për trajtime shëndetësore jashtë vendit, si pasojë e nivelit relativisht të ulët të teknologjisë dhe paisjeve shëndetësore, mandej mungesës së kuadrit adekuat shëndetësor disa nga sëmundjet dhe intervenimet nuk kanë mundësi të shërohen gjegjësisht të kryhen brenda vendit.

Statusi i shëndetit të popullatës dhe niveli i sistemit shëndetësor në Kosovë duhet përmirësuar në të gjitha aspektet si: infrastrukturë, pajisje, menaxhim, financim etj. Politika e financimit është njëra ndër çështjet e rëndësishme përmes së cilës do të sigurohej realizueshmëria financiare në sistemin shëndetësor.⁸¹

1.4.5.3. Konteksti rajonal

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor⁸² (HDI) është i përbërë nga disa indikatorë zhvillimor të njohur nga institucionet ndërkombëtare: Jetëgjatësia - Niveli i arsimit te të rriturit - Vijimi i përgjithshëm në shkolla dhe GDP-ja. Këta indikatorë janë përmbledhje e tre koncepteve themelore, jetëgjatësisë, njohurisë dhe standardit jetësor.


► Krahasimi i HDI-së të Kosovës me vendet tjera në rajon

Numri rendor në listën e HDI	Vendi	Jetëgjatësia	Arritjet në arsim	GDP(US\$)	HDI
29	Slovenia	0.84	0.94	0.85	0.874
46	Kroacia	0.81	0.88	0.72	0.803
56	Bullgaria	0.76	0.90	0.66	0.772
60	Maqedonia	0.80	0.86	0.64	0.766
	Kosova	0.82	0.83	0.55	0.733
85	Shqipëria	0.80	0.80	0.58	0.725

Nga kjo tabelë shohim se vetëm Shqipëria ka HDI më të ulët se Kosova.

Financimi i sistemit shëndetësor dhe arsimor në Kosovë bëhet në masë të konsiderueshme nga komuniteti donator dhe të ardhurat nga tatimet. Shpenzimet e shtetit në këta dy sektorë varen nga kapaciteti shpenzues (të ardhurat vendore), shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë, madhësia e sektorit të arsimit dhe shëndetësisë, shpërndarja e mjeteve për nevoja të ndryshme dhe efikasiteti në shpërndarjen e të hyrave.

Sipas FMN-së kur krahasohen shpenzimet në sektorin e shëndetësisë, shumica e shpenzimeve në këtë sektor në vitin 2000 ishte 81 milion DM që është 2.7% e GDP (Prodhimi i Përgjithshëm Vendor) dhe 19% e shpenzimeve në sektorin publik.



► Raporti mjek, shtetër/banorë në Kosovë dhe në Evropë

Në Kosovë shërbimet mjekësore janë më të ulëta në rajon dhe në Evropë

⁸¹ Banka Botërore, Huluntimi në Kosovë, viti 2000
⁸² HDI - nga gjuha angleze - Indeksi i Zhvillimit Njerëzor



Krahasimet me vendet tjera tregojnë se kjo është një pjesë shumë e vogël e GDP-së. Nga informacionet që ekzistojnë, tregohet se, vlera e investimeve në shëndetësi krahasuar me shtetet në tranzicion ekonomik, në Kosovë është më e ulëta, diçka më e lartë se ajo që është në Shqipëri. Në Kosovë, në sistemin shëndetësorë janë të punësuar 10,000 punëtorë shëndetësorë; prej tyre 2,500 janë mjek, përafërsisht 1.3 mjek në 1,000 banorë, ndërkohë që në Evropë ky proporcion është 3.5 mjek në 1,000 banorë.

1.4.5.4. Çështjet:

- Shkaqet e mungesës së ekuilibrit në nivelin arsimimit në mes vajzave dhe djemve, duhen hulumtuar duke siguruar informacione në bazë të cilave do të zhvilloheshin politikat e orientuara drejt përmirësimit në këtë fushë.
- Të dhëna të besueshme në nivel të Kosovës do të ndihmonin në pasqyrimin e situatës reale në këtë fushë.
- Krijimi i kushteve më të mira hapësinore për mësim në shkolla në zonat urbane.
- Ngritja e nivelit të kuadrit mësimor është kërkesë urgjente e cila do të krijonte kushte për tu përgjigjur kërkesave në shtim të gjeneratave të reja.
- Zgjidhja e drejtë e statusit të funksionimit të sektorit privat do të krijonte një alternativë të shëndoshë të shkollimit.
- Sigurimi i qasjes në objekte dhe shërbime e të gjithë popullatës duke e reformuar atë sipas modelit të bazuar në nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme të popullatës.
- Sigurimi i imunizimit të popullatës dhe dhënia e prioritetit në fushën e preventivës e jo mjekimit.
- Pajisja me aparaturë bashkëkohore dhe trajnimi i personelit mjekësor në klinika me reputacion.
- Sigurimi social të ngjitet në nivelin e duhur dhe ti përgjigjet një pjese të konsiderueshme të popullatës e cila nuk ka mundësi materiale të kujdeset për shëndetin.
- Definimi i politikës së funksionimit të praksës private për të mundësuar ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore në të dy sektorët.

1.4.6. SHKALLA E LARTË E VARFËRISË

Në disa pjesë të Kosovës kjo shkallë është më e lartë se zakonisht.

Si do të sigurohemi se mënyra në të cilën e drejtojmë zhvillimin e Kosovës, e adreson këtë çështje ?

1.4.6.1. Varfëria në Kosovë

Zhvillimi njerëzor synon të bëjë rritjen e mundësive të zgjedhjes. Varfëria ndikon drejtpërsëdrejti në mundësitë dhe gjasat e zgjedhjes për zhvillim njerëzor: të jetohet një jetë më e gjatë, e shëndetshme dhe kreative, të gëzohet një standard i mirë i jetesës, liri, dinjitet, vetë-respekt dhe respektimi i të tjerëve. Varfëri do të thotë më shumë se mungesë e të domosdoshmes për mirëqenie materiale. Varfëria duhet të trajtohet në tërë dimensionet e saja, njohja e varfërisë, mundësitë dhe gjasat e zgjidhjes, e jo vetëm në të ardhura.

Synimet zhvillimore të mileniumit bazuar në Samitin e Mileniumit të Kombeve të Bashkuara të mbajtur në shtator të vitit 2000 zhdukjen e varfërisë së skajshme dhe urisë e përcaktojnë si synimin e parë të mileniumit.

Këto synime njihen si Synimet Zhvillimore të Mileniumit, të cilat duhet të plotësohen deri në vitin 2015.

Varfëria absolute dhe relative në Kosovë është në rritje. Gjatë ofrimit të kushteve për rritje ekonomike dhe prosperitet, Kosova duhet të përfshij edhe strategjitë për zhdukjen e varfërisë (Dok. BB 2001).

1.4.6.2. Konteksti - Cilat janë trendët, elementet dhe forcat ndikuese që shpjegojnë gjendjen ekzistuese?

► Varfëria në Kosovë në krahasim me rajonin

	Sërbia dhe Mali i Zi	Maqedonia	Bullgaria	Shqipëria	Rumania	Kosova
Shkalla	30%	24%	12.6%	30%	44.5%	50.3%

bazuar në anketimin të publikuar në vitin 2001 (realizuar nga Banka Botërore):

- rreth 50% e popullatës nën linjën e varfërisë së plotë = 1.534 USD për të rritur /ditë
- rreth 15% e popullatës jeton në kushte të varfërisë ekstreme = 0.813 USD për të rritur /ditë
- Varfëria është e përhapur, por jo e thellë.

Më poshtë janë përshkruar një varg çështjesh me të cilat tregohet shkalla e varfërisë në Kosovë sikur janë të ardhurat, arsimit, shëndetësia, papunësia dhe mbrojtja sociale.

► Të ardhurat

	Varfëria ekstreme	Varfëria e përgjithshme ⁸³	Hendeku i varfërisë ⁸⁴	Serioziteti i varfërisë ⁸⁵
Gjithsejtë	11.9%	50.3%	15.7%	6.8%
Hapësira rurale	11.6%	52.0%	16.1%	6.9%
Hapësira urbane	12.5%	47.5%	15.1%	6.7%

Burimi: Banka Botërore, 2001

- Shihet që shkalla e varfërisë është më e madhe në zonat urbane se në ato rurale,
- familjet në varfëri ekstreme në zonat urbane ndryshojnë nga ato rurale
- Në zonat urbane niveli i arsimit është më i lartë
- kryefamiljarët janë të papunë, dhe në kërkim të punës janë për më shumë se një vit.

⁸³ Amvisnitë nën linjën e varfërisë së plotë e cila merr parasysh edhe shpenzimet për artikujt joushqimorë.

⁸⁴ Diferenca ndërmjet shpenzimit aktual dhe linjës së varfërisë.

⁸⁵ Masë e hendekut të varfërisë, mirëpo që në veçanti thekson ato amvisni të cilat janë shumë larg nga linja e varfërisë

1.4.6.2.1. Arsimi

Si edhe në shumë vende të tjera, edhe në Kosovë është e shprehur ndërlidhja e fuqishme e varfërisë ekstreme me të arriturat e vogla në arsim. Përpyekjet për të ofruar shanse shkollimi për të gjithë janë të një rëndësie të veçantë, për arsye se fëmijët e lindur në familje të varfra janë të rrezikuar të futen në kurthin e rrethit të gabueshëm, prej nga të ardhurat e ulëta të familjeve qojnë deri në rezultate të dobëta. Kjo më vonë ndikon në mënyrë direkte në mirëqenien e këtyre fëmijëve. Duke i marrë të gjitha këto në konsideratë, përmirësimi i rezultateve në arsim paraqet një komponentë të rëndësishme të një strategjie afatgjate për çrrënjosjen e varfërisë. Për më tepër, arsimimi paraqet dimension të rëndësishëm të varfërisë, pasi që në mungesë të tij edhe aftësitë janë të mangëta.

Edhe pse shkalla e përfshirjes në edukimin primar në Kosovë është gati univezale, megjithatë ekzistojnë jobarazi të mëdha të ndërlidhura me nivelet e të ardhurave. Në këtë kontekst, në qendrat urbane, gati rreth 20% të fëmijëve të amvisërive që bëjnë pjesë në kategoritë me shpenzime më të ulëta, nuk janë regjistruar në shkollën tetëvjeçare. Në këtë aspekt, arsimimi i mesëm paraqet një pabarazi edhe më të madhe. Në këtë drejtim, përqindja e të rinjve nga kategoritë e varfra në zonat rurale është sa gjysma e atyre të kategorisë së pasur.

1.4.6.2.2. Shëndetësia

Të dhënat e pakta që disponohen lidhur me gjendjen shëndetësore, tregojnë se Kosova gjendet në nivelin më të ulët në Evropë, në pothuajse në të gjithë treguesit shëndetësorë.

Disa nga treguesit më themelorë të shëndetësisë që përdoren për matjen e nivelit relativ të zhvillimit të një rajoni janë shkallët e jetëgjatësisë së pritur, fertiliteti, nataliteti, vdekshmërisë, shtimi i popullatës, si dhe të vdekshmërisë së popullatës.

Projeksionet e fundit në dispozicion për jetëgjatësinë e pritur në Kosovë janë bërë për periudhën 1995 - 1996. Duke u bazuar në trendët e këtij indikatori gjatë viteve të kaluara, projeksiioni për jetëgjatësinë e pritur në lindje për fëmijët e lindur gjatë kësaj periudhe ishte 71, 45 vjet për meshkuj dhe 76, 64 vjet për femra.

Kushtet që mbizotëronin në Kosovë gjatë periudhës 1996 - 1999 sugjerojnë se shkalla e jetëgjatësisë do të jetë ulur gjatë atyre viteve.

Për shkak të kushteve të pafavorshme gjatë dekadës së kaluar, ndryshime kanë pësuar edhe indikatorët e tjerë themelorë të shëndetësisë.

	1991	2000a	2000b	2001
Shkalla e natalitetit (në 1000 banorë)	28.5	26.9	18.9	...
Shkalla e mortalitetit (në 1000 banorë)	5.2	4.8	5.8	...
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (në 1000 lindje)	44.0	33.6	35	...
Shkalla e vdekshmërisë perinatale (në 1000 lindje)	33	28.7
Skalla e shtimit natyror	23.3	22.1	13.1	20.1

2000a - Vlerësimet në bazë të trendëve në të kaluarën

2000b - Të dhënat nga UNFPA/IOM, 2000.

2001 - Të dhënat nga WHO/UNICEF, 2002.

Në bazë të këtyre shënimeve, shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë, e mbështetur në evaluimin e bazuar në hulumtimin e 7000 familjeve, është më e lartë se i prituri nga trendët e mëparshme. Si për shembull pakësimi i popullsisë në krahasim me atë të parashikuar është i prituri konsiderohen kushtet e jetesës në dekadat e kaluara.

Edhe pse pothuajse të gjithë indikatorët e shtimit të popullatës kanë shënuar rënie gjatë dekadës së kaluar, megjithatë, popullata e Kosovës mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë dhe më të reja në Evropë.

1.4.6.2.3. Papunësia

Si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga konflikti, si dhe për shkak të natyrës ende transitorë të periudhës pas konfliktit, shkalla e lartë e papunësisë është bërë problem i madh social dhe ekonomik.

Burime të ndryshme e vlerësojnë shkallën e tanishme të papunësisë të jetë rreth 50 - 55 %, çka shënon një rënie me 74% sa ishte në gjysmën e dytë të vitit 1999. Kjo paraqet më shumë se gjysmën e të aftëve për punë (rreth 600 mijë të papunësuar, ose më shumë se 25% të popullatës së tërësishme). Pjesa më e madhe e të papunësuarve janë femra dhe ose / të rinj. Shkalla e lartë e papunësisë është tregues i kalimit të ngadalshëm nga ekonomia socialiste në atë të tregut. Krahas ekonomisë së pazhvilluar, një arsye tjetër për këtë shkallë të lartë të papunësisë në Kosovë është procesi i ngadalshëm i privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha publike dhe shoqërore, numri i të cilave është rreth 350. Edhe pse më shumë se 80% të këtyre ndërmarrjeve patën rifilluar punën pas konfliktit mesatarja e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre është vetëm 35 - 40%, kurse punësojnë vetëm një të katërtën e të punësuarve në vitin 1989.

► Papunësia regionale

Nr. Regjionet	Norma e papunësisë
1 Prishtina	42,50%
2 Prizreni	53,90%
3 Peja	43,50%
4 Mitrovica	56,40%
5 Gjilani	55,00%
6 Ferizaj	51,70%
7 Gjakova	33,30%
Totali	49,00%

1.4.6.2.4. Mbrojtja sociale

Keqësimi i gjendjes sociale në Kosovë menjëherë pas konfliktit mund të perceptohet nga zvogëlimi për rreth 50% i të ardhurave familjare, të cilat kishin rënë në 300 DM në muaj. Numri i familjeve me të ardhura nga pagat, të hyrat nga bizneset dhe burimet e tjera të të hyrave kishte rënë po ashtu në mënyrë drastike në krahasim më periudhën para konfliktit. Në të njëjtën kohë, numri i familjeve që jetonin nga ndihma humanitare ishte rritur për 10 herë. Edhe numri i atyre që jetonin nga mjetet financiare të marra nga jashtë ishte rritur për disa herë. Pas konfliktit, ndihmat e marra nga familjarët në diasporë përbënin gjysmën e buxhetit të familjeve kosovare. Filluar nga viti 1999, shumë familjeve u është dashur t'i shpenzojnë kursimet e tyre, e shpesh edhe t'i shesin patundshmëritë e tyre, për të siguruar nivelet minimale të mbijetesës.

Përveç vështirësive me të cilat përballen njerëzit e papunë edhe shumë segmente të tjera të shoqërisë janë lënë anash si:

- Ish pensionistët
- Veteranët që janë në moshë për të punuar, por jo edhe të aftë për punë
- Individët e paaftë që nuk i kanë mbushur 65 vjet, dhe kështu nuk i plotësojnë kushtet për pension
- Fëmijët jetimë
- Familjet me vetëm një mbajtës të familjes, posaçërisht kur ato mbahen nga gratë e veja dhe nënat e vetme, të cilat nuk kanë edukim apo trajnim profesional, kështu që nuk kanë kualifikime të duhura formale për punësim
- Familjet nga zonat rurale të cilat kanë migruar drejt qyteteve dhe ballafaqohen me mungesë të burimeve për jetesë

1.4.6.3. Konteksti i gjerë

Varfëria në rritje, si ndikim i ekonomisë në tranzicion?

Shtirja hapësinore e kapaciteteve të vjetruara?

Zonat e koncentrimin? Fenomeni urban ?

Ndonjë trend i urbanizimit varfërisë (ngjashëm me trendin global)?



1.4.6.4. Lista e çështjeve

- Në përgjithësi,, segmente të disfavorshme dhe të varfra të popullatës urbane, posaçërisht rinia, gratë...janë të parët që vuajnë dhe të fundit që të përfitojnë nga ndonjë ringjallje apo zhvillim eventuale.
Urbanizimi i varfërisë në Kosovë? Varfëria e “fshhtë” në Kosovë ?
Si mund të kontribuoj Plani Hapësinor në këtë aspekt ?
- Gjatë tranzicionit të ekonomisë, disa miniera dhe industri ndotëse janë mbyllur duke kontribuar kështu në rritjen e papunësisë dhe varfërisë në vazhdim
Cila është shtrirja hapësinore?
- Lëvizja nga zonat rurale drejt zonave urbane për jetë më të mire, arsim dhe shërbime, shfaqet si tërheqje totale nga veprimtaritë bujqësore dhe përfitimeve nga të.
Cilat modalitete të punësimit në fshatra duhet promovuar?
A ekziston ndonjë kërkesë specifike territoriale apo hapësinore të plotësohet për këtë arsye?

1.4.7. STANDARDET, NORMAT DHE PRINCIPET

Implementimi i standardeve i aprovuar nga Qeveria është esenciale për të ardhmen.

Si do ta planifikojë zhvillimin për të ardhmen në mënyrë që të implementohen standardet ndërkombëtare - transparenca, pjesëmarrja publike në vendim marrje, barazia?

1.4.7.1. Prapavija

Agjenda e Kombeve të Bashkuara të UN-Habitatit ka përcaktuar zotimet për strategjinë që tu mundësojë të gjithë faktorëve kyç publik, privat dhe sektorëve komunal të kenë rol efektiv në nivel nacional, shtetëror/ lokal dhe qendrave të mëdha - në banim human dhe zhvillim të strehimit. Mes objektivave tjera, është formuar grupi udhëheqës lokal me mbështetjen e rregullave demokratike, me ushtrimin e autoriteteve publike dhe duke shfrytëzuar burimet publike me qëllim që të sigurohet transparenca, përgjegjësia, llogaritshmëria, drejtësia, qeverisja efektive e qyteteve dhe zonave metropole.

Me promovimin e decentralizimit dhe burimeve si dhe funksioneve dhe përgjegjësi, të adresimit të nevojave më të mëdha të njerëzve në vendbanimet e tyre, duke përkrahë institucionet gjinore_sensitive dhe draftin ligjor si dhe ndërtimin e kapaciteteve në nivel nacional dhe lokal drejt angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes së gjerë në zhvillimin e vendbanimit human, inkurajimin e formimit të organizatave komunale, organizatave të shoqërisë civile, dhe formave të tjera të entiteteve joqeveritare, institucionalizimin e qasjes së pjesëmarrjes drejtë zhvillimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të vendbanimit human, Agjenda e Habitatit tenton të realizojë “përfshirjen” e çdo njerit në një vend lidhur me dobinë, gjininë, moshën, racën apo religjionin, tu mundësohet pjesëmarrje produktive dhe pozitive. Për arritjen e përfshirjes në këtë, Agjenda është angazhuar në përkrahjen e integritimit gjinor në vendbanimin human lidhur me ligjin, politikën, programet dhe projektet përmes aplikimeve të analizave të ndjeshmërisë gjinore, dhe duke zhvilluar metodologjitë praktike dhe konceptuale për inkorporimin e perspektivave gjinore në planifikimin e vendbanimit human, zhvillimin dhe vlerësimin, si dhe duke përfshirë zhvillimin e indikatorëve.

Por demokratizimi dhe vendim marrja marrin kuptim të plotë atëherë kur njerëzit dinë saktë se çka duhet të vendosin apo për çka duhet të votojnë. Angazhimi civil ka të bëjë me të drejtën e njerëzve për pjesëmarrje, por këto bëhen të pakuptimta kur njerëzit nuk mund të japin propozime për shkak të informimit të dobët, apo për arsye se informatat në dispozicion nuk janë të sakta. Një sistem informativ i saktë, në dispozicion dhe me qasje për qytetarët do të jetë parakusht për suksesin e pjesëmarrjes në proces. Për këtë arsye, Agjenda është angazhuar në krijimin e mundësisë të qasjes së barabartë për informata të sigurta në nivel nacional, lokal, kur të përvetësohet komunikimi me rrjetë dhe teknologji moderne.

Plani Strategjik për Kosovën i Grupit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara 2003-2004, vendosi si sfida kryesore, krijimin e sistemit politik përfshirës i cili respekton të drejtat e grupeve të ndryshme etnike dhe tregon vendosmëri për barazi gjinore, rini, dhe është përgjegjës ndaj nevojave të popullatës në zonat rurale dhe zhvillimit të strategjisë.

1.4.7.2. Konteksti

Në vitet para konfliktit, popullata Shqiptare ishte e diskriminuar kur është fjala për shërbime qytetare. Pozitat menaxhuese në ndërmarrjet publike ose në administratën publike ishin përgjegjësi e bazuar në përkatësi etnike dhe pjesëmarrja në vendimmarrje nuk ishte në duart e popullatës së Kosovës. Si pasojë e kësaj dukurie, pjesëmarrja në procesin e planifikimit, ishte e rezervuar vetëm një segmenti të shoqërisë.

Vitet e qeverisjes së centralizuar kanë mbajtur Kosovarët larg vendimmarrjes, posaçërisht gjatë viteve të fundit para luftës kur popullata e Kosovës ishte jashtë rrjedhave të jetës publike. Si pasojë popullata e Kosovës nuk pranoi të merrte pjesë në çfarëdo shërbim civil të imponuar nga regjimi i asaj kohe, në cilindo nga nivelet/zinxhirët e hierarkisë qeveritare.

Pas luftës, situata ndryshoi, por ka ende konfuzion në lidhje me përgjegjësitë e autoriteteve në sferat e ndryshme të jetës publike. Duhet sqaruar vijat e ndryshme të përgjegjësi dhe të pushtetit, paqartësi e cila ka rezultuar me mungesë në informacione të publiku i cili nuk

din se ku duhet të drejtohet për nevojat e veta⁸⁶. Është posaçërisht e rëndësishme që të dy, shërbyesit civil dhe njerëzit, të jenë të njoftuar për rolet e qeverisë qendrore dhe lokale/komunale, për të krijuar mundësitë për angazhim më të madh të publikut.

Me 10 Shtator 2003, Parlamenti i Kosovës aprovoi Ligjin për planin hapësinor, me qëllim të sigurimit të zhvillimit hapësinor të planifikuar dhe racional, për të arritur baraspeshë në mes të zhvillimit dhe mbrojtjes së hapësirave dhe mjedisit. Ky ligj ka gjithashtu ka për qëllim të vendosë legjislacionin e Kosovës në lidhje logjike me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare.

Shprehjet si informacion, demokratizim, qasje transparente në shërbime dhe të dhëna, rrjete e të dhënave gjeografike digjitale dhe informacione nëpërmes internetit për aktivitetet e qeverisë, kanë hyrë në përdorim dhe përmenden ç’do ditë më shumë. Arritja e sfidave të tilla teknologjike, kërkon angazhim dhe përkushtim nga institucionet, por më e rëndësishmja nga këto është njohja e qytetarëve të Kosovës për rregullat e reja të cilat caktojnë kufijtë e zhvillimit të Kosovës dhe janë kontribut i madh drejt arritjes së standardeve, principeve dhe vlerave ndërkombëtare.

1.4.7.3. Lista e çështjeve

Zhvillimi i demokracisë nëpërmes qyteteve të udhëhequra mirë dhe gjithëpërfshirës është kontribut i rëndësishëm në arritjen e Standardeve dhe vlerave e principeve ndërkombëtare.

- Si mund të sigurojmë që sigurimi dhe menaxhimi i shërbimeve publike janë përgjegjësi e autoriteteve të nivelit më të ulët i cili është në pozitë më të volitshme për të ofruar këto shërbime?
- Si mund të sigurojmë që këto shërbime të ofrohen në mënyre efikase .
- Si mund të arrijmë qasje të barabartë drejt pozitive publike deri te barazia e individëve të aftë, pavarësisht etnitetin apo gjininë.
- Planifikimi hapësinor dhe menaxhimi në planifikim hapësinor është njëra nga rrugët kryesore të sigurimit të efikasitetit. Si mund të sigurojmë që ne kemi bërë shfrytëzim më se efektiv të burimeve?
- Përgjegjësia duhet të jetë njëra ndër synimet tona. Si mund të sigurojmë që një qytetarë i zakonshëm të dijë se kush dhe për çka është përgjegjës? Si mund të sigurojmë që përgjegjësitë në mes të niveleve të ndryshme të qeverisë të jenë të qarta dhe të njohura për gjithë qytetarët?
- Si mund t’iu bëjmë të mundur të gjithë aktorëve kryesorë dhe “hisedarëve” të marrin pjesë në procesin e planifikimit hapësinor dhe vendimmarrjes.
- Si mund të ngrisin përmes pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, ndjenjën e pronësisë jo vetëm të procesit por edhe të rezultateve të tij ndërmjet qytetarëve të Kosovës?
- Si mund të garantojmë transparencë në të gjitha etapat e procesit të planifikimit hapësinor për territorin e Kosovës?
- Si mund të sigurojmë transparencë dhe qasje të barabartë të informatave në dispozicion përfshirë këtu edhe të dhënat bazë publike? Si mund të arrijmë besueshmërinë publike të informatave në dispozicion.
- Gjithëpërfshierja në suazë të qëllimeve planifikuese e rritë mundësinë e partneritetit publik dhe privat në shpërndarjen e shërbimeve publike dhe investimeve kapitale. Si mund të arrijmë në një plan hapësinor gjithëpërfshirës e poashtu edhe një proces planifikues gjithëpërfshirës.
- Si mund të rikrijojmë ndjenjën e shërbimit publik ndërmjet shërbyesve civil?
- Si mund të stimulojmë shërbyesit civil që të shërbej më mirë dhe ti shmanget korrupsionit?
- Si mund të krijojmë një mekanizëm të përshtatshëm (mekanizma të paanshëm) për anti-korrupsion?
- E-qeverisje/qeverisje elektronike (duke integruar edhe diasporën), mund të jetë një mënyrë e integritit të kosovarëve që jetojnë jashtë vendit dhe mund të josh poashtu investimet e diasporës. Cilat mjete mund të shfrytëzohen për këtë synim?
- Si mund të integrojmë idetë e mëparshme, propozimet dhe projektet përbrenda planit hapësinor të Kosovës, për të promovuar ndjenjën e pronësisë në mes të njerëzve?

⁸⁶ Mozaiku I Kosovës. Perceptimi I qeverise lokale dhe shërbimeve publike ne Kosove, UNPD, Marsh 2003, Faqe 26.

2. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

2.1. DEKLARATA E VIZIONIT PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS:

*Vend i integruar në Bashkësinë Evropiane;
Me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë dhe forcë pune të kualifikuar;
Një Kosovë që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve;
Shoqëri e hapur që promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve duke respektuar të drejtat e të gjithëve.*

2.2. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM/MBROJTJE

Nga Ligji për Planifikim Hapësinor

2.2.1. PARIMET

Rregullimi dhe planifikimi hapësinor duhet të bazohet në këto parime të pranuar ndërkombëtare:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të Kosovës duke mbrojtur resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.
- Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.
- Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë kosovarët.
- Promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës dhe forma të balancuara të vendbanimeve.
- Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të zhvillimit hapësinor Evropian

2.2.2. PARIMET UDHËZUESE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM HAPËSINOR TË KONTINENTIT TË EVROPËS

- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit socio-ekonomik më të balancuar të rajonit dhe përmirësimit të konkurrencës
- Inkurajimi i zhvillimit e gjeneruar nga funksionet urbane dhe përmirësimi i raportit në mes të qytetit dhe fshatit
- Promovimi i qasjes më të balancuar
- Mundësimi i qasjes në informata dhe njohuri
- Zvogëlimi i dëmeve mjedisore
- Përparimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore dhe të trashëgimisë natyrore
- Përparimi i trashëgimisë kulturore si faktor për zhvillim
- Zhvillimi i resurseve energjetike së bashku me ruajtjen e sigurisë
- Inkurajimi i kualitetit të lartë, turizmi i qëndrueshëm
- Kufizimi i ndikimeve nga fatkeqësitë natyrore



2.2.3. PARIMET E QEVERISJES SE MIRË URBANE

- Qëndrueshmëria
- Subsidiariteti
- Barazia
- Efikasiteti
- Transparenca
- Angazhimi, përfshirja civile
- Pjesëmarrja
- Përgjegjshmëria

2.3. CAQET ZHVILLIMORE AFATGJATA SYNIMET DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Synimi:

Kosova vend i integruar në Bashkësinë Evropiane

Objektivat:

- Kosova - Shtet demokratik
- Vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë
- Organizimi hapësinor në shtatë rajone
- Kryeqytet - Prishtina si qendër administrative-politike

Synimi:

Arritja e zhvillimit social të balancuar me mundësi të barabarta të qasjes në shërbime për të gjithë

Objektivat:

- Hapësira adekuate për arsim, shëndetësi dhe kulturë
- Arsimim cilësor dhe i vazhdueshëm për të gjithë
- Pajisje dhe infrastrukturë adekuate e teknologjisë informative
- Sigurimi i mjedisit adekuat për zbatimin e reformave në arsim
- Shpërndarje e barabartë e përmbytjeve nëpër të gjitha trevat e Kosovës
- Shpërndarje adekuate e arsimit profesional dhe arsimit të lartë
- Shërbime mjekësore me cilësi të lartë dhe të decentralizuara

Synimi:

Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor, zhvillim i balancuar hapësinor, ruajtja dhe respektimi i resurseve - trashëgimisë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve

Objektivat:

- Planifikimi i hapësirës për shfrytëzim racional të territorit
- Mbrojtja e mjedisit
- Zhvillim hapësinor i balancuar
- Stimulimi i politikave të zhvillimit të zonave rurale
- Shfrytëzimi i mineraleve për një zhvillim të qëndrueshëm
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Rregullimi i ndërtimeve ilegale dhe vendbanimeve joformale



Synimi:

Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, i balancuar, i bazuar në resurse natyrore, njerëzore, teknologji moderne, konkurrencën e tregut dhe përmbushjes së standardeve për mbrojtjen e mjedisit

Objektivat:

- Krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës
- Avancimi i teknologjisë prodhuese
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale
- Krijimi i kushteve për konkurrencë në tregun rajonal
- Arsimimi i vazhdueshëm i kuadrit profesional
- Krijimi i mjedisit atraktiv për investitorë

Synimi:

Infrastruktura dhe komunikimi i integruar duke respektuar standardet e mbrojtjes së mjedisit

Objektivat:

- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë
- Përmirësimi i rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme
- Shërbime publike cilësore
- Kyçje në korridoret rajonale-evropiane
- Bashkëpunim rajonal në zhvillimin e infrastrukturës
- Llojlojshmëria dhe cilësia e telekomunikimeve

2.4. PRIORITETET STRATEGJIKE

- Kosova vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë;
- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë
- Arsimim cilësor dhe i vazhdueshëm për të gjithë;
- Shërbime mjekësore me cilësi të lartë dhe të decentralizuara;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale;
- Zhvillim hapësinor i balancuar;
- Krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës;

3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar për zhvillimet hapësinore në Kosovë. Pjesë të saj janë konceptet e zhvillimit hapësinor dhe struktura hapësinore për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm.

3.1. KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR


Për hartimin e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit hapësinor, në fillim puna është përqendruar në propozimet dhe testimin e koncepteve të ndryshme të zhvillimit hapësinor. Koncepti i korridorit, koncepti i zhvillimit nodal, koncepti i shpërndarjes së barabartë të zhvillimit, i zhvillimit të koncentruar, koncepti i brezit të gjelbër dhe atij të unazave rrugore ishin konceptet e aplikuara në këtë fazë. Përparësitë e koncepteve të analizuar janë diskutuar edhe në grupet punuese ndërministrrore, përmes testimit të skenarëve alternativ.

Pas analizimit të koncepteve të ndryshëm është konstatuar se, për zhvillimin e ardhshëm hapësinor në Kosovë, nuk është i përshtatshëm ndonjë koncept i vetmuar por ata duhet të kombinohen. Nga grupet punuese që e kanë përpiluar Planin Hapësinor të Kosovës, si koncept bazë është përvetësuar koncepti i zhvillimit nodal me elemente të konceptit të korridorit. Koncepti i zhvillimit nodal (në qendra, në pika të caktuara) nënkupton koncentrimin e zhvillimit të ardhshëm në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës, kurse zhvillimet hapësinore përgjatë rrugëve që kanë ndodhur në disa pjesë të Kosovës, e që paraqesin konceptin e korridorit, do të kontrollohen në mënyrë rigorozë dhe nuk do të lejohen në tokat bujqësore të kategorive I deri IV.

Me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova ndahet në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona. Këto tipare paraqesin llojllojshmërinë dhe në të njëjtën kohë janë unike për secilën nga to. Tiparet sipas të cilave është bërë ky zonim janë: potencialet zhvillimore të këtyre zonave, karakteristikat gjeografike të tyre dhe veprimtaritë ekonomike që zhvillohen në këto zona. Këto zona janë emëruar me emra që prezantojnë një formë të identitetit të zonave, disa karakteristika të tyre dhe në hartë paraqiten me ngjyra të caktuara. Zonat janë:

- Thesari i Kosovës (Hapësira e gjelbër) - industriale, shërbyese tregtare - paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Mitrovica si qendër kryesore dhe Vushtrria, Skenderaj, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku si komuna më të vogla të cilat gravitojnë në Mitrovicë.
- Porti i Kosovës (Hapësira e kaltër) - administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike - paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina si qendër kryesore dhe kryeqendër e Kosovës, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Lypjani, Drenasi dhe Shtime që gravitojnë në qytetin e Prishtinës.
- Urat e Kosovës (Hapësirat e verdha) - shërbyese tregtare, agro-industriale e turistike - paraqesin pjesët juglindore dhe jugperëndimore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Ferizaj, Gjilan, Kaçanik, Shtërpce, Kamenicë, Novobërdë dhe Viti, në qendër me qytetet e Ferizajt dhe Gjilanin; 2) Gjakovë, Deçan, Rahovec dhe Malishevë në qendër me qytetin e Gjakovës.
- Kopshtet e Kosovës (Hapësirat e portokallta) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale paraqesin pjesët perëndimore/veriperëndimore dhe jugore të Kosovës, të përbërë nga komunat: 1) Pejë, Klinë dhe Istog me qytetin e Pejës në qendër; 2) Prizren, Suharekë dhe Dragash me qytetin e Prizrenit në qendër.

► Kosova e ndarë skematikisht në zona sipas karakteristikave dhe potencialeve të ngjashme zhvillimore



3.2. STRUKTURA HAPËSINORE E ZHVILLIMIT DHE ORGANIZIMIT TË ARDHSHËM

Struktura e zhvillimeve hapësinore në të ardhmen do të jetë në përputhshmëri me caqet madhore të cilët i synon populli i Kosovës.

- 3.2.1. Zhvillimi socio-ekonomik;
- 3.2.2. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit, resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore;
- 3.2.3. Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit.

3.2.1. ZHVILLIMI SOCIO-EKONOMIK

Kosova synon një zhvillim të balancuar social me mundësi të barabarta në shërbime për të gjithë dhe një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, të bazuar në resurset natyrore, humane, teknologji bashkëkohore, treg konkurrues dhe zbatim të standardeve mjedisore. Duke bashkërenditur politikat dhe veprimet e të gjithë sektorëve relevant, synohet:

- Vendosja e zhvillimit të qëndrueshëm policentrik që nënkupton edhe zhvillimin e trevave me pak të zhvilluara - pjesa qendrore, pjesët kodrinore dhe zonat kufitare të vendit të cilat kanosen nga shpopullimi.
- Forcimi i karakteristikave zhvillimore të vendbanimeve dhe shfrytëzimi i potencialeve të pashfrytëzuara me qëllim të:
 - Uljes së varfërisë, sidomos në zonat më të prekura nga ky problem;
 - Uljes së numrit të të papunëve;
 - Decentralizimit dhe ngritjes së kualitetit në arsim dhe shëndetësi - hapja e kapaciteteve të reja në përputhje me kërkesat dhe karakteristikat e zonave;

- Zhvillimit të barabartë ekonomik për të gjithë territorin.
- Përmirësimi i përgjithshëm i kushteve të jetesës duke i riorganizuar përmbajtjet dhe funksionet e brendshme të vendbanimeve;
- Ndalimi i zhvillimit të pakontrolluar në zonat urbane;
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike në zonat rurale;
- Përmirësimi i kualitetit dhe lehtësimit i qasjes në banim për të gjithë;
- Ofrimi i optimumit të infrastrukturës sociale dhe teknike për të gjitha vendbanimet;
- Ofrimi i mundësive komplementare për zhvillimin e zonave rurale në mënyrë që të zvogëlohet shpopullimi i tyre;
- Aktivitetet ekonomike të orientohen në zonat me infrastrukturë të ndërtuar dhe të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese, ndërkaq, krahas kësaj të mendohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për programe të reja ekonomike në hapësira të pashfrytëzuara;
- Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve ekzistuese deri tash të pashfrytëzuara sa duhet duke iu shmangur investimeve të panevojshme dhe të paarritshme;
- Rigjenerimi i zonave dhe komplekseve të vjetruara industriale duke i transformuar ato në komplekse funksionale ekonomike

Zhvillimi socio-ekonomik bazohet në rend të parë në forcimin e qendrave të mëdha urbane të Kosovës, shtrirjen e rrjetit përkatës të infrastrukturës për rrjetin urban dhe forcimin e lidhjeve në mes të qendrave të mëdha dhe atyre të vogla urbane. Ky zhvillim poashtu mundëson sigurimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore më afër qytetarit, forcimin e bujqësisë dhe industrisë përpunuese si sektorë të fortë për të promovuar zhvillimin e balancuar në kontekstin urban-rural, rehabilitimin e industrisë së rëndë (xehetaria dhe industria përpunuese e metaleve) në favor të zhvillimit më të fuqishëm ekonomik, rritjen e konkurrencës në tregun rajonal përmes shërbimeve efikase tregtare, promovimin dhe forcimin e turizmit si sektor me rëndësi për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

3.2.1.1. Shpërndarja dhe zhvillimi i vendbanimeve

Shtimi natyral në Kosovë është i qëndrueshëm, me një rënie të vogël krahasuar me vitet e mëhershme. Në Kosovë jetojnë afërsisht 2 milion banorë nga të cilët pjesa më e madhe jetojnë në zonat rurale (më tepër se 60%) dhe pjesa tjetër jetojnë në zonat urbane dhe periurbane (më pak se 40%). Nga numri i përgjithshëm i banorëve më tepër se 1/5 jetojnë në Prishtinë, e cila momentalisht nuk mund t'i përgjigjet kërkesave për shtimin e hapësirave të reja të banimit, të shkollimit, të punës, gjë që shkakton rënien e përgjithshme të kualitetit të shërbimeve. Ky përqendrim i madh i popullsisë në qendrat e mëdha në njërin anë dhe shtimi i familjeve të reja në anën tjetër i shton kërkesat për sipërfaqe të reja dhe mirë të organizuara të banimit. Në këtë drejtim, gjatë hartimit të politikave zhvillimore qendrore dhe atyre lokale në mënyrë racionale duhet të planifikohet shtimi i këtyre sipërfaqeve, në mënyrë që këtyre familjeve t'u mundësohet qasje e lehtë në të gjitha shërbimet, vende të reja pune dhe hapësirë të mjaftueshme për banim. Kjo nënkupton:

- Shfrytëzimin e mundësisë së dendësimit të sipërfaqeve ekzistuese të banimit - në zonat urbane dhe në rastet kur kjo është e pamundur, të sigurohen sipërfaqe të reja të mjaftueshme për banim, duke pasur për qëllim mbrojtjen maksimale të tokës bujqësore.
- Ndërtimin e koncentruar në zonat rurale në kufijtë e një vendbanimi normal dhe të urbanizuar, me qëllim të ruajtjes së tokës kualitative bujqësore.
- Të gjitha vendbanimet të kenë qasje në infrastrukturë teknike dhe sociale dhe shërbime të mjaftueshme varësisht cilit rang i takon vendbanimi përkatës.
- Dekoncentrimin dhe shpërndarjen e barabartë të zhvillimit, duke ofruar kushte të njëjta jetësore për gjithë territorin, duke ruajtur dhe rinovuar përmbajtje specifike me rëndësi për vendin, duke ofruar beneficione për zhvillim të shpejtë ekonomik në zona deri tash të pazhvilluara dhe në këtë mënyrë në të gjithë territorin e Kosovës të ndërtojmë mjedis të përshtatshëm dhe atraktiv për të krijuar dhe jetuar.
- Vënien nën kontroll të migrimit të popullsisë në qendrat e mëdha urbane sidomos "Zona e Kaltër" (Prishtina).

- Zonat joformale periurbane të futen në kuadër të planeve të reja zhvillimore urbane në mënyrë që banorëve të këtyre zonave tu mundësohet qasje normale në infrastrukturë dhe shërbime duke pasur për synim ruajtjen dhe kultivimin e mënyrës së të jetuarit në hapësira më të qeta. Kjo do të mundësojë që banorët nga zonat e zhurmshme urbane të kenë dëshirë dhe mundësi lëvizjeje drejtë zonave periferike.

Zhvillimi policentrik i propozuar është i bazuar në strukturën dhe shtrirjen ekzistuese të vendbanimeve të cilat karakterizohen për nga përmbajtja dhe veprimtaritë që kanë në funksion. Zhvillimi i qendrave të mëdha (Prishtina, Mitrovica, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj) të cilat edhe për një kohë të konsiderueshme do të jenë nën presionin e vazhdueshëm të ardhjes së popullsisë nga zonat e pazhvilluara, do të vazhdojë. Gradualisht, me zhvillimin e këtyre qendrave do të krijohen mundësi për zhvillim indirekt edhe të vendbanimeve përreth. Kjo do të mundësojë krijimin e kushteve të përshtatshme që do të thotë ofrimin e shërbimeve për të cilat njerëzit nuk kanë nevojë të ndërrojnë mjedisin ku jetojnë. Zhvillimi i vendbanimeve të mesme (qytetet me: 10.000 - 20.000 b.) dhe të vogla (nën 10.000 b. dhe fshatrat) do të mundësohet edhe me politikën e investimeve për përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore të brendshme dhe lidhjen me funksionale me rrjetin e infrastrukturës së nivelit më të lartë, ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në të gjitha vendbanimet, ndërtimin e linjave të reja për furnizim me energji elektrike dhe linjave të telekomunikimeve, ngritjen e kualitetit të shërbimeve në arsim dhe shëndetësi, në mënyrë që të mundësohet zhvillim i mjaftueshëm dhe i barabartë edhe në zonat tjera me theks të veçantë në “Zonën e Verdhë” (vendbanimet kodrinore-malore dhe zonat kufitare) dhe “Zona e Gjelbër” (Rajoni i Drenicës).

Fuqizimi i rrjetit të vendbanimeve duhet të shërbejë si bazë e organizimit të ardhshëm hapësinor të Kosovës. Gjatë procesit të hartimit të dokumenteve dhe planeve hapësinore të niveleve të ndryshme, duhet të kihet parasysh zhvillimi i barabartë dhe i qëndrueshëm për gjithë territorin e Kosovës duke pasur për synim që, përveç banimit dhe punës të ofrojë edhe shërbimet e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe rekreacionit sidomos për vendbanimet ku këto shërbime mungojnë.

Përcaktimi i një minimumi, që shprehë një rrjet të fuqishëm dhe kualitativ urban, arrihet me angazhim për planifikim:

- të një strukture të harmonizuar të vendbanimeve që nënkupton edhe shpërndarjen e njëtrajtshme të popullsisë përkatësisht shmangie nga koncentrimi i popullsisë, shpërndarjen e barabartë të shërbimeve për të plotësuar kërkesat e zonave të caktuara gjithnjë në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetës,
- të shfrytëzimit sa më racional të resurseve natyrore dhe shfrytëzimit maksimal të potencialit njerëzor në funksion të zhvillimit të njëtrajtshëm dhe policentrik,
- të alokimit të investimeve në objekte prodhuese dhe në infrastrukturë teknike dhe sociale me qëllim të zhvillimit të qendrave më pak të zhvilluara,
- të kontrollit dhe vëmendjes më të madhe sidomos të qendrave me koncentrim më të madh të popullsisë (me theks të veçantë të Prishtinës (Zona e Kaltër) dhe qendrave tjera të mëdha: Mitrovica (Zona e Gjelbër), Peja, Prizreni (Zona e Portokalltë), Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj (Zona e Verdhë) duke i orientuar zhvillimet në drejtim të shfrytëzimit të përparësive, mundësive dhe kapaciteteve që disponon qendra përkatëse, dhe duke pasur për synim plotësimin e standardeve minimale urbane,
- të shfrytëzimit të potencialeve ekzistuese të qendrave të mëdha të cilat i karakterizojnë ato, me qëllim që të arrihet synimi që: “Zona e Kaltër” (Prishtina) të jetë qendër administrative, universitare, tregtare, dhe energjetike në të cilën kryqëzohen korridoret kryesore të rrugëve tokësore, hekurudhore dhe ajrore; që “Zona e Gjelbër” (Mitrovica) të jetë qendër industriale e vendit dhe e rajonit; që Zona e Portokalltë (Peja, Prizreni) të jenë qendra kulturore, turistike, ekonomike dhe tregtare; dhe “Zona e Verdhë” (Gjakova, Gjilani, Ferizaj) të jetë urë lidhëse e vendit me vendet fqinje, të jetë qendër e veprimtarive të fuqishme ekonomike tregtare, prodhuese dhe bujqësore.
- të rigjenerimit së zonave rurale duke i shtuar aktivitetet për përmirësimin e lidhjeve ekzistuese dhe ndërtimin e lidhjeve të reja me zonat urbane duke pasur për synim zbutjen e shpopullimit në zonat kufitare dhe zonat kodrinore-malore dhe që këto zona

të mos trajtohen vetëm si zona bujqësore por edhe si pjesëmarrëse aktive në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

3.2.1.2. Struktura e rrjetit të vendbanimeve


Me rastin e përcaktimit të rëndësisë së vendbanimit dhe pozitës që ka vendbanimi përkatës në rrjetin e përgjithshëm të vendbanimeve brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, është marrë për bazë oferta dhe mundësitë që ofron secili vendbanim në përmbushjen e kriterëve që secilit vendbanim i përcaktojnë rangun adekuat.

Prishtina - si qendra më e madhe e “Zonës së Kaltër” dhe kryeqendër e Kosovës, në të cilën në bazë të analizave joformale dhe informatave të marra nga disa burime, jetojnë diku rreth 400 deri në 500 mijë banorë ose përafërsisht 1/5 e gjithë popullsisë së Kosovës. Duke u mbështetur edhe në disa funksione që i ka pasur dhe që i ka sot, rekomandohet që:

- Të forcohet pozita si kryeqendër e Kosovës në shërbim funksional për të gjitha qendrat tjera në Kosovë, duke e konsideruar pozitën e saj si qendër kryesore administrative, në të cilën janë të vendosura Institucionet qeverisëse shtetërore dhe të gjitha zyrat ndërlidhëse (ambasadat) e shteteve të huaja.
- Të përparohet zhvillimi i kryeqytetit në raport me rajonin dhe me intencë të arritjes së nivelit të kryeqendrave të vendeve të rajonit dhe në Evropë, duke krijuar një sistem funksional të transportit automobilistik dhe hekurudhor; synim ndërtimin e unazës rrugore e cila ndihmon zhvillimin e lidhjeve të kësaj zone me rajonin përmes Korridoreve ndërkombëtare VIII⁸⁷ dhe X⁸⁸
- Rigjenerimi urban duhet të konsiderohet si mënyrë për zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe sociale, për përmirësimin e mjedisit të ndërtuar në zonat e zhvilluara pa plan. Këto veprime duhet të sjellin ndryshime kualitative fizike, në mënyrë që Prishtina të bashkërendohet në pikëpamje të kualitetit të jetës me kryeqendrat tjera në rajon.
- Të definohej kufijtë e saktë të territorit komunal dhe raporti me qendrat më të afërta komunale: Obiliqin, Fushë Kosovën dhe Lipjanin për të definuar pozitën e aeroportit, stacionit hekurudhor në Fushë Kosovë dhe termocentraleve të cilat paraqesin përmbajtje të një rëndësie shtetërore.
- Funksionet superiore si arsimi dhe shëndetësia të mos jenë ekskluzivitet vetëm i Prishtinës, por preferohet që disa njësi - fakultete dhe klinika të gjejnë vend edhe në qendrat tjera, në mënyrë që të stimulohet zhvillimi ekonomik i tyre, ulja e fluksit të udhëtimit dhe migrimit ditor, si dhe përqendrimit të popullsisë vetëm në Prishtinë.

⁸⁷ “Korridori X” - korridor i rrugëve automobilistike në rrjetin e përgjithshëm të rrugëve kryesore evropiane që lidhë shtetet e BE me Detin Egje- Athinë

⁸⁸ “Korridori VIII” - korridor i rrugëve automobilistike që lidhë Detin Adriatik- Durrës me Azinë e Vogël - Stamboll



► Struktura dhe rrjeti i vendbanimeve

3.2.1.2.1. Qendrat e mëdha

Mitrovica, Peja, Prizreni, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj do të forcojnë edhe më tutje pozitën e tyre si qendra rajonale në shërbim të qendrave që kanë përreth dhe në plotësimin e shërbimeve në raport me kryeqendrën. Me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik - rekomandohet shfrytëzimi i të gjitha resurseve ekzistuese, me theks të veçantë ato të cilat i dallojnë këto qendra në mes veti duke pasur si synim plotësimin e mozaikut të zhvillimeve dhe mundësive ekonomike për të gjithë territorin e Kosovës. Këto qendra duhet të jenë bartës të zhvillimeve dhe ndryshimeve me të cilat do të synohet:

- transformim nga qendra statike në qendra të hapura dhe konkurrencte jo vetëm brenda, por edhe jashtë territorit të Kosovës
- rigjenerimi urban që nënkupton përtëritjen jo vetëm të mjedisit të ndërtuar, por edhe rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale përmes hapjes së vendeve të reja të punës dhe investimeve publike. Shtimi i numrit të banesave përmes dendësisimit, duhet të konsiderohet si politikë urbane me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore, por gjithnjë duke pasur parasysh ruajtjen e identitetit.
- Rigjenerimi i zonave industriale dhe adaptimi kërkesave të reja të zhvillimit të prodhimit dhe biznesit në parqe të biznesit që do të jenë pjesë përbërëse e tërë qendrës.
- infrastrukturë e brendshme efektive rrugore e lidhur me unazë që do ta lidhë qendrën përkatëse me qendrat tjera dhe do ta orientojë transportin tranzitor jashtë qendrave të qytetit



3.2.1.2.2. Qendrat e vogla

Obiliqi, Fushë Kosova, Drenasi, Lipjani, Podujeva dhe Novobërda (Zona e Kaltër); Skënderaj, Vushtrria, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi (Zona e Gjelbër); Istogu, Klina, Suhareka, dhe Dragashi (Zona e Portokalltë); Deçani, Rahoveci, Malisheva, Vitia, Kamenica, Shtimja, Kaçaniku dhe Shtërpce (Zona e Verdhë) përfaqësojnë grupin e qendrave të cilat në zhvillimet e ardhshme hapësinore duhet të luajnë rol aktiv në:

- përmirësimin e ofertës së shërbimeve dhe ato të jenë më efikase,
 - në forcimin e lidhjeve me fshatrat përreth dhe
 - në përpjekjen që zona si tërësi të funksionojë në bazë të programeve të përcaktuara zhvillimore.

3.2.1.2.3. Komunitet e reja

Në bazë të rekomandimeve të dala nga Pako e Ahtisarit dhe në bazë të Ligjit të aprovuar për kufijtë administrativ komunal (2008/03-L041), është paraparë themelimi i dhjetë (10) komunave të reja. Komunitet janë themeluar me zonat e kadastrave të renditura në këtë ligj dhe me seli të përcaktuara si: Komuna e Novobërdës me seli në Bostan⁸⁹; Komuna e Mitrovicës së Veriut me seli në Mitrovicë; Komuna e Mitrovicës së Jugut me seli në Mitrovicë; Komuna Junik me seli në Junik; Komuna e Hani i Elezit me seli Hani i Elezit; Komuna e Mamushës me seli në Mamushë; Komuna e Graçanicë me seli në Graçanicë; Komuna Ranillug me seli në Ranillugë; Komuna Partesh me seli në Partesh; dhe Komuna Kllokot me seli në Kllokot. Të gjitha këto komuna, varësisht nga lokacioni i ndodhjes, duhet ti nënshtrohen kritereve të përcaktuara sipas strukturës hapësinore të zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm në Kosovë.

3.2.1.2.4. Fshatrat

Fshatrat përbëjnë numrin më të madh të vendbanimeve në Kosovë. Rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në fshatra të shpërndara në të gjithë territorin e Kosovës. Në bazë të zhvillimit, fshatrat në Kosovë dallohen nga shumë të zhvilluara - zakonisht në rrafshina dhe në afërsi të akseve kryesore të rrjetit rrugor si dhe afër qendrave të mëdha urbane, deri te ato shumë pak të zhvilluara të cilat janë kryesisht në zonat kodrinore malore dhe ku rrjeti rrugor është i dobët. Procesi i migrimit ka marrë përmasa të mëdha, kryesisht po ndodhë në fshatrat e zonave malore ku mungon zhvillimi ekonomik, infrastruktura rrugore dhe shërbimet themelore të infrastrukturës sociale. Duke konsideruar që ky proces do të vazhdojë edhe për një kohë, do të duhej që me politika afatshkurtra dhe afatgjata të ndihmohet rigjenerimi i fshatit me aktivitete të bazuara në shfrytëzimin maksimal të potencialeve ekzistuese dhe atë në:

- zonat të cilat kanë rëndësi për gjithë vendin dhe të cilat ndikojnë në zhvillimin e hapësirës më të madhe se vet zona;
- zonat në të cilat nuk kërkohet ndonjë investim i madh dhe përmes këtyre investimeve përfiton një territor më i madh se vet zona;
- zonat të cilat zhvillimin e tyre e bazojnë kryesisht në forca vetanake në të cilat një investim eventual do të jetë shtytës dhe përkrahje për banorët e asaj zone.

⁸⁹ Komuna e tanishme e Novobërdës e me seli në Bostan do të zgjerohet dhe përbëhet nga zonat kadastrave të renditura në "Ligjin për kufijtë administrativ të komunave", Ligji nr. 03/L-041.



3.2.2. RUAJTJA DHE MBROJTJA E MJEDISIT, RESURSEVE NATYRORE DHE TRASHËGIMISË KULTURORE


Duke konsideruar ruajtjen e resurseve dhe mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si qëllim të zhvillimit hapësinor të Kosovës, ky aspekt ka për qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, të zhvillimit të kontrolluar hapësinor, mbrojtjen dhe respektimin e resurseve, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe duke u bazuar në gjendjen ekzistuese e cila thekson çështjet e:

- humbjes së tokës kualitative bujqësore;
- shkallën e lartë të ndotjes mjedisore;
- shfrytëzimin joracional të resurseve dhe
- zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve i paraqet si alarmante,

Qasja për një zgjidhje të ardhshme duhet të konsistojë në veprime të përqendruara të:

- mbrojtjes së mjedisit dhe resurseve natyrore,
- përkujdesjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore dhe promovimit të prodhimeve kualitative vendore, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve minerale dhe
- kontrollit të rritjes së vendbanimeve.

Gjatë procesit të hartimit të planit hapësinor të Kosovës, disa nga rajonet apo zonat në Kosovë janë veçuar për nga përmbajtja dhe funksioni. Zonat e tilla duhet të trajtohen si zona nën kujdes të veçantë të shtetit varësisht se çfarë rëndësie kanë. Ekzistojnë dy kategori të këtyre zonave: Zonat e mbrojtura dhe Zonat e veçanta të mbrojtura.





3.2.2.1. Zonat e mbrojtura⁹⁰

Janë pjesa e hapësirës të cilat caktohen me qëllim të ruajtjes të vlerave natyrore, kulturore-historike dhe arkeologjike, të mbrojtjes nga ndotja të mjedisit jetësor ose sigurimi i kushteve hapësinore për ushtrimin pa pengesë të veprimtarisë dhe siguria e banorëve dhe e hapësirës për rreth;

Në kuadër të këtyre zonave kemi:

- Zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore,
- Zona të mbrojtura të trashëgimisë natyrore, dhe
- Zonat me interes të veçantë për Kosovën.

Zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore⁹¹


Në tërë territorin e Kosovës momentalisht janë 426 monumente të cilat kanë status të mbrojtjes. Në hartën e mësipërme kemi të paraqitura numrin e monumenteve të trashëgimisë arkitekturale dhe trashëgimisë arkeologjike (me objekte të paluajtshme).

Zona të mbrojtura të trashëgimisë natyrore⁹²

Në kuadër të këtyre zonave kemi këto kategori:

Zonat me status të mbrojtjes	Kategoria IUCN	Numri i zonave	Sipërfaqja /ha	%
Rezervate natyrore	I	11	698.4	1.52
Parqe kombëtare	II	1	39 000	84.55
Monumente natyrore	III	38	4 867.9	10.55
Peizazhe të mbrojtura	V	2	1 681	3.17
Total			46 247.3	100

Në hartën e mëposhtme janë të paraqitura zonat, monumentet dhe vlerat tjera natyrore të Kosovës që kanë statusin e mbrojtjes.



⁹⁰ Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikim hapësinor nr.03/L-106/2008, (neni 2);

⁹¹ Të dhënat janë marrë nga MKRS/Divizioni për trashëgimi kulturore. Për shkak të numrit të madh të tyre nuk janë listuar në këtë dokument. Për informata më detale të konsultohet Divizioni për trashëgimi kulturore.

⁹² Të dhënat janë marrë nga dokumenti “Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës”, Prishtinë 2005, nga Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrë, sot Agjencia për mbrojtjen e mjedisit.



Zonat me interes të veçantë për Kosovën

Në kuadër të kësaj kategorie kemi zona ku duhet të vendoset një regjim i caktuar i zhvillimit:


- Zona e mihjes sipërfaqësore të linjimit dhe prodhimit të energjisë;
- Investimet kapitale të nivelit qendror;
- Zona e veprimit të koordinuar (Trekëndëshit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës - TZHEK);
- Aeroporti i Prishtinës;
- Kalimet kufitare dhe zonat ndërkufitare të zhvillimit; dhe
- Zonat tjera të shpallura nga institucionet qendrore të Kosovës.

Zonat ku duhet të rigjenerohet mjedisi i degraduar e të cilat duhet të rishfrytëzohen për qëllime tjera janë:

- Deponitë e mbetjeve industriale në Mitrovicë, Obiliq, Kishnicë dhe Elez Han;
- Lokacionet e deponive të mbyllura komunale

3.2.2.2. Zonat e Veçanta të Mbrojtura - janë kategori hapësinore të cilat në detaje janë të përshkruara në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Ligji në fjalë është pjesë përbërëse e Pakos së Ahtisarit⁹³ të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2008. Sipas Ligjit, në territorin e Kosovës janë identifikuar 45 zona të tilla që kryesisht i përkasin trashëgimisë kulturore ortodokse.

► Shtirja e zonave të veçanta të mbrojtura sipas komunave:⁹⁴



⁹³ Propozim gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

⁹⁴ Shtresa (layer) e sipërfaqes së Zonave të veçanta të mbrojtura është marrë nga UNOSEK-u.



Këto zona janë të ndara në tri grupe të cilat janë me karakteristika të ndryshme.

1. Në Grupin I-rë bëjnë pjesë zonat kufiri i të cilave është caktuar me anë të hartave.
2. Në Grupin II-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 100m' nga perimetri i "oborrit" të tyre.
3. Në Grupin III-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 50m' nga perimetri i "oborrit" të tyre.

Këto zona kanë të caktuara kriteret sipas të cilave përcaktohen:

Aktivitetet e ndaluara brenda tyre - të cilat kanë të bëjnë kryesisht me: ndërtimet e objekteve industriale, digave (pendave), centraleve elektrike, furrave, fabrikave, rrugëve tranzite në zonat rurale dhe ndërtimeve që bëjnë shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit të asaj zone.

Aktivitete të kufizuara brenda ZVM - kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimet e objekteve eventuale me etazhitet më të lartë se monumenti që duhet mbrojtur, ndërtimet e rrugëve, punëtorive, restoranteve, hoteleve, klubeve të natës, pompave me karburante të naftës, riparimet e automjeteve, vetëshërbimet, tubimet publike dhe urbanizim të tokës bujqësore.

3.2.3. ZHVILLIMI DHE INTEGRIMI I INFRASTRUKTURËS DHE KOMUNIKIMIT

Shpërthimi i izolimit nga rrjedhat rajonale varet nga statusi dhe pozita e Kosovës në proceset e integrimit Evropian dhe projekteve të parapara siç janë integrimi në korridoret e transportit evropian, pjesëmarrja në marrëveshjen për komunitetin e energjisë së Evropës JL, etj.

Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit nënkupton integrimin në rrjetin rajonal dhe Evropian të transportit (TEN), përmirësimin e transportit brenda territorit të Kosovës, furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike për kërkesat vendore dhe rajonale dhe sigurimin e sasisë së mjaftueshme të ujit për pije, bujqësi dhe industri. Zhvillimi i infrastrukturës do të ndikojë në zvogëlimin e papunësisë së lartë, do t'i kontribuojë zhvillimit më të barabartë të rajoneve të ndryshme në Kosovë, do të ofrojë kualitet më të mirë të zhvillimit në zonat rurale dhe do të mundësojë qasje në infrastrukturë për të gjithë.



3.2.4. KONFLIKTET DHE SINERGJITË POTENCIALE

Konfliktet

Për hapësira, territore të njëjta në Kosovë, sektorë të ndryshëm planifikojnë zhvillimet hapësinore me interes për ta. Në këtë rast zhvillimet hapësinore të planifikuara nga sektorët e ndryshëm për një hapësirë të njëjtë do të jenë në konflikt njëri me tjetrin që do të thotë se do të ketë konflikte sektoriale. Plani hapësinor nuk ofron zgjidhje për të gjitha problemet e hapura. Ai tenton që të minimizojë konfliktet ndër-sektoriale të shfaqura në një rajon duke ofruar opsione të mundshme të bashkërenditjes së politikave dhe veprimeve për rajonin përkatës. Janë identifikuar rajonet me konflikte ku konfliktet më të shprehura janë:

- Shfrytëzimi i rezervave të linjitet kundrejt mbrojtjes së tokës bujqësore;
- Mbrojtja e mjedisit kundrejt zhvillimit të industrisë;
- Zhvillimi i rrjetit të transportit kundrejt promovimit të bujqësisë si veprimtari ekonomike dhe
- Promovimi i trekëndëshit të zhvillimit ekonomik të Kosovës kundrejt zhvillimit të bujqësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe kushteve më të mira për banim

Sinergjitë

Plani Hapësinor i Kosovës është në përkrahje të veprimeve sinergjike të sektorëve të ndryshëm të qeverisë së Kosovës. Duke i mbishtresuar këto veprime arrihet deri te veprimet më të forta sinergjike të cilat karakterizohen me hapësirën ku ndodhin dhe veprimin e harmonizuar. Ato janë:

- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me zhvillimin e turizmit;
- Kultivimi i bujqësisë me zhvillimin e zonave rurale dhe të pa zhvilluara;
- Zhvillimi kompakt me mbrojtjen e tokave kualitative bujqësore;
- Zhvillimi i rrjetit rrugor në harmoni me zhvillimet lokale ekonomike dhe lidhjen më të fortë të vendbanimeve;
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik;
- Akumulimet e reja ujore në harmoni me zhvillimin e bujqësisë dhe furnizimin me ujë të pijshëm



3.2.7. STRUKTURA HAPËSINORE E ZHVILLIMIT DHE ORGANIZIMIT TË ARDHSHËM NË KOSOVË


3.2.7.1. Thesari i Kosovës (Hapësirë e gjelbër) - industriale, shërbyese e tregtare - Mitrovica

Karakteristikat e hapësirës së gjelbër - Paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok në qendër me qytetin e Mitrovicës.

Hapësira e gjelbër me një sipërfaqe prej 2.083 km², rreth 300.000 banorë (UNHCR, 1998) është zonë kryesisht rurale ku rreth 65% e popull-sisë jeton në fshatra dhe rreth 35% në qytete. Qyteti i Mitrovicës kishte rreth 68.000 banorë('98), ndërsa sot rreth 75.000 banorë (vlerësim). Komuna e Skenderajt në krahasim me 5 qendrat tjera ka shkallë të lartë të popullsisë rurale rreth 95%, që merren kryesisht me bujqësi dhe është ndër më të pa zhvilluarat në Kosovë. Sipërfaqet e mëdha me tokë bujqësore kualitative në komunën e Vushtrrisë, paraqesin bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, ndërsa sipërfaqet me kullosa dhe pyje në pjesët më të larta malore të komunës së Leposaviqit dhe Zubin Potokut, ofrojnë mundësi për stimulimin e bujqësisë dhe pylltarisë.



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e gjelbër



Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore të rajonit:



- Burimi termomineral në Vuqë, Leposaviq - Monument natyror me karakter hidrologjik;
- Kamilja në Leposaviq - Bregore gëlqerore është rezervati veçantë natyror me veçori paleontologjie;
- Minalet-Kristalet - Minerale dhe kristale të ruajtura në muzeun e kristaleve në Stan Tërg;

► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes⁹⁵



► Zonat e veçanta të mbrojtura

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

1. Manastiri i Sokolicës, Zveçan;
2. Manastiri i Banjskës, Zveçan;
3. Manastiri Duboki Potok, Zubin Potok;
4. Manastiri i Soçanicës, Leposaviq;
5. Manastiri i Deviçit, Skënderaj;

Në grupin ku zonat të përcaktuara me harta, por të cilat me rast të ndonjë aktiviteti të ri, duhet t'a konsultojnë drejtpërsëdrejti KZM-në janë:

1. Kështjella Mesjetare e Zveçanit, Zveçan;
2. Ura Mesjetare /e Vjetër e Vojnoviqëve, Vushtrri.

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 100m nga perimetri i "oborrit" të tyre janë:

1. Manastiri i Premtit të Shenjtë, Leposaviq;
2. Manastiri i Shëruesve të Shenjtë, Leposaviq;

⁹⁵ Lista e monumenteve me status të mbrojtjes gjindet në MKRS/Divizioni për Trashëgimi Kulturore. Për shkak të numrit të madh nuk është paraqitur lista në dokument.



Qyteti i Mitrovicës - “qyteti i minatorëve”, me pasuritë nëntokësore në hapësirën e gjelbër, ofrojnë mundësi që kjo zonë të merr rolin udhëheqës në zhvillimin e industrisë së rëndë në nivel të Kosovës. Nëntoka e kësaj zone është e pasur me plumb dhe zink, e në sasi më të vogël me argjend dhe ari.

3.2.7.1.1. Vizioni

Zonë e zhvilluar industriale që merr rolin udhëheqës në industrinë përpunuese të mineraleve duke respektuar standardet për mjedis, zhvillim të agrobiznesit, tregtisë e industrisë shërbyese, rritjen e kualitetit të jetës, punësimit dhe barazisë sociale, përmes qeverive lokale aktive, transparente dhe efikase.

3.2.7.1.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Bashkim i qytetit të Mitrovicës, të lidhur në rrjet me qendrat e tjera,
- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban i vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, përmirësim të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësim dhe barazi sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK - shfrytëzim të përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndërurbane, rrjetit të infrastrukturës (rrugor, hekurudhor, TI-së).
- Zhvillimin e industrisë përpunuese-metalurgjike, veprimtarive shërbyese tregtare, agroindustriale, me intensifikim të politikave të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së mjedisit.

3.2.7.1.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të hapësirës së gjelbër

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i industrisë së rëndë, • Shfrytëzimi racional i rezervave, me eksploatimin, përpunimin e xeheve, mundësia e revitalizeve dhe aplikimit të teknologjisë së avancuar për përpunim të tyre në kuptim të prodhimeve finale konkurrencte në treg, • ngritja profesionale e kuadrit të specializuar për industrinë përpunuese të mineraleve, • Prezenca e Fakultetit Xhehtar Metalurgjik në Mitrovicë - bazë e mirë për përgatitjen e kuadrove të reja • Zhvillimi rural me lidhje të mira në mes të fshatrave dhe qyteteve, të integruara në zhvillimin e përgjithshëm të zonës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Qytet i ndarë i Mitrovicës, me qeverisje paralele në pjesën veriore, me probleme të shumta politike, • Mos vlerësimi i gjendjes ekzistuese të minierave, • Eksploatimi dhe shitja e xeheve si lëndë e parë, • Mungesë e kuadrit të specializuar për industrinë përpunuese të mineraleve, • Mungesë e teknologjisë së re për përpunim të mineraleve • Mos avancimi i Fakultetit Xhehtar Metalurgjik dhe bashkëpunimit e shkëmbimit të përvojave me qendrat e tjera, • ballafaqim i popullatës me papunësi, varfëri, migrim, • Larg qendrave të zhvilluara urbane e një pjese të konsiderueshme të fshatrave në hapësira të thella malore, • Në vendbanimet urbane (sidomos në Mitrovicë dhe Vushtrri) ku numri i popullsisë është më madh, hapësirat shkollore dhe shëndetësore nuk i plotësojnë kërkesat, • Shkallë e ulët e kualitetit të jetës, shërbimeve komunale,


3.2.7.1.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Gjelbër

Konfliktet:

- Qyteti i ndarë i Mitrovicës dhe zhvillimi i baraspeshuar ekonomik, social dhe politik të Kosovës;
- Zhvillimi i industrisë përpunuese metalurgjike me teknologji të vjetër dhe ndotja e mjedisit;
- Eksploatimi i pasurive nëntokësore dhe zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm;
- Mbrojtja e tokës kualitative bujqësore (Vushtrri) dhe zgjerimi të vendbanimeve.

Sinergjitë:

- Planet zhvillimore komunale dhe urbane ndihmojnë zhvillimin e kontrolluar dhe mbrojtjen të tokës bujqësore;
- Zhvillimi i industrisë metalurgjike nga shfrytëzimi i xeheve të plumbit, zingut, argjendit dhe arit;
- Ngritja profesionale e kuadrit në fakultetin Xhehtar-Metalurgjik dhe avancimi i teknologjisë ndihmojnë zhvillimin e industrisë përpunuese në periudhë afatgjatë. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore ndihmon mbrojtjen e mjedisit, atraktivitetin e peizazheve të hapura.



3.2.7.2. Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) - administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agroindustriale, turistike - Prishtina

Karakteristikat e hapësirës së kaltër - Kjo tërësi paraqet pjesën verilindore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Lypjani, Drenasi dhe Shtime në qendër me qytetin e Prishtinës.

Kjo tërësi e paraqitur me ngjyrë të kaltër, e përbërë nga 7 qytete, me Prishtinën në qendër, ka karakteristika të rajonit të dendur të qendrave urbane dhe atyre rurale në zhvillim e sipër, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, pasuri nëntokësore (linjit, Ni, Pb, zink, ari), hapësirave dhe objekteve të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore, hapësirave të lira të gjelbra, ndërsa për nga veprimtaritë ekonomike karakterizohet me ato industriale, tregtare dhe shërbyese, si dhe veprimtaritë administrative, shëndetësore, arsimor dhe shkencore.



3.2.7.2.1. Vizioni


Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrencte me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.

Prishtina si kryeqytet, me seli të qeverisë dhe zyrave diplomatike, lidhje të mira me qytetet fqinje kosovare dhe ato jashtë kufijve, përmes rrjetit të infrastrukturës fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, energjetike) si dhe asaj administrative dhe institucionale.

Të lidhura në rrjet, qytetet në këtë zonë krijojnë kushte të volitshme për veprimtari ekonomike, industriale, komerciale dhe shërbyese.

Në qendër të zonës së kaltër, parashihet TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare. Arsyet për një përcaktim të tillë të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të TZHEK-ut janë: 1) afërsia e qytetit të Prishtinës si qendër e ardhshme më e madhe administrative, arsimore-shkencore dhe shërbyese në Kosovë si vend i mundshëm joshës për investitorë të vendit dhe të huaj, 2) korridoret kryesore të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ajrore, telekomunikimeve dhe energjisë, 3) Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës si pikë strategjike për ndërlidhje me botë në aspektin e shkëmbimit të mallrave dhe njerëzve 4) Afërsia e korridoreve evropiane.






► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e kaltër

TZHEK - Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës merr rolin e bartësit të zhvillimit ekonomik jo vetëm të zonës por në të njëjtën kohë do të jetë njëra ndër shtyllat e zhvillimit të gjithmbarshëm të ekonomisë kosovare. Për këtë arsye përpilimi i Planit Strategjik të Zonës së Kaltër, gjegjësisht të TZHEK-ut është hap i parë që mundëson zhvillimin e lokacioneve tanimë të identifikuara për prodhimin e energjisë elektrike.

Trekëndëshi në aspektin hapësinor do të përkufizohej me: (Qytetin e Prishtinës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe dy rrugët magjistrale Prishtinë-Pejë-Mal i Zi dhe Prishtinë-Ferizaj-Maqedoni). Një përcaktim paraprak hapësinor për një destinim të tillë të grupimeve të aktiviteteve ekonomike në hapësirë të caktuar - TZHEK, për ato të shërbimeve publike dhe tregtare, është i dobishëm në joshjen e investitorëve të huaj, kompanive ndërkombëtare, natyrisht të shoqëruar me veprime specifike institucionale, legjislative e financiare, të qeverisë qendrore dhe lokale kosovare të involvuara e po ashtu edhe ato ndërkombëtare me qëllim të veprimit të koordinuar në investime.

Analizat e Praktikave të mira në botë, programet e ndryshme zhvillimore ndërkombëtare, shtimi i vendeve të punës, mundësi për grupime të reja multifunkionale me institucionet e arsimit të lartë, institucioneve hulumtuese e shkencore paraqesin grupimin e suksesshëm për një zhvillim ekonomik të fuqishëm e të qëndrueshëm.




► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura

- Gazimestan, Prishtinë - Rezervat bimor i Bozhurit (Paenonia decora Anders);
- Parku rajonal Gërmia, Prishtinë;
- Shpella e Gadimes, Lipjan - gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore...
- Shpella e Bajincës, Drenas - gjeomonument i natyrës me vlera speleologjike dhe hidrologjike;
- Shpella në Gllanasellë, Drenas - gjeomonument i natyrës me vlera speleologjike dhe hidrologjike;
- Trungu i qarrit në Dumnicë të Poshtme, Podujevë - monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Polatë, Podujevë - monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i plepit në Orllan, Podujevë;
- Trungu i qarrit në Dobratin, Podujevë - monument natyror me karakter botanik;
- Plepi në Bajqinë, Podujevë - monument natyror me karakter botanik;
- Burim i ujit në Revuqë, Podujevë - monument natyror me karakter hidrologjik;
- Burim i ujit mineral në Sallabajë, Podujevë - monument natyror me karakter hidrologjik;
- Burim i ujit në Shakovicë, Podujevë - monument natyror me karakter hidrologjik;



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



► Zonat e veçanta të mbrojtura

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

1. Manastiri i Graçanicës, Prishtinë;
2. Kisha e Shpalljes së Virgjëreshës, Lipjan;

Në grupin ku zonat të përcaktuara me harta, por të cilat me rast të ndonjë aktiviteti të ri, duhet ta konsultojnë drejtpërsëdrejti KZM-në është:

1. Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve, Obiliq;



3.2.7.2.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillimi i rrjetit e atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazi sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK - shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndër urbane me hapësirat tjera dhe më gjerë lidhjet e fuqishme rajonale përmes zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së).
- Promovim i TZHEK, lokacion për grupim aktiviteteve në aspekt hapësinor, investime të huaja, kompani multinacionale,
- Mbështetje aktiviteteve H&ZH, për një ekonomi të njohurive, mbështetur nga kapacitetet organizative,
- Promovimi i Prishtinës si qendër e diturisë të rajonit më të gjerë të Evropës Juglindore.
- Zhvillim i aktiviteteve administrative, arsimore, shërbyese tregtare, energjetike, agroindustriale e turistike.

3.2.7.2.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të zonës së kaltër

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Pozitë qendrore gjeografike në Evropën juglindore, • Qyteti i Prishtinës me pozitë qendrore në Kosovë, me koncentrim të institucioneve qeveritare, administrative e zhvillimore hulumtuese të rëndësishme, • Nyje e ndërlidhjeve të linjave të trafikut vendor e rajonal (rrugor, hekurudhor, ajror, energjetik, potencialisht të TI-së), • Popullata me moshë të re krahasuar me vende tjera evropiane, e orientuar kah BE, me njohuri të trendëve të reja dhe teknologjisë informative, • Ekonomi të orientuar kah BE e cila me prezencën e frymës ndërmarrëse dhe trendin aktual të shërbimeve të llojllojshme tregtare, mund të jetë konkurrenente në rajon • Prezenca e organizatave ndërkombëtare diplomatike në Prishtinë si përparësi zhvillimore, • Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit jo të lartë dhe rrugëve e projekteve tjera të trafikut të planifikuara dhe të mbështetura financiarisht. • Trendi i ndërtimit (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investiv privat, • Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore, • Koncentrim i institucioneve të arsimit të lartë në Prishtinë, Universitetit të Prishtinës, Universiteteve private, Qendrës Klinike Universitare, instituteve dhe agjencive zhvillimore hulumtuese që mund të shërbejnë si bazë për aktivitete të ekonomisë së njohurive • Prezenca e vlerave historike dhe kulturore të cilat kontribuojnë në identitetin e zonës dhe atraktivitetin e zonës njëkohësisht ndihmë ekonomisë së njohurive, 	<ul style="list-style-type: none"> • Pamjaftueshmëri e Kapaciteteve Organizative (Mbështetjes politike, shoqërore, rrjetave strategjike, partneritetit publiko privat etj) • Të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të sigurta për strukturën e popullatës dhe e parashikimeve. • Zhvillimi paplanifikuar i vendbanimeve, objekte të papërfunduara, jo të përdorshme për treg të banimit, infrastrukturë joadekuate sipas standardeve moderne teknike, të cilat bllokojnë zhvillimin e qyteteve. • Pasiguri për investime afatgjata për shkak të statusit të pa definuar të Kosovës, • Mangësi të shumta në sistemin dhe kualitetin e arsimit, • Lidhje të pamjaftueshme me rrjetin e transportit Evropian, standard i ulët i rrugëve, hekurudhës dhe transportit publik brenda në Kosovë, dhe me vendet e tjera në rajon. • Furnizim i pasigurt, i pa mirëmbajtur dhe i pamjaftueshëm me ujë të pijes, mungesë e trajtimit të ujërave të zeza dhe industrial, kanalizimit, • Nivel i lartë i ndotjes, nga prodhimi i energjisë, ndotja dhe degradimi i lumenjve, përrenjve, tokës dhe ujërave nëntokësor nga ujërat e zeza, deponitë e egra të mbeturinave si dhe mungesë e menaxhimit të tyre. • Rrezik i madh i hapësirave të pazhvilluara dhe potencialeve natyrore, si dhe mungesa e hapësirave të gjelbra dhe rekreative në hapësirat urbane, kushte jo të favorshme për këmbësorë dhe çiklistë, • Mungesë e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mbrojtjes së mjedisit.



3.2.7.2.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të TZHEK-ut

Konfliktet

Zhvillimi i TZHEK - në konflikt me mbrojtjen e tokës bujqësore, mjedisin dhe banimin,

Sinergjitë

Zhvillimi i TZHEK ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës, rritjen e atraktivitetit të qytetit të Prishtinës-investimet e huaja/joshjen e kompanive ndërkombëtare, zhvillimin dhe aplikimin direkt të hulumtimeve dhe zhvillimeve, orientimin investimeve kapitale për infrastrukturë fizike.

Zhvillim potencial i TZHEK-ut -Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, do të ishte në konflikt me strategjitë për: tokën bujqësore, mjedisin dhe banimin,


Spektri i veprimeve - i përmbledhur për nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes, janë të aspektit institucional e ligjor dhe financiar:

Institucional dhe ligjor -

- Kapacitetet organizative duhet të jenë funksionale efikase e efektive, për të arritur qëllimin për një zonë të fuqishme të zhvillimit ekonomik të Kosovës, zonës së kaltër, TZHEK-ut. Udhëheqja, mbështetja politike, mbështetja shoqërore, rrjetet strategjike si dhe evaluimi i zhvillimeve në formë të rezultateve do të ishte parakusht.
- Legjislacioni përkatës për mbështetje strategjive sektoriale - Përkrahje përpilimit të Planit Hapësinor të zonës së veçantë (TZHEK) së bashku me grupin e përbërë për menaxhim e koordinim të TZHEK, (grupi për qeverisjen e rajonit urban metropolitan)
- Marrëveshje ndërmjet komunave të involvuara dhe me interes të përbashkët në zhvillimin e TZHEK-ut.
- Mbështetje për bashkëpunim ndërmjet institucioneve arsimore shkencore dhe atyre prodhuese, në ngritjen e kualitetit të arsimit dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale, krahas nevojave të tregut në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, dhe një nismë në aplikimin e ekonomisë së njohurive.
- Financiar - Ndarja e fondeve, mbështetja financiare për:
 - Hartimin e Planit Hapësinor të TZHEK-ut, organizimin e trupit koordinues dhe menaxhues të TZHEK-ut,
 - Investime kapitale në infrastrukturë fizike (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së), punën e AKMM-së (monitorim të zbatimit të VNM dhe VNS), stimulimin e përdorimit të teknologjive të reja,
 - Investime në arsim, shkencë e teknologji, përgatitje të kuadrove sipas kërkesës së tregut, edukimit mjedisor - peizazhit dhe menaxhimit urban.
 - mbështetje iniciativave qytetare dhe OJQ-ve për monitorim të gjendjes, ngritjes së vetëdijes qytetare për zhvillimet e ardhshme të parashikuara, krahas mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetës.

Hulumtimet

Me qëllim të caktimit të prioriteteve si fazë e fundit të përpilimit të planeve të veprimit si dhe ndarjes së përgjegjësisive në hapat e mëtejshme të qeverisë qendrore, lokale si dhe institucionet ndërkombëtare monetare e zhvillimore, nevojiten analiza e studime për çmimin - përfitimin e zgjidhjeve alternative siç janë investimet në infrastrukturën fizike, investime në ngritjen institucionale, investimet në arsim dhe shkencë etj.




3.2.7.3. Urat e Kosovës (Hapësira e verdhë) - shërbyese tregtare, Turistike agro - industriale, dhe industri e lehtë - Ferizaj dhe Gjilani



Karakteristikat e hapësirës së verdhë - Kjo tërësi e paraqitur me ngjyrë të verdhë, paraqet pjesën jug-lindore të Kosovës, të përbërë nga komunat: Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, Novobërdë, Viti, Kamenicë dhe Shtërpce.

Ka karakteristika të rajonit të kombinuar nga qendrat urbane dhe më shumë të atyre rurale, me tokë bujqësore të kualitetit të lartë, me resurse të ujërave minerale, hapësira të lira të gjelbra, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore, që kanë ekzistuar prej kohësh. Shtrihet në fushën e Anamoravës, malet e Karadakut, luginën e lumit Lepenc dhe në Malet e Sharrit. Pozita e mirë lidhëse me qytetet e Kosovës dhe rajonin, si dhe bashkëpunimi i mirë ndërkuftitar mundëson lidhje të mirë të ekonomive rajonale, duke krijuar një mjedis të favorshëm dhe tërheqës për investitorë.

► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e verdhë



- Legjenda**
- Thesari i Kosovës- Hapësira e gjelbërt
 - Port i Kosovës - Hapësira e kaltërt
 - Kopshtet e Kosovës - Hapësira e portokalltë
 - Urat e Kosovës-Hapësira e verdhë
 - Parku Nacional i Sharrit
 - Bjeshkët e Nemuna
 - Trashëgimia kulturore-historike
 - Toka bujqësore kualitative
 - Vendbanimet me pop. mbi 1000 banorë
 - Qendrat e vogla
 - Qendrat e mëdha
 - Kryeqyteti, Prishtina
 - Zonat kufitare
 - Rrugët unazore
 - Rrjeti rrugor
 - Rrugët e propozuara për zjerim dhe ngritje të kualitetit
 - Rrugët e propozuara për ndërtim
 - Propozim për lidhje me Malin e Zi -Koridori 6
 - Autostrada Merdare-Durrës Varianti 1
 - Varianti 2
 - Alternativa "A" dhe "B" të Autostradës
 - Rrjeti hekurudhor ekzistues
 - Hekurudhat e reja të propozuar
 - TZHEK-Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës
 - Zonat ekonomike
 - Aeroporti
 - Stacionet Hekurudhore
 - Administrata
 - Arsimi i lartë
 - Qendra Klinike Universitare
 - Termocentrali
 - Bazenet e lignitit
 - Minierat
 - Industria
 - Bujqësia, agroindustria
 - Vrshetaria
 - Aktivitete shërbyese-tregtare
 - Trashëgimia kulturore
 - Trashëgimia natyrore
 - Shpella
 - Turizëm malor
 - Turizëm rekreativ
 - Turizëm rekreativ
 - Ujrat termal
 - Blegtoaria
 - Pemtaria


MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



Katër pikat kufitare ekzistuese (Elez Hani, Gllloboqica, Konçuli dhe Muqibaba) janë pika ndërlidhëse tregtare me shtetet fqinje, e sidomos ajo e Elez Hanit nëpër të cilën bëhet shkëmbim i madh tregtar në mes Kosovës dhe rajonit. Afërsia me Aeroportin e Prishtinës dhe me atë të Shkupit e bëjnë këtë hapësirë lehtë të arritshme dhe atraktive për investime. Linja hekurudhore po ashtu është e rëndësishë primare për zhvillim ekonomik, transportit publik apo të mallrave.


E rëndësishme për këtë rajon është fryma ndërmarrëse e qytetarëve si potencial duhet çmuar dhe mbështetur për çdo zhvillim të ardhshëm.

Aktiviteti më i shprehur ekonomik është tregtia, sidomos përgjatë korridoreve rrugore, dhe bujqësia e blegtoria në brendi të hapësirës. Një mbështetje institucionale, legjislativë e financiare do të ndihmonte dhe shtyjë përpara aktivitetet ekonomike, duke u grupuar, për të pasur qasje të barabartë në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Si potencial duhet të konsiderohen përparësitë konkurruese, për të cilat nevojitet: njohuria, marrëdhëniet e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe motivimi. Krijimi i kushteve për garën konkurruese së bashku me përparësitë konkurruese të përmendura është detyrë primare për kapacitetet organizative të qeverisë lokale dhe qendrore.



► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura

- Bifurkacioni i lumit Nerodime, Ferizaj - Rezervat special natyror, fenomen unikat në Europë dhe i dyti në botë.
- Arneni në Nerodime, Ferizaj - ish monument natyror me karakter botanik;
- Ramjani, Viti - monument memorial i natyrës;



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



► Zonat e veçanta të mbrojtura

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave është:

1. Manastiri i Dragancit, Gjiilan;

Në grupin ku zonat të përcaktuara me harta, por të cilat me rast të ndonjë aktiviteti të ri, duhet ta konsultojnë drejtpërsëdrejti KZM-në është:

1. Qyteti Mesjetar i Novobërdës, Novobërdë;

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 100m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre është:

1. Manastiri i Uroshit të Shenjtë, Nerodime, Ferizaj;
2. Manastiri i Binçit, Buzovik, Viti.

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 50m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre janë:

1. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Shtërpçë;
2. Kisha e Teodorit të Shenjtë, Biti e Poshtme, Shtërpçë;
3. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpçë;
4. Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpçë;
5. Kisha e Shën Gjergjit, Biti e Epërme, Shtërpçë;

3.2.7.3.1. Vizioni

Urë e zhvillimit të lidhjes së Kosovës me rajonin, rrjet funksional i fuqishëm i qyteteve dhe fshatrave, atraktive për të jetuar dhe punuar në to, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm, atraktive për investitime dhe ndërmarrësi në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm shërues e rekreativ me plotësimin e kriterëve për mbrojtje të mjedisit.

3.2.7.3.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillim i rrjetit atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit dhe barazive sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK - shfrytëzim të përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brendaurbane, ndërurbane me hapësirat tjera dhe më gjerë atë rajonal nëpërmjet zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TIK-së).
- Zhvillimin e shërbimeve tregtare, agroindustriale e turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.



3.2.7.3.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të hapësirës së verdhë

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Qyteti i Ferizajt me pozitë qendrore në korridorin e zhvillimit në jug të Kosovës - pikë kufitare në Han të Elezit-vend tregtimi me Maqedoni e më tej Shqipëri, Greqi, • Traditë dhe trendi aktual i fuqishëm për tregti, • Baza e KFOR-it si përparësi, me vullnet për ndihmë Kosovës në zhvillimin ekonomik, • Tradicionalisht hapësirë ku bashkëjetojnë, punojnë, me shkallë të lartë të tolerancës, grupe të ndryshme etnike, • Hapësirë e cila në nuk është afektuar shumë nga pasojat e luftës së fundit, krahasuar me viset tjera në Kosovë, • Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit ende jo të lartë, • Trendi i ndërtimeve (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investiv privat, • Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore, • Toka kualitative, e përshtatshme për zhvillim të bujqësisë, industrisë përpunuese e shërbyese, agrobiznes, • Prezenca e resurseve natyrore, rekreative, shëruese, të ujërave termal, mundësi për zhvillim të turizmit malor, rekreativ e shërues, • Mundësia e shfrytëzimit të atraksionit natyror të bifurkacionit të lumit të Nerodimes si resurs turistik, 	<ul style="list-style-type: none"> • Kapaciteteve Organizative të pa mjaftueshme (mbështetja politike, shoqërore, rrjeteve strategjike, partneritetit publik-privat etj) , • Mungesë e planifikimit, zhvillimet e paplanifikuara të vendbanimeve, të pa kontrolluara, sidomos përgjatë rrugëve magjistrale, objekte të papërfunduara e jo të përdorshme për treg të banimit, infrastrukturë joadekuata sipas standardeve moderne teknike, të cilat bllokojnë zhvillimin e qyteteve në shumë drejtime. • Rënie e interesimit të nxënësve për vazhdim të shkollimit të lartë, e lidhur me zhvillimin e aktiviteteve tregtare si më të leverdishme të ditës, mangësi dhe kërcënim në kuptimin afatgjatë, • Furnizim i pasigurt, i pa mirëmbajtur dhe i pamjaftueshëm me ujë të pijes, mungesë e masave për trajtim të ujërave, kanalizimit, • Nivel i lartë i ndotjes, nga prodhimi i energjisë, ndotja dhe degradimi i lumenjve, përrenjve, tokës dhe ujërave nëntokësor nga ujërat e zeza, deponitë e egra të mbeturinave si dhe mungesë e menaxhimit të tyre. • Rrezik i madh i hapësirave të pazhvilluara dhe potencialeve natyrore, si dhe mungesë e hapësirave të gjelbra e atyre rekreative në hapësirat urbane, kushte jo të favorshme për këmbësorë dhe biçiklist, • Mungesë e vetëdijes në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mbrojtjes së mjedisit.

3.2.7.3.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Verdhe

Konfliktet

Zhvillimet potenciale në konflikt me mbrojtjen e tokës bujqësore dhe mjedisin,

Sinergji

Zhvillimet e planifikuara në hapësirë ndihmojnë zhvillimin lokal ekonomik, rritjen e atraktivitetit të qyteteve, lidhjeve ndërmjet qyteteve dhe fshatrave, krijimin e vendeve të reja të punës, kualitetit të jetës.

Për të caktuar prioritetet dhe në lidhje me to përpilimin e planeve të veprimit për investimet konkrete nga BKK, IDN dhe sektorit privat, hulumtimet e çmimit dhe përfitimit të zgjidhjeve alternative duhet të përkrahen në mënyrë institucionale.

Hapësirat me interes të veçantë për Kosovën në zonën e verdhë:

- Katër pikat kufitare ekzistuese (Hani i Elezit, Gllloboqica, Konçuli dhe Muçibaba),
- Parku Nacional (Malet e Sharrit)
- Bifurkacioni i lumit të Nerodimes






3.2.7.4. Kopshtet e Kosovës (Hapësira e portokalltë) - kulturore-turistike, dhe tregtare, agro-industri dhe industri të lehtë - Prizreni

Karakteristikat e hapësirës së portokalltë - gjendet në pjesën jugore të Kosovës, ku përfshihen tri komuna: Suhareka, Dragashi dhe Prizreni si qendër komunale, hapësirë me rreth 360.000 banorë, hapësirë ku afër 65% të popullsisë jeton në fshatra ndërsa 35% në qytete (OSCE, 2000). Komuna e Prizrenit ka rreth 180.000 banorë, me shkallën më të lartë të popullsisë urbane rreth 52%, ndërsa dy komunat tjera janë më të vogla dhe kanë shkallë më të lartë të popullsisë rurale. Dendësia e popullsisë në këtë hapësirë është cca. 230 banorë/km², ndërsa dendësia më e madhe është në qytetin e Prizrenit cca. 370 banorë/km². Migrimi i popullsisë prej hapësirave rurale drejt hapësirave urbane është dukuri e theksuar dhe paraqet një rën prej sfidave me të cilën përballen qytetarët e kësaj zone.




Prizreni është qytet me vlera të lashta kulturore dhe historike që duhet të shpallet “Qytet muze”, me aktivitete të zhvillimit si ato në arsim, tregti, turizëm, bujqësi, industri të lehtë ushqimore, tekstilit, farmaceutikës. Suhareka qytet me traditë në përpunimin dhe prodhimin e verës, në zhvillimin e blegtorisë; Dragashi, me aktivitet ekonomik të blegtorisë, përpunimit të prodhimeve të qumështit dhe mishit, turizmit malor dhe pylltarisë.

► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e potokalltë



- Legjenda**
- Thesari i Kosovës- Hapësira e gjelbërt
 - Port i Kosovës - Hapësira e kaltërt
 - Kopshtet e Kosovës - Hapësira e portokalltë
 - Urat e Kosovës-Hapësira e verdhë
 - Parku Nacional i Sharrit
 - Bjeshkët e Nemuna
 - Trashëgimia kulturore-historike
 - Toka bujqësore kualitative
 - Vendbanimet me pop. mbi 1000 banorë
 - Qendrat e vogla
 - Qendrat e mëdha
 - Kryeqyteti, Prishtina
 - Zonat kufitare
 - Rrugët unazore
 - Rrjeti rrugor
 - Rrugët e propozuara për zgjerim dhe ngritje të kualitetit
 - Rrugët e propozuara për ndërtim
 - Propozim për lidhje me Malin e Zi -Koridori 6
 - Autostrada Mendare-Durrës Varianti 1 Varianti 2
 - Alternativa "A" dhe "B" të Autostradës
 - Rrjeti hekurudhor ekzistues
 - Hekurudhat e reja të propozuar
 - TZHEK-Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës
 - Zonat ekonomike
 - Aeroporti
 - Stacionet Hekurudhore
 - Administrata
 - Arsimi i lartë
 - Qendra Klinike Univerzitare
 - Termocentrali
 - Bazenet e lignitit
 - Minierat
 - Industria
 - Bujqësia, agroindustria
 - Vrështria
 - Aktivitete shërbyese-tregtare
 - Trashëgimia kulturore
 - Trashëgimia natyrore
 - Shpella
 - Turizëm malor
 - Turizëm rekreativ
 - Turizëm rekreativ
 - Ujrat termal
 - Blegtoria
 - Pemtaria






► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura

- Parku Nacional “Mali Sharr”;
- Pisha e Arnenit (Rrobullit), Prizren - rezervat bimor me përbërje të pastër të arnenit;
- Oshlaku, Prizren - rezervat natyror i arnenit dhe i disa bimëve endemike;
- Pisha e madhe, Prizren - rezervat bimor i llojit të Molokës dhe i disa shpendëve këngëtarë;
- Rusenica, Suharekë - rezervat shtazor i rrëqebullit;
- Gryka e lumit Lumbardh - monument natyror me karakter hidrologjik dhe peisazhor;
- Rrapi në Marash, Prizren - monument natyror me karakter botanik;
- Vidhi fushor në Lukinaj - ish monument natyror me karakter botanik;
- Rahavane, Suharekë - projekti “88 trungje”.



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



► Zonat e veçanta të mbrojtura



Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

1. Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë, Prizren;
2. Kisha e Shën Gjergjit, Gornjasellë, Prizren;
3. Vetmia e Petrit të Shenjtë, Korishë, Prizren.

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 100m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre janë:

1. Manastiri i Markut të Shenjtë, Korishë, Prizren;
2. Manastiri i Treshit të Shenjtë, Mushtisht, Suharekë;
3. Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Sredskë, Prizren;

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 50m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre janë:

1. Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë në Hodegetri, Mushtisht, Suharekë;
2. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Mushnikovë, Prizren;
3. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Bogoshevc, Prizren;
4. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Draçiq, Prizren;
5. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Sredskë, Prizren;
6. Kisha e Apostujve të Shenjtë (ose e Premtit të Shenjtë), Mushnikovë, Prizren;
7. Kisha e Shën Gjergjit, Sredskë, Prizren.

Në mesin e zonave të identifikuara është edhe zona “Qendra historike e Prizrenit”, si pjesë kryesore e qytetit, me specifika të veçanta krahas zonave tjera, sepse në vete përmban monumente të trashëgimisë fetare dhe kulturore të komuniteteve të ndryshme, që jetojnë në qytetin e Prizrenit.

3.2.7.4.1. Vizioni

Zonë e zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare ku Prizreni zhvillohet në rrënjët e traditës së lashtë, si qendër ekonomike moderne me qeveri lokale të përgjegjshme aktivitete afariste private dhe zhvillim ekonomik lokal përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe njerëzore.

Krijimi i një mjedisi tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve afariste private dhe inkurajimin për shfrytëzimin më të mirë të potencialit ekonomik lokal dhe resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në veprimtaritë e turizmit dhe bujqësisë.

3.2.7.4.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillimi dhe përparimi i infrastrukturës fizike
- Zhvillimi i rrjetit atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimi, barazive sociale.
- Zhvillimi i pemëtarisë, vreshtarisë dhe blegtorisë
- Promovim i Prizrenit “Qytet muze”,
- Mbështetje ZHEL për ZHEK - shfrytëzim të përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndërrurbane me hapësirat tjera dhe më gjerë atë regjional nëpërmjet zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TI-së).
- Zhvillimi i turizmit kulturor e malor, industrial shërbyes e tregtar, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore kulturore.

3.2.7.4.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Hapësirë e pasur me resurse natyrore dhe njerëzore me traditë në aktivitete bujqësore, prodhim të ushqimit dhe artizanat, • Prizreni, qytet tërheqës historik e kulturor për vizitorë dhe investitorë potencial, • Trashëgimi kulturorë e historike, potenciale për zhvillimin e turizmit, • Lidhjet e mira rrugore me tregjet kosovare dhe të shteteve fqinje, kyçja në portet detare të Adriatikut • Popullatë e arsimuar dhe e trajnuar (shkolla e lartë teknike dhe Universitetit në Prizren) • Vetëdijesim i Qeverisë Lokale për ZHEL - nëpërmes përkrahjes së NVM-ve, • Përfshirja e diasporës në përpjekjet për ZHEL, • Burime të mjaftueshme uji (pije, sistem të ujitjes, hidroenergji) 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e planifikimit urban, • Ndërtim ilegal me shfrytëzim të pakontrolluar të resurseve, • Moskoordinim ndërmjet qeverisë lokale dhe komunitetit të biznesit, me komunat fqinje • Administrim i dobët lokal, • Shkalla e lartë e papunësisë • Prezenca e ekonomisë joformale • Humbja e tokës bujqësore,

3.2.7.4.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Portokalltë

Konfliktet

- Shtrirja e vendbanimeve me tokën bujqësore
- Shtrirja e vendbanimeve në mënyrë horizontale në konflikt me shfrytëzimin e hapësirës
- Degradimi i trashëgimisë kulturo-historike në konflikt me zhvillimin e turizmit

Sinergjitë

- Hartimi i planeve zhvillimore ndihmon shfrytëzimin racional të hapësirave,
- Promovimi i Prizrenit “Qytet Muze”, ndihmon mbrojtjen e trashëgimisë kulturo-historike, ruajtjen dhe kultivimin e zejeve tradicionale, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e turizmit, ZHEL, ZHEK,
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në sinergji me zhvillimin e bujqësisë
- Ndërtimi rrugëve transitorë përreth qyteteve, shkarkojnë trafikun urban, ndotja e ajrit është më e vogël në brendi të qytetit, shkurton kohën e transportit ndërurban, shtytje për rregullimin e transportit publik.
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në sinergji me zhvillimin e turizmi
- Investimet në Malet e Sharrit ndihmojnë zhvillimin e turizmit,
- Ndërtimi i hidrocentralit në Zhur ndihmon ZHEL, ZHEK, mbrojtjen e mjedisit.

Zonat hapësinore në zonën e portokalltë me interes të veçantë për Kosovën

- Zona e kalimit kufitar në Vërmicë
- Parku Nacional (Malet e Sharrit)
- Zonat e trashëgimisë kulturo-historike
- Zonat e mbrojtur rreth lumenjve Drini Bardhë, Bistrica e Prizrenit
- Akumulimi në fshatin Dragaqinë
- Sipërfaqet e kullosave në komunën e Dragashit
- Korridori i autostradës Merdare - Durrës





3.2.7.5. Urat e Kosovës (Hapësira e verdhë) - shërbyese tregtare e turistike, agro-industriale dhe industri e lehtë - Gjakova



Karakteristikat e hapësirës së verdhë


Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunat: Deçani, Rahoveci, Malisheva dhe Gjakovën si qendër më e madhe komunale.

Kjo zonë shtrihet në pjesën e mesme të rrafshit të Dukagjinit të rrethuar me male, lartësi mbidetare prej 365m - 2656m, klimë të mesme kontinentale me ndikim të dobësuar të klimës mesdhetare, kohëzgjatje të vegjetacionit 200-250 ditë, rrjetë të pasur hidrografie, trashëgimi natyrore dhe kulturore, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, kullosa, livadhe, traditë në kultivim të pemëve e vreshtave, bletarisë e shpezëtarisë, e dalluar për kultivimin e zejeve tradicionale.


Qyteti i Gjakovës deri në fund të shekullit të XV ishte i njohur si qendër pazari për viset e Malësisë së Madhe, ndërsa me kohë u zhvillua në qendër administrative, duke potencuar zhvillimin e industrisë, tregtisë dhe të turizmit si dhe shërbimet e zhvilluara të arsimit dhe kulturës.

Lidhja e ardhshme ndërkufitare me Shqipërinë mundëson që rajoni i Gjakovës që paraqet pjesën e rëndësishme të Rrafshit të Dukagjinit, të bëhet bartëse i zhvillimit ekonomik të hapësirës dhe qendër e korridorit që do ta lidhë një pjesë të madhe të Kosovës me bregdetin shqiptar. Korridori i paraparë është alternativë e mirë e lidhjes së Kosovës me Portin detar të Shëngjinit, në të cilin do të duhej të kryheshin shërbime enkas për Kosovën, që praktikisht do të ndikoj në shkarkimin e shërbimeve të tejngarkuara në Portin e Durrësit.

► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e verdhë



► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura




- Maja e Ropsit, Deçan - rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut;
- Kozhnjeri, Deçan - rezervat shtazor i llojit të dhisë së egër;
- Malet e Prelepit, Deçan - rezervat bimor me përbërje të panjës malore;
- Rrjedha e lumit Mirusha, Malishevë - me rëndësi hidrologjike dhe peisazhore;
- Kanioni i Drinit të Bardhë te ura e fshejtë, Gjakovë - monument natyror me rëndësi hidro-gjeomorfologjike;

- Bliri në Isniq, Deçan - monument natyror me karakter botanik;
- Bliri në Strellc të Epërm, Deçan - monument natyror me karakter botanik;
- Trungjet e Blirit në Isniq, Deçan - Monumente natyrore me vlera të rralla botanike;
- Trungjet e bungut në Lozicë, Malishevë - monument natyror me karakter botanik;
- Çabrati, Gjakovë - monument memorial i natyrës;
- Pishat e Deçanit, Deçan - Përbërja e pastër e pishës së zezë;
- Parku rajonal i Mirushës, Klinë, Malishevë, Rahovec - Kanioni, ujëvaret dhe peizazhet specifike, një fenomen natyror me rëndësi të jashtëzakonshme.



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



► Zonat e veçanta të mbrojtura

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

1. Manastiri i Deçanit, Deçan;
2. Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, Rahovec;
3. Fshati Hoqë e Madhe, Hoqë e Madhe, Rahovec;



3.2.7.5.1. Vizioni

Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.

Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro-industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.

3.2.7.5.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK - shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, ndërrurbane me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

3.2.7.5.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të hapësirës së verdhë

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Burimet njerëzore, moshë e re e popullsisë (55% nën 26 vjet) • Vetëdije kolektive e lartë, • Përvoja në udhëheqje, • Pozita e mirë gjeografike, zonë kufitare, • Shndërrimi dhe shfrytëzimi i aeroportit ushtarak të Gjakovës në atë civil, • Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale, • Përvoja në industri, • Sektori joqeveritar dhe diasporë e fortë dhe përkrahëse e zhvillimeve, • Sipërfaqet e punueshme dhe nën ujtitje, • Resurset natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit, • Zhvillimi i tregtisë, shërbimeve, • Zhvillimi i eko-bujqësisë, • Kooperimi me qytete tjera brenda dhe jashtë Kosovës, • Hapja e shkollave profesionale, • Shfrytëzimi i TIK në shërbime, • Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Nivel i ulët i decentralizimit fiskal komunal, • Mungesa e vetiniciativës, • Vonesa e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nga AKM, • Migrimi i popullatës - posaçërisht të moshës së re, • Ndërmarrjet e mëdha industriale në pronësi shoqërore jo aktive , • Degradim i konsiderueshëm i resurseve natyrore (shfrytëzimi i rërës dhe prerja e pyjeve), • Mungesa e kooperimit socio-kulturor,

3.2.7.5.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Verdhë

Konfliktet

- Shtirirja e vendbanimeve me tokën bujqësore,
- Zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve,
- Zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore,

Sinergjitë

- Zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore,

Zonat hapësinore me interes të veçantë për Kosovën

- Aeroporti i Gjakovës,
- Kanjoni i Drinit të Bardhë me Urën e Fshejtë,
- Parku rajonal i Mirushës,
- Miniera e kromit në Devë,
- Liqeni akumulues - Radoniqi
- Manastiri i Deçanit,
- Çarshia e Madhe - Gjakovë,
- Kullat e Dukagjinit,
- Kalimet kufitare (Prush e Morinë).





3.2.7.6. Kopshti i Kosovës (Hapësira e portokalltë) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale - Peja

Karakteristikat e hapësirës së verdhë - Kjo hapësirë zë pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Kosovës, shtrihet në luginën e pëlleshme të Dukagjinit, përgjatë kufirit me Bjeshkët e Nemuna, në luginën e Lumëbardhit, me afro 300.000 banorë, klimë kontinentale e klimë mesdhetare dhe me një rrjet hidrografie të zhvilluar. Komunitetet që përbëjnë këtë zonë janë: Peja, Istogu dhe Klina.

Hapësira karakterizohet me mjedis të pastër, pyje dhe tokë kualitative bujqësore, rezerva të ujërave termal, thëngjillit në afërsi të Klinës, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore, si dhe një traditë në kultivim të agro-industrisë, tregtisë dhe turizmit. Lidhja ndërkufitare e qytetit të Pejës me Malin e Zi bën që qyteti të jetë bartës i zhvillimit ekonomik të hapësirës dhe zgjerimin e tregut.



► Strategjia e zhvillimit hapësinor - Hapësira e portokalltë




► Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura

- Gubavci, Pejë - rezervat bimor i llojit endemo-relikt boshtira;
- Burimi i ujit mineral në Dresnik, Klinë - monument natyror me karakter hidrologjik;
- Gryka e lumit Klina, Klinë - monument i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike;
- Gryka e Rugovës, Pejë - rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peisazhore, speleologjike dhe botanike;
- Mani Sham, Pejë - monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Zllakuqan, Klinë - monument natyror me karakter botanik dhe turistik;

- Trungu i qarrit në Poterq të ulët, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i Vidhit në Qabiq, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik;
- Trungu i qarrit në Bërkovë, Klinë - ish monument natyror me karakter botanik;



► Monumentet kulturore me status të mbrojtjes



► Zonat e veçanta të mbrojtura

Në grupin ku kufiri i zonave është përcaktuar me anë të hartave janë:

1. Patriarkana e Pejës, Pejë;
2. Manastiri i Gorioç, Istog;
3. Manastiri i Budisavcit, Klinë;
4. Kisha e Heremitëve, Ularicë, Klinë;

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 100m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre është:

1. Manastiri i Virgjërshës së Shenjtë të Hvosnos, Istog;

Në grupin ku zonat kanë një bufer zonë prej 50m’ nga perimetri i “oborrit” të tyre janë:

1. Manastiri i Dollcit, Klinë;
Kisha e Shën Nikollës, Gjurakoc, Istog;

3.2.7.6.1. Vizioni

Zonë e zhvilluar kulturore e turistike, agro-industriale dhe tregtare, zhvilluar në rrënjët dhe traditat e lashta, me qeveri lokale të përgjegjshme dhe efikase, në bashkëpunim me qytetarët e saj dhe aktorët për zbatim të qëllimeve zhvillimore me shfrytëzim të resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në fushën e turizmit, afarizmit e bujqësisë.



3.2.7.6.2. Qëllimet e përgjithshme:

- Zhvillimi i rrjetit e atraktiv të qyteteve të planifikuara,
- Mbështetje ZHEL për ZHEK me promovim të NVM me - shfrytëzim të përparësive konkurruese,
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brendaurbane, ndërrurbane, rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TI-së).
- Qeverisje dhe administratë lokale efikase dhe përkrahëse në synimet për zhvillime,
- Zhvillimi i turizmit malor e kulturor, veprimtarive industriale, shërbyese e tregtare, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore, kulturore.
- Bashkëpunim ndërkufitar për zhvillime me interes të përbashkët,

3.2.7.6.3. Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Hapësirë e pasur me resurse njerëzore e natyrore, me traditë në kultivim të artizanateve, procesim të prodhimeve ushqimore, tregti e industri përpunuese. • Peja, qytet tërheqës kulturor për vizitorë dhe investitorë potencial, afërsi me Bjeshkët e Nemuna si park nacional. • Trashëgimi kulturor e historike, potenciale për zhvillimin e turizmit, • Lidhjet e mira rrugore me tregjet kosovare dhe shtete fqinje Mal të Zi e më tej Adriatik • Fakulteti i Biznesit në Pejë, • Përfshirja e diasporës në përpjekjet për ZHEL, • Burime të mjaftueshme uji (pije, sistem të ujitjes, hidroenergjia) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shkallë e lartë e papunësisë, • Humbja e tokës bujqësore, • Mungesë e planifikimit urban, • Ndërtim ilegal me shfrytëzim të pakontrolluar të resurseve, • Hekurudha joaktive, • Moskoordinim institucional ndërmjet qeverisë lokale dhe komunitetit të biznesit, me komunat fqinje administrim i dobët lokal, • Ekonomia joformale,

3.2.7.6.4. Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Portokalltë

Konfliktet


- Zhvillimet potenciale në konflikt me mbrojtjen e tokës bujqësore, mjedisin.
- Degradimi i trashëgimisë kulturo-historike në konflikt me zhvillimin e turizmit

Sinergjitë


- Hartimi i planeve zhvillimore ndihmon shfrytëzimin racional të hapësirave,
- Promovimi i trashëgimisë kulturore ndihmon zhvillimin e turizmit, ZHEL, ZHEK, mbrojtjen e trashëgimisë kulturo-historike, ruajtjen dhe kultivimin e zejeve tradicionale, mbrojtjen e mjedisit,
- Ndërtimi rrugëve transitore për rreth qyteteve, shkarkojnë trafikun urban, ndotja është më e vogël e ajrit në brendi të qytetit, shkurton kohën e transportit ndër urban, shtytje për rregullimin e transportit publik.
- Investimet në Bjeshkët e Nemuna, hidrocentrale të vogla ndihmojnë zhvillimin e turizmit, ZHEL, ZHEK, mbrojtjen e mjedisit.
- Planifikimi i korridoreve rrugore në sinergji me mbrojtjen e tokës bujqësore
- Ndërtimi i hidrocentraleve në Bjeshkët e Nemuna në sinergji me zhvillimin ekonomik lokal.

Zonat hapësinore në zonën e portokalltë me interes të veçantë për Kosovën

- Zonat e kalimit kufitar (Kulla, Çakorr),
- Parku Nacional (Bjeshkët e Nemuna),
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike (Patriarkana e Pejës, Manastiri i Deçanit, Kullat Shqiptare)
- Mbrojtja e ujërave (Drini Bardhë, Lumëbardhi i Pejës), ujërat termalë.



► **Strategjia e Zhvillimit Hapësinor**



Legjenda

- Thesari i Kosovës- Hapësira e gjelbërt
- Port i Kosovës - Hapësira e kaltërt
- Kopshtet e Kosovës - Hapësira e portokalltë
- Urat e Kosovës-Hapësira e verdhë
- Parku Nacional i Sharrit
- Bjeshtët e Nemuna
- Trashëgimia kulturore-historike
- Toka bujqësore kualitative
- Vëndbanimet me pop. mbi 1000 banorë
- Qendrat e vogla
- Qendrat e mëdha
- Kryeqyteti, Prishtina
- Zonat kufitare
- Rrugët unazore
- Rrjeti rrugor
- Rrugët e propozuara për zgjerim dhe ngritje të kualitetit
- Rrugët e propozuara për ndërtim
- Propozim për lidhje me Malin e Zi -Koridor 6
- Autostrada Mercare-Durrës Varianti 1
- Alternativa "A" dhe "B" të Autostradës
- Rrjeti hekurudhor ekzistues
- Hekurudhat e reja të propozuar
- TZHEK-Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës
- Zonat ekonomike
- Aeroporti
- Stacionet Hekurudhore
- Administrata
- Arsimi i lartë
- Qendra Klinike Universitare
- Termocentrali
- Bazenet e lignitit
- Minerat
- Industria
- Bujqësia, agroindustria
- Vreshtaria
- Aktivete shërbyese-tregtare
- Trashëgimia kulturore
- Trashëgimia natyrore
- Shpella
- Turizëm malor
- Turizëm rekreativ
- Ujrat termal
- Blegoria
- Pentaria

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



4. STRATEGJIA, DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Strategjia paraqet pakon e përbërë nga politikat, masat, aktivitetet, projektet konkrete me anë të të cilave synohet të arrihen objektivat e përcaktuar brenda një afati të caktuar kohor. Në përbërjen strategjisë, janë edhe implikimet financiare që paraqesin burimet e mundshme financiare prej nga do të financohen aktivitetet dhe projektet për arritjen e objektivave. Përveç kësaj, strategjia përmban edhe kornizën institucionale e cila paraqet institucionet dhe të gjithë aktorët që janë përgjegjës dhe që mundësojnë realizimin e aktiviteteve dhe projekteve për arritjen e synimeve dhe objektivave.

4.1. VEPRIMET, AKTIVITETET E NEVOJSHME PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

4.1.1. ZHVILLIMI SOCIAL

Veprimet, aktivitetet për arritjen e objektivave të zhvillimit social janë në funksion të arritjes së objektivave që kryesisht kanë të bëjnë me zhvillimin e arsimit, shëndetësisë dhe përmirësimin e kualitetit të banimit.

4.1.1.1. Arsimi

Është e njohur dhe e pranuar edhe tek ne, se arsimi është njëri ndër shtytësit kryesor për sukses ekonomik dhe sukses në përgjithësi në shoqëritë moderne. Trendi në Evropë tregon se është në rritje interesimi për këtë sektor dhe se kushti për një ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm është edukimi i mirëfilltë i individit dhe shoqërisë. Arsimimi është gjithashtu i rëndësishëm për arritjen e zhvillimit të barabartë, të krijimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse ku të gjithë banorët kanë mundësi dhe iniciativë të marrin pjesë me tërë kapacitetin që kanë në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Më e rëndësishmja për suksesin e ardhshëm ekonomik dhe shoqëror është zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe kualitativ. Kjo do të duhej të kuptohet si pjesë e rëndësishme e strategjisë së zhvillimit hapësinor që do të ketë për synim përkrahjen në ngritjen e arsimit kualitativ në të gjithë territorin dhe arsimimit për të gjithë.

Edhe në Kosovë është e shprehur ndërlidhja e fuqishme e varfërisë me të arriturat e vogla në arsim. Përpjekjet për të siguruar mundësinë e arsimimit për të gjithë është me rëndësi të veçantë. Edhe pse shkalla e përfshirjes në arsimin e obligueshëm në Kosovë është gati universale, megjithatë ekzistojnë jobarazi të ndërlidhura me nivelet e të ardhurave. Në këtë pikëpamje, në arsimin e mesëm e të lartë hasen jobarazi të mëdha.

Deri më tani, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, është bërë shumë në rifillimin e aktiviteteve në të gjitha nivelet e arsimimit në Kosovë, mirëpo edhe shumë çështje mbesin për tu trajtuar.

Trendi i lëvizjes së popullatës pas vitit 1999 ka shkaktuar mungesë të hapësirës shkollore sidomos në zonat urbane edhe pse në përgjithësi në Kosovë mund të thuhet se hapësira shkollore është e pamjaftueshme.

Në mënyrë që të arrihen objektivat që kanë të bëjnë me zhvillimin e arsimit është e nevojshme të ndërmerren aktivitet si:

- Krijimi i hapësirave të reja shkollore posaçërisht në zonat urbane;
- Aplikimi i reformave në sistemin e arsimit në Kosovë;

- Vazhdimi i aftësisë të mësimdhënësve në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies;
- Pranimi i kuadrit të kualifikuar në institucionet arsimore me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Zbatimi i ligjeve;
- Arsimimi në mjedisin më të afërt për t'iu përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale;
- Krijimi i një partneriteti në mes të shkollave dhe komuniteteve;
- Krijimi i profileve të cilat mundësojnë punësimin pas përfundimit të mësimin;
- Zgjidhja e transportit për zonat e largëta;
- Avancimi i menaxhimit të shkollave;
- Krijimi i ambienteve të sigurta dhe funksionale;
- Hartimi dhe zbatimi i një politike arsimore bashkëkohore, gjithëpërfshirëse, plotësimi me legjisllacionin përkatës, avancimi në menaxhim dhe koordinim;
- Ngritja e kapaciteteve për punë kërkimore-shkencore, infrastrukture e plotë dhe funksionale;
- Mbështetja e universitetit publik për të bashkëpunuar me institucionet tjera në rajon;
- Shpërndarja adekuatë - hapja e degëve në qendrat tjera të arsimit profesional dhe arsimit të lartë qoftë atë publik, qoftë atë privat

4.1.1.2. Shëndetësia

Gjendja e sotme e sektorit të shëndetësisë në Kosovë nuk kënaqë. Përmirësimi i kësaj gjendjeje është nevojë e ngutshme dhe në mënyrë që kjo të ndodhë, duhet të ndërmerren aktivitetet si:

- **Decentralizimi i financimit të kujdesit primar shëndetësor nëpër komuna** - Kapaciteti i komunave do të duhet të forcohet, për tu siguruar se mund të veprojnë me përgjegjësitë e menaxhimit financiar dhe të zvogëlojë çfarëdo rreziku që pengon ofrimin e shërbimeve.
- **Ristrukturimi i sistemit të ofrimit të shërbimeve** - Ekzistojnë tri produkte në sistemin e ofrimit të shërbimeve: njerëzit, ndërtesat, pajisjet dhe barërat. Si shtylla të efektshmërisë dhe kualitetit, duhet të përdoren që të tria në të njëjtën kohë dhe të ndikojnë në mënyrë të volitshme në sistemin shëndetësor dhe së fundi në shëndetin e popullatës.
- **Njerëzit** - Duhet punuar në planifikim të burimeve financiare njerëzore (shkalla e ulët e financimit ka bërë që shumë profesionistë ta braktisin mjekësinë dhe të merren me punë tjera), në shfrytëzimin e burimeve ekzistuese humane (një pjesë e kuadrit profesional shëndetësor të hapësirave rurale u punësua në qendrat urbane, kështu që qasja në shërbimet shëndetësore në këto hapësira u vështirësua), në ndërtimin e kapaciteteve në shumë nivele (mesatarja e raportit mjek/banor është ende shumë më e vogël se mesatarja evropiane), si dhe në rritjen e shkallës së aftësisë së mjekëve.
- **Ndërtesat dhe pajisjet** - Ende ka nevojë për investime kapitale për të sjellë objektet shëndetësore në standardet më të cilat do të mund të ofronin kujdes të kënaqshëm për popullatën. Duhet racionalizuar dhe riorganizuar hapësirën dhe shërbimet brenda ndërtesës me theks në zonat urbane (numri i shtretërve është shumë më i vogël krahasuar me mesataren evropiane), të eliminohet dyfishimi i shërbimeve, si dhe të rritet efektshmëria.
- **Përmirësimi i financimit për kujdesin shëndetësor** - Duhet të gjenden burime të qëndrueshme në mënyrë që të bëhet reduktimi i sasisë së shpenzimeve që pacientët paguajnë nga xhepi.





4.1.1.3. Gjendja jo e kënaqshme dhe qasja e vështirësuar në banim

Plani Hapësinor synon që secili të ketë mundësinë e sigurimit të një hapësire adekuate të banimit duke ofruar dhe mundësuar zgjedhje më të madhe dhe dallimet sociale në banim të zvogëlohen. Nevojat e banimit të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë duhet pranuar, duke përfshirë edhe ata me nevoja për banim të volitshëm (jo të shtrenjtë) apo ata me nevoja speciale, qoftë në zonat urbane apo rurale. Sigurimi i banimit duhet të përqendrohet në lokacione me infrastrukturë ekzistuese nëpër vendbanime në mënyrë që t'u promovohet qëndrueshmëria e zhvillimit dhe shfrytëzimit më të mirë të tokës së urbanizuar. Dizajni i banimit të ri duhet të jetë bashkëkohor dhe të mundësojë rigjenerimin urban të vendbanimeve tona të degraduara dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Aktivitetet kryesore me të cilat tentohet të avancohet banimi në Kosovë janë:

- Kompletimi i kornizës ligjore, institucionale, ekonomike dhe skemave të ndryshme të banimit si dhe të propozohen masat adekuate për të përmirësuar gjendjen jo të volitshme të banimit në Kosovë.
- Problemet e mëdha siç janë numri i madh i të papunëve, të ardhurat e ulëta, çmimet e larta të banesave dhe qirasë, e theksojnë domosdoshmërinë e krijimit të mekanizmave dhe angazhimit të institucioneve lokale dhe qendrore për ofrimin e kushteve për banim adekuat.

Më poshtë janë grupuar aktivitetet sipas disa kategorive si: institucionale, sociale, financiare dhe hapësinore.

Institucionale

- Vlerësimi i nevojave dhe kapacitetit urban për banim;
- Identifikimi i zonave dhe vendeve;
- Alokimi dhe lirimi i tokës për zhvillimin e banimit;
- Shfrytëzimi i fuqisë për blerje të dhunshme - (eksproprijim) të tokës për komasacion.

Sociale

- Krijimi i komuniteteve të përziera - ndikimi në lloj dhe madhësi të banimit;
- Ofrimi i banimit të volitshëm (jo të shtrenjtë);
- Monitorimi i banimit të volitshëm.

Financiare

- Krijimi i Partneriteti konstruktiv në mes të sektorit publik dhe privat;
- Krijimi i fondeve për zhvillimin e banimit;
- Krijimi i fondit të banimit nga niveli qeveritar;
- Promovimi dhe sigurimi i banimit me qira të subvencionuar dhe joprofitabile.

Hapësinore

- Krijimi i mjediseve të qëndrueshme të banimit
- Shfrytëzimi më i mirë i tokës
- Ndërlidhja e zhvillimit me transportin publik
- Ridestinimi i zonave të punës dhe funksioneve tjera për funksionin e banimit
- Promovimi i zhvillimit me destinim të përzier
- Gjelbërimi në zonat e banimit
- Disejnimi cilësor

4.1.2. ZHVILLIMI EKONOMIK

Objektivat e përcaktuar për zhvillimin ekonomik të Kosovës kanë të bëjnë me krijimin e një mjedisi atraktiv për investitorë, avancimin e teknologjisë prodhuese, ngritjen e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale, krijimin e vendeve të mjaftueshme të punës, uljen e varfërisë dhe dhënien e përparësisë për zhvillim trevave më pak të zhvilluara. Për arritjen e këtyre objektivave është e nevojshme të ndërmerren aktivitete të caktuara. Këto aktivitete janë ndarë sipas çështjeve apo problemeve të caktuara të cilat, të gjitha në mënyrën e vet kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik. Këto çështje janë: papunësia e lartë, shkalla e lartë e varfërisë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, kualiteti i zhvillimit në zonat urbane, vendbanimet me zhvillim të pamjaftueshëm, energjetika, vendbanimet joformale, humbja e tokës bujqësore, rritja e fondit blegtoral, zhvillimi i vreshtarisë dhe depopullimi i vendbanimeve.

4.1.2.1. Papunësia e lartë

Me qëllim të arritjes së objektivit për uljen e papunësisë duke krijuar vende të reja të punës, sidomos në komunat ku papunësia është më e lartë, është e nevojshme të ndërmerren aktivitetet si:

- Duhet të organizohen trajnime profesionale për grupe specifike (gra, të rinj, etj.) duke i kushtuar rëndësi kërkesave të tregut të punës; krijimi i vendeve të lira të punës duhet të jetë në fokus të krijuesve të politikave dhe strategjisë së zhvillimit.
- Qeveria dhe organet komunale duhet të hartojnë strategjinë e punësimit dhe të vlerësojnë se në çfarë mase, politikat ekonomike ekzistuese janë në përputhshmëri me këtë qëllim primar.
- Ngritja e nivelit të kuadrit dhe kompensimi i tij adekuat, zhvillimi i politikave të mirëfillta sidomos në bujqësi, krijimi i kushteve më të favorshme në zona rurale, ripërtëritja e kapaciteteve industriale
- Privatizimi, kushte më të mira për kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - (NVM-të) dhe bizneset familjare, lansimi i një programi atraktiv për tërheqjen e investimeve të jashtme, eliminimin e pengesave në tregti me vendet fqinje etj.
- Organet komunale të krijojnë sistemin informativ me të dhëna të sakta mbi trendët e punësimit-papunësisë dhe informatat mbi tregun e punës.

4.1.2.2. Shkalla e lartë e varfërisë

Veprimet, aktivitetet që duhet të ndërmerren në tentim të uljes së shkallës së varfërisë me theks të veçantë në zonat rurale e sidomos në zonat e caktuara si zona me shkallë të lartë të varfërisë - zona veriore dhe qendrore e Kosovës janë:

- Të përkrahët programet politike që përshpejtojnë zhvillimin e përgjithshëm të Kosovës
- Promovimi i zhvillimit më të madh ekonomik.
- Përmirësimi i infrastrukturës
- Përmirësimi i qasjes në arsim dhe trajnim.
- Zbatimi i standardeve.
- Gjatë hartimit të politikave zhvillimore, qeveria dhe institucionet përkatëse duhet që problemin e varfërisë ta trajtojnë urgjentisht.
- Rritja e kontributit të sektorit privat në zhvillimin e përgjithshëm, krijimi i politikave për zhvillimin dhe stimulimin e sektorit të bujqësisë.
- Rritja e kohezionit social duke forcuar unifikimin e sistemit të kujdesit social dhe reduktimin e çështjeve që forcojnë pabarazitë gjinore, etnike dhe të moshës për të gjithë territorin e Kosovës.
- Përmirësimi i efikasitetit dhe drejtësisë së shpenzimeve të shëndetësisë publike me racionalizimin e përdorimit të barnave, adresim të çështjeve të personelit, rregullimit të sektorit privat, dhe luftimit të korrupsionit.
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, sa më afër popullatës do të ndihmonte në ngritjen e standardit jetësor.
- Ofrimi i mundësive dhe kushteve më të mira për arsimim do të ndihmojë në përgatitjen profesionale të të rinjve në lëmi specifike sipas kërkesave të tregut të punës.
- Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet barazisë gjinore dhe fuqizimit të femrës dhe të rinjve duke i arsimuar dhe përgatitur për punë profesionale.
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike (rrugë, kanalizime, ujësjellësi, telekomunikimet etj.) kryesisht në hapësira rurale do të ndikojë shumë në uljen e shkallës së varfërisë etj.



4.1.2.3. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik

Zonat e komunave të Malishevës, Drenasit (Glogocit), Skenderajt, Shtimes, Vitisë, Kaçanikut, Klinës dhe Sharrit (Dragashit) janë identifikuar si zona që janë më prapa sa i përket zhvillimit ekonomik. Dhënia e përparësisë për zhvillim ekonomik zonave më pak të zhvilluara në mënyrë që të arrihet një zhvillim më i balancuar i trevave të Kosovës, është një prej objektivave të përcaktuar me këtë plan hapësinor. Me qëllim që kjo të arrihet duhet:

- Të veprohet me qëllim që gjendja e tanishme e zhvillimit të pabarabartë ekonomik të orientohet drejtë zhvillimit të balancuar.
- Duke i realizuar prioritetet zhvillimore të sektorëve të ndryshëm të qeverisë, që janë pjesë e strategjisë për zhvillimin e infrastrukturës fizike, ndikohet në mënyrë direkte që të përmirësohet gjendja në zonat me zhvillimin ekonomik të ulët.
- Asfaltimi i rrugëve dhe rrjeti funksional i hekurudhës do të ndikojë në fuqizimin dhe shkurtimin e lidhjeve midis vendbanimeve e kjo mundëson qarkullim më të madh të mallrave dhe njerëzve dhe në mënyrë indirekte do të ndikohet në zbutjen e migrimit drejtë zonave më të zhvilluara.
- Shtimi i prodhimit të energjisë do të ndikojë në zhvillim ekonomik, duke krijuar kështu një mjedis të sigurt për investime në ngritjen e kapaciteteve ekonomike.
- Me qëllim të rritjes së llojeve dhe kualitetit të shërbimeve të telekomunikimeve në Kosovë duhet të fokusohemi në zhvillimin e teknologjisë informative dhe komunikuese, në modernizimin e shërbimeve telefonike - fikse dhe mobile, shtrirjen e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve më të mira të Internetit etj.

4.1.2.4. Kualiteti i zhvillimit në zonat urbane

Sot nuk mund të thuhet se në Kosovë zonat urbane kanë një kualitet të lartë të zhvillimit. Ngritjen e këtij kualiteti, në radhë të parë do ta mundësonte zhvillimi i infrastrukturës teknike, prandaj me qëllim që të avancohet infrastruktura teknike në këto zona është e nevojshme:

- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me energji elektrike me ndihmën e kapaciteteve të reja do të ndikojë pozitivisht si në kualitetin e jetesës ashtu edhe në krijimin e një mjedisi atraktiv për investitorët e ndryshëm.
- Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugëve të reja do të krijonte lidhje më të mira midis vendbanimeve.
- Ndërtimi i unazave përreth zonave kryesore urbane do të zbusin qarkullimin dhe trafikun brendaurban.
- Zhvillimi i rrjetit hekurudhor e rritë mundësinë e komunikimit të mes qyteteve duke ndikuar në shkarkimin e trafikut rrugor dhe do të mundësoj lidhjet më funksionale tregtare brenda dhe jashtë vendit.
- Akumulimet e reja ujore do të mundësojnë furnizim më të mirë me ujë të zonave urbane në të cilat shtrihet funksioni i këtyre akumulimeve.
- Mbulimi i zonës me shërbime të telefonisë fikse dhe mobile.
- Shtrirja e rrjetit të Internetit dhe qasja në të për të gjithë.



4.1.2.5. Vendbanimet me zhvillim të pamjaftueshëm

Zhvillimi i pamjaftueshëm konsiston kryesisht në mungesat sa u përket infrastrukturës sociale dhe teknike në këto vendbanime. Aktivitetet që duhet të ndërmerren për ngritjen e nivelit të zhvillimit të këtyre infrastrukturave janë në funksion të arritjes së synimit për një zhvillim të balancuar të trevave të Kosovës. Aktivitetet janë:

- Përpjekjet më të mëdha për zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara. Komunitetet e Skenderajt, Drenasit, Malishevës, Shtimes, Vitisë, Klinës, Kaçanikut, Shtërpçës, Novobërdës dhe Sharrit duhet të kenë përparësi në investimet qeveritare për ngritjen e kapaciteteve të reja të infrastrukturës sociale dhe teknike dhe riaktivizimin e kapaciteteve ekzistuese ekonomike;
- Të stimulohet bujqësia dhe blegtoria në mënyrë që të ulët edhe shkalla e migrimit prej fshatrave në qytete;
- Në aspektin e zhvillimit të infrastrukturës sociale duhet të ndërtohen shkolla dhe punkte shëndetësore të reja, shpërndarja e tyre të jetë adekuate dhe të përmirësohet infrastruktura shkollore dhe shëndetësore, kurse shërbimet të zgjerohen edhe në ato specialistike të mundshme për këto komuna;
- Në aspektin e infrastrukturës teknike, në këto zona do të duhej të investohet në asfaltimin e rrugëve, në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike, vendosjen e trafostacioneve të reja për përmirësimin e tensionit të rrymës elektrike, në zhvillimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, në zhvillimin e sistemeve të ujitjes, në rrjetin e telefoninë fikse dhe të Internetit;

4.1.2.6. Energjetika

Zhvillimi i sektorit të energjetikës është jetik për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Masat që do t'i ndërmerr Qeveria e Kosovës në këtë drejtim janë:

- Ekspertiza ku do të jenë të angazhuar ekspertët e jashtëm dhe tërheqja e investimeve të jashtme
- Gjetja e investitorit dhe e ndërtuesit të termoelektranës së re „Kosova e Re” me kapacitet prej 1000 MË;
- Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë, siç është caktuar nga ‘Task Force’ për Efiçencë të Energjisë i Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE);
- Transpozimi i Direktivës së BE-së për Shërbime të Energjisë në ligjin dhe rregulloret vendore gjatë periudhës 2009-2010;
- Plotësimi i kornizave ekzistuese ligjore dhe rregullatore për efiçencën e energjisë dhe burimeve të ripërtërishme në pajtim me kërkesat e TKE-së, përfshirë Ligjin për Efiçencë të Energjisë;
- Përcaktimi dhe miratimi i strategjisë për sektorin e ngrohjes, bazuar në Studimin e tregut të ngrohjes në Kosovë (2007), përfshirë opsionin e lidhjes së sistemit të ngrohjes qendrore të Prishtinës me TC Kosova B;
- Rishikimi i politikave ekzistuese dhe miratimi i masave stimuluese të cilat do të përkrahin zhvillimin e sektorit të burimeve të ripërtërishme;
- Dhënja me koncesion e ndërtimit të Hidrocentralit të Zhurit, pasi ai t'i nënshtrohet studimeve të pranueshme të fizibilitetit, të masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale dhe të kalojë në procesin e konsultimeve publike;
- Identifikimi dhe vlerësimi gjatë viteve 2009 dhe 2010 i hidro-potencialëve tjerë të vogla që ekzistojnë në Kosovë;
- Dhënja, deri në fund të vitit 2011, me koncesion investitorëve privatë ndërtimin e të gjitha hidrocentraleve të vogla të identifikuar dhe që do të identifikohen gjatë 2009-2010 përmes një procesi transparent dhe konkurrues të tenderimit;
- Zhvillimi dhe fuqizimi, deri në fund të vitit 2009, i masave stimuluese fiskale për promovimin e efiçencës së energjisë dhe teknologjive të energjisë së ripërtërishme;
- Zhvillimi, deri në fund të vitit 2010, i një programi gjithëpërfshirës për promovimin e investimeve private në projekte të efiçencës së energjisë dhe energjisë së ripërtërishme

Sipas dispozitave të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, Kosova është zotuar në rritjen e pjesës së energjisë të përfituar nga burimet e ripërtërishme në portofolion e saj të gjenerimit. Qeveria ka vendosur një cak për Kosovën e ky është që energjia elektrike që prodhohet duke shfrytëzuar burimet e ripërtërishme, deri në vitin 2016 të marr pjesë me 7% në totalin e



energjisë elektrike të prodhuar. Përbushja e parashikimeve për prodhimin e energjisë nga BRE përbën objektiv afatgjatë që lidhet edhe me respektimin e detyrimeve të TKE-se. Rritja e Eficiencës së Energjisë dhe shfrytëzimi i Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme do të kontribuojnë në realizimin e tri qëllimeve të politikës energjetike të vendit: mbështetjes për rritjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit.

4.1.2.7. Vendbanimet joformale

Ndër problemet thelbësore të vendbanimeve në Kosovë është organizimi i dobët i vendbanimeve. Vendbanimet joformale, në mungesë të planeve zhvillimore urbane dhe komunale, po zhvillohen në mënyrë të paorganizuar në aspektin hapësinor. Këto vendbanime janë duke u zhvilluar në zonat urbane, periurbane dhe rurale dhe në afërsi të magjistraleve. Disa prej këtyre vendbanimeve janë zhvilluar në tokat bujqësore, duke përfshirë këtu edhe ndërtimet pa leje përgjatë brezave rrugorë. Këto vendbanime nuk kanë fare qasje, ose kanë qasje ilegale në infrastrukturën fizike dhe shërbimet që lidhen me këtë infrastrukturë. Vendbanimet joformale gjithashtu karakterizohen edhe me zotërim jo të sigurt të pronës, dhe pjesëmarrje joadekuata ose mos pjesëmarrje në qeverisje. Këto vendbanime gjithashtu karakterizohen me objektet që lidhen me infrastrukturën sociale siç janë punktet shëndetësore, shkollat, çerdhet etj

Vendbanimet jo të organizuara mirë janë zhvilluar në tokat bujqësore I- IV, në afërsi të magjistraleve sidomos korridoreve të zhvillimit, në zonat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, në afërsi të zonave ku ndotja është mjaft e shprehur. etj

Është nevojë e kohës që vendbanimet joformale të trajtohen dhe të rregullohen. Rregullimi i tyre është në funksion të arritjes së objektivave për uljen e shkallës së varfërisë dhe zhvillimin e balancuar të zonave të ndryshme. Për këtë janë të nevojshme aktivitetet si:


- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në qytetet e Kosovës.
- Parandalimi i menjëhershëm i zhvillimit të vendbanimeve joformale dhe ndërtimeve ilegale
- Përgatitja e udhëzuesve për rregullimin e vendbanimeve joformale dhe ndërtimeve ilegale (udhëzuesit të përgatiten nga niveli qendror)
- Parandalimi i ndërtimit në tokat e kategorive I - IV
- Rregullimi i vendbanimeve joformale duke ofruar infrastrukturën teknike dhe sociale, zgjidhja e çështjeve pronësore si dhe mundësimi i pjesëmarrjes në qeverisje.

4.1.2.8. Ndërtimet pa leje

Pas luftës së vitit 1999, Kosova po kalon në një proces tranzicioni, drejt një demokracie parlamentare. Krahas përgjegjësisë tjera të nivelit qendror dhe lokal është dhe menaxhimi në fushën e planifikimit hapësinor, urban dhe të ndërtimit. Periudha prej një decenie dëshmoi se menaxhimi në fushat e lartpërmendura nuk ishte i nivelit të dëshiruar. Sa i përket planifikimit hapësinor e urban, munguan planet, kurse sa i përket ndërtimit, ndodhën ndërtimet pa leje. Këto të fundit, në këtë periudhë të pas luftës u shtuan në mënyrë rapide duke u bërë kështu dukuri shumë shqetësuese për shoqërinë kosovare.

Shkaktarët e ndërtimeve pa leje janë:

- Lëvizjet e popullsisë drejt zonave më të zhvilluara
- Nevoja e popullsisë për ndërtim dhe strehim
- Moszbatimi i legjislacionit përfshirë këtu mos-hartimin e planeve hapësinore planeve zhvillimore urbane dhe planeve rregullative (për pjesën më të madhe të vendbanimeve të Kosovës) si dhe mungesën e monitorimit dhe zbatimit të mekanizmave nga organet përgjegjëse qendrore dhe komunale
- Mungesa e vullnetit politik për ndërprerjen e ndërtimeve ilegale
- Ndërlkueshmëria e procedurave administrative për lëshimin e lejes ndërtimore
- Mungesa e respektimit të afateve kohore të organeve komunale për dhënjen e lejeve urbanistike dhe ndërtimore



Përgjegjësitë

Ndërprerja e dukurisë së ndërtimeve pa leje si dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese në një raport gjithëpërfshirës, është nevojë urgjente dhe përgjegjësi e institucioneve të Kosovës në nivel qendror dhe lokal.

Rekomandimet

Trajtimi i problemit të ndërtimeve pa leje kërkon një qasje shumëdimensionale, me përfshirje të sektorëve tjerë relevant krahas sektorit të planifikimit, ndërtimit dhe banimit. Masat që duhet të ndërmerren janë:

- Të gjitha komunat në afat të përcaktuar me ligjin përkatës, duhet t'i hartojnë raportet lidhur me gjendjen e objekteve pa leje. Raporti duhet të përmbajë listën e objekteve ilegale sipas destinimit, kategorizimin e tyre sipas pronësisë së tokës në të cilën janë ndërtuar dhe historikun e secilit prej tyre (a është kërkuar leja për të apo jo, pse nuk është dhënë leja etj.)
- Funkcionalizimi i inspektorateve ndërtimore
- Arritja e marrëveshjes se gjere politike dhe aprovimi i ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje
- Krijimi i kushteve për të ngritur dhe zhvilluar kuadro të aftësuar profesionalë.
- Reformimi i procedurave për lëshimin e lejeve ndërtimore
- Zvogëlimi i ndikimeve politike
- Stimulimi i zhvillimit rural me qëllim të zvogëlimit të migrimit të qytetareve në zonat urbane
- Përkushtimi i organeve komunale për përfundimin e planeve hapësinore dhe urbanistike
- Organizimi i fushatës për sensibilizimin e organeve përgjegjëse komunale për rëndësinë e hartimit të PZHK dhe PZHU, në funksion të përshpejtimit të hartimit të planeve
- Angazhimi i sektorit të planifikimit në funksion të ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e planifikimit hapësinor.

4.1.2.9. Humbja e tokës bujqësore

Zvogëlimi i vazhdueshëm deri te humbja e tokës kualitative bujqësore nga zhvillime aktuale të paplanifikuara dhe të pakontrolluara janë rezultat i mungesës së planeve zhvillimore urbane dhe mbrojtjes institucionale përmes politikave adekuate të Qeverisë së Kosovës.

Bazuar në këto zhvillime, sektori i bujqësisë rrezikohet me:

- Zvogëlimin e sipërfaqeve të tokave kualitative bujqësore (ndërrim i destinimit të tokës bujqësore-shfrytëzimi i saj për qëllime tjera);
- Mosinteresimin e fermerëve për punimin e tokës dhe aktivitete të tjera bujqësore për shkak të politikave jo të volitshme dhe kostos së lartë të prodhimit;
- Ndërtimet mbi tokat bujqësore dhe atyre nën skemën e ujitjes së menaxhuar.

Me moton "Ti mbrojmë tokat bujqësore sa më tepër në mënyrë që ti shfrytëzojmë sa më mirë" do të ecet drejt arritjes së objektivit për ngritjen e prodhimit të tokës bujqësore. Në funksion të arritjes së këtij objekti janë: mbrojtja me ligj e tokës kualitative bujqësore të kategorisë 1-4, konsolidimi i tokës bujqësore, krijimi i një fondi të qëndrueshëm blegtoral, zhvillimi i sektorit të vreshtarisë, zhvillimi i sektorit të pemëtarisë.

4.1.2.9.1. Mbrojtja me ligj e tokës kualitative bujqësore të kategorisë 1-4**Aktivitetet**


- Me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve (me planet urbanistike), të mbrohet toka sidomos kategoria e I,II,III,IV, në harmoni mbi Ligjin për tokat bujqësore si dhe kategoritë tjera të tokës të cilat janë nën sistem të ujitjes.
- Objektet e ndërtuara dhe infrastruktura tjetër në kategoritë e tokave të cilat janë të mbrojtura me ligj, të mos legalizohen (të rrënohen).

- Komiteti bashkërendues për administrimin e tokave, duhet të sigurojë korniza për administrimin e tokës bazuar në parimet e drejtës së këmbimit të pronës dhe praktikës së mirë për të përkrahur zhvillim të qëndrueshëm dhe ekonomik. Ky grup duhet të këshillojë dhe përgatisë udhëzime politike për menaxhimin e tokave bujqësore, ujitjes e kullimit, prodhimit bujqësor dhe të kafshëve, pyjeve dhe pjesëmarrje në aktivitetet e mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndotësit e çfarëdo natyre.
- Zonimi i tokave kualitative bujqësore 1-4, ka rëndësi të veçantë sepse kufizon shfrytëzimin e tokave të tilla vetëm për prodhimtari bujqësore, që ndikon në rritjen e rendimentit të prodhimeve bujqësore për njësi të sipërfaqes.
- Mos legalizimi i objekteve dhe infrastrukturës së ndërtuar në kundërshtim me ligjin për tokat bujqësore 21/84
- Krijimi i fondit për ripërtëritjen e tokës bujqësore - për të rritur sipërfaqen e tokës bujqësore për kokë të banorit në vendin tonë, të gjitha tokat bujqësore të cilave ju ka ndryshuar destinimi, pronari do të duhej të paguaj një taksë të caktuar e cila do të derdhej në një fond, qëllimi i të cilit është krijimi i tokave të reja bujqësore dhe përmirësimin e tokave me potencial të ulët prodhues.

4.1.2.9.2. Konsolidimi i tokës bujqësore

Me konsolidimin e tokës arrihet grupimi i ngastrave të shkapërderdhura në një sipërfaqe më të madhe. Aktivitetet në funksion të kësaj janë:

- Matjet e reja të tokës,
- Formësimi i ri i ngastrave më mënyrë të rregullt gjeometrike,
- Rregullimi i ri i marrëdhënieve pronësore-juridike,
- Krijimi i kadastrit të ri të tokës,
- Qasje në rrugë, shfrytëzim më të mirë të mekanizimit bujqësor dhe rritje të rendimentit të prodhimtarisë bujqësore për njësi të sipërfaqes
- Urbanizimi i fshatrave me të gjithë infrastrukturën përcjellëse




4.1.2.10. Krijimi i një fondi të qëndrueshëm blegtoral

Aktualisht ekzistojnë tendenca për kalim nga sistemi i ekonomive të vogla fermere (që do të vazhdojnë të ekzistojnë kryesisht nëpër fshatrat që ndodhen në viset malore), në ferma të mesme dhe të mëdha komerciale me kushte intezive të rritjes (me 25-50 krerë lopë qumështore dhe 30-60 ha, që do të zhvillohen në ultësirat me tokë më pjellore) me bazë gjenetike të prodhimitarisë së lartë. Ndryshimet pozitive në fondin blegtoral, janë të kushtëzuara nga ndryshimet e strukturave foragjere dhe bazës ushqyese në përgjithësi.

Aktivitetet

- Krijimi i komplekseve të fermave të mëdha, ndërtimi i objekteve dhe infrastruktura blegtorale duhet të jetë në harmoni me dispozitat ligjore të ligjeve përkatëse për planifikim hapësinor;
- Sigurimi i ushqimit: Ruajtja e mundësive ekonomike të Kosovës që të shfrytëzojë efektivisht resurset e veta rurale për të zvogëluar nevojën e importit të ushqimit dhe ushqimit të kafshëve;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale sipas kriterëve të ekonomisë së tregut;
- Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e ligjit dhe mbështetjen e fermerëve
- Privatizimi i aseteve;
- Mbështetja e fermerëve komercialë përmes kredive preferenciale;
- Zhvillimi i agropërpunimit;
- Krijimi i mundësive për punësim të popullatës rurale me qëllim të parandalimit e migrimit



► Rajonalizim i komunave në bazë të potencialeve të zhvillimit të bujqësisë me anë të sektorit profitabil - blegtorisë (kullosave dhe livadheve në ha - sipas të dhënave kadastrale),





4.1.2.11. Zhvillimi i sektorëve të vreshtarisë dhe pemëtarisë

Mbrojtja e sipërfaqeve të përshtatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit, mbjellja e saj në sipërfaqe deri në 7000 ha, sidomos në rajonin vreshtar të Kosovës dhe mbjellja e fidanëve frutorë në sipërfaqe deri në 10000 ha gjatë periudhës së ardhshme dhjetëvjeçare janë disa nga aktivitetet në funksion të arritjes së objektivit për rritjen e prodhimit të bujqësorë. Prodhimi dhe eksportimi i verës është një biznes i rëndësishëm për Kosovën.



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



4.1.2.12. Depopullimi i vendbanimeve

Fenomeni i depopullimit të një numri të vendbanimeve të Kosovës është pasojë e zhvillimit të pamjaftueshëm ekonomik në ato vendbanime, prandaj përpjekjet duhet të orientohen në krijimin e kushteve që ato vendbanime të mos braktisen. Aktivitetet që duhet të ndërmerren në funksion të krijimit të këtyre kushteve e që njëkohësisht janë edhe në funksion të arritjes së objektivit për zhvillimin e trevave më pak të zhvilluara janë:

- Popullsia e këtyre vendbanimeve të stimulohet me krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira;
- Mundësitë për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në mjete teknike, duke ndikuar në hapjen e vendeve të reja të punës, sidomos në bujqësi;
- Lehtësime në shkollimin e të rinjve, përmirësimin e shërbimeve shëndetësore;
- Përmirësimin e infrastrukturës teknike (rrugët, ujësjellësi, kanalizimi, energjia etj.);
- Mbrojtja dhe menaxhimi më i mirë i resurseve natyrore

4.1.3. RUAJTJA DHE MBROJTJA E MJEDISIT, RESURSEVE NATYRORE DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Plani Hapësinor i Kosovës i ka përcaktuar disa objektiva që kanë të bëjnë me mjedisin, resurset natyrore dhe trashëgiminë kulturore si: ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit (ajrit, ujit dhe tokës) nga ndotja dhe degradimi, ruajtja, mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore (mbitokësore dhe nëntokësore) dhe ruajtja, mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. Me qëllim të arritjes së këtyre objektivave është e nevojshme të ndërmerren veprime, aktivitete të caktuara. Këto aktivitete janë ndarë sipas objektivave të cilave u dedikohen.

4.1.3.1. Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe degradimi

Aktivitetet për arritjen e këtij objektivi janë:

Uji


- Ndalimi me ligj i nxjerrjes së inerteve nga shtretërit e lumenjve, nga operator të pa licencuar.
- Ndalimi i hedhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve.
- Standardizimi i deponive.
- Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në bujqësi të jetë konform standardeve për minimizimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Të sigurohet mbrojtje më efikase në deponitë e materieve të rrezikshme që mund të shkaktojnë katastrofa në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Çdo objekt industrial apo lloj veprimtarie industriale, minierë, mihje sipërfaqësore, duhet të ndërtojë impiantet industriale në bazë të veprimtarisë ekonomike dhe të bëjë pastrimin kimik dhe biologjik të ujërave dhe të lirojë ujëra të pastra në ujërrjedhje.
- Të ndërtohen impiantet për pastrimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve.
- Në pikat ku paraqitet nevoja për mënjanimin e depozitimeve të inerteve të punohet në mënyrë profesionale.
- Ndalimi i çdo aktiviteti mekanik në shtretërit e lumenjve me makineri operuese.
- Të ndalohet larja e mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësore
- Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre nga të gjitha nivelet e qeverisjes.
- Ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e botës bimore dhe shtazore të lumenjve.
- Zbatimi i dënimeve rigorozë për ndotësit.
- Monitorimi i deponive legale dhe vlerësimi i gjendjes aktuale.
- Eliminimi i të gjitha deponive ilegale të cilat bëjnë ndotjen e ujërave
- Riparimi apo edhe ndërtimi i shtresave argjilore dhe kanaleve kulluese të deponive me qëllim të largimit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore.
- Pastrimi i Parkut Industrial të Mitrovicës është emergjent nga se nga ky park industrial ndotë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore me metale të rënda.
- Kontrolli strikt i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve në tokat bujqësore.

- Ndalimi i përdorimit të preparateve kimike pranë brigjeve lumore që janë të përcaktuara me ligj.
- Ndalimi i shkarkimit në ujëra i çdo substance kimike e biologjike që përdoret në bujqësi
- Sigurim, monitorim dhe mirëmbajtje e rregullt e deponive që kanë materie të rrezikshme e sidomos ato në Kompleksin Trepça, në KEK dhe Elez Han.
- Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza sipas të cilës çdo vendbanim duhet të ketë impiantin për trajtim të ujërave të zeza ose trajtim i centralizuar në shtatë qendra regjionale të ndërtohen impiantet


► Reduktimi i ndotjes së lumenjve sipas prioriteteve në etapa dhe nevoja e mbrojtjes:

Prioriteti	ITUZ	Emri i lumit	Kategoria	Etapa e parë		Etapa e dytë	Shtypja ndër.
				Trajtim primar	Trajtim terciar		
I	Prishtinë	Sitnica	IV	2007-2009	2010-2011	2013-2014	E lartë
II	Mitrovicë	Sitnica-Ibri	IV-III	2009-2010	2012-2013	2015-2016	E lartë
III	Prizren	D.i Bardhë	Klasa I-II	2008-2013	2012-2013	2014-2016	E ultë
IV	Peja	Bistrica	Klasa I-II	2009-2010	2013-2014	2016-2018	E ultë
V	Gjakova	Ereniku	Klasa I-II	2013-2015	2018-2019		E ultë
VI	Gjilani	Morava-Kriva reka	Klasa II	2014-2015	2017-2018	2020	E ultë
VII	Ferizaj	Nerodime - Lepenc	II-III	2016-2017	2018-2019	2020	E lartë


Burimi: Studimi mbi Strategjinë për trajtimin e ujërave të zeza, Projekt Raport Final-Ministria e punëve të jashtme të Finlandës-MMPH



Ajri dhe toka



- Respektimi i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit;
- Zbatimi i dispozitave ligjore për mbrojtjen e ushqimit nga rrezatimi jonizues;
- Definimi i vlerave të lejuara të ndotësve në ujë, ajër, tokë në përputhje me BE;
- Trajtimi i deponisë me mbeturina të rrezikshme në Trepçë;
- Rikultivimi dhe gjelbrimi i deponisë së hirit në KEK;
- Përdorimi i obligueshëm i automjeteve me katalizator;
- Rikultivimi i tokës pas përfundimit të eksplotimit të resurseve natyrore;
- Masat për mbrojtje nga erozioni;
- Ndërprerja e ndërtimeve ilegale në tokat (pjellore) bujqësore;
- Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe vlerave natyrore;
- Për të gjitha projektet e investuara të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis;
- Reduktimi i nevojave për djegjen e drurit përmes zgjidhjeve alternative;
- Menaxhimit i qëndrueshëm me pyje dhe resurse pyjore;
- Ndërprerja e prerjeve ilegale dhe shkatërrimit të pyjeve;
- Menxhimi i veprimtarive ekonomike që janë të dëmshme për mjedisin.
- Vendosja e mbeturinave në deponi dhe riciklimi i tyre.
- Pyllëzimi i 10.000 ha. sipërfaqe të zhveshura nga 1000 ha/vit.
- Nxerrja e Ligjit për Parkun Nacional "Mali Sharr" me sipërfaqe të përafërt prej 35.000 Ha.
- Zgjerimi i territorit të Parkut Nacional "Mali Sharr" në drejtim të Komunës së Dragashit (zgjerimi të bëhet në faza sipas planit të përcaktuar nga vlerësimi në terren me sip. të përafërt prej 30.000Ha);
- Pas përfundimit të vlerësimeve të nevojshme të bëhet shpallja e Parkut Nacional "Bjeshkët e Nemuna";
- Përcaktimi i zonave të pyjeve të virgjëra, rezerveteve pyjore dhe të gjuetisë.
- Mbrojtja e llojeve relikte dhe endemike të florës dhe faunës.
- Përkujdesje ndaj mjedisit nga ndërtimi dhe zhvillimi i zonave rekreative-turistike.
- Rehabilitimi i mjedisit jetësor në qendrat e ndotura urbane dhe në zonat industriale.
- Krijimi i unazave të gjelbërta perreth zonave me ndikim negativ mjedisor.



4.1.3.1.1. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni

Vërshimet

Me qëllim që zonat e rrezikuara nga vërshimet të vihen nën kontroll, MMPH gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e ujërave, në bashkëpunim me autoritet kompetente për ekonomi, financa, bujqësi, pylltari, tregti, industri, shërbime publike, komunikacion, transport, energji, zhvillim rural, banim, ndërtim dhe mbrojtje të natyrës duhet të përpilojnë: Planin për Administrimin e Përmbytjeve me të vetmin synim të minimizojnë pasojat apo edhe të zvogëlojnë përmbytjet. Për arritjen e kësaj janë të nevojshëm aktivitetet:

- Krijimi i regjistrit me bazën e të dhënave për prurjet e lumenjve.
- Pasqyra hartografike e zonave të rrezikuara përgjatë shtretërve dhe valës së përmbytjes të lumenjve me qëllim të monitorimit të përhershëm.

Sistemi i parashikimit dhe alarmimit të përmbytjeve

- Në nivel kombëtar të ngritët stafi profesional për parashikim, monitorim dhe alarmim të vazhdueshëm.
- Hartimi i planeve emergjentë për përmbytje nga institucionet përkatëse për menaxhim të krizave.


Parandalimi i efekteve negative nga përmbytjet me masa teknike paraprake.

- Të ndërmerren masa teknike në brigjet e lumenjve apo edhe në shtratin e lumit për të mënjeluar pengesat natyrore apo edhe ato të krijuara nga faktori njeri.

- Ndërtimi i brigjeve mbrojtëse në zonat ku shtrati nuk mundë ti pranoj të plotat, me ndërhyrje teknike (argjinatura me materiale natyrore, po edhe atyre me materiale të forta).
- Urbanizimi i brigjeve lumore, meliorimi i tyre dhe pyllëzimi si masë mbrojtëse.
- Mirëmbajtja e grykëderdhjeve me ndërhyrje sa ma natyrore.
- Ndalimi me ligj i shfrytëzimit të tokave bujqësore pran brigjeve lumore që ndikon në shkallën e rrezikshmërisë së përmytjeve
- Ndalimi i të gjitha veprimtarive ndërtimore pranë brigjeve lumore, përveç atyre objekteve që kanë karakter ekonomik (urat, pendët, kanalet e kullimit etj.) që nuk rrezikojnë ujërrjedhën nga të cilat mund të shkaktojnë përmytje.

Parandalimi i shkatërrimit të florës përgjatë brigjeve të trupave uhor, në përjashtim të atyre që ndikojnë negativisht.

- Ndalimi i shkatërrimit të florës përgjatë brigjeve lumore
- Mbjellja e llojeve drunore përgjatë brigjeve të lumenjve me qëllim të parandalimit të erozionit, përmytjeve po edhe si peizazh natyror, konform studimeve paraprake.
- Parandalimi i nxjerrjes së inerteve nga shtretërit e lumenjve.
- Rikthimi në gjendje të mëparshme i shtratit të lumit
- Ndalimi i ndërrimit të drejtimit të shtratit të lumit.



Koncepti i masave dhe punëve prioritare kundër vërshimeve Rregulimi hidrologjik

Legjenda	
	Liqene
	Pellgjet
	Siperfaqet e rrezikuara nga vërshimet
	Masat hidroteknike që duhet ndërmarrë
	Punët që duhet zhvilluar Prioriteti i parë
	Punët që duhet zhvilluar prioriteti i dytë
Lumenjë	



Erozioni

Rajonet, në të cilat erozioni ka intensitet të madh e që sjellin pasoja të dëmshme në ujërrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe palujtshmëri të tjera, duhet të shpallen zona erozive ku sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës i shpallë komuna.

Qeveria e Kosovës shpallë zonë erozive atëherë kur interesat e mëdha kombëtare janë të prekura nga erozioni dhe përpilon masa mbrojtëse.

Mbrojtja nga erozioni është synim dhe detyrë e të gjithë shfrytëzuesve, si atyre të tokave bujqësore, kodrinore-malore, pyjeve, ujërave dhe begative tjera të natyrës me qëllim të mbrojtjes së rrugëve, vendbanimeve, tokave bujqësore dhe të mirave tjera materiale.

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv duhet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
2. Ndalimi i mbikullotjes
3. Ndalimi i shfrytëzimit të të mirave materiale që shkaktojnë erozion

Veprimet antierozive

Për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike.

Masat hidroteknike

- Ndërtimi i tarracave, gardoneve dhe pendëve në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese;
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve sipas parandalues e gërryerjes;
- Mbjellja e fidanëve pyjore në shtretërit e lumenjve;
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve.

Masat bujqësore

- Të mirëmbahen tokat bujqësore;
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore;
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve;
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

Masat biologjike


- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
- Ndalimi i kullotjes në masivet e zhveshura dhe të varfra nga bimësia
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
- Krijimi i brezave të gjelbra në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
- Mbjellja e fidanëve përgjatë shtretërve të lumenjve, përrenjve dhe përroskave aty ku është aktiv erozioni.

Lokacionet prioritare ku duhet të ndërmerren masat antierozive:

- Në pellgun e lumit Ibër në rreth 947km² ose 23% e sipërfaqes së pellgut janë në shkallën e I,II, të rrezikshmërisë.
- Në pellgun e lumit Morava e Binçes në rreth 700km² ose rreth 41% u kanoset rreziku i shkallës I,II.
- Në Pellgun i Drinit të Bardhë në rreth 800km²ose 24% të sipërfaqja e pellgut u kanoset rreziku i shkallës së parë dhe dytë të erozionit dhe
- Në pellgun e lumit Lepenc në rreth 230km²ose 35% e sip. të pellgut u kanoset rreziku i shkallës së parë dhe dytë
- Intervenimet në hapësirë sipas shënimeve dhe të paraqitura në hartë duhen të bëhen në 2620km²që rrezikohen nga erozioni shumë i fortë dhe erozioni i fortë.
- Qeveritë komunale duhet ti shpallin zonat më të rrezikuara dhe të ndërmerren hapa konkret antieroziv në bashkëpunim me MMPH, MBPZHR, Agjencionin e pyjeve, MSHP, MEF etj.




Harta e antierozionit



Tërmetet

Nga harta e intensiteteve maksimale të pritshme në Kosovë, periudha e përsëritjes 500 vjet që duhet përdorur në projektimin e ndërtimeve masive në qytet e në fshat, siç rekomandon Eurokodi 8, rezulton se janë vetëm dy zona, dhe konkretisht zona Ferizaj-Viti-Gjilan dhe zona Kopaonik ku në të ardhmen mund të ndodhin tërmete me intensitet maksimal të pritshëm IX ballë MSK-64, ndërsa në gjithë pjesën tjetër të territorit të Kosovës priten tërmete me intensitet maksimal të pritshëm VIII ballë MSK-64.



► Harta e intensitetit sizmik, periudha e përsëritjes 500 vjet



Objektivat e Institutit Sizmologjik të Kosovës

- Të monitorojë aktivitetin sizmik të vendit si dhe të mbledhë, ruaj, përpunoj, analizoj dhe të botoj të dhënat sizmologjike që fitohen nëpërmjet të këtij rrjeti.
- Të njoftoj me urgjencë organet kompetente shtetërore, në rast se brenda territorit të Kosovës bien tërmete me Magnitudë ≥ 3.8
- Të shkëmbej të dhënat e rrjetit sizmologjik me institucionet e ngjashme në rajon, Evropë dhe Botë si dhe me Qendrat Ndërkombëtare Sizmologjike sipas detyrimeve të miratuara.
- Të kryej studime Sizmologjike dhe Sizmotektonike për njohjen sa më të thellë të aktivitetit sizmik e sizmicitetit të Kosovës dhe vlerësimin e rrezikut sizmik të saj.
- Të kryej studime Sizmologo-Inxhinierike si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Të kryej studime për vlerësimin e rrezikut sizmik në nivel lokal për qendrat e banuara, qytetet për qëllime të planifikimit fizik dhe urban në zonat sizmike.
- Të kryej studime të Inxhinierisë së tërmeteve lidhur me problemet e kodifikimit të parametrave të projektimit antisizmik në nivel të Kosovës, të vulnerabilitetit dhe riskut sizmik për qendrat të banuara ose vepra të veçanta, si dhe punime eksperimentale në këtë fushë.
- Përpilimi i hartës së rrezikut sizmik për Kosovën
- Hartimi projekteve për monitorimin sizmik të objekteve me rëndësi të veçantë (vendosja e akcelerometrave)
- Bashkërendimi aktiviteteve me institucionet kompetente në mënyrë që të respektohen masat adekuate për ndërtimet asizmike
 - Përfshirja e legjislacionit të ndërtimit, në mënyrë që shkalla e sizmicitetit të mirret zyrtarisht nga institucioni kompetent (ISK);
 - Marrja e shkallës së sizmicitetit për lokacionin e ndërtimit, ku aplikuesi duhet të paguaj taksë, e cila duhet të ketë vlerë të njëjtë me shtetet e regjionit.



► Shpërndarja e nxitimit maksimal në territorin e Kosovës për truall mesatar, periudha e perseritjes 500 vjet



4.1.3.2. Ruajtja, mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore

Objektivi është shfrytëzimi sa më racional i resurseve në mënyrë që ato të jenë të mjaftueshme dhe në shfrytëzim edhe për gjeneratat e ardhshme. Aktivitetet për arritjen e këtij objektivi janë:

- Të ndërpritet prerja e ilegale e pyjeve duke i futur nën regjimin e kontrolluar dhe sistematik të prerjes
- Aplikimi i kushtit: “një dru i prerë të zëvendësohet me dy tjerë të mbjellur”
- Zonimi dhe klasifikimi i sipërfaqeve në të cilat paraprakisht përcaktohet regjimi i prerjes
- Të përpilohet plani i ripërtëritjes së mihjeve të vjetra sipërfaqësore
- Të kushtëzohet ripërtëritja e tokës pas shfrytëzimit për qëllime të mihjeve të reja për nxjerrjen e thëngjillit
- Të ndërpritet çdo intervenim hapësinor në zonat me interes të veçantë për vendin
- Të hartohen plane për shfrytëzimin racional të hapësirave të shpallura si zona me vlera të trashëgimisë natyrore
- Të përpilohet plani i sanimit të deponive të mbetjeve industriale në kompleksin e Trepçës dhe mihjes sipërfaqësore të Obiliqit
- Nxjerrja e mineraleve të shoqërohet me përpunim dhe prodhim final të produkteve

Problemet që duhet urgjentisht të adresohen

- Struktura ekzistuese e prodhimit industriale e cila mbështetet në eksplotimin maksimal të resurseve natyrore, me potencial të lartë të ndotjes së mjedisit
- Emetimi i pakontrolluar i gazrave nga termocentralet që në përbërje kanë nivel të lartë të dyoksidit të karbonit, oksidit të azotit dhe pluhurit
- ndotja e ujit e cila shkaktohet për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave industriale nga termocentralet
- Deponitë e mbetjeve industriale dhe hirit të cilat kanë mbi 40 milion tonelata hi dhe zënë rreth 150 ha të tokës bujqësore
- Shpërpjesëtimet serioze midis dinamikës së eksplotimit dhe rivitalizimit të sipërfaqeve të eksploatuara
- Mungesa e një sistemi funksional të monitorimit të përhershëm të emetimit të dëmshëm në mjedis

Me vendosjen e sistemit të planifikimit afatgjatë duhet të ndikohet në shfrytëzimin racional të hapësirës. Qëllimi strategjik është ruajtja e hapësirës, mjedisit dhe harmonizimi i objektivave zhvillimore me nevojën e ruajtjes së barazpeshës mjedisore.

4.1.3.3. Ruajtja dhe mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore

Duke e ndërprerë shkallën e lartë të rrezikut nga degradimi i vazhdueshëm i tërësive urbane, arkitektonike, mjedisore dhe monumenteve të trashëgimisë së qyteteve dhe zonave specifike, duhet përcaktuar ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore si qëllim kryesor i parimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Nuk mjafton të bëhet vetëm mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, por duhet bërë edhe shfrytëzimin racional duke ruajtur funksionin e tyre, në kontekst të zhvillimit të saj.

Në kontekstin e mbrojtjes nga degradimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore janë listuar synimet dhe veprimet që duhet të ndërmirren:

Inventarizimi (data baza) i objekteve dhe tërësive në tërë territorin e Kosovës

- Duhet të bëhet inventarizimi i objekteve dhe tërësive sipas kriterëve nga MKRS;
- Të bëhet vlerësimi i objekteve dhe tërësive të inventarizuara dhe të propozohet lista për monumente të reja, që do ta kenë statusin e mbrojtjes në nivel të Kosovës;
- Kontrollimi i gjendjes së monumenteve me status të mbrojtjes, në perioda të caktuara, që do të realizohen nga organet përgjegjëse të përcaktuara nga MKRS;
- Të bëhet digjitalizimi i të gjitha monumenteve me status të mbrojtjes.
- Mbrojtja, ruajtja dhe restaurimi i detajeve origjinale arkitektonike të objekteve të rëndësishme, që kontribuojnë në ngritjen e vlerave të trashëgimisë.



Definimi i zonave historike me trashëgimi kulturore (TK)

- Hartimi i planeve rregulluese për zonat me TK, planeve për konservim dhe menaxhim të zonave me trashëgimi kulturore;
- Kontrollimi i zhvillimeve do të bëhet me anë të planeve rregulluese.
- Ndërtimet moderne nuk duhet të kenë ndikime përçarëse, komerciale dhe uniforme, por ato duhet të inkorporohen, harmonizohen me të vjetrën dhe t'a pasurojnë edhe më shumë trashëgiminë kulturore;

Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore (TK)

- Inkorporimi i TK dhe TN në planprogramet shkollore;
- Specializimi i kuadrove në sfera të caktuara për trashëgimi kulturore;
- Aftësimi i ciceronëve për TK dhe TN në nivel lokal dhe qendror;
- Shenjëzimi i të gjitha monumenteve dhe tërësive të mbrojtura të TK dhe TN;
- Prgatitja e hartave, broshurave, fletëpalosjeve etj. për monumente dhe tërësi të TK dhe TN;

Bashkëpunimi ndërshtetëror në sferën mbrojtjes së TK

- Konkurrimi në fonde ndërkombëtare me projekte që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm në aspekt të mbrojtjes së TK;
- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (European Landscape Convention, Convention for the protection of the Archaeological Heritage of Europe-Granada Convention 1985, European Convention on Protection of the Archaeological Heritage - Valletta 1992, etj.)

Bashkëpunimi ndërinstytucional i nivelit qendror dhe lokal

- Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rëndësinë dhe rolin e TK, përmes politikave zhvillimore, që do të jenë bazë për arritjen e qëllimit tonë që është mbrojtja e TK nga degradimi i vazhdueshëm.
- Realizimi i projekteve të përbashkëta duke i harmonizuar detyrat dhe obligimet që dalin nga institucionet e veçanta;
- Respektimi i hierarkisë ndërinstytucionale, gjithmonë me përmbushjen e kërkesave me qëllim të zhvillimit të planifikuar dhe të qëndrueshëm.

Turizmi kulturor si faktor i zhvillimit ekonomik të vendit

- Të bëhet përfshirja funksionale e këtyre zonave, mundësimi i qasjes së lirë të vizitorëve, preferohet të bëhet jetësimi i tyre, përmes ndërrim destinimit p.sh. restoran, shitore me punime artizanale, muze, galeri, ekspozita etj. pra, në funksion të zhvillimit të turizmit;
- Ofrim i lehtësimeve të pronarëve të objekteve me TK, përmes stimulimeve në kontekst të mbrojtjes së TK dhe TN;



4.1.4. ZHVILLIMI DHE INTEGRIMI I INFRASTRUKTURËS DHE KOMUNIKIMIT

Qasje sa më e lehtë në rrugët urbane dhe rajonale, korridoret kryesore rrugore brenda Kosovës të cilat lidhin Kosovën me rajonin, qasje në shërbimin e transportit publik, furnizim të pandërprerë me energji elektrike, qasje në rrjetin e ujësjellësve, kanalizimeve, telefonisë fikse dhe Internetit.

Kosova gjendet e rrethuar nga korridoret rrugore që e lidhin këtë pjesë të rajonit me pjesët tjera të Evropës. Synimi ynë është që Kosova të lidhet dhe të bëhet pjesë e këtij rrjeti. Ky synim dhe përforsimi i rrjetit të brendshëm të trafikut që nënkupton qasje për të gjithë, shprehin përcaktimin dhe qëllimet kryesore të planit lidhur me zhvillimin e infrastrukturës.

Ndryshimet që po ndodhin në ekonomi, ndikojnë në të gjithë sektorët duke e përfshirë edhe sektorin e transportit dhe telekomunikimit. Ato shprehen në forma të ndryshme nga të cilat më e theksuara është:

- Kërkesa për një qarkullim më të shpejtë të njerëzve, mallrave dhe informacioneve që nënkupton:
 - ndërtimin e qarkoreve për qendrat e mëdha
 - zgjerimin e akseve kryesore dhe ngritja e nivelit të këtyre rrugëve
 - ndërtimin e rrugëve të reja që do të lidhin zonat kufitare në pjesën veriore dhe verilindore të Kosovës
 - shkarkimin e trafikut të panevojshëm nga zonat e banimit
 - ngritjen e kualitetit të transportit publik brenda qyteteve dhe atij ndërrurban
 - sanimin dhe ndërtimin e linjave të reja hekurudhore duke promovuar transportin hekurudhor si transportin më të volitshëm
 - përforsimin dhe përhapjen e linjave të telekomunikimit
- Për nivelin jashtëm, përpjekja dhe synim kryesor është:
 - lidhja e Kosovës me Detin Adriatik përmes porteve Durrës dhe Shën Gjini, përkatësisht ndërtimi i autostradës Merdare-Durrës dhe si alternativa dhe ndërtimi rrugës Gjakovë - Shën Gjini (korridori “Adriatik Alpe”)
 - lidhja e rrjetit të brendshëm me: Korridorin VIII dhe Korridorin X, Magjistralen e Adriatikut dhe
 - Zgjerimi i rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike me vendet fqinje



► Përforsim i rrjetit të brendshëm për të mundësuar qasje për të gjithë dhe lidhje e Kosovës me rrjetin e rajonit dhe Evropës



Qëllimi kryesor është integrimi i infrastrukturës dhe komunikimit në Kosovë me ato në rajon dhe Evropë. Ky qëllim është pjesë e vizionit për Kosovën dhe shprehë përpjekjet me të cilat do të arrihet:


- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë
- Përmirësimi i rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme
- Shërbime publike cilësore
- Lidhje me korridoret rrugore evropiane
- Bashkëpunim rajonal në zhvillimin e infrastrukturës
- Llojlojshmëri dhe cilësi e lartë e telekomunikacionit

Strategjia e propozuar, pjesa e infrastrukturës dhe lidhjeve është bazuar në synimet dhe projektet zhvillimore të sektorëve të ndryshëm të Qeverisë dhe rekomandimet e dalura në takimet me grupet ndërmministrorë dhe takimet e shpeshta publike. Kjo strategji bazohet në këto projekte:

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonat rurale dhe brezin kufitar ku si prioritetë janë:
 - Asfaltimi i rrugës në relacionin Deçan - Kozhner - kufiri me Malin e Zi
 - Ndërtimi i rrugës që lidhë drejtpërdrejt Kamenicën me Podujevën
 - Ndërtimi i rrugës në relacionin Prizren - kufiri me Maqedoninë
 - Ndërtimi i rrugës që lidhë Albanikun(Leposaviqin) me rrugën rajonale R126
- Zgjerimi i rrugëve M2 (nga Prishtina deri në Mitrovicë), M9, M22.3, M25.2, M25.3, R107, R101 dhe M9.1
- Ndërtimi i autostradës Merdar - Vërmicë
- Ndërtimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit
- Ndërtimi i unazës së Prishtinës
- Përmirësimi i stacioneve të autobusëve
- Ndërtimi i hekurudhave në relacionet Prizren - Vërmicë; Ferizaj - Gjilan, Ratkoc - Gjakovë dhe Pejë - tuneli i Çakorit (Mali i Zi)
- Aktivizimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve mobile hekurudhore;
- Ndërtimi i terminalit të transportit integral në Fushë Kosovë
- Zhvillimi i stacioneve hekurudhore e posaçërisht e stacioneve Prishtinë, F.Kosovë, Podujevë, Livadhi, Mitrovicë, Leshak, Drenas, Klinë, Pejë, Ferizaj, Kaçanik, H.Elezit, Prizren dhe ndërtimi i stacioneve të reja në Gjilan dhe Gjakovë
- Rritja e kapacitetit, modernizimi, ngritja e kodit referent dhe kategorisë për aterrim të aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës
- Avancimi i aeroportit të Gjakovës në aeroport civil
- Ndërtimi i termocentraleve të reja në afërsi të Kastriotit (ish Obiliqi)
- Ndërtimi i hidrocentralit në Zhur
- Ndërtimi i minihidrocentraleve në bazë të studimit të fizibilitetit për ndërtimin e tyre
- Hapja e minierës së re të lignitit në Sibovc, komuna e Kastriotit
- Ndërtimi i largpërçuesit 400 kV që lidhë Kosovën me Shqipërinë
- Përforcimi i rrjetit të bartjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike - ndërtimi i unazës së linjave 400 kV të bartjes me 4 nënstacione kryesore 400/110 kV (TC Kosova B, Peja, Prizren dhe Ferizaj) dhe lidhjet direkte nga këto nënstacione me sistemet elektrike të vendeve fqinj
- Kalimi suksesiv nga sistemi elektroenergjetik 110/35/10 kV në sistemin 110/20 kV
- Fillimisht furnizimi i Prishtinës me energji termike të kogjeneruar nga termocentrali Kosova B e më vonë furnizimi i Mitrovicës, Ferizajt, Vushtrrisë, Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit;
- Ndërtimi i rezervuarëve për karburantet e lëngët me kapacitet për furnizim 90 ditor
- Instalimi i gypave të gazsjellësit përgjatë rrugëve magjistrale që lidhin shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës dhe disa qendra më të vogla dhe lidhja e tyre me rrjetet e gazsjellësve të Serbisë dhe Maqedonisë; furnizimi në pesë faza :
 - Faza e parë - furnizimi me gaz natyror i Prishtinës ose nga IRJM ose nga Serbia
 - Faza e dytë - furnizimi i Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit
 - Faza e tretë - formimi i harkut ndërmjet Unionit Serbi e Mali i Zi dhe IRJM
 - Faza e katërt - furnizimi i Gjakovës dhe Vushtrrisë
 - Faza e pestë - furnizimi i Dardanës (Kamenicës) dhe Besianës (Podujevës)



- Ndërtimi i akumulacioneve ujore të Dragaqinës, komuna e Suharekës, të Kremenatës, komuna e Dardanës (ish Kamenica), të Ponošecit dhe Ripajës, komuna e Gjakovës, të Bisticës dhe Vaganicës, komuna e Mitrovicës, të Pollatës dhe Majancit, komuna e Besianës (ish Podujeva), të Cecelisë dhe Miroqit, komuna e Vushtrrisë, të Drelajve dhe Kërstovcit, komuna e Pejës, të Movës, komuna e Skënderajt, të Dobroshevcit, komuna e Drenasit, të Makovcit, komuna e Prishtinës, të Shtimes, të Reçanit, komuna e Prizrenit, të Firajës, komuna e Shtërpces dhe të Binaqit, komuna e Vitisë
- Ndërtimi i unazës së kabllave optik
- Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës komutuese
- Zgjerimi i rrjetit nacional të transmetimit mikrovalor SDH
- Mbulimi i tërë territorit të populluar të Kosovës me rrjetin e telefonisë mobile
- Zgjerimi i rrjetit të Internetit (dial-up dhe rrjeti pa tela)



MJEDESIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Prioritetet e mësipërme mundësojnë arritjen e qëllimeve kryesore të listuara më lartë. Një pjesë e tyre kanë rolë të veçantë dhe japin rezultate më të shpejta. Një pjesë e tyre mundëson lidhjen e vendit tonë me rajonin dhe Evropën, ndërkohë që pjesa tjetër mundëson përmirësimin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Ndërkaq, prioritet tjera kanë ndikim të drejtpërdrejt në arritjen e llojllojshmërisë dhe cilësisë së lartë të telekomunikimeve.

Prioritetet zhvillimore të sektorëve të ndryshëm të qeverisë që janë pjesë e strategjisë për zhvillimin e infrastrukturës fizike, realizimi i tyre ndikon në zbutjen e njërit prej problemeve më të mëdha - papunësisë.

Ndërtimi i rrugëve dhe lidhjeve të reja mundëson dhe krijon kushte që shërbimet të ngriten në nivel më të lartë duke ndikuar në këtë mënyrë në ndalimin e shpërnguljen e panevojshme të popullatës në kërkim të kushteve më të mira.

Ngritja dhe zhvillimi i rrjetit të hekurudhës si njëri ndër transportet më të lira do të mundësojë lidhjen qendrave të mëdha të Kosovës dhe do të ofrojë kushte më të mira të



shkëmbimit të mallrave brenda dhe jashtë vendit. Në këtë mënyrë, do të krijohen kushte më të mira dhe do të shkarkohet transporti dhe qarkullimi rrugor.

Me ndërtime e autostradës krijohen mundësi të reja të punësimit dhe të krijimit të të hyrave nga taksat e shfrytëzimit që në mënyrë direkte do të ndihmonin në zhvillimin e rrjetit të rrugëve në përgjithësi në Kosovë.

Vënia në funksion dhe shtimi i linjave të reja në rrjetin e hekurudhës, gjithashtu rritë mundësitë për punësimi dhe krijimit të të hyrave për zhvillim në përgjithësi.

Ngritja e kapaciteteve të reja energjetike është një mundësi tjetër e zhvillimit e cila siguron një mjedis më të favorshëm dhe të sigurt për investime dhe ngritje të kapaciteteve të reja ekonomike.

4.2. VLERËSIMI I STRATEGJISË

Strategjia është testuar përballë skenarit të trendit apo të ashtuquajturës ”*strategji e mosbërjes gjë*”. Testimi apo vlerësimi është realizuar duke përdorë matricën e arritjes së qëllimeve. Kjo e ashtuquajtur strategji do të thotë të lejohet që zhvillimet e ardhshme në hapësirën e Kosovës të bëhen sipas trendit të tanishëm pa i planifikuar ato. Testimi i skenarit të trendit ka rezultuar me përfundimin se nëse ky skenar do të jetësohej, gjendja e përgjithshme hapësinore do të përkeqësohej edhe më tepër.

Në mungesë të planifikimit për një shfrytëzim më racional të hapësirës, vendbanimet/ qytetet e mëdha do të vazhdonin trendin e rritjes së tyre. Me këtë do të rritej edhe sipërfaqja e territorit joformal. Kjo gjendje do të rezultojë me koston e lartë të investimeve në infrastrukturë dhe shërbime, dhe nuk do të shfrytëzonte as minimumin e mundësisë së veprimit sinergjik. Trendi i migrimit drejt qendrave të mëdha do të vazhdojë, ndërsa hapësira për banim me qasje të lehtë dhe kushte të volitshme nuk do të kishte fare. Qendrat e mëdha do të vazhdonin zhvillimin e vet në kushte të ekonomisë së tregut duke vendosur më tepër kriteret e mbijetesës se sa të promovojnë një zhvillim komplementar. Prishtina, për shkak të funksionit si qendër administrative dhe universitare, do të grumbullonte veprimtaritë kryesore ekonomike dhe sociale, që në njërin anë i ofron pozitë më të volitshme në tregun rajonal mirëpo, në kontekstin Kosovar ajo do të kishte pasoja të zhvillimit të pabarabartë socio ekonomik në raport me pjesët tjera të territorit të vendit. Në këtë mënyrë do të arrinim në një situatë të depopullimit të zonave rurale, dhe qendrave më të vogla urbane, gjë që do të shkaktonte tensione sociale dhe ndante Kosovën në dy rajone, atë të gjallë dhe atë me shenja të shprehura të periferialitetit në zhvillim.

Në rast se nuk do të ndërmerrej asnjë veprim, duke u bazuar vetëm në faktin se legjislati në fuqi nuk do të zbatohet, mund të parashikohen lëvizje të mëdha në aspektin e reformimit të administratës. Mirëpo ajo që është më brengosëse në këtë rast është parashikimi i humbjes së pakthyeshme të resurseve natyrore, pikërisht për shkak të mungesës së strategjisë efektive për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e tyre të qëndrueshëm. Pyjet, toka kualitative bujqësore, minierat, uji dhe vlerat e krijuara të karakterit të trashëgimisë do të degradoheshin dhe sillleshin në kufijtë kritik të funksionimit dhe shfrytëzimit të tyre.

Vazhdimi i trendit të njëjtë do të kishte pasoja negative në disa aspekte:

- Mos kycja e Kosovës në rrjetin e infrastrukturës rajonale ndikon në koston më të lartë transportit civil dhe mallrave.
- Qasja e vështirësuar në vendbanime do të ndikon në stagnimin e gjithmbarshëm ekonomik të vendit.
- Ngushtimi i arterieve kryesore do të pengon lëvizjen normale brenda territorit,
- Mungesa e shërbimeve themelore - (infrastrukturës fizike dhe sociale) në vendbanime do të nxis lëvizjen e popullatës drejt qyteteve të mëdha dhe Prishtinës.

Dhe si pasojë, e tërë kjo, do të ndikojë në prezantimin joadekuat të Kosovës karshi rajonit dhe Evropës, do të ndikoj në krijimin e klimës jo të favorshme për investitorët e mundshëm për të cilët momentalisht, vendi ynë ka shumë nevojë.





5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Dispozitat për zbatim paraqesin kushtet që duhet të plotësohen për zbatimin e Planit Hapësinor të Kosovës.

Dispozitat e përgjithshme

- Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokumenti kryesor për sistemin e planifikimit në Kosovë;
- Të gjitha dokumentet tjera që për bazë kanë hapësirën dhe ndikimin në të, duhet të përputhen dhe ti nënshtrohen udhëzimeve që dalin nga PHK;
- Dokumenti i PHK-së mbulon periudhën prej së paku dhjetë vitesh, duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi.
- Rishikimi dhe Revidimi eventual i dokumentit duhet të bëhet në periudhën prej pesë vitesh. Në raste të veçanta revidimi mund të bëhet edhe sipas nevojës.
- Përgjegjës për rishikim dhe revidim është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjegjësisht Instituti për Planifikim Hapësinor;
- Ky dokument hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës;

5.1. Kushtet e ndarjes së hapësirës sipas karakteristikave të shfrytëzimit dhe destinimit

- Hapësirat me destinime të caktuara duhet t'i plotësojnë kushtet e mbrojtjes së mjedisit, ngritjes së kualitetit të jetesës dhe mosrrezikimit të shëndetit të popullatës, shfrytëzimit racional të territorit dhe të resurseve natyrore;
- Hapësirat për banim, për sport dhe rekreacion nuk mund të jenë pranë kapaciteteve industriale;
- Hapësirat për banim dhe për të gjitha destinimet tjera, me përjashtim të bujqësisë, nuk mund të jenë në tokat bujqësore të kategorive I deri IV;
- Hapësirat për banim dhe për të gjitha destinimet tjera nuk mund të jenë në zonat e mbrojtura të natyrës. Këtu bëjnë përjashtim disa hapësira të limituara për banim të përkohshëm, për rekreacion dhe aktivitete të limituara sportive;
- Hapësirat për banim dhe për të gjitha destinimet tjera nuk mund të jenë në territoret për të cilët është planifikuar të mbushen me ujë për krijimin e liqeneve;
- Hapësirat për banim dhe për të gjitha destinimet tjera nuk mund të jenë në territoret ku është konstatuar se ka pasuri të konsiderueshme nëntokësore. Këtu bëjnë përjashtim hapësirat e destinuar për industrinë e cila do t'i eksploatojë dhe përdorë ato pasuri;

5.2. Kushtet e caktimit të hapësirës për objektet me rëndësi për Kosovën

- Në shumë raste hapësirat ku do të ndërtohen objekte me rëndësi për Kosovën caktohen nga potencialet për zhvillim dhe nga faktorët ekzistues natyror në ato hapësira.
- Të gjitha objektet me rëndësi shtetërore duhet ti nënshtrohen procesit të hulumtimit i cili përfundon me arsyeshmëri për ndërtimin e objektit përkatës.

- Termocentrali do të ndërtohet në një hapësirë për të cilën hulumtimi ka treguar se është e pasur me thëngjill i cili mund të eksploatohet për një kohë të gjatë.
- Rreth hapësirës në të cilën ndodhet termocentrali duhet të caktohet hapësira apo brezi i gjelbër që ka për qëllim ta mbrojtë mjedisin nga ndikimi i dëmshëm i termocentralit.
- Gjatë caktimit të hapësirave ku do të ndërtohen rrugët e rëndësishme (autoudhët, rrugët nacionale) për Kosovën, duhet t'i iket sa më shumë që është e mundur hapësirave ku janë tokat bujqësore të kategorive I deri IV dhe atyre me pasuri nëntokësore. Nuk lejohet që rrugët e rëndësishme të ndërtohen në hapësirat me pasuri të konsiderueshme nëntokësore që janë vitale për Kosovën, në parqe nacionale, në zonat e veçanta të mbrojtura, në zonat strikte etj.
- Në të dyja anët e autoudhëve duhet të caktohen hapësirat mbrojtëse, brezat e gjelbër që kanë për qëllim ta mbrojnë mjedisin nga zhurma dhe gazrat që emitojnë automjetet.
- Ndalohet ndërtimi i objekteve të forta, të përhershme në hapësirat ku në të ardhmen do të ndërtohen objekte me rëndësi për Kosovën.
- Objektet me rëndësi të veçantë lejohen të ndërtohen në rastet kur këtë e lejojnë faktorët ekzistues natyror. Përparësi kanë hapësirat (lokacionet) ku ekziston infrastruktura si: qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, telekomunikacioni, ujësjellësi, kanalizimi etj.

5.3. Kushtet e vendosjes së veprimtarive ekonomike në hapësirë

- Veprimtaritë ekonomike duhet të plotësojnë të gjitha standardet e mbrojtjes së mjedisit;
- Hapësirat pranë zonave ekzistuese të banimit nuk mund të destinohen për industri e cila nuk i plotëson standardet;
- Hapësirat pranë zonave ekzistuese turistike nuk mund të destinohen për industri ndotëse përtej normave të lejuara;
- Hapësirat që destinohen për veprimtari tregtare - furnizim të popullatës me mallra të konsumit të përditshëm dhe të gjerë, duhet të jenë brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre;
- Zgjerimi i zonave ekzistuese të industrisë dhe biznesit do të lejohet vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për t'u alokuar;
- Realizimi i parqeve eventuale të biznesit duhet të bazohet në kriteret në vijim:
 - Qasje të mirë në korridoret rrugore - jo përmes vendbanimeve,
 - Disponueshmëria e tokës me çmim të ulët,
 - Minimizimi i ndikimeve të dëmshme në vendbanim dhe peizazh,
 - Potenciali për zhvillim, toka, infrastruktura përkatëse (kanalizimi, uji, rryma, komunikimet, ngrohja),
 - Maksimumi i indeksit të shfrytëzimit të ngastrës nuk duhet të tejkalojë 45% të ngastrës dhe së paku 20% e sipërfaqes duhet të jetë gjelbërim;
- Komplekset spitalore duhet të vendosen në hapësirat e pastra që nuk u janë ekspozuar llojeve të ndryshme të ndotjes;
- Objektet e institucioneve parashkollore dhe ato të arsimit fillor duhet të vendosen brenda hapësirave të destinuara për banim ose fare pranë tyre. Hapësirat duhet të rregullohen me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Institucionet parashkollore 20 - 40 m²/fëmijë
 - b) Shkollat fillore 20 - 50 m²/fëmijë
- Zonat e destinuara për sport dhe rekreacion duhet të jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë pajisje sportive rekreative. Maksimumi i indeksit të zënies së ngastrës nuk guxon të kalojë standardet e caktuara për këto qëllime.
- Të gjitha veprimtaritë publike duhet të plotësojnë edhe kërkesat për personat me aftësi të kufizuara fizike të parapara me norma dhe standarde ndërkombëtare;

5.4. Kushtet për caktimin e zonave ndërtimore

- Nuk lejohen zona ndërtimore në tokat bujqësore të kategorive I deri IV;

- Zonat ndërtimore në hapësirat e mbrojtura të natyrës (parqe nacionale, parqe rajonale, parqe natyrore etj.) përcaktohen me planet hapësinore dhe planet rregulluese për këto hapësira;
- Nuk lejohen zona ndërtimore në hapësirat me pasuri të konsiderueshme nëntokësore që janë vitale për Kosovën;
- Nuk lejohen zona ndërtimore në hapësirat ku me planet hapësinore është paraparë krijimi i liqeneve artificiale;
- Nuk lejohen zona ndërtimore në të cilët me plane hapësinore është paraparë ndërtimi i rrugëve si: autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rrugëve regjionale;
- Në mënyrë që të caktohen si zona ndërtimore, përparësi kanë hapësirat pranë të cilave ekziston infrastruktura e domosdoshme teknike si qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, telekomunikacioni, ujësjellësi dhe kanalizimi. Nëse nuk ekziston infrastruktura në afërsi, është e domosdoshme që para se një zonë të destinohet për ndërtim, të ndërtohet infrastruktura.
- Në zonat ndërtimore ndërtimi duhet të bëhet sipas parametrave urbanistik, arkitektonik dhe teknik që caktohen me planet rregulluese urbane dhe projektet arkitektonike të ndërtesave.
- Asnjë ndërtim nuk mund të fillojë në zonat ndërtimore pa u pajisur paraprakisht me lejen urbanistike dhe lejen e ndërtimit. Për objektet që kanë rëndësi të veçantë për Kosovën si: ndërtimet e ndërlidhjeve dhe telekomunikimit, objektet energjetike, objektet hidroteknike objektet industriale dhe objektet për qëllime të veçanta, lejet ndërtimore i lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërkaq për objektet tjera, lejet ndërtimore i lëshojnë komunat në territoret e të cilave realizohet ndërtimi.

5.5. Kushtet (funktionale, hapësinore, ekologjike) e përcaktimit të sistemeve të komunikimit dhe infrastrukturës tjetër në hapësirë

- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në sipërfaqet në të cilat ky plan hapësinor e parasheh ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike (autoudhëve, nacionale, regjionale dhe lokale) dhe në sipërfaqet e brezave mbrojtës të këtyre rrugëve;
- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në sipërfaqet e brezave mbrojtës të rrugëve ekzistuese (autoudhëve, nacionale, regjionale dhe lokale);
- Brezi mbrojtës rrugor paraqet sipërfaqen në të dy anët e autoudhëve, rrugëve nacionale, regjionale dhe lokale. Gjerësia e këtij brezi në rrugët nacionale, regjionale dhe lokale është përcaktuar me Ligjin Nr. 2003/11 - Ligjin për Rrugët;
- Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) është kompetente për autoudhët, rrugët nacionale dhe regjionale, prandaj ndërtimi i këtyre rrugëve realizohet me lejen dhe nën mbikëqyrjen e kësaj ministrie;
- Qeveritë komunale janë kompetente për rrugët lokale në territoret e komunave të tyre, prandaj ndërtimi i këtyre rrugëve realizohet nën mbikëqyrjen e organeve kompetente komunale;
- Gjatë ndërtimit të autoudhëve, rrugëve nacionale, rrugëve regjionale dhe atyre lokale, duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjerësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre dhe standarde tjera) për ndërtimin e tyre, të parapara me ligjet dhe rregullat në fuqi.
- Gjatë ndërtimit të hekurudhave, poashtu duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e tyre;
- Të gjitha kyqjet e reja në rrugë duhet të bëhen me leje paraprake të lëshuar nga MTPT;
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër autoudhët, rrugët nacionale, rrugët regjionale dhe ato lokale duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta të nxjerra nga MTPT;
- Transportin publik të udhëtarëve mund ta realizojnë vetëm operatorët e licencuar të transportit. Licencimi bëhet nga MTPT;
- Në mënyrë që transporti i udhëtarëve të jetë sa më i sigurt, automjetet transportues duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike të përcaktuara nga MTPT;
- Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e tyre;
- Numrin e parkingjeve dhe vendin e tyre të saktë në hapësirë e përcakton plani rregullativ për zonën e caktuar:
 - a) Shërbime - 1 vendparkim (VP) për 3 të punësuar;

- b) Restorante - 1 VP për 1 tavolinë;
- c) Hotele - 1 VP për 1 dhomë;
- d) Zyre - 1 VP në 75m² btto zone;
- e) Dyqane - 1 VP në 50m² btto zone
- Ndërmarrjet ndërtimore nuk mund të fillojnë ndërtimin e terminalit të transportit integral në Fushë Kosovë dhe ndërtimet në funksion të rritjes së kapacitetit të aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës dhe aeroportit të Gjakovës pa lejet ndërtimore që i lëshon MTPT;
- Nuk mund të fillojë ndërtimi i termocentraleve të reja pa pasur paraprakisht studimin e fizibilitetit dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS);
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, rrjetave të reja bartëse dhe distribuive të gazit, linjave të reja direkte elektro-energjetike dhe linjave gypore direkte për transitin e gazit natyral, bazohet në procedurat e autorizimit ose procedurat e tenderimit, pas të cilave ndërmarrja e energjisë, fituese e tenderit, do të pajiset nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me lejen e ndërtimit dhe me licencën që nevojitet për kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
- Ndërmarrjet e energjisë që do t'i kryejnë punët e distribuimit dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike, energji termike (ngrohje) ose gaz natyror duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE;
- Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të distribuimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror duhet të kryhen në përputhshmëri të plotë me kodet teknik që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë dhe të cilët i miraton ZRRE.
- Ndërtimi i pendave për formimin e liqeneve nuk mund të fillojë pa pasur paraprakisht studimin me të cilin do të: arsyetohet ai ndërtim, argumentohet se ndërtimi i tij është i leverdishëm dhe caktohen lokacionet e ndërtimit;
- Për ndërtimin e pendës së lartpërmendur në territorin e një komune, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Pendat projektohen, ndërtohen dhe shfrytëzohen sipas dokumentacionit të paraparë teknik, të hartuar në pajtim me aktin nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
- Nëse studimi e arsyeton ndërtimin e pendës, lokacioni ku do të formohet liqeni, duhet të ruhet për këtë qëllim që do të thotë se duhet të ndalohet çfarëdo ndërtimi në të;
- Për ndërtimin e sistemeve publik të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe të kolektorëve që mbledhin këto ujëra, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Operatori i telefonisë mobile nuk mund të fillojë veprimtarinë e vet (fillimisht vendosja e antenave dhe pastaj shërbimet e telefonisë) pa pasur licencën për këtë, të cilën e lëshon Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART);
- Përveç licencës që merret nga ART, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MMPH. Nuk lejohet vendosja e antenave në rezervatat strikte të natyrës;
- Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në Park dhe në vendbanimet rreth tij, ofruesi i shërbimeve të telefonisë fikse (kompania publike apo private) duhet të jetë i pajisur me licencë nga ART dhe pëlqim paraprak nga autoriteti i Parkut;
- Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në Park dhe në vendbanimet rreth tij, operatori i shërbimeve postare duhet të jetë i pajisur me licencë nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT);
- Të drejtën për ndërtimin e deponisë së mbeturinave dhe për administrimin me mbeturinat në Park dhe në vendbanimet rreth tij, e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me licencë nga MMPH;
- Me rastin e zgjedhjes së lokacionit ku do të ndërtohet deponia e mbeturinave duhet të përmbushen kriteret për zgjedhjen e lokacionit që janë përcaktuar me Ligj.

5.6. Masat e ruajtjes së peizazheve

- Komunat në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) duhet të hartojnë plane rregulluese për zona të caktuara në mënyrë që t'i mbrojnë vlerat e dëshmuara peizazhore të atyre zonave.

5.7. Masat e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

- Planifikimi urban/hapësinor, duhet të shfrytëzohet si instrument për kontrrollin e zhvillimeve në zona me vlera kulturo-historike;
- Duhet të bëhet trajtimi i zonave të definuara në të gjitha nivelet e planifikimit;
- Zbatimi i ligjit për Planifikim hapësinor dhe ligjeve tjera si: ligji për Trashëgiminë Kuturore, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Parkun Nacional “Mali Sharr”, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës etj;
- Në zonat me lokalitete arkeologjike, ndalohet çfarëdo ndërtimi;
- Në zonat historike të qyteteve duhet të kërkohet leje (edhe nga niveli qendror) për ndonjë ndryshim apo ndërtim në këto zona;
- Aplikimi i mekanizmave ligjorë, të koordinuar, me bashkëpunim dhe pjesëmarrje të koordinuar nga niveli qendror, përmes nivelit lokal të qeverisjes deri te qytetari i thjeshtë.
- Të bëhet kompletimi i inventarizimit (bazës së të dhënave) i të gjitha objekteve dhe tërësive me vlera në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas standardeve europiane, me qëllim të sigurimit të bazës për mbrojtje të TK;
- Të bëhet rivlerësimi i monumenteve të cilat kanë status të mbrojtjes dhe të kemi një raport mbi gjendjen e tyre sot;
- Të bëhet vlerësimi i objekteve dhe tërësive të TK të inventarizuara dhe plotësimi me monumente tjera me status të mbrojtjes për Kosovën;
- Restaurimi, rikonstruimi dhe revitalizimi i objekteve dhe monumenteve të Kosovës duhet të kryhet nga persona të kualifikuar në fusha të caktuara.
- Të definohen kjartë aktivitetet e lejuara të zonave të mbrojtura të TK;
- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në rezervatet natyrore;
- Përcaktimi i bufer zonave në monumentet natyrore dhe peisazhet e mbrojtura;
- Planet hapësinore, planet rregulluese dhe planet menaxhuese i përmbajnë masat gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike të Kosovës. Për zonat e veçanta të shpallura si *zona të mbrojtura të natyrës*, planet hapësinore dhe ato menaxhuese i përpilon MMPH, kurse planet rregullative i përpilojnë komunat në territorin e të cilave gjenden ato zona.

Masat që parashihen me planet e lartpërmendur në formë të përgjithësuar janë:

- Mbrojtja e *zonave të natyrës* dhe peisazheve tjera nga ndërtimet e paligjshme;
- Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, nga insektet dëmtues dhe nga sëmundjet;
- Mbrojtja e llojeve endemike dhe të rralla të florës dhe faunës;
- Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimi i paligjshëm i zhavorrit të tyre;
- Shfrytëzimi racional i ujërave nëntokësor;
- Konsolidimi i tokave në zonat e deponive ilegale;
- Politikat komunale për gjelbërim dhe rregulloret që komunat i nxjerrin për hapësirat e gjelbërta;
- Në zonat me interes të veçantë për Kosovën dhe në zonat e veçanta të mbrojtura (të përcaktuara me Pakon e Ahtisarit) duhet të ndërmerren masa të veçanta zhvillimore. Këto masa caktohen me planet hapësinore dhe rregulluese dhe kanë të bëjnë me caktimin e një regjimi të veçantë të zhvillimit, i cili kryesisht bazohet në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

5.8. Mënyra e trajtimit të hedhurinave

- Hedhurinat duhet të: mblidhen, grumbullohen, ndahen ato që mund të riciklohen, transportohen deri tek deponitë dhe aty të deponohen;
- Punët rreth trajtimit të hedhurinave i kryejnë kompanitë publike rajonale për menaxhimin e hedhurinave si operatorë të licencuar nga MMPH;
- Hedhurinat mund të deponohen vetëm në deponitë legale - deponitë rajonale që janë në funksion;
- Komunat në bashkëpunim të ngushtë me MMPH, duhet t'i eliminojnë deponitë e egra ilegale dhe t'i konsolidojnë tokat në të cilat kanë qenë këto deponi;
- Komunat së bashku me kompanitë rajonale publike për menaxhimin e hedhurinave duhet të organizojnë ndarjen e hedhurinave në bazë të materialeve prej të cilëve përbëhen dhe riciklimin e tyre.

5.9. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Lejet për ndërtimin e kapaciteteve industriale lëshohen vetëm nëse paraprakisht investitori ofron vlerësimin e ndikimit në mjedis për kapacitetin;
- Gjatë zgjedhjes së lokacioneve për vendosjen e veprimtarive ekonomike duhet të plotësohen kushtet për vendosjen e këtyre veprimtarive (shih dispozitat 5.3.);
- Lejet për ndërtimin dhe funksionimin e kapaciteteve industriale lëshohen vetëm nëse kapacitetet aplikojnë teknologji bashkëkohore që nuk bëjnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës;
- Në vendet ku priten ndotje më të mëdha të ajrit qoftë nga kapacitetet industriale, qoftë nga veprimtaritë tjera, duhet të vendosë aparataturat për monitorimin e vazhdueshëm të ajrit;
- Kapacitetet e reja industriale duhet të përputhen me normat dhe standardet e planifikimit, duke përfshirë edhe respektimit e kahjes së erërave (trëndafili i erërave);
- Duhet të ndërtohen impiantet për pastrimin e ujërave të zeza siç e parasheh Plani Hapësinor i Kosovës;
- Kapacitetet industriale që lirojnë ujëra të ndotur industrial e që mund të ndërtohen në të ardhmen duhet t'i kenë impiantet për pastrimin e këtyre ujërave;
- Ndalohet hedhja e mbeturinave në dhe pranë lumenjve dhe liqeneve;
- Në mënyrë që të mbrohen ujërat nëntokësor nga ndotja eventuale:
 - Sistemet e kanalizimeve të ujërave të zeza duhet të ndërtohen me elemente të papërshkueshme nga uji;
 - Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit;
 - Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza;
- Deponitë ilegale ekzistuese duhet të eliminohen (shih dispozitat 5.9.), ndërkaq të rejat duhet të ndërtohen sipas standardit evropian me qëllim që të pengohet ndotja e dheut dhe e ujërave nëntokësor nga mbeturinat;
- Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga zhurma është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve rrugore dhe vendbanimeve.

5.10. Masat e zbatimit

5.10.1. Karakteri obligativ i hartimit të dokumentit të rregullimit hapësinor

- Komunat janë të obliguara me Ligjin për Planifikim Hapësinor t'i hartojnë planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregulluese urbane;
- Planet zhvillimore urbane hartohen njëkohësisht, ose pas planeve zhvillimore komunale;
- Planet rregulluese urbane hartohen së pari për zonat me përparësi. Përparësi kanë zonat ku zhvillimet e pakontrolluara hapësinore kanë marrë hov më së shumti.
- Për çfarëdo zhvillimesh hapësinore që shtrihen në sipërfaqe më të mëdha se 2 ha jashtë zonave urbane, duhet të hartohen planet rregulluese;
- Lejet ndërtimore për zhvillimet hapësinore jashtë zonave urbane mund të lëshohen sipas vendimeve me planet zhvillimore komunale;
- Planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregulluese urbane duhet të rishikohen së paku për çdo 5 vjet por rishikimi mund të bëhet edhe sipas nevojës;

5.10.2. Zonat dhe lokalitetet për hulumtime dhe përcjellja e paraqitjeve dhe proceseve në hapësirë

- Në disa nga zonat me interes të veçantë për Kosovën si në parqet nacionale e rajonale, në Trekëndëshin e Zhvillimit Ekonomik (TZHEK), në zonat me pasuri nëntokësore, në zonat me kushte natyrore për formimin e liqeneve artificiale, në zonat ku janë deponitë e mbetjeve industriale, në zonat ndërkufitare etj. duhet të bëhen hulumtime me qëllim të sigurimit të të dhënave të reja dhe të arritjes së përfundimeve për arësyeshmërinë e investimeve për zhvillime të ardhshme hapësinore në ato zona. Të dhënat janë të domosdoshme për hartimin e planeve hapësinore për këto zona.

Literatura

- Davidson, F. 1999, "Toëards sustainable urban development: A strategic approach, Consultative guidelines for Urban Development Cooperation", EC-Brussels.
- EC, CARDS assistance Programme to the Eastern Balkans 2001, "Regional Strategy Paper (2002-2006)", Brussels.
- EU pillar, PISG, Energy office, 2003, "Energy strategy and policy of Kosova - ëhite paper", Prishtina
- European Stability Initiative, 2002. "De-industrialisation and its consequences, a Kosova story", Prishtina - Berlin.
- International Monetary Fund, 2004. "Aide-Mémoire Staff Visit to Kosova March 10-19", Prishtina, Kosova.
- Kosova Government, 2004, "Kosova General Government 2004 Budget". Pristina, Kosova Government.
- KTA, 2004, "Draft Strategy of the Privatisation Department of Kosova Trust Agency," Prishtina, Kosova.
- MASHT, 2003, "Strategic plan for development of education in Kosova (2002- 2007)", Prishtina-Kosova.
- MASHT, 2004, "Strategy paper for development of higher education in Kosova (2005-2015)", Prishtina, Kosova.
- MBPZHR, 2003, „Strategy of sustainable rural and agricultural development in Kosova - Green book, Prishtina, Kosova.
- MBPZHR, 2004, „Policy documents and agricultural statistics”, Prishtina-Kosova.
- MEM, 2005, "Report of energetic sector", Prishtina, Kosova.
- MMPH, 2004, "Strategy paper of ëaste management", Prishtina, Kosova.
- MSH, 2004, "Strategy paper of health system development in Kosova (2005-2015)", Prishtina, Kosova.
- OSCE, 2000, "Assessment of number of population", Pristina, Kosova.
- EC, 1999, "European Spatial Development Principles", Brussels.
- PTK, 2004, "Annual report of PTK 2004", Prishtina, Kosova.
- RIINVEST, 2002. "Foreign Direct Investment in Kosova", Research Report, Pristina, Kosova.
- Riinvest, 2003, "Labour market and unemployment in Kosova", Research report, Prishtina, Kosova.
- Riinvest, 2003, „Strategy of local development (2003- 2006)" (Vucitrn, Kacanik, Klina, Istog, Viti, Prizren), Prishtina, Kosova.
- Riinvest, 2004, „Rural development in Kosova", Pristina, Kosova.
- Riinvest, 2005, "Socio economic profile of Kosova and development challenges", Prishtina-Kosova.
- Riinvest, 2005, „Challenges of spatial development (2004- 2015)", Prishtina, Kosova.
- SIDA, 2003, "Restructuring of railëays in Kosova"- Final report, Prishtina, Kosova.
- MMPH, 2004, "Strategy for environmental protection and sustainable development", Pristina, Kosova.
- MMPH, 2002, "Policy guidelines for housing reconstruction", Prishtina, Kosova.
- UNDP, 2002, "Human Resource Development Report", Prishtina, Kosova.
- World Bank, 2002, "Institutional support to PISG in Kosova", Prishtina, Kosova.
- World Bank, 2004. "Kosova Economic memorandum", Washington DC.

Organizimi dhe pjesëmarrësit

Bartës i procesit:
Qeveria e Kosovës

Ministria e Mjedisit
dhe Planifikimit Hapësinor -

Përgjegjës për hartimin e dokumentit
Instituti për Planifikim Hapësinor

Koordinator përgjegjës i dokumentit final:
Luan Nushi, Inxh. dipl. ark., drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor

Koordinator përgjegjës i draftit të parë:
Ilir Gjinolli, Inxh. dipl. ark., ish drejtor
Instituti për Planifikim Hapësinor

Bashkëpunëtorë përgjegjës:
F. Davidson - ekspert - Strategji Zhvillimore,
IHS-Rotterdam
A. Sallova - arkitekt - Planer - UN Habitat

Përgjegjësit e fushave tematike:

Demografi dhe zhvillim social

Luan Nushi, Inxh. dipl. ark.,
Planer profesional

Luljeta Orana, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Hylkije Gollopeni, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Hazer Dana, prof. i gjeografisë,
Hulumtues profesional

Besim Avdyli, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Besim Gollopeni, prof. i sociologjisë
Sociolog-planer

Zhvillim ekonomik

Elvida Pallaska, MA Menaxh. dhe Zhvillim Urban
Planer profesional

Zana Mehmeti, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Veton Maloku, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Gëzime Grajqevci, inxh. dipl. ark.
Planer profesional

Bashkëpunëtorë:

B.Qerkini, Ecc i dipl
Planer - UN habitat

Xh.Gashi, Ecc i dipl
Planer - UN habitat

Infrastrukturë

Arbën Rrecaj, Inxh. dipl. ark.,
Planer profesional

Lendita Ajeti, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Mimoza Kallaba, prof. i gjeografisë
Hulumtues profesional

Gazmend Muhaxheri, Inxh. dipl. ndërt.,
Planer profesional

Ramush Hajdaraj, Inxh. dipl. ndërt.,
Planer profesional

Mjedis dhe shfrytëzim i tokës

Faton Deva, Inxh. dipl. ark.,
Planer profesional

Festa Nela, Inxh. dipl. ark.,
Hulumtues profesional

Shpend Agaj, Prof. I gjeografisë,
Hulumtues profesional

Nexhmije Kamberi, Prof. I biologjisë,
Hulumtues profesional

GIS - përgatitje teknike

Bekim Kajtazi, arkitekt,
GIS ekspert

Ismail Gagica, prof. i gjeografisë,
GIS ekspert

Rizah Murseli, prof. i gjeografisë
GIS ekspert

Bashkëpunëtorë:

A.Zhuri, Inxh. i dipl. i bujqësisë
GIS ekspert - UN Habitat

Informimi dhe komunikimi

Bekir Bozhdaraj, FF- gjermane
Zyrtar për informim dhe komunikim

Bashkëpunëtor:

Flamur Abrashi
Përkthyes profesional-UN Habitat

Përkrahja nga Dep. i planifikimit hapësinor

H. Zhuri, Inxh. dipl. ark.,

L. Gashi, MA menaxh. dhe zhv. Urban;

S. Goranci, Inxh. dipl. ark.,

Y. Vokshi, Inxh. dipl. ark.,

A. Elshani, ecc i dipl.

V. Puka, Inxh. dipl. ark.

Përkrahja nga ekspertë të pavarur

Asllan Pushka; Kolë Staka; Vahdet Pruthi;
Sali Spahiu; Luljeta Sokoli; Esat Hoxha;
Burhan Kavaja; Shefqet Abazi; Xhevdet
Elezi; Flamur Doli;

Institucionet përkrahëse

UN Habitat - Kosovë

**IHS - Instituti për Banim dhe Studime
Urbane - Rotterdam**

**RIINVEST - Instituti për Hulumtime
Zhvillimore - Kosovë**

Universiteti i Prishtinës,

ICO - Zura Civile Ndërkombëtare

**Ministria e mjedisit dhe planifikimit
hapësinor**

Departamenti i planifikimit hapësinor,
Departamenti i mbrojtjes së mjedisit,
Departamenti i ujërave,
Departamenti i banimit dhe ndërtimit,
Instituti hidrometeorologjik
Instituti për mbrojtjen e natyrës,

**Ministria e arsimit, shkencës dhe
teknologjisë**

Departamenti i arsimit

Ministria e bujqësisë dhe zhvillimit rural

Agjencioni i pyjeve të Kosovës
Zyra e politikës dhe statistikës
Departamenti i prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve
Departamenti i zhvillimit rural

Ministria e ekonomisë dhe financave,

Departamenti i buxhetit

Ministria e energjetikës dhe minierave

Departamenti i strategjisë dhe zhvillimit
Departamenti i energjisë

**Ministria e kulturës, rinisë, sportit dhe
çështjeve jo rezidente**

Departamenti i sportit,
Departamenti i trashëgimisë kulturore,

Ministria e punës dhe mbrojtjes sociale

Instituti i politikave sociale

Ministria e shërbimeve publike

Agjencioni kadastral i Kosovës
Departamenti i shërbimeve dhe menaxhimit të
ndërtesave

**Ministria e transportit dhe post
telekomunikacionit**

Departamenti i ICT
Departamenti i transportit dhe shërbimeve publike
Departamenti i transportit të aviacionit civil,
hekurudhor dhe detar
Departamenti i infrastrukturës rrugore

Ministria e tregtisë dhe industrisë

Departamenti i veprimtarive shërbyese
Departamenti i zhvillimit të sektorit privat dhe
investimeve
Departamenti i turizmit

Ministria e shëndetësisë,

Agjencioni Kosovar për Shëndetësi

Përgatitja grafike:

Instituti për Planifikim Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Dokument i përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor
në bashkëpunim me sektorët tjerë të Qeverisë së Kosovës.

Prishtinë, Qershor 2010.